

# Përgatitja dhe Zbatimi i një Strategjie MIBU

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar  
të Burimeve Ujore

16 qershor 2017



“Skënderbej” Street  
Building no.6  
Entrance no.2  
Apartment no. 11  
Tirana  
Albania

T +355 4454 0772

mottmac.com

# **Përgatitja dhe Zbatimi i një Strategjie MIBU**

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar  
të Burimeve Ujore

16 qershor 2017



# Të dhëna rreth botimit dhe rishikimeve

Rishikimet	Data	Autor	Kontrollues	Miratues	Përshkrimi
1.00	21.12.2017	Ekipi i projektit	Mircea Vasilescu	Wim Verheugt	Versioni Përfundimtar
2.00	16.06.2017	Ekipi i projektit	Monica Melinte Halit Kamberi	Wim Verheugt	Versioni Përfundimtar i Përditësuar

## Kategori Informacioni: Standarde

Ky dokument është hartuar për palën porositese dhe për qëllime të veçanta të lidhura vetëm me projektin e lart përmëndur. Nuk duhet shfrytëzuar nga asnjë palë tjetër ose të përdoret për ndonjë qëllim tjetër.

Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për pasojat ne se ky dokument përdoret nga palët e tjera, për ndonjë qëllim ose ne se përmban ndonjë gabim ose mungesë e cila mund të jetë për shkak të një gabimi apo mungese në të dhënat e marra nga ne nëpërmjet palëve të tjera.

Ky dokument përmban informacion konfidencial dhe pronësi intelektuale të autorit. Nuk duhet t'i tregohet palëve të tjera pa miratimin nga ne dhe nga pala porositëse.

## Information class: Standard

This document is issued for the party which commissioned it and for specific purposes connected with the above-captioned project only. It should not be relied upon by any other party or used for any other purpose.

We accept no responsibility for the consequences of this document being relied upon by any other party, or being used for any other purpose, or containing any error or omission which is due to an error or omission in data supplied to us by other parties.

This document contains confidential information and proprietary intellectual property. It should not be shown to other parties without consent from us and from the party which commissioned it.

# Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	1
Përmbledhje	3
Arsyetimi	7
<b>1 Kushtet aktuale</b>	<b>11</b>
1.1 Hyrje	11
1.2 Burimet ujore	12
1.2.1 Balanca e ujit	12
1.2.2 Ndikimi i Klimës në burimet ujore	14
1.2.3 Ujërat sipërfaqësore	16
1.2.4 Ujërat nëntokësore	18
1.2.5 Basenet ujore	19
1.2.6 Efektet që parashikohet të kenë ndryshimet klimatike në burime ujore	24
1.3 Përdorimi aktual i ujit	29
1.3.1 Uji për Njerëzit	30
1.3.2 Uji për Ushqim	33
1.3.3 Uji për Industrinë dhe Energjinë	37
1.3.4 Uji për Mjedisin	43
1.3.5 Efektet e ndryshimeve klimatike tek bilanci i ujit	45
1.4 Kuadri ligjor dhe institucional	46
1.4.1 Legjislacioni parësor	46
1.4.2 Legjislacioni dytësor (aktet nënligjore)	48
1.4.3 Përputhshmëria ligjore	48
1.4.4 Marrëveshjet ndërkombëtare	49
1.4.5 Kuadri institucional	51
1.5 Përfundime	58
<b>2 Vizionet, Politikat dhe Qëllimet Strategjike</b>	<b>60</b>
2.1 Deklarata e Vizionit	60
2.2 Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore dhe Direktiva Kuadër e Ujit	61
2.3 Politikat dhe parimet	62
2.3.1 Politikat dhe parimet e BE-së	62
2.3.2 Politikat dhe strategjitë ekzistuese për menaxhimin e ujit	63
2.4 Analiza e mangësive	68
2.4.1 Problematikat kryesore të burimeve ujore	68
2.4.2 Problematikat kryesore lidhur me përdorimin e ujit	69
2.4.3 Problematikat kryesore lidhur me menaxhimin e ujit	69
2.5 Objektivat Strategjike	75
<b>3 Objektivat e politikës dhe rezultatet kryesore</b>	<b>77</b>
3.1 Objektivat e politikave që lidhen me sasinë e ujit	77

3.1.1	Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni uJOR	77
3.1.2	Masat për përballjen me ndryshimet klimatike	77
3.1.3	Përmirësimi i rrjetit tëshpërndarjes së ujit (infrastruktura) dhe masat për ruajtjen e tij	78
3.1.4	Shpërndarja e barabartë e përfitimeve	78
3.1.5	Përfshirja e publikut dhe debati i hapur	79
3.2	Objektivat e politikave për cilësinë e ujit	79
3.2.1	Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni uJOR	79
3.2.2	Përcaktimi i masave për përballjen me ndryshimet klimatike	80
3.2.3	Përcaktimi i statusit “cilësi e mirë e ujit”	80
3.2.4	Zhvillimi i programeve lidhur me masat për zbatimin e DKU-së	81
3.2.5	Pjesëmarrja e publikut dhe një debat i bazuar në ndarje informacioni	82
3.3	Objektivat e politikave lidhur me rreziqet që vijnë nga uji	82
3.3.1	Menaxhim efektiv i katastrofave natyrorenë vend	83
3.3.2	Sigurimi i mbrojtjes nga përmytjet	83
3.3.3	Përgatitja për përballje me thatësitat dhe kufizimet e ujit	84
3.3.4	Plane kontrolli dhe masa për përballjen me ndryshimet klimatike	85
3.4	Objektivat e politikave lidhur me informacionin për ujin	85
3.4.1	Përcaktimi i rrjetit të monitorimit të ujit	85
3.4.2	Nxitja e kërkimeve shkencore	86
3.4.3	Përmirësimi i aksesit në informacion dhe i prodhimit të të dhënave	87
3.4.4	Krijimi i një kuadri institucional të përshtatshëm për ujin dhe klimën	87
3.5	Objektivat e politikës lidhur me menaxhimin e ujit	90
3.5.1	Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësisve në MIBU	90
3.5.2	Zbatim i plotë i parimeve të BE-së për ujin dhe mjedisin	91
3.5.3	Arritja e zhvillimit të kapaciteteve	94
3.5.4	Nxitja e bashkërendimit dhe planifikimit ndërsektorial	94
3.5.5	Zhvillimi i instrumenteve ekonomike dhe financiare për rikuperimin e kostove	95
3.5.6	Rritja e integritetit dhe transparencës	95
3.5.7	Pjesëmarrja e grupeve të interesit në MIBU	96
3.5.8	Hartimi i marrëveshjeve ndërkufitare	97
3.5.9	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për menaxhimin e ujit	97
3.6	Rezultatet kryesore	97
3.7	Supozime dhe rreziqe	99
3.7.1	Supozime kyçe	99
3.7.2	Rreziqet që i kanosen objektivave të synuar	99
3.7.3	Menaxhimi i riskut	100

## 4 Burimet Financiare 101

4.1	Hyrje	101
4.2	Metodologjia e përdorur	101
4.3	Kostoja	103
4.3.1	Buxheti i shtetit	104
4.3.2	Burime të jashtme financimi	107
4.3.3	Nevoja shitesë për periudhën buxhetore 2016-2018	110

## 5 Raportimi, Monitorimi, dhe Vlerësimi 111

5.1	Hyrje	111
-----	-------	-----

5.2	Objektivat Strategjikë	114
5.3	Objektivat e Politikave	117
5.3.1	Sasia e Ujit	117
5.3.2	Cilësia e ujit	118
5.3.3	Rreziqet që vijnë nga uji	119
5.3.4	Informacioni për ujin	120
5.3.5	Menaxhimi i ujit	121

## Shtojcat 123

### A. Plani i veprimit 2017-2019 124

A.1	Sasia e Ujit	125
A.2	Cilësia e Ujit	131
A.3	Rreziqet që vijnë nga uji	132
A.4	Informacioni për ujin	133
A.5	Menaxhimi i ujit	134

### B. Referencat 135

#### Tabelat

Tabela 1:	Financimet e nevojshme për periudhën kohore 2017-2027	5
Tabela 2:	Të dhënat e vendit për vitin 2015	11
Tabela 3:	Balanca e ujit	13
Tabela 4:	Bilanci i ujit për prurjet mesatare vjetore për gjashtë basenet ujore	13
Tabela 5:	Bilanci i Ujit përgjatë muajve të verës	14
Tabela 6:	Parametrat dhe kriteret e monitorimit të ujërave sipërfaqësore	19
Tabela 7:	Pasqyrë e përgjithshme e burimeve ujore dhe problematikave në nivel baseni	23
Tabela 8:	Skenarët e reshjeve/temperaturës	24
Tabela 9:	Shpeshia mesatare vjetore e rrjedhjes maksimale me probabilitet përsëritjeje 1/100 vjet për Shqipërinë dhe Evropën dhe ndryshimi në përqindje midis situatës normale dhe afateve kohore të parashikuara	26
Tabela 10:	Efektet e përmytjes në nivel kombëtar	27
Tabela 11:	Efektet e përmytjeve sipas qarqeve (quark)	28
Tabela 12:	Përmbledhje e performancës së sektorit të furnizimit me ujë për vitin 2012-2015	30
Tabela 13:	Ndarja e Zonave të Mbrojtura	43
Tabela 14:	Gjendja e ligatinave	44
Tabela 15:	Llojet e pyjeve	45
Tabela 16:	Përmbledhje e treguesve siç përcaktohet në Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin	80
Tabela 17:	Programet buxhetore sipas institucionit	102
Tabela 18:	Përmbledhja e kostos totale dhe financimi në mbështetje të objektivave të politikës së Strategjisë MIBU (Siç janë detajuar në shtojcën A))	103
Tabela 19:	Programet e buxhetit në mbështetje të objektivave të politikës MIBU (në /000,000 Lekë)	105
Tabela 20:	Buxheti i parashikuar për periudhën 2019-2027 (në /000,000 ALL)	107
Tabela 21:	Projektet në vazhdim të financuara nga fondet e huaja (në /000,000 Euro)	108



Tabela 22: Projektet e planifikuara të financuara përmes fondeve të huaja (në/000,000 Euro)	109
Tabela 23: Nevoja për financime shtesë për periudhën buxhetore 2016-2018 (në /000,000 Lekë)	110

## Figurat

Figura 1: Reshjet mujore	15
Figura 2: Temperatura mesatare mujore	16
Figura 3: Harta e baseneve ujore	20
Figura 4: Rritja e Turizmit	31
Figura 5: Zonat agro-ekologjike	34
Figura 6: Vendndodhja e digave bujqësore	35
Figura 7: Zona e Ujitur	36
Figura 8: Diga e Vaut të Dejës turbina edhe nen-stacioni elektrik	39
Figura 9: Diga e Banjës – Tregon shkarkuesin nga përmytjet dhe bankinat mbrojtëse në bjeftin e poshtëm	40
Figura 10: Vendndodhja e e hidrocentraleve të vegjël	41
Figura 11: Struktura organizative e institucionale për menaxhimin e burimeve ujore	54
Figura 12: Integrimi i katër ‘shtyllave’ strategjike për menaxhimin e ujit	60
Figura 13: Kuadri i propozuar institucional për menaxhimin e burimeve ujore	90
Figura 14: Rrjeti Institucional dhe përgjegjësitë për Monitorimin dhe Vlersimin e Strategjisë MIBU	112

# Lista e shkurtimeve

ABU	Agjencia e Basenit Ujor
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ALL	Lekë Shqiptarë
APL	Huaja e Programit që Përshtatet
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
AKUK	Autoriteti Kombëtar i Ujwsjellws-Kanalizimeve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BK	Bordi i Kullimit
BOD	Kërkesa Biologjike për Oksigjen
BP	Bifenil i Poliklorinuar
°C	Gradë Celsius
CEDAW	Konventë për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
CESR	Qendra për Kërkimin e Sistemeve Mjedisore
CESVI	Organizata humanitare Italiane ("Cooperazione e sviluppo" Bashkëpunim dhe Zhvillim)
(Projekti) CEMSA	Konsolidim i Sistemit të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri (Projekt)
cm	Centimetër
COM	Komunikim nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin Evropian, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve
CRED	Qendra për Kërkime mbi Epidemiologjinë e Katastrofave
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
DP	Direktiva e Përmbytjeve
ECOSOC	Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara
ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
EM-Dat	Banka e të Dhënave Ndërkombëtare për Katastrofat
ENVSEC	Rreziqet Mjedisore dhe të Sigurisë në Bashkëpunimin në Rajonin e Evropës Juglindore
ESMAP	Programi i Asistencës për Menaxhimin e Sektorit Energjetik
FAO	Organizatë për Ushqim dhe Bujqësi
FOPU	Federata e Organiizatave të Përdoruesve të Ujit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FM	Funksionim dhe Mirëmbajtje
GEF	Instrumenti Mjedisor Global
GII	Treguesi i Pabarazisë Gjinore
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GWh	Gigawatt në orë
GWP	Partneriteti Global për Ujin
GWPCEE	Partneriteti Global për Ujin për Evropën Qendrore dhe Lindore
ha	Hektarë
HDI	Treguesi i Zhvillimit të Njeriut
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IDB	Banka ndër-Amerikane për Zhvillim
IFC	Korporata Ndërkombëtare e Financave
IFI	Institucioni Ndërkombëtar i Financave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkenacave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit,
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti për Asistencën e Paraaderimit
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
ISBN	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISSN	Numri Standard Ndërkombëtar i Serisë
ITUN	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
KBU	Këshilli i Basenit Ujor
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
Km	Kilometër
l	Litër
LBU	Ligji për Burimet Ujore
m	Metër

MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
mg	Miligram
MIBU (Strategji)	Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (Strategji)
mm	Milimetër
MM	Ministria e Mjedisit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MS	Masat Shoqëruese
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës
MW	Megawatt
MWh	Megawatt orë
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NH <sub>4</sub>	Amoniak
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
Nr.	Numër
NVE	Drejtoria Norvegjeze e Burimeve Ujore dhe Energjisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OJF	Organizatë jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPU	Organizata e Përdoruesit të Ujit
p.e.	Ekuivalenti i popullsisë
p.sh.	për shembull
PBA	Programi i Buxhetimit Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PBUU	Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
PISU	Projekti për Investime në Sektorin e Ujit
PM(O)	Zyra e Kryeministrit
PM	Programi i Masave
PMRP	Plani i Menaxhimit i Rrethit nga Përmblytjet
Pop.	Popullsia
PPP	Partneritet Publik Privat
QJoIA	Revista Tremujorëshe e Bujqësisë Ndërkombëtare
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RBMP	Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor
REC	Qendra Rajonale Mjedisore
SEC	Dokument Pune i Stafit të Komisionit të BE-së
SHGSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
(F)SHPU	(Federata e) Shoqatave të Përdoruesve të Ujit
Sida	Agjencia Suedeze Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim
SKSFUK	Strategjia Kombëtare Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMART	Specifik, Të Matshëm, të Arritshëm, Përkatës, në Kohë
SRES	Raport i Veçantë mbi Skenarin e Emetimeve
STKKU	Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit
TBD	Për t'u vendosur
TEC	Komitet Teknik
UN	Ujërat Nëntokësore
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
USAID	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VKM	Vendim i Këshillit të Minsitrave
WWF	Fondi Mbarë Botëror për Natyrën
ZM	Zonë (zonat) e mbrojtur

# Përmbledhje

**Uji është burim natyror strategjik për Shqipërinë. Megjithëse i pasur me burime ujore, me tetë lumenj dhe tre liqene të mëdhenj të lundrueshëm dhe ndërkuftarë, një numër të madh ligatinash të rëndësishme dhe burime të bollshme ujërash nëntokësore, vendi do të përballë me efektet e ndryshimeve klimatike që shoqërohen me rritjen e temperaturave dhe uljen e sasisë së reshjeve, gjë që do të sjellë dimër më të butë, pranverë më të ngrohtë dhe verë e vjeshtë më të thatë dhe më të nxehtë. Burimet ujore pritet të ulen me 14% deri në vitin 2050. Ndryshimi i regjimit të reshjeve do të sjellë reshje të rrëmbyeshme të gërshetuara me shkrirje të hershmetë dëborës shkaktuar nga rritja e temperaturës në pranverë duke sjellë kështu përmytje më të shpeshta. Presione shtesë do të vijnë për shkak të rritjes së popullsisë, zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës për burimet ujore.**

Shqipëria ka zhvilluar një Vizion të qartë afatgjatë<sup>1</sup> për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore i cili i hap rrugën “Akses të ujit të sigurt për të gjithë përdoruesit dhe grupet sociale në sasinë dhe cilësinë e nevojshme për mirëqenien sociale, duke nxjerrë përfitime ekonomike dhe financiare maksimale nga burimet ujore, në një kohë që garantohet ruajtja e ekosistemeve të ujit dhe e funksionit natyror të burimeve ujore për një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen, bazuar në legjislacionin mjedisor Evropian dhe parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore”.

## Sfidat

Për të përmbushur këtë Vizion, sfidat kryesore do të jenë zvogëlimi i rezervave ujore gërshetuar me rritjen e kërkesave të shumëfishta për ujë nga çdo sektor, ndërsa duhet të garantohet ruajtja e burimeve ujore për brezat e ardhshëm. Në dhjetëvitet e ardhshme, përdorimi i burimeve ujore për prodhimin e energjisë, furnizimin e popullsisë me ujë, zgjerimin e vaditjes për bujqësinë, industrinë dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore do të kërkojë sasi më të mëdha uji dhe përmirësimin e cilësisë së tij.

Kapaciteti i vendit për menaxhimin e burimeve ujore është aktualisht i kufizuar përse i përket burimeve njerzore, institucioneve, eksperiencës dhe infrastrukturës. Për më tepër, edhe baza e njohurive që nevojitet për hartimin e politikave, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e tyre kërkon përmirësime nëpërmjet ndërhyrjeve specifike të cilat do të çojnë në rritjen e kapaciteteve administrative dhe teknike në nivel kombëtar dhe baseni.

Për t'i bërë ballë këtyre sfidave, menaxhimi i integruar i burimeve ujore të vendit është thelbësor dhe kërkon hartimin e një Strategjietë qartë të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU). Përmes zhvillimit të kësaj strategjie, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) ka si qëllim të trajtojë dhe të shërbejë si udhëzues për politikën për ujin, dhe të nxisë zhvillime operationale dhe investimen dërmjet të gjithë sektorëve brenda një afati kohor 10 vjeçar.

## Proçesi i Strategjisë MIBU

Proçesi i zhvillimit të Strategjisë MIBU për Shqipërinë është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv.

Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- **Përfshirjes së shumë sektorëve:** strategjia kërkon të dhëna dhe mbështetje nga të gjithë sektorët që ndikojnë dhe që ndikohen nga menaxhimi dhe përdorimi i ujit (shëndetësia, energjia, turizmi, industria, minierat, bujqësia dhe mjedisi);
- **Mbajtjes së një fokusi të përgjithshëm:** në përputhje me objektivat e zhvillimit, strategjia do t'i japë përparësi përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore në lidhje me integrimin e të gjithë përdoruesve të ujit në çdo sektor;

<sup>1</sup> Siç është përmendur nga Kryeministri Edi Rama, qershor 2015.

- **Një përqsasje dinamike më shumë se sa statike:** strategjia ka si qëllim të identifikojë një kuadër që ofron një proces të veprimeve strategjike të bashkërenduar në vazhdimësi dhe që përshtatet me kohën;
- **Pjesëmarrjes aktive të grupeve të interesit:** strategjia përfshin grupe të shumta interesi dhe grupet e synuara vulnerabël, me interesa shpesh të ndryshme me shumë mundësi konfliktesh me njëra-tjetrën.

Ky proces ka çuar në hartimin e një Strategji MIBU gjithëpërfshirëse që përqendrohet në ruajtjen e burimeve ujore për brezat e ardhshëm në përputhje me kërkesat e politikave dhe rregullave evropiane për ujin dhe mjedisin. Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër 'shtylla' strategjike: 'Ujë për Njerëzit', 'Ujë për Ushqim', 'Ujë për Industrinë', dhe 'Ujë për Mjedisin'.

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në vend do të arrihet nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, ekonomik, institucionale, teknike dhe sociale duke u bazuar në legjislacionin Evropian për mjedisin dhe parimet e MIBU-s.

## Objektivat

Strategjia MIBU fillon me një përshkrim të kushteve aktuale të burimeve ujore dhe të përdorimit aktual të ujit në vend, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe institucional. Përmes analizave dhe konsultimeve, janë përcaktuar çështjet dhe mangësitë përkatëse që pengojnë MIBU-n. Për përmbushjen e këtyre mangësive, **Strategjia MIBU përcakton 5 Objektiva Strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë:**

1. **Sasia e Ujit:** sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare ,të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
2. **Cilësia e Ujit:** sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e "gjendjes së mirë të ujit" deri në vitin 2027, nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare ,të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
3. **Rreziqet nga Uji:** ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësitrat) përmes menaxhimit dhe investimeve, që i shërben të gjitha interesave, nëpërmjet aplikimit të akteve edhe nën-akteve ligjore kombëtare ,të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
4. **Informacion për Ujin:** sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar në institucionet respektive të cilat i zotërojnë këto të dhëna;
5. **Administrimi i Ujit:** menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe të BE-së.

Analizat dhe konsultime të mëtejshme kanë çuar në hartimin e objektivave më specifike të politikave dhe përcaktimin e rezultateve të pritshme të cilët janë zbrërthyer në aktivitete/masa.

Rezultatet kryesore të pritshme përfshijnë:

- Përdorim dhe shpërndarje të ujit në mënyrë efikase dhe të barabartë dhe një rritje thelbësore në efikasitetin e përdorimit të ujit në të gjithë sektorët me qëllim shfrytëzimin, riciklimin dhe ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore;
- Ulje të ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimit të shkarkimeve të lëndëve kimike të rrezikshme në trupa ujorë (niveli i saktë i uljes do të jetë në funksion të numrit dhe natyrës të këtyre shkarkimeve);
- Rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësisë për t'u përshtatur ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve që vijnë nga katastrofat natyrore;
- Një njohje të thellë të të gjitha burimeve ujore në vend, duke ofruar kështu një bazë njohurish publike për vendimet (politikat), lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- Politika të qarta MIBU dhe zbatim të PMBU-së që synon a) objektiva të matshme në afate kohore të caktuara, në nivele të duhura, dhe b) përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të autoriteteve, duke u bazuar në një monitorim dhe vlerësim efikas.

## Financat

Strategjia MIBU për Shqipërinë është hartuar me qëllim ofrimin e një kuadri për një administrim gjithëpërfshirës të burimeve ujore, ku të gjitha grupet e interesit, burra dhe gra, duke përfshirë sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetin e përdoruesve, do të luajnë një rol aktiv. Rreziqet kryesore për zbatimin me sukses të Strategjisë MIBU lidhen me kohën e gjatë që nevojitet për krijimin e kuadrit të nevojshëm për administrimin e ujërave, si dhe aftësinë për të siguruar financimet e duhura për periudhën 2017-2027 siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1: Financimet e nevojshme për periudhën kohore 2017-2027**

Qëllimi Strategjik	Investimi total (në / 000.000 Euro)	Arritje afatmesme 2022 (%)	Arritjet e synuara 2027 (%)	Burimet
1. <b>Sasia e ujit:</b> Sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave	1,563.00	50%	100%	Shteti, Donatorë Bilateralë, BB
2. <b>Cilësia e ujit:</b> Sigurimi i cilësisë së të gjitha burimeve ujore, duke arritur një gjendje të mirë deri në vitin 2027	23.12	50%	100%	Shteti, Donatorë Bilateralë, BB
3. <b>Rreziqet e ujit:</b> Kufizimi i rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësitrat) përmes menaxhimit të duhur dhe investimeve	55.83	75%	100%	Shteti, Donatorë Bilateralë, BB
4. <b>Informacion për Ujin:</b> sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar në institucionet relevante të cilat i zotërojnë këto të dhëna	10.15	75%	80%	Shteti, Donatorë Bilateralë, BB
5. <b>Administrim i ujit:</b> menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i tij dhe mundësi për brezat e ardhshëm.	61.2	85%	100%	Shteti, Donatorë Bilateralë, BB

Buxheti për Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore është përllogaritur në bazë të programeve të buxhetit në mbështetje të objektivave të politikave të MIBU-s. Për periudhën 2016 - 2018 buxheti total i shtetit arrin në 48.5 miliardë lekë (347 milionë Euro). Për llogaritjet për 2019-2027 janë bazuar në supozimin që raporti i burimeve financiare për këto programe, krahasuar me buxhetin e përgjithshëm, mbetet i njëjtë dhe rritja ekonomike për këto vite është mesatarisht 2.6% në vit. Supozimi është i cënueshëm meqenëse strategjia shtrihet në një kohë shumë më të gjatë. Si rrjedhojë, ka shumë mundësi që, gjatë kësaj kohe, të ketë ndryshime të politikave për ujin të cilat mund të sjellin edhe ndryshime në financimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe, përllogaritja e buxhetit total të shtetit është afërsisht 166 miliardë Lekë (1.184 miliardë Euro).

Aktualisht, janë 39 projekte në zbatim lidhur me MIBU-n, me një vlerë totale prej 534 milion euro (shih Tabelën 21 dhe 228), nga të cilat, 149 milion euro janë grante dhe rreth 285 milion euro janë hua. Për më tepër, duke u bazuar mbi Dokumentet Strategjike të Vendit të përgatitur nga donatorët kryesorë që veprojnë në Shqipëri, veçanërisht në sektorin e ujit, si për shembull Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe GIZ, janë aktualisht 14 projekte që arrijnë një vlerë totale prej rreth 146 milionë euro. Nga këto, 13 milionë euro janë grante dhe 133 milionë euro janë hua.

Vlen të theksohet se, megjithëse burimet e financimit mund të jenë edhe të huaja (Financim i Donatorëve; IFIs), në PBA këto janë planifikuar/alokuar brenda tavanit të programit buxhetor, pra pjesë e llogaritjes. Në 2017-2019, kohë që PBA do të regjistrojë çdo financim publik, qoftë ky vendas apo i huaj, i përcaktuar me Ligj, arrijmë në përfundimin se Buxheti i Shtetit përbën të vetmin burim financiar për strategjinë.

## Monitorimi

Monitorimi i kryer me kujdes, do të ofrojë një bazë të qartë për ecurinë e zbatimit të Strategjisë MIBU. Do të jetë e nevojshme që monitorimi i objektivave strategjike të verifikueshëm të ndërmerret nga ministritë

përgjegjëse të linjës, duke i bërë ato përgjegjëse për bashkëpunimin me institucionet, agjensitë, si dhe me organet vendore dhe qeveritare.

Duke zbatuar Strategjinë MIBU, Shqipëria do të bëhet një vend me efikasitet ujore, me një menaxhim funksional të integruar të burimeve të tij, ku përdorimi i ujit mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë dhe barazisë për përfitime ekonomike të barabarta sociale-gjinore dhe drejtësi mjedisore për të sotmen dhe për brezat e ardhshëm.

# Arsyetime

Megjithëse uji duket sikur është një burim i pashterrshëm, Qeveria Shqipëtare e ka përcaktuar ujin si një çështje me përparësi për shkak të kërkesave të ndryshme dhe, ndonjëherë në konkurrencë me njëra-tjetrën, të sektorëve të ndryshëm të ujit. Me qëllim menaxhimit e cilësisë, sasisë dhe rreziqeve që i kanosen burimeve ujore në mënyrë të qëndrueshme, nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse e burimeve ujore e cila siguron:

- ujë, në sasi dhe cilësi të mjaftueshme për konsum nga popullsia dhe kafshët;
- prodhimin e sigurt të ushqimit;
- përdorim të balancuar të burimeve ujore për prodhim të energjisë dhe qëllime të tjera industriale;
- mbrojtjen e habitateteve, ekosistemeve dhe biodiversitetit që varet nga uji;
- mbrojtjen ndaj ndotja e ujit, përmbytjeve dhe thatësirave;
- zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si “një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkënduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore”. (GWP, 2000). Si i tillë, një proces eficient i zbatimit të Strategjisë MIBU kërkon:

- **Përfshirjen e sektorëve të ndryshëm:** strategjia kërkon të dhëna dhe mbështetje nga të gjithë sektorët që ndikojnë dhe që janë të ndikuar nga zhvillimi dhe menaxhimi i ujit (shëndetësia, energjetika, turizmi, industria, bujqësia dhe mjedisi);
- **Fokus të përgjithshëm:** strategjia e shikon menaxhimin e ujit në lidhje me përdoruesit e tjerë të integruar, për arritjen e qëllimeve gjithë përfshirëse zhvillimore;
- **Një përjasje dinamike më shumë se sa statike:** strategjia synon të identifikojë një kuadër veprimesh strategjike dhe të koordinuara për një proces që vazhdon dhe që përshtatet;
- **Pjesëmarrjen e grupeve të interesit:** një strategji ka shumë grupe interesi me mandate të ndryshme që mund të jenë edhe në konflikt me njëri-tjetrin. Zbatimi i strategjisë kërkon një pjesëmarrje shumë më të gjerë dhe të zgjeruar nga grupet e interesit se sa një proces tradicional planifikues; ai kërkon një debat të hapur.

Strategjia Kombëtare MIBU është zhvilluar në kuadër të projektit “Burimet Ujore dhe të Ujitjes (PBUU)”. Projekti zbatohet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), me financim në formë huaje nga Banka Botërore (BB) dhe financim në formë granti nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

## Baza Ligjore

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore është zhvilluar në përputhje me:

- Nenin 16 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujoret”, i cili deklaron se:
  - Strategjia MIBU është një dokument planifikues që parashtrohet vizionin e politikave shtetërore, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujit në një kohë afatgjatë;
  - Strategjia MIBU duhet të bazohet mbi kërkime shkencore, monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes dhe fenomeneve që lidhen me ujin dhe përdorimin e tij, duke vlerësuar problemet specifike dhe të Integruara të ujit dhe mbrojtjes mjedisore në çdo basen ujor;
  - Strategjia MIBU është një dokument kuadër për zhvillimin e planeve të menaxhimit të ujit dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes mjedisore, biodiversitetit, peisazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, si dhe përfshin shëndetin publik dhe dokumente të tjera përkatëse;



- Strategjia MIBU duhet të rishikohet çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, por mund të rishikohet dhe përditësohet përpara përfundimit të kësaj periudhe, nëse një veprim i tillë diktohet nga ndryshime në sistemin ujor dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit;
- Organet, entet, institucionet që janë përgjegjëse për ujin, do të jenë përgjegjëse për krijimin e Strategjisë MIBU nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit;
- Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 1, (17.02.2015), 'Mbi përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore, dhe Planeve të Menaxhimit për Rrezikun nga Përmbytjet';
- Ligji për barazinë gjinore në shoqëri (Nr. 997/24.07.2008) i cili krijoi kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen kundër të gjitha llojeve të diskriminimit gjinor dhe promovimin e mundësive të barabarta. Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare dhe planin për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;
- Urdhrin e Kryeministrit Nr. 93 (07.08.2012) që përshkruan Strukturën për Dokumentet Strategjike Sektoriale dhe Ndërsektoriale si më poshtë:
  - Kapitulli 1: Kushtet Aktuale;
  - Kapitulli 2: Vizionet, Politikat dhe Objektivat Strategjike;
  - Kapitulli 3: Objektivat e Politikave dhe Rezultatet Kryesore;
  - Kapitulli 4: Burimet Financiare;
  - Kapitulli 5: Llogaridhënia, Monitorimi dhe Analiza e Vlerësimit.

Kjo strategji është e vlefshme për një periudhë dhjetëvjeçare: nga viti 2017 (*data e përlogaritur e miratimit në Këshillin e Ministrave*) deri në vitin 2027<sup>2</sup> dhe do t'i nënshtrohet përditësimit çdo dy vjet, me rishikim të ndërmjetëm në vitin 2022 (ose nje date tjetër te percaktohet kohe pas kohe ne përputhje me programet e zbatueshme)

### Përfshirja

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) ka përgatitur Strategjinë MIBU me ndihmën e konsulentit teknik dhe në bashkëpunim me organet përkatëse të administratës shtetërore, agjencitë, institutet dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, duke përfshirë:

- Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj. Zyrën e Kryeministrit;
- Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit;
- Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë;
- Ministrinë e Mjedisit;
- Ministrinë e Shëndetësisë;
- Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës;
- Ministrinë e Zhvillimit Urban;
- Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Ministrinë e Financave;
- Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
- Enti Rregullator i Ujit;
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- Këshillat e Baseneve Ujore;
- Autoritetet e Baseneve Ujore;

<sup>2</sup> Është propozuar 10 vite si përjashtim sepse 2027 është një propozim duke qenë se korrespondon me afatin e fundit të dorëzimit të raundit të tretë të PMBL-ve të BE-së, një tjetër opsion është janë periudhat 15 vjeçare siç edhe citohet ne Vendimin Nr. 4 (17.02.2015) të Këshillit Kombëtar të Ujit.

- Ndërmarrjet e Ujësjetës dhe Kanalizimeve;
- Ndërmarrjet Publike dhe Private;
- Shoqërinë Civile dhe OJQ-të.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka publikuar një dokument për procesin e konsultimit dhe rishikimit të ndërmarrë përpara miratimit të kësaj strategjie.

### Metodologjia

Zhvillimi i Strategjisë MIBU bazohet mbi parimet e mëposhtme:

- Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (BB, 2009) dhe (GWP, 2004) sugjerojnë marrjen në konsideratë të të gjitha aktiviteteve dhe zhvillimeve vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkufitare që kërkojnë ujë ose që kanë ndikim tek burimet ujore. Për këtë arsye, përshkrimet e përdorimit të ujit përfshijnë furnizimin me ujë si dhe higjenën, ujitjen, kërkesat ekologjike dhe ato të biodiversitetit, pylltarinë, peshkimin, hidroenergjinë, transportin ujor, turizmin dhe përdorimet për industrinë;
- Miratimi i strategjisë MIBU nga grupet e interesit është një parakusht për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të posaçme në lidhje me sektorin e ujit, si dhe planeve operacionale, duke siguruar kështu që zhvillimi të kryhet në përputhje me politikat kombëtare dhe strategji të tjera ekzistuese;
- Integrimi gjinor, bazuar mbi barazinë dhe efikasitetin, është një pjesë integrale e procesit MIBU. MIBU shkon përtej ofrimit të shërbimeve të ujit ose menaxhimit të veprimtarive që lidhen me ujin, duke marrë në konsideratë kontekstin social brenda së cilit veprojnë këto shërbime në përdorimin e ujit;
- Një Strategji MIBU mund të jetë efiçase vetëm atëherë kur përfshin një sërë programesh të ndara sipas përparësive. Një strategji e pranuar në nivel ndërkombëtar për të siguruar një kuadër rezultatesh me synime të përcaktuara qartazi nga ana e aktorëve të përfshirë në të gjitha nivelet është Menaxhimi që Bazohet në Rezultate (UNDP, 2011) me anë të të cilit, të gjithë aktorët që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë për arritjen e një sërë rezultatesh, sigurojnë që proceset, produktet dhe shërbimet e tyre kontribuojnë për rezultatet e dëshiruara dhe përdorin informacionin dhe të dhënat në lidhje me rezultatet aktuale për të dhënë informacion për vendimmarrjen, për hartimin, pasurimin dhe shpërndarjen e programeve dhe aktiviteteve, si dhe për llogaridhënie dhe raportim.

Deri më tani, Qeveria ka ndërmarrë nisma të qarta për mbështetjen e MIBU-s dhe është angazhuar në zbatimin e reformave të burimeve ujore nëpërmjet:

- Angazhimit në këtë projekt të financuar nga Banka Botërore dhe investime të tjera të financuara në nivel kombëtar dhe/ose nga FMN për menaxhimin e burimeve ujore;
- Krijimit të kuadrit bazë institucional që lidhet me rekomandimet për MIBU-n për Këshillin Kombëtar të Ujit dhe Agjencitë dhe Këshillat e Baseneve Ujore;
- Transpozimin e Direktivës Kuadër të BE-së për Ujin 2000/60/EC (BE-DKU, 2000) dhe Direktivës së BE-së për Përmbytjet 2007/60/EC (BE-DP, 2007) në legjislacionin Shqiptar i cili përfshin organizimin e menaxhimit të burimeve ujore për sa i përket baseneve ujore.

Zhvillimi i Strategjisë MIBU bazohet gjithashtu edhe mbi një Analizë të Mangësive, një metodologji që është nxitur, ndër të tjera, nga Udhëzimet DKU/DP të Bashkimit Evropian (EBE, 2003), Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Vijave Ujore Ndërkufitare dhe Udhëzimet e Liqeneve Ndërkombëtare (UNECE, 2013) dhe nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD, 2016). Strategjia MIBU identifikon fillimisht mangësitë thelbësore nëpërmjet një analize të parimeve të politikave, objektivave dhe instrumentave të menaxhimit.

Për më tepër, Strategjia MIBU identifikon mospërputhjet ndërmjet kushteve aktuale (të dhëna në Kapitullin 1) dhe parashikimeve në lidhje me burimet ujore në të ardhmen që vijnë si rezultat i skenarëve të ardhshëm siç edhe sugjerohet nga Udhëzimet DKU (BE, 2009) dhe DP (BE, 2014). Në këtë mënyrë janë identifikuar problematika të rëndësishme në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

Vizionet, politikat dhe objektivat Strategjike të Strategjisë MIBU përcaktohen në Kapitullin 2. Objektivat e Politikave dhe rezultatet kryesore janë renditur në Kapitullin 3, për të formuluar masat e nevojshme për plotësimin e mangësive që janë identifikuar në Kapitullin 2.

Strategjia MIBU nuk përcakton veprime të hollësishme për të gjithë sektorët e tjerë specifikë të ujit, por përfshin një plan të përgjithshëm veprimi që shërben si një bosht dhe një kornizë e përgjithshme politikash, që vendos kushtet për strategji të tjera që lidhen me sektorin e ujit. Burimet financiare që nevojiten për zbatimin e Strategjisë MIBU si dhe përgjegjësitë. Kornizat e monitorimit dhe vlerësimit, jepen në Kapitujt 4 dhe 5.

# 1 Kushtet aktuale

## 1.1 Hyrje

Republika e Shqipërisë ndodhet në skajin Perëndimor të Gadishullit Ballkanik në Evropën Juglindore. Vendi ka një sipërfaqe totale prej 2.9 milionë hektarë, dhe përbëhet prej dy rajoneve gjeografike dalluese: malësitë/malet mbi 300m, të cilat zënë tre të katërtat e territorit dhe fushat bregdetare të sheshta ose kodrat e ulëta në afërsi të Detit Adriatik dhe Jon.

Klima ndryshon në varësi të topografisë: verë e nxehtë dhe e thatë dhe shtrëngata të shpeshta dhe dimër i lagësht dhe i butë në fushat bregdetare; dhe më shumë reshje në verë dhe dimër i ftohtë dhe pothuajse shumë i ashpër në male, me shumë dëborë. Mesatarja vjetore e reshjeve është 1.485mm, ku mesatarja e reshjeve në bregdet është 1.000mm, por në rajonet malore mund të arrijë deri në 3.000mm. Shumica e reshjeve shkarkohen në lumenj të cilët derdhen në Detin Adriatik ose Detin Jon. Temperatura mesatare e ajrit në vend është rreth 12°C, por me ndryshime të mëdha në mbarë vendin. Temperatura varet nga gjatësia dhe gjerësia gjeografike (MMPMU, 2009).

Censusi i popullsisë tregon se popullsia e përgjithshme ka rënë nga 3.13 milionë në vitin 2000 në 2.92 milionë në vitin 2014, nga të cilat 49.5% janë gra dhe 50.5% burra. Tabela (BB, 2015), (INSTAT, 2015) dhe (UNDP, 2014) më poshtë paraqet disa tregues të përgjithshëm të zhvillimit njerëzor:

**Tabela 2: Të dhënat e vendit për vitin 2015<sup>3</sup>**

<b>Popullsia<sup>1</sup></b>	2.92 Milion	<b>HDI<sup>3</sup></b>	0.716	<b>PBB për frymë</b>	\$9,243
<b>Rritja e popullsisë</b>	-0.1% në vit	<b>Renditja HDI për 187 vende</b>	95	<b>Indeksi Gini<sup>5</sup></b>	34.5
<b>Jetëgjatësia<sup>2</sup></b>	M=76.4 Vjet F=80.3 Vjet Të gjithë =77.4 Vjet	<b>Indeksi i Arsimiti KB</b>	0.609	<b>Varfëria<sup>6</sup></b>	1.2%
<b>Popullsia Urbane</b>	57%	<b>Pabarazia gjinore<sup>4</sup></b>	0.245	<b>Papunësia<sup>7</sup></b>	16%

Shkaku kryesor i rënies së vazhdueshme të numrit të popullsisë në shkallë vendi është emigrimi, i cili në 15 vitet e fundit është llogaritur të jetë afërsisht 480.000 persona. Si rrjedhojë, kjo ka sjellë një popullsi që është më shumë urbane, që do të thotë se në vitin 2014 raporti midis popullsisë urbane dhe asaj rurale ishte 57% dhe 43% përkatësisht, krahasuar me vitin 2005 ku vetëm 47% e popullsisë ishte urbane dhe 53% ishte rurale (INSTAT, 2015).

Migrimi i popullsisë në zonat urbane ka ardhur si rrjedhojë e mundësive më të shumta për punësim që ofrojnë qytetet më të mëdha e cila sjell si pasojë rritjen e moshës mesatare për punë të burrave dhe grave. Megjithatë treguesi i pabarazisë gjinore është deri diku i ulët, duke u renditur në vendin e 45 nga 155 vende, gratë mbajnë 20% të vendeve në parlament, dhe 82% e tyre të rritura, kanë arritur të paktën nivelin e shkollës së mesme krahasuar me 88% të meshkujve, dhe pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është 45% krahasuar me 66% për burrat (UNDP, 2015). Megjithatë, gratë janë pak të përfaqësuara në pozicionet vendimmarrëse<sup>4</sup> në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

<sup>3</sup> Shënime nga të dhënat e vendit në tabelën 2:

1. Të dhëna për popullsinë nga INSTAT;
2. Jetëgjatësia e meshkujve (M) dhe femrave (F) nga INSTAT, Të dhëna mesatare nga raporti IZHNJ;
3. Indeksi I Zhvillimit Njerëzor;
4. Indeksi I Pabarazisë Gjinore (GII) – që përdoret për matjen e pabarazisë gjinore, përdor tre dimensione për ta bërë këtë: shëndetin riprodhues, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen në tregun e punës. Varion nga 0, e cila tregon që gratë dhe burrat janë të barabartë, deri në 1, që tregon se gratë paraqiten shumë keq në të gjitha dimensionet e matura;
5. Indeksi Gini, mat shkallën sipas së cilës shpërndarja e të ardhurave (ose, disa raste, shpenzimet për konsum) të individëve ose familjeve brenda një ekonomie devijojnë nga një shpërndarje krejtësisht e barabartë;
6. Popullsia në varfëri shumë dimensionale;
7. Përlogaritja e përqindjes totale të fuqisë punëtore.

<sup>4</sup> Megjithatë Ligji Nr. 9970/2008 "Mbi barazinë gjinore në shoqëri" shpreh se 30% e vendeve gjatë zgjedhjeve politike dhe në institucionet vendimmarrëse duhet të mbahen nga gratë.

## 1.2 Burimet ujore

Shqipëria është e pasur me burime ujore, me tetë lumenj të mëdhenj, tre liqene të lundrueshme ndërkufitare, një numër të madh dhe të çmuar ligatinash si dhe burime nënujore të bollshme. Megjithatë burimet ujore janë shpërndarë në të gjithë vendin, shpërndarja e tyre përgjatë territorit nuk është në mënyrë të njëtrajtshme. Megjithatë Shqipëria konsiderohet si një vend me ujë të bollshëm dhe me burime ujore të rinovueshme që llogariten afërsisht deri në 41.7 km<sup>3</sup>/vit. (1,320 m<sup>3</sup>/s), nga të cilat 65% burojnë brenda vendit dhe 30% janë ujëra nëntokësore (Lushaj dhe të tjerë, 2016).

### 1.2.1 Balanca e ujit

Krijimi i balancës ujore është një hap i parë i rëndësishëm drejt zhvillimit të një Strategjie për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore. Në thelb, bilanci i ujit vlerëson (kuantifikon) burimet e disponueshme të ujit, përdorimet e tij dhe çfarë mbetet në dispozicion për përdorime alternative. Llogaritja e balancit të ujit është bazuar në dokumentin " Dokument Udhëzues për aplikimin e balancit të ujit për të mbështetur zbatimin e DKU" (Raport Teknik - 2015 - 090). Ky është udhëzuesi zyrtar mbi Bilancin e ujit, i përcaktuar nga Komisioni Europian. Burimet e ujit përbëhen nga ujërat sipërfaqësorë (lumenjt) dhe akuiferët (ujrat nëntokësorë). Në rastin e Shqipërisë, burimet ujore sipërfaqësore brenda vendit rriten nga flukset hyrëse nga vendet fqinje. Për këtë arsye, në tabelën e mëposhtme, 'baseni hidrografik' është më i madh se sipërfaqja e vendit. Tre përdorimet kryesore të ujit janë klasifikuar Bujqësia, Industria dhe Uji i pijshëm. Natyrisht ka përdorime të tjera të lidhura me bujqësinë, të tilla si uji i pijshëm për kafshët dhe akuakulturën, por këto janë shumë të vogla në krahasim me ujitjen. Një situatë e ngjashme ekziston në lidhje me industrinë. Përdorimi industrial i ujit të pijshëm është i ulët në Shqipëri dhe është klasifikuar si 'ujë me shishe' dhe 'përdorime të tjera'. Ka edhe disa përdorime të ujërave nëntokësorë nga industrinë. Marrja e ujërave nëntokësore /Abstrakimi përfshin të gjitha marrjet për përdorim komunal. Përdorimi i katërt i ujit, flukset mjedisore, nuk janë kuantifikuar plotësisht dhe nuk janë përfshirë në tabelë. Por është konsideruar në bazë të Ligjit Shqipëtar, si rrjedhja minimale që ndodh natyrshëm në 355 ditë në vit. Rëndësia e saj është domethënëse, veçanërisht pasi kërkesat për ujë janë rritur dhe burimet janë pakësuar nga ndryshimet klimatike. Ndërsa në dukje e thjeshtë, është e rëndësishme që bilanci i ujit të njohë karakteristikat specifike të llojeve të ndryshme të përdorimit të tij. Një shembull shumë i qartë i kësaj është krahasimi i ujitjes dhe hidrocentraleve. Kur uji përdoret për vaditje shumica e tij avullon dhe shumë pak, kthehet në lumenjtë apo në ujërat nëntokësorë për përdorim të mëtejshëm. Edhe pse është e njohur se jo i gjithë uji që devijohet për ujitje arrin në fusha. Kur uji përdoret për hidrocentralet pothuajse i gjithë uji që hyn në një rezervuar kalon nëpër turbinat për të gjeneruar energji elektrike. Është për këtë arsye që dokumenti udhëzues i balancit të ujit thotë se hidrocentralet nuk përfshihen në llogaritjen e balancit të ujit. Në faqen 22, në paragrafin 5. Fjalor i termave kyç dhe komponentëve të balancit të ujit, thotë: «uji që shfrytëzohet për gjenerimin e hidrocentraleve (përdorim në vend) duhet të përjashtohet nga formulimi i ekuacionit të balancit të ujit". Për hidrocentralet, përdorimi bruto është i lartë, por përdorimi neto është i ulët; ndërsa për vaditjen, vlen e kundërta. Konsiderata të ngjashme zbatohen për ujin e pijshëm publik, ku një pjesë e ujit të abstraktuar kthehet në një burim potencial uji, qoftë nëpërmjet rrjedhjeve si ujëra nëntokësore qoftë në lumë, pas trajtimit në një impiant të trajtimit të ujërave të zeza. Aktualisht, ka humbje të madha në sistemin e shpërndarjes si nga sistemi ashtu edhe nga lidhjet pa matës; në të ardhmen, këto humbje do të kontrollohen dhe thithja për ujë të pijshëm do të zvogëlohet edhe pse sasia e furnizuar do të rritet. Përveç sa më sipër, ka edhe një dallim në rëndësinë e llojeve të ndryshme të burimeve të ujit. Për shembull, një pjesë e madhe e ujit të pijshëm vjen nga burimet nëntokësore. Tabela e mëposhtme përmbledh bilancin e ujit për dy periudha; e pari është vlerësimi aktual dhe e dyta është për vitin 2027. Të dhënat e 2027 përfshijnë një koeficient për ndikimin nga ndryshimet klimatike, e cila është parashikuar të reduktojë disponueshmërinë e burimeve ujore, dhe për kërkesën e ardhshme të ujit, e cila pritet të rritet.

Burimet kryesore të informacionit të përdorura për të përgatitur këtë tabelë janë:

- Master Plani për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimeve për Shqipërinë - Janar 2013. Kjo është përmbledhje e fundit e kërkesave të ujit brenda Shqipërisë;
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë për UNFCCC (draft i tretë). Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike është një nga organet kryesore ndërqeveritare në lidhje me ndryshimet e klimës. Raportimi në këtë komision mund të konsiderohet si përfaqësues i mendimit të qeverisë mbi ndryshimet klimatike;

- Eftimi "Karakteristikat hidrogeologjike të Shqipërisë" AQUAmundi (2010). Ky dokument, edhe pse ka të bëjnë kryesisht me ujërat nëntokësorë jep gjithashtu informacion të përgjithshëm mbi hidrologjinë dhe burimet ujore të Shqipërisë. Nga ana e tij, ky dokument bazohet në dokumente të tjera të prodhuara nga Qeveria e Shqipërisë, në veçanti "Klima e Shqipërisë" e prodhuar nga Instituti i Hidrometeorologjisë në vitin 1975 dhe "Hidrologjia e Shqipërisë" botuar në 1984 nga i njëjti burim .
- Përdorimi industrial bazohet në dy burime. 'Regjistri Kombëtar për Licencat e Përdorimit të Burimeve Ujore', Ministria e Mjedisit, 2014 dhe Prodhimi dhe Përdorimi i Ujërave Nëntokësore nga Familjet dhe Industritë, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve, 2011.

**Tabela 3: Balanca e ujit****Të dhënapër vendin**

Reshjet (mm/vit)	1,450	
Sipërfaqja e vendit (km <sup>2</sup> )	28,748	
Basenet ujore (km <sup>2</sup> )	43,304 <sup>5</sup>	
<b>Burimet ujore (10<sup>9</sup> m<sup>3</sup>/vit)</b>	<b>Aktualisht</b>	<b>2027<sup>6</sup></b>
Prurjet brenda Shqipërisë	27.11	25.89
Prurjet nga jashtë territorit të Shqipërisë	14.59	13.93
<b>Totali i ujërave sipërfaqësore</b>	<b>41.70</b>	<b>39.82</b>
Nga të cilat ujëra nëntokësore	9.04	8.63
<b>Totali i burimeve ujore të rinovueshme</b>	<b>41.70</b>	<b>39.82</b>
<b>Kërkesa për ujë (10<sup>9</sup> m<sup>3</sup>/year)</b>	<b>Aktualisht</b>	
	<b>Bruto</b>	<b>%<sup>7</sup></b>
	<b>Bruto</b>	<b>%</b>
Uji i përdorur për bujqësi (përfshirë ujitjen)	0.74 <sup>8</sup>	1.8
Uji i përdorur për industrinë (përfshirë hidroenergjinë)	0.01	0.0
Uji i përdorur si ujë i pijshëm	0.33	0.8
<b>Kërkesa totale</b>	<b>1.08</b>	<b>2.6</b>
<b>Balanca e ujit</b>	<b>40.62</b>	<b>38.42</b>

Tabela e mësipërme përmbledh situatën kombëtare. Megjithatë, fakti që në shkallë kombëtare ka një bilanc pozitiv uji, nuk do të thotë se domosdoshmërisht ka një bilanc pozitiv në secilin prej gjashtë baseneve lumorë të përcaktuara në vend. Tabela e mëposhtme jep situatën në nivel vjetor për gjashtë basenet e lumenjve.

**Tabela 4: Bilanci i ujit për prurjet mesatare vjetore për gjashtë basenet ujore**

Vlerat në (10 <sup>9</sup> m <sup>3</sup> /vit)	Kombëtar		Basen Ujor			
	Drin	Mati	Ishem-Erzen	Shkumbini	Semani	Vjosa
<b>Burimet totale ujore të rinovueshme</b>	<b>36.05</b>	<b>21.44<sup>9</sup></b>	<b>3.25</b>	<b>0.66</b>	<b>2.45</b>	<b>2.70</b>
Uji i përdorur për bujqësi	0.64	0.12	0.05	0.06	0.05	0.26
Uji i përdorur për ujë të pijshëm	0.28	0.02	0.01	0.14	0.03	0.04
<b>Bilanci i ujit</b>	<b>35.13</b>	<b>21.30</b>	<b>3.19</b>	<b>0.46</b>	<b>2.37</b>	<b>2.40</b>

<sup>5</sup> Eftimi "Karakteristikat hidrogeologjike të Shqipërisë" AQUAmundi (2010).

<sup>6</sup> Burime të reduktuara me 4.5%. 'Komunikimi Kombëtar i Tretë i Shqipërisë në UNFCCC (drafti i tretë)'.

<sup>7</sup> Si përqindje e burimeve totale të ujërave të rinovueshme.

<sup>8</sup> Marrë nga 'Master Plani i Ujësjetës-Kanalizimeve për Shqipërinë - Janar 2013'.

<sup>9</sup> Përfshire ttjedhjen sipërfaqësore jashtë territorit të Shqipërisë

Vlerat kombëtare në tabelën e mësipërme janë pak ndryshe nga tabela e mëparshme, pasi ato përdorin burime të ndryshme dhe janë mesatarizuar mbi periudha të ndryshme. Duke pasur parasysh se ato janë llogaritur në mënyrë të pavarur nga metoda të ndryshme është e kënaqshme fakti që janë kaq të përafërta. Ato janë në përputhje me ato të përdorura për modelin hidrologjik të Drinit-Bunës dhe Seman në projektin paralel Menaxhimi i Baseneve Ujore, për këto dy basene lumore.

- 'Rrjedha ujore' është rrjedhja natyrore sipërfaqësore në basenin ujqor. "Furnizimi publik me ujë" është uji i furnizuar nga kompanitë e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Llogaritja është një proces me dy faza. Së pari, çdo kompani e furnizimit me ujë është e lidhur me një Bashki dhe më pas secili qark është pjesë e një baseni ujqor. Kur një qark shtrihet në dy basene ujore, atëherë kërkesa është e ndarë midis dy baseneve ujore. Duhet theksuar se kjo tabelë përdor shifra për ujin e furnizuar dhe se një pjesë e tij do të kthehet në lumenj përmes sistemit të kanalizimit, ose, në rastin e rrjedhjeve të tubacionit, në ujërat nëntokësorë.
- "Ujitja" ishte llogaritur duke përdorur zonat e ujitura dhe të dhënat meteorologjike. Ashtu si dhe me furnizimin publik me ujë, ky ishte një proces shumë-fazësh. Faza e parë ishte për të llogaritur kërkesën për ujë në milimetra në bazë të reshjeve dhe avullimit të mundshëm për secilin qark. Të dhënat e përdorura janë nxjerrë nga Njësia e Kërkimit Klimatik në Universitetin e Anglisë Lindore. Kur një qark ka qenë midis dy njesive me të dhënat e rrjetit, vlerat janë ndarë në mënyrë të ponderuar. Faza tjetër ka qenë për të llogaritur kërkesën për ujë në miliarda metra kub në një shkallë kohore mujore për periudhën nga viti 1971 deri në vitin 2015, për secilin qark. Si përfundim, vlerat për secilin qark, që janë përdorur për të llogaritur ujitjen, janë ndarë për secilin basen. Ashtu si dhe me furnizimin publik me ujë, ku një qark ishte në më shumë se një basen ujqor janë ndarë vlerat midis dy baseneve.

Tabela 4 tregon situatën për secilin basen në një bazë vjetore. Megjithatë, një prej kërkesave më të mëdha të ujit është për ujitje, e cila ndodh kryesisht gjatë katër muajve, nga qershori në shtator. Tabela 5. paraqet bilancin e ujit për këto 4 muaj.

**Tabela 5: Balanci i Ujit përgjatë muajve të verës**

Vlerat në (10 m <sup>3</sup> /vit)	Kombëtar				Basen Ujqor		
	Drini	Mati	Ishem-Erzen	Shkumbini	Semani	Vjosa	
<b>Burimet totale ujore të rinovueshme</b>	<b>5.12</b>	<b>2.20</b>	<b>0.65</b>	<b>0.13</b>	<b>0.49</b>	<b>0.54</b>	<b>1.11</b>
Uji i përdorur për bujqësi	0.77	0.16	0.06	0.07	0.06	0.31	0.11
Uji i përdorur për ujë të pijshëm	0.09	0.01	0.00	0.05	0.01	0.01	0.02
<b>Bilanci i ujit</b>	<b>4.26</b>	<b>2.03</b>	<b>0.59</b>	<b>0.01</b>	<b>0.42</b>	<b>0.22</b>	<b>0.98</b>

Kjo tabelë tregon se në verë teprica është shumë më e vogël, veçanërisht në basenin e lumit Erzen dhe Ishëm, i cili përfshin Tiranën dhe zonën metropolitane.


Një aspekt i dokumentit udhëzues të bilancit të ujit është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë - ky është prodhimi hidroenergjitik. Siç u përmend më lart, dokumenti udhëzues Evropian mbi bilancin e ujit, përjashton në mënyrë specifike hidrocentralet. Udhëzimi ka kuptim nëse hidrocentralet nuk konsumojnë ujë. Referenca për 'përdorim në-vend' përfshin rastin e digave në basenet e lumenjve Drini dhe Seman, ku i gjithë uji nga këto basene është përdorur përsëri në të njëjta basene. Vetëm nëse uji devijohet jashtë nga baseni lumor për në hidrocentral tek një basen tjetër, atëherë duhet të merret në konsiderat në bilancë.

### 1.2.2 Ndikimi i Klimës në burimet ujore

Shqipëria ndodhet në pjesën veriore të zonës së Mesdheut. Vendi karakterizohet nga fusha në zonën bregdetare në perëndim dhe male të larta në pjesën tjetër të territorit: pika më e lartë arrin në 2,751 m në kufirin me Kosovën dhe Maqedoninë, ndërsa shumë vargmale i tejkalojnë 2,000m në pjesë veriore, qendrore dhe jugore të vendit.


Shirat kanë karakter stinor ku vetëm 14% e tyre bien gjatë periudhës Qershor-Gusht. Muajt më të lagësht janë Tetori dhe Dhjetori. Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen mujore të reshjeve për periudhën 1970-2000. Në të paraqiten dy kategori të dhënash: mesatarja e të gjitha viteve, si edhe mesatarja e tre viteve më të thata (të emërtuar si 1-në-10 vitet më të thata). Një element që bie në sy kur krahasojmë mesataren dhe vitet e thata është se shpërndarja sezonale është e ndryshme, ku vihet re një ulje e sasisë së reshjeve në muajt e dimrit.

**Figura 1: Reshjet mujore**



Shpërndarja e temperaturës gjatë vitit është gjithashtu sezonale, ku temperaturat gjatë verës janë 20°C më të larta se temperaturat gjatë dimrit. Grafiku i mëposhtëm paraqet temperaturën mesatare mujore për vendin për periudhën 1970-2000, si dhe mesataren e 3 viteve më të nxehta (të emërtuar si 1-në-10 vitet më të nxehtë). Ky ndryshim në temperaturë midis një viti 'të nxehtë' dhe vitit mesatar është pak a shumë i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit.



**Figura 2: Temperatura mesatare mujore**

Përveç ndryshimeve nga njëri vit në tjetrin si dhe ndryshimeve sezonale, në vend ka edhe ndryshime gjeografike shumë të dukshme. Shirat vijnë kryesisht nëpërmjet erërave jugperëndimore dhe ndikohen edhe nga relievi. Kjo ofron një larmi veçorish klimatike dhe të ecurisë së reshjeve në rajonet e vendit. Edhe pse reshjet e shumta shoqërohen përgjithësisht me rritje të nivelit të ujit, kjo nuk ndodh njëllë në të gjithë territorin si në pjesën e sipërme të Basenit të Drinit, e cila mbetet një zonë e thatë.

Reshjet më të pakta vjetore në Shqipëri bien në zonat bregdetare në jug me vlera nën 1,000mm/vit. Megjithatë, ka pjesë të basenit ujor të Drinit në Kosovë dhe Maqedoni ku reshjet vjetore janë më të pakta dhe nuk i kalojnë 800mm/vit. Reshjet më të shumta bien në rajonin e Liqenit të Shkodrës ku reshjet mesatare vjetore i tejkalojnë 3,000mm/vit.

Temperaturat mesatare vjetore më të larta vihen re në pjesën perëndimore të vendit me 15°C më të larta në bregdet. Temperaturat vjetore më të ulëta shënohen në veri afër kufirit me Kosovën dhe në lindje afër Liqenit të Ohrit.

Efekti i kombinuar i reshjeve dhe temperaturës (dhe ndryshime të tjera meteorologjike) çojnë në përfundimin se prurjet janë më të larta në veri dhe jug të vendit, ku sasia e reshjeve tejkalon sasinë e ujit që avullon më shumë se 500mm në vit. Në pjesën qendrore të vendit reshjet arrijnë më pak se gjysma e kësaj vlere.

### 1.2.3 Ujërat sipërfaqësore

Ujërat sipërfaqësorë përfshijnë lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe lagunat. Rreth 150 përrenj të vegjël formojnë tetë lumenj të mëdhenj në Shqipëri. Këto përfshijnë Bunën (41 km), Drinin (285 km), Matin (115 km), Ishmin (74 km), Erzenin (109 km), Shkumbinin (181 km), Semanin (281 km), dhe Vjosën (272 km), të cilët rrjedhin në drejtim Jug-Lindje-Veri-Perëndim në drejtim të Detit Adriatik. Lumenjtë kanë një rrjedhë stinore të parregullt të cilat kulmojnë në dimër ose në fillim të vjeshtës (Lushaj dhe të tjerë, 2016). Pothuajse të gjithë kanë më pak se 10% të mesatares së tyre të dimrit gjatë stinës së verës. Shumica e rrjedhave të ujit janë të rrëmbyeshme me shpate të thepisura (Pano dhe të tjerë, 2016), duke i bërë ata pre e erozionit të dheut. Me qëllim menaxhimin e burimeve ujore, vendi është ndarë në 6 basene ujore të përkrahura në Pjesën 1.2.3.

Tre liqene të mëdhenj dhe 247 liqene të vegjël mbulojnë gjithsej 4% të territorit të vendit. (Lushaj dhe të tjerë, 2016). Tre liqenet e mëdha (Ohri, Prespa dhe Shkodra) janë ndërkuftare. Liqenet ndikohen nga ndryshime të forta natyrore, dhe nga ndërhyrjet intensive dhe të pakontrolluara të njeriut (Popovska, 2013).

Liqeni i Ohrit dhe Liqeni i Prespës janë liqenet më të mëdha tektonike në Evropë dhe i përkasin pellgut ujëmbledhës të Drinit, i cili derdhet në Detin Adriatik. Sipërfaqja e Liqenit të Ohrit është 358km<sup>2</sup>, nga të cilat 249km<sup>2</sup> i përkasin Maqedonisë dhe 109km<sup>2</sup> Shqipërisë. Vetë liqeni ka një gjatësi maksimale prej rreth 30km, me thellësi maksimale prej 289m dhe një thellësi mesatare prej 164m. Rajoni i Prespës përfshin dy liqene të ndërlidhura ndërmjet tyre: Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe të cilat janë rrethuar nga ekosisteme malore. Të dy liqenet së bashku formojnë pjesën më të thellë të një baseni të brendshëm malor i cili nuk ka një pikë rrjedhjeje natyrore (burim) në sipërfaqe. Derdhja e ujit bëhet vetëm nëpërmjet një lidhje nëntokësore nga Liqeni i Madh i Prespës drejt Liqenit të Ohrit. Sipërfaqja aktuale e të dy Liqeneve është afërsisht 301km<sup>2</sup>.

Regjimi i ujit në Liqenin e Ohrit kontrollohet në Strugë. Niveli i ujit në Liqenin e Prespës së Madhe ka një tendencë në rënie që prej vitit 1987. Në të vërtetë, një raport nga UNDP (2014) tregon se niveli i ujit në të dy liqenet është duke rënë në një shkallë të konsiderueshme nga pikëpamja statistikore. Aktualisht, Liqeni i Ohrit dhe Liqeni i Prespës kanë lëndë ushqyese në sasi të kufizuar (janë oligotrofikë), me përjashtim të disa zonave ku shkarkimet në degët e lumenjve ushqyes kanë rritur përqendrimin e nitrogjenit dhe fosforit.

Liqeni i Shkodrës, i cili ka një origjinë tektonike dhe karstike, është liqeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit. Ai ndodhet në pjesën Jug-Lindore të Malit të Zi, në Luginën Zeta-Shkodra, dhe në Shqipëri në terrenin karstik të Alpeve Dinarike Jug-Lindore. Sipërfaqja e Liqenit është 368km<sup>2</sup> nga të cilat 149 km<sup>2</sup> shtrihen në vend. Gjatësia e vijës së tij është 48km, gjerësia është 26km dhe thellësia 7-10m. Bregu i Liqenit është 150km i gjatë.

Përsa i përket cilësisë së ujit, përbërjet organike dhe ushqimore për të gjithë liqenet ishin në nivele të kënaqshme në periudhën 2004-2011<sup>10</sup>. Aktualisht, gjendja e cilësisë së ujit nuk është e qartë duke qenë se shumë parametra fiziko-kimikë nuk monitorohen në mënyrë të rregullt. Vlerësimet e cilësisë së ujit të kryera në vitin 2016 duke përdorur sisteme klasifikimi dhe duke u bazuar mbi parametrat biologjikë, hidromorfologjikë, kimikë dhe fiziko-kimikë (Karakterizimi BE-DKU), tregojnë ndotje dhe ndryshime hidromorfologjike në ekosistemet ujore (GIZ, 2016).

Shqipëria ka rreth 626 rezervuarë të cilët janë ndërtuar më së shumti përgjatë lumenjve, dhe që kanë një kapacitet grumbullues prej 5.6 miliardë m<sup>3</sup> që përdoret për ujitje, mbrojtje kundër përmytjeve dhe prodhimin e energjisë elektrike (Lushaj dhe të tjerë, 2016). Afërsisht 97% e prodhimit të përgjithshëm të brendshëm të energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet përgjatë Lumenjve të Drinit, Matit dhe Bistricës. 50% e tokës bujqësore që prodhon rreth 80% të produktit bujqësor në vend ujitet nga këto burime ujore.

Shqipëria ka një sasi të konsiderueshme ujërash bregdetare dhe tranzitore (Miho dhe të tjerë, 2013) me një vijë bregdetare prej rreth 427km. Bregdeti është i ndarë në katër zona kryesore nga të cilat 273km i përkasin bregdetit të rrafshët të Adriatikut<sup>11</sup> dhe rreth 154km bregdetit shkëmbor Jonian<sup>12</sup>. Uji i detit përparon në tokë deri në disa kilometra në disa prej zonave bregdetare, përmes grykëderdhjeve lumore, lagunave, moçaleve dhe kënetave. Habitatet më të rëndësishme tranzitore, ligatinat bregdetare dhe lagunat shtrihen përgjatë bregdetit fushor të Adriatikut.

Pas viteve 1950, shumë nga këto ligatina u thanë dhe u përdorën për tokë bujqësore. Lumenjtë u ndryshuan nga digat dhe shpesh atyre iu ndryshua drejtimi, siç është rasti i Drinit në Lezhë. Kanale të rëndësishme kullimi dhe stacione pompimi janë instaluar për të parandaluar përmytjen e fushave bujqësore. Si rezultat, ligatina me vlera u zhdukën edhe pse ende mbeten laguna të mëdha ku përfshihen Laguna e Karavastasë,

<sup>10</sup> Raportuar nga Autoritetet Shqiptare pranë Agjencisë Evropiane e Mjedisit 2004-2011.

<sup>11</sup> Me (a) deltën e Bunës, dhe (b) bregdeti midis Shëngjinit dhe Vlorës.

<sup>12</sup> Nga (c) Gjiri i Vlorës deri në Sarandë dhe (d) nga vija bregdetare e Sarandës, në zbritje drejt Greqisë.

Nartës dhe Butrintit. Këto sisteme natyrore ujore të cilat janë të rëndësishme për shak të vlerave të tyre të veçanta për biodiversitetin, janë nën kërcënim të vazhdueshëm nga ndotja që vjen si pasojë e ndërhyrjeve të njeriut. Shumë kanale kullimi si dhe mbetjet nga kënetat ose lagunat bregdetare të mjelmëta të mëparshme u përmytën, duke formuar ligatina të kripura shpesh me një përqendrim të lartë algash. Shumë nga këto zona tranzitore (në grykëderdhje) janë populluar nga peshqit e detit dhe shpendët shtegtarë të ujit, të dy të rëndësishëm si për vendin edhe për të gjithë vijën bregdetare të Adriatikut (Miho dhe të tjerë, 2013). Ndotja me pesticide është aktualisht e papërfillshme për kënetat përgjatë Detit Adriatik (Nuro dhe Marku, 2012).

Çdo vit, Instituti i Shëndetit Publik kryen monitorimin e cilësisë së ujërave në vende për larje/plazhe në zonat bregdetare. Gjatë sezonit të larjes janë marrë kampione uji të cilët janë analizuar për baktere gjë që tregon praninë e ndotjes nga ujërat e zeza ose bagëtisë. Në vitin 2015, 50% e ujërave bregdetarë përmbushën vlerat e detyrueshme, ndërsa në vitin 2014 kjo përqindje ishte 98.6 % (AEM, 2016).

Të dhëna të tjera të raportuara mbi cilësinë e ujit (AKM, 2006-2015) në ujërat sipërfaqësore tregojnë një përmbajtje të lartë të elementeve ushqyeshme (nitrogjen dhe fosfor) dhe të elementëve të ngurtë të patretur, duke çuar kështu në ndotjen me lym të ujit, veçanërisht në grykëderdhjet e lumenjve dhe lagunave bregdetare. Nga ana tjetër, raportet tregojnë se sasia e metaleve të rënda në ujë dhe e sedimenteve në biotë është relativisht e ulët, e cila mund të vijë si pasojë e ndikimit në rënie të industrisë minerare që ka mbetur. Megjithatë, ujërat tranzitore dhe ujërat bregdetare në Republikë janë nën ndikimin negativ të ujërave të zeza dhe shkarkimeve industriale (Miho, 2013).

#### 1.2.4 Ujërat nëntokësore

Përshkrimet e përgjithshme hidrogeologjike të Shqipërisë tregojnë se akuiferët janë të pranishëm në shtatë formacione gjeologjike kryesore duke datuar që nga epokat Paleozoike te ajo Kuternare. Ujërat nëntokësore vijnë nga katër shtresa të ndryshme: depozitat aluviale, konglomeratet, karbonatet (guri gëlqeror) dhe shkëmbi bazë. Këto lloje kanë kapacitet ujëmbajtës dhe cilësi të ujit që ndryshon. Rrjedha totale e ujërave nëntokësore vlerësohet se është rreth 12.8 miliardë m<sup>3</sup>/vit (UNDP, 2012), megjithëse nuk ka një informacion të besueshëm për burimet aktuale të disponueshme të ujërave nëntokësore. Për më tepër, të dhënat paraprake tregojnë se burime të bollshme të ujërave nëntokësore janë të disponueshme në sistemin akuiferik ndërkuftar Dinarik Karstik me deri në 1.25 miliardë m<sup>3</sup>/vit. (Eftimi, 2010).

Akuiferët shumë prodhues janë të pranishëm kryesisht në akuiferët kuartenarë aluvionalë zhavorrorë që mbushin kryesisht luginat e lumenjve, fushat e ulëta, si dhe fushat ndërmaalore (Eftimi, 2010). Akuiferë të tillë përfshijnë rezervuarë me prodhim të lartë të ujërave nëntokësore. Akuiferë porozë me prodhueshmëri të ulët ndodhen në depozitat kuartenare të disa zona të Shqipërisë Qendrore dhe Perëndimore ku akuiferët prej çakulli nuk janë të pranishëm.

Drejtimi kryesor i rrjedhës së ujërave nëntokësore varet nga tiparet hidro-gjeomorfologjike, nga rrjeti i lumenjve dhe nga shkalla e çarjeve dhe shpellave të shkëmbinjve karstikë. Si i tillë, drejtimi kryesor shkon nga pjesa Lindore në atë Perëndimore të Shqipërisë, duke u derdhur në Detin Adriatik dhe Jon. Ujërat që lidhen me zonën ndërkuftare me Malin e Zi derdhen kryesisht në Detin Adriatik përmes shkarkimeve të tyre në Liqenin e Shkodrës, si dhe në Lumenjtë Buna dhe Drini. Një pjesë më e vogël e këtyre ujërave nëntokësore derdhet në drejtim të Malit të Zi në rajonin e Zonës së Vermoshit, si dhe në Kosovë, nga Jugu në Veri.

Ujërat nëntokësore përbëjnë një rezervë të rëndësishme natyrore duke qenë se janë burimi kryesor i ujit të pijshëm (ME, 2002). Afërsisht 75% e sasisë së përdorur për furnizim me ujë të pijshëm nxirret nga një total prej 90 pusesh dhe 110 burimesh natyrore, ndërsa ujërat sipërfaqësore përdoren për pjesën tjetër prej 25%. Për më tepër, ekziston një numër i papërcaktuar pusesh që marrin ujë nga akuiferët e cekët për ujë të pijshëm dhe ujitje.

### 1.2.5 Basenet ujore

Me qëllim menaxhimin e ujit, tetë pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve të mëdhenj në vend, janë kombinuar në gjashtë njësi kryesore hidrografike, të quajtura “Basene Ujore” (shih figurën 3), në përputhje me rregullat e BE-së (DKU, Neni 3). Tabela 6 paraqet vlerat kufi të BE-së për vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së ujit të trupave ujorë, ndërsa tabela 7 ofron një krahasim ndërmjet Baseneve Ujore për sa i përket sasisë së ujit, cilësisë së ujit dhe parametrave social-ekonomikë (që lidhen me ujin). Vlerësimi i cilësisë së ujit krahason pesë parametra të cilësisë së ujit<sup>13</sup>. Profilet sociale që lidhen me ujin përfshijnë informacion për demografinë dhe arsimin, sistemet e furnizimit me ujë, punësimin, veprimtarinë ekonomike dhe ekuilibrin gjinor. Krahasimi mund të përdoret për përcaktimin e përparësive/masave të ardhshme për secilin basen ujqor bazuar mbi treguesit e zhvillimit social-ekonomik dhe çështjet specifike në basen.<sup>14</sup>


**Tabela 6: Parametrat dhe kriteret e monitorimit të ujërave sipërfaqësore**

Parametër monitorues	Kufijtë e cilësisë evropiane				
Oksigjen i tretur	>7 mg/l	>6 mg/l	>5 mg/l	>4 mg/l	<3 mg/l
NBO <sub>5</sub>	<2 mg/l	<3.5 mg/l	<7 mg/l	<18 mg/l	>18 mg/l
Fosfor	<0.1 mg/l	<0.2 mg/l	<0.4 mg/l	<1 mg/l	>1 mg/l
NH <sub>4</sub>	<0.05 mg/l	<0.3 mg/l	<0.6 mg/l	<1.5 mg/l	>1.5 mg/l
NO <sub>3</sub>	<0.8 mg/l	<2 mg/l	<4 mg/l	<10 mg/l	>10 mg/l
<b>Vlerësimi i përgjithshëm</b>	<b>Shumë i mirë</b>	<b>I mirë</b>	<b>Mesatar</b>	<b>I dobët</b>	<b>Shumë i Dobët</b>

<sup>13</sup> Kërkesat për monitorimin e ujit për secilin basen ujqor janë detajuar në Vendimin Nr. 1189, datë 18.11.2009, që rendit parametrat cilësorë që duhet të analizohen për ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë. Monitorimi kryhet në 34 stacione, katër herë në vit për lumenjtë kryesorë.

<sup>14</sup> Bazuar në vizitat në terren, diskutimet, observimet dhe seminarët REC për Menaxhimin e Integruar të Ujit në vitin 2014.

Figura 3: Harta e baseneve ujore



## Drini

Baseni i Lumit Drin është më i madhi në vend dhe shtrihet në Shkodër, Kukës dhe në Rajonin e Dibrës. Trupat ujore të këtij sistemi ndërkufitar hidrologjik janë Liqeni i Prespës, Liqeni i Ohrit, Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Drinit dhe Lumenjtë e Bunës (të cilët shkarkojnë mesatarisht një volum prej 680m<sup>3</sup>/s (Lushaj dhe të tjerë, 2016) dhe tre rezervuarë artificialë<sup>15</sup> që u krijuan në fillim të viteve '60 dhe '70 për prodhimin e energjisë.

Pjesa më e madhe e ujit të pijshëm në Lumin Drin merret nga burimet, dhe 73% e popullsisë ka sisteme furnizimi me ujë me tubacion brenda ose jashtë ndërtesës. Për sa i përket arsimit, 65% kanë arsim bazë, 24% kanë arsim të mesëm, dhe 7% kanë diploma universitare. Rreth 4% e popullsisë është analfabete (INSTAT, 2011).

Sjelljet kulturore janë më shumë konservatore dhe patriarkale në këtë Basen në krahasim me zonat e tjera të vendit. Gratë janë më së shumti të pranishme në administratë publike dhe aktivitete bujqësore, ndërsa burrat në tregtinë me shumicë, aktivitete bujqësore dhe administrimi publik. Brenda Këshillit të Basenit Ujor, përfaqësimi i grave është aktualisht 8%, ndërsa në Agjencinë e Basenit Ujor gratë arrijnë kuotën 30%.

## Mati

Baseni i Lumit Mat mbulon një zonë prej rreth 2.993 km<sup>2</sup> (Lushaj dhe të tjerë, 2016) mbi Qarkun e Lezhës, duke qenë i formuar nga dy degë: Lumi Fan, që buron në Veri-Lindje, dhe Lumi Mat që rrjedh nga Martaneshi, në Rajonin e Bulqizës, në liqenin artificial të Ulzës, i cili transporton sasi të mëdha sedimentesh përgjatë rrugës së tij duke shkaktuar ndryshime në strukturën e shtratit të lumit që mund të shihen qartazi pranë kryqëzimit të Milotit (Grontmij/CarlBro, 2010).

Qytetet kryesore në këtë basen përfshijnë Rrëshenin, Laçin, Lezhën, dhe Burrelin. 95% e familjeve në Rajon janë të pajisura me sisteme të furnizimit me ujë, dhe 77% janë sisteme të furnizimit me ujë me tubacion brenda ose jashtë ndërtesave të tyre. Pjesa tjetër prej 18% e popullsisë ka sisteme alternative të furnizimit me ujë.

Niveli i arsimit është më i ulët se në Basenet e tjera Ujore, duke qenë se 4% e popullsisë është analfabete, 64% ka arsim bazë, 26% ka arsim të mesëm dhe vetëm 6% kanë vijuar arsimin e lartë. Pothuajse të gjitha veprimtaritë ekonomike në Basen mbizotërohen nga meshkujt. Në Këshillin e Basenit Ujor, gratë nuk janë të përfaqësuara dhe si rrjedhojë nuk janë të përfshira në procesin e vendim-marrjes për lejet për përdorimin e ujit. Në Agjencinë e Basenit Ujor vetëm 20% e punëmarrësve janë femra.

## Ishëm-Erzeni

Baseni Ujor i Lumit Ishëm-Erzen ndodhet në qender të vendit dhe ka një sipërfaqje me lartësi të ulët prej 1.439 km<sup>2</sup> (Lushaj dhe të tjerë, 2016), që mbulon Qarqet e Tiranës dhe Durrësit, të dy me më shumë se një milionë banorë. 98% e familjeve në Qarkun e Tiranës dhe 96% e familjeve në Qarkun e Durrësit janë të pajisura me sisteme të furnizimit me ujë. Ishëm-Erzeni përbëhet nga dy nën-ujëmbledhëskryesorë: Lumi Ishëm që përshin lumin e Tiranës dhe Lumin e Lanës dhe Lumi Erzen.

Arsimi dhe shkollimi është relativisht e lartë, me vetëm 2% banorë analfabetë, 50% me arsim bazë, 32% me arsim të mesëm dhe 16% me arsim të lartë. Meshkujt në Qarqet e Tiranës dhe Durrësit janë kryesisht të punësuar në tregtinë me pakicë dhe shumicë, ndërsa gratë në administratë publike, tregti me shumicë dhe pakicë si dhe aktivitete prodhuese dhe bujqësore (INSTAT, 2011).

Në Agjencinë e Basenit Ujor, përfaqësimi i grave është vetëm 7.7% ndërsa 37.5% e stafit të Autoritetit të Basenit Ujor janë femra, gjë e cila përputhet me Ligjin "mbi barazinë gjinore në shoqëri"<sup>16</sup>.

## Shkumbini

<sup>15</sup> Liqeni i Fierzës (sipërfaqe 82.60 km<sup>2</sup>, gjatësi 70 km), Liqeni i Komanit (sipërfaqe: 12 km<sup>2</sup>, gjatësi 34.5 km) dhe Liqeni i Vaut të Dejës (sipërfaqe 25 km<sup>2</sup>, gjatësi 10km).

<sup>16</sup> Bazuar në vizitat në terren.

Baseni Ujor i Shkumbinit përmban vetëm Lumin Shkumbin, disa degë të vogla dhe rezervuarë të vegjël për ujitje që përdoren për qëllime bujqësore (Lushaj dhe të tjerë, 2016). Ai zgjatet drejt Qarkut të Elbasanit, ku 75% e popullsisë ka sisteme të furnizimit me ujë me tubacion brenda ose jashtë ndërtesës. Lumi Shkumbin ka probleme të konsiderueshme mjedisore për shkak të ish-Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, i cili shkarkonte ujërat e ndotura industriale drejtpërsëdrejti në lum, ku shtretërit e lumenjve grumbullonin mbetjet e ngurta nga veprimtaritë në impiant (UNDP, 2009).

Në lidhje me arsimin dhe ndjekjen e studimeve, popullsia e Basenit Ujor të Shkumbinit përbëhet nga 4% banorë analfabetë, 65% me arsim bazë, 24% me arsim të mesëm dhe 7% me diploma universitare. Të dhënat e punësimit në qarkun e Elbasanit tregojnë shifra të njëjta për burrat dhe gratë me punësim në masë në sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Administrata publike ka një nivel më të lartë të punësimit të grave, ndërsa burrat mbizotërojnë në tregtinë me pakicë dhe shumicë. Duke qenë se nuk ka gra në Këshillin e Basenit Ujor dhe vetëm 20% e stafit të Agjencisë së Basenit Ujor janë femra, përfaqësimi i grave mund të konsiderohet si i ulët.

### Semani

Baseni i Lumit Seman përbëhet nga katër Lumenj (Semanin, Osumin, Devollin dhe Gjanicën) dhe shtrihet në Qarkun e Beratit, Fierit, Elbasanit dhe Korçës, ku 88% e popullsisë kanë furnizim me ujë me tubacion brenda ose jashtë ndërtesës. Megjithatë ende ekzistojnë zona historikisht të ndotura, analizat e fundit (Lushaj dhe të tjerë, 2016) kanë treguar një përmirësim të dukshëm të cilësisë së ujit në pjesën e poshtme të Lumit Seman. Ka shumë të ngjarë që ky përmirësim ka të bëjë me uljen e aktivitetit të nxjerrjes së naftës si dhe me përpjekjet për përmirësim të kontrollit të shkarkimeve në fushat e naftës, si dhe një ulje të veprimtarisë së industrisë kimike në Fier (Banka Botërore, 2015).

Afërsisht 3% e popullsisë është analfabete, 64% ka arsim bazë, 26% ka arsim të mesëm, dhe 7% ka diploma universitare. Si burrat ashtu edhe gratë punojnë në sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Sektorët e ndërtimit, përpunimit dhe minierave mbizotërohen nga meshkujt, ndërsa administrata publike, mbrojtja, arsimi, shëndetësia dhe veprimtaritë e punës sociale nga femrat.

Duke qenë se asnjë grua nuk punon në Këshillin e Basenit Ujor dhe vetëm një është e punësuar në Agjencinë e Basenit Ujor, nuk ka një pajtueshmëri me Ligjin Nr. 9970 “për barazinë gjinore në shoqëri”<sup>16</sup>.

### Vjosa

Baseni Ujor i Lumit Vjosa është sistemi i dytë më i madh ujor në vend, i cili rrjedh përmes Qarqeve të Vlorës dhe Gjirokastrës. Trupat ujore kryesore të tij janë lumenjtë Vjosa, Drino dhe Shushica si dhe Liqeni i Butrintit dhe Lagunat e Nartës dhe Orikumit. Në lumin Vjosa është duke u ndërtuar një digë hidroenergjetike dhe disa hidrocentrale të vegjël me sisteme devijimi në degët e tij. Lumi është ndërkufitar, ku një e treta e sipërfaqes së tij shtrihet në territorin e Greqisë.

93% e popullsisë ka sisteme të furnizimit me ujë me tubacion brenda ose jashtë ndërtesës. Rreth 3% e popullsisë është analfabete; 52% ka arsim bazë, 30% ka arsim të mesëm, dhe 12% ka diplomë universitare. Sektorët ekonomikë në të cilët janë të punësuar shumica e meshkujve janë bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, administrata publike dhe përpunimi, ndërsa shumica e femrave janë të punësuar në administratën publike, tregtinë me shumicë dhe pakicë, bujqësi dhe përpunim. Për sa i përket Ligjit Nr. 9970 “për barazinë gjinore në Shoqëri”, meshkujt mbizotërojnë në Këshillin e Basenit Ujor, ku gratë përfaqësojnë vetëm 16.6% të anëtarëve të këshillit. Agjencia e Basenit Ujor ka 40% anëtare femra, gjë që pasqyron një përfaqësim të ekuilibruar të të dy gjinive.

### Krahasimet ndërmjet baseneve

Tabela e mëposhtme ofron një përmbledhje të disa karakteristikave të përgjithshme të baseneve ujore<sup>17</sup>, duke krahasuar çështjet e përgjithshme social-ekonomike dhe rreziqet që vijnë nga përdorimin e burimeve ujore.

**Tabela 7: Pasqyrë e përgjithshme e burimeve ujore dhe problematikave në nivel baseni**

Parametri	Drini-Buna	Mati	Ishëm-Erzen	Shkumbini	Semani	Vjosa
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> ) (Baseni total në kllapa)	6,998 (6,818) (19,582)	2,993	1,433	2,444	5,649	4,365 (6,784)
Numri i banorëve	437,686	134,027	1,012,150	295,827	968,459	247,816
Numri i personave të punësuar	49,106	18,813	105,393	27,506	84,382	22,611
% e grave në Këshill/Agjenci	8/30	0/20	7.7/37.5	0/20	0/20	16.6/40
<b>Burimet ujore</b>						
Numri i lumenjve kryesorë	2	1	3	1	1	1
Numri i degëve	5	2	3	1	3	3
Gjatësia e lumit kryesor (km)	285	144	Ishëm-74 Erzen-108	181	281	192
Numri ekzistues i stacioneve monitoruese	5	4	10	4	6	5
Rrjedhja vjetore m <sup>3</sup> /s)	680	103	55.5	63.6	83.2	176
Cilësia e ujërave sipërfaqësore	Mirë –Shumë mirë	Mesatare	Moderuar	Mirë – Shumë mirë	Mesatare	Mesatare
Numri i liqeneve të mëdha	3	-	-	-	-	1
Numri i rezervuarve bujqësorë	80	40	95	85	115	95
Numri i akuiferëve kryesorë të përdorur (Banka Botërore, 2012)	3	1	2	3	2	5
Ujërat bregdetare	1 lagunë	4 laguna	-	1 lagunë	-	2 laguna + Zona Joniane
<b>Përdorimi i ujit</b>						
Rezervuarët për ujitje	Përdorim i lartë	Përdorim Mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim Mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim i lartë
Numri i hidrocentraleve	4	2	-	0	2	0
Koncesionet e hidrocentraleve	148	85	4	112	104	65
Përdorimi sipas industrisë	Përdorim i lartë	Përdorim Mesatar	Përdorim Mesatar	Përdorim Mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim Mesatar
Potenciali për vende të ndotura	i Lartë	i Ulët	Mesatar	Mesatar	Mesatar	i Ulët
Numri i Zonave të Mbrojtura	10	6	2	6	11	18
Rëndësia e mbulimit me pyje	Shumë i rëndësishëm	Rëndësi mesatare	Rëndësi mesatare	Rëndësi mesatare	Rëndësi mesatare	Tepër i rëndësishëm
Përdorime të tjera	Transport ujor/ Peshkim	Ndërtim	Turizëm	Ndërtim	Peshkim	Turizëm
Rreziku nga thatësitrat	i Ulët	i Ulët	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Mesatar
Rreziku nga përmblytjet	i Lartë	Mesatar	i Ulët	i Ulët	i Lartë	i Lartë

Lidhur me tabelën e mësipërme, është e rëndësishme të theksohet se gjatë dy dekadave të fundit nuk është kryer monitorim sistematik i cilësisë së ujërave dhe se një pjesë e mirë e të dhënave lidhur me cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore janë të besueshme deri në një farë niveli. Megjithëse ka të dhëna dhe shumica e raporteve bazohen mbi mbledhjen josistematike të këtyre të dhënave, ato duket sikur japin vetëm një kuadër të përgjithshëm të sasisë dhe cilësisë së ujit.

<sup>17</sup> Përshkrime më të hollësishme gjenden në Strategjinë e MIBU-s tek pjesa e raportit të sfondit mbi basenet ujore.



### 1.2.6 Efektet që parashikohet të kenë ndryshimet klimatike në burime ujore

Shqipëria i përket zonës klimatike Mesdhetare Subtropikale e cila karakterizohet nga një dimër i butë me sasi të mëdha reshjesh, verë të nxehtë dhe të thatë, ku të gjitha kanë një ndikim thelbësor mbi burimet ujore në vend. Rajoni Mesdhetar është zona e Evropës ku temperaturat do të rriten më së shumti gjatë verës<sup>18</sup>, ndërsa reshjet vjetore dhe numri vjetor i ditëve me reshje ka shumë të ngjarë të ulet, gjë e cila nga ana tjetër rrit rreziqet nga thatësira.

Janë raportuar më parë skenarë në lidhje me ndryshimet klimatike (ME, 2002) duke përdorur disa modele IPCC<sup>19</sup>. Periudha 1961-1990 është përzgjedhur si periudha bazë. Simulimet tregojnë se rritja e pritshme vjetore e temperaturës mund të jetë 1°C deri në vitin 2025, dhe 1.8°C deri në 2050, përkatësisht. Reshjet priten të bien me 3.8% deri në vitin 2025 dhe 6.1% deri në vitin 2050, përkatësisht. Temperatura pritet të rritet gjatë të gjitha stinëve, siç edhe tregohet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 8: Skenarët e reshjeve/temperaturës**

Shtrirja në kohë	2025		2050	
	Reshjet	Temperatura	Reshjet	Temperatura
Vjetore	-3.4 -2.6%	0.8-1.1°C	-6.9 -5.3%	1.7-2.3°C
Dimër	-1.8 -1.3%	0.7-0.9°C	-3.6 -2.8%	1.5-1.9°C
Pranverë	-1.2 -0.9%	0.7-0.9°C	-2.5 -1.9%	1.4-1.8°C
Verë	-11.5 -8.7%	1.2-1.5°C	-23.2 -17.8%	2.4-3.1°C
Vjeshtë	-3.0 -2.3%	0.8-1.1°C	-6.1 -4.7%	1.7-2.2°C

Deri në vitin 2050, sasia totale e reshjeve vjetore pritet të luhetet ndërmjet 570mm (në Jug-Lindje të vendit) dhe 2,100mm (në zonën Jug-Perëndimore). Vlera maksimale parashikohet të jetë rreth 2,650-2,850mm në zonat alpine. Për shkak të temperaturave mesatare që priten të jenë më të larta në dimër, ka mundësi që pjesa më e madhe e reshjeve të bjerë në formën e shiut dhe jo të dëborës, gjë që do të rrisë lagështirën e tokës së bashku me erozionin dhe rrëshqitjen e saj. Ndërkohë pritet që të shtohet edhe numri i rasteve me shira të rrëmbyeshme. Numri i ditëve me reshje të rrëmbyeshme (maksimumi 24 orë) krahasuar me mesataren e viteve 1961-1990 ka gjasa të rritet me 1-2 ditë deri në vitin 2025, me 2-3 ditë deri në vitin 2050.

Për më tepër, është parashikuar që do të ndryshojnë edhe parametra të tjerë (MEFWA, 2009):

- Vranësitat priten të ulen me 2.6% deri në vitin 2050 krahasuar me vitin 1990. Si rrjedhojë e lidhjes së ngushtë me rrezatimin, numri i orëve me diell dhe rrezatimi global priten të rriten;
- Erëra më të mëdha priten të fryjnë kryesisht në verë;
- Temperaturat në rritje priten të kontribuojnë në një numër më të madh ditësh me stuhi breshëri në verë;
- Temperaturat më të larta do të ndikojnë gjithashtu shpeshtësinë dhe intensitetin e ditëve të nxehta dhe valëve të të nxehtit. Numri i ditëve me një temperaturë më të lartë se 35°C ka të ngjarë të rritet me 3-4 ditë deri në vitin 2020 krahasuar me mesataren e viteve 1961-1990;
- Numri i ditëve me ngrica (me temperatura më të ulëta se -5°C) në lartësi të mëdha pritet të ulet me 4-5 ditë deri në vitin 2025, dhe me 9 ditë deri në vitin 2050.

Si përfundim, temperaturat stinore dhe ndryshimet e reshjeve sugjerojnë një prirje drejt një dimri më të butë, pranverë më të ngrohtë, verë dhe vjeshtë më të thatë dhe të nxehtë. Nxehtësia në rritje dhe reshjet në rënie do të sjellin si rrjedhojë një zvogëlim të burimeve ujore që do të ketë ndikime negative të drejtëpërdrejta në popullsi dhe në ekosisteme. Me shtimin e ndryshimeve klimatike, duhet të ndryshojë infrastruktura dhe ofrimi i informacionit në mënyrë që të përballemi me pasojat e ndryshimeve klimatike (GWP, 2009).

<sup>18</sup> Modeli PRECIS bazohet në një skenar mesatar duke supozuar rritje ekonomike shumë të shpejtë, rritje të vogël popullore, me popullatën njerëzore që arrin pikun në mesin e shekullit, si dhe përdorimin e teknologjive të reja dhe më efikase.

<sup>19</sup> Komunikimi i Parë dhe i Dytë Shqiptar me Konventën Kuadër të Ndryshimeve Klimatike të Kombeve të Bashkuara përdorën Modelin MAGICC / SCENGEN për Vlerësimin e Ndryshimeve Klimatike të Shkaktuara nga Gazrat Serrë.

## Pamjaftueshmëria e ujit dhe thatësitrat

Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë të reshjeve në bimësi, është e qartë se ulja e parashikuar më sipër e sasisë së reshjeve do të ulë edhe prurjet e lumenjve. Studimet tregojnë një rënie të kullimit nga 1.2% deri në 2.1% për çdo 1% rënie të reshjeve. Ndjeshmëria e kullimit ndaj ndryshimeve klimatike varet nga karakteristikat e pellgut ujëmbledhës; sa më i vogël pellgu ujëmbledhës, aq më e madhe ndjeshmëria dhe prekshmëria nga ndryshimet (Arias, 2014).

Burimet ujore priten të ulen me 14% (EVN/Starkraft, 2009) deri në vitin 2050<sup>20</sup>. Përlllogaritet se gjatë verës, rrjedha e mbetur në basenet e Semanit dhe Shkumbinit do të arrijë më së shumti rrjedhën aktuale Q95<sup>21</sup>. Në skenarin e rastit më të keq, baseni Ishëm-Erzen do të përfshihet gjithashtu në këtë kategori.

Në lidhje me zonat e tjera të vendit, deri në vitin 2050, rrjedha e mbetur në verë parashikohet të jetë 2-4 herë më pak se rrjedha aktuale, që do të thotë rrjedha natyrore hidro-dinamike e ujit do të jetë në rrezik. Deri në vitin 2050 rrjedha Q95 pritet të ulet me 25-50% (CESR, 2011). Një tjetër vlerësim i ndjeshmërisë ndaj klimës (BB-ESMAP, 2009) i përgatitur duke u bazuar në parashikimet e temperaturave dhe reshjeve vlerëson se do të ketë reduktime me rreth 20% në pellgjet ujëmbledhëse të Lumenjve të Drinit, Matit dhe Vjosës.

Rrjedhat mjedisore, të cilat nevojiten për të ruajtur shëndetin e ekosistemeve, janë të kërcënuara paralelisht nga ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimet social-ekonomike. Si rezultat, është e rëndësishme që të ulet reduktimi gjatë periudhave me rrjedhë të ulët (verë) për të pasur mundësi të ruhen funksionet e ekosistemit. Lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet ujit, mjedisit natyror, strukturës dhe funksionit të habitateve detyron përdoruesit e ujit të menaxhojnë burimet në mënyrë të tillë që të mbrojnë, dhe aty ku është e mundur, të rrisin në maksimum mundësinë për të ruajtur dhe rikthyer biodiversitetin (Defra, 2012).

Krahasimi i nxjerrjes së ujit me disponueshmërinë e ujit tregon se basenet e Semanit, Shkumbinit dhe Ishëm-Erzenit janë parashikuar që të kenë mungesë të theksuar uji në verën e viteve 2050, qoftë edhe në skenarin më optimist<sup>22</sup>. Baseni i Vjosës nga ana tjetër karakterizohet nga një mungesë mesatare e ujit deri në vitin 2050 qoftë edhe në skenarin më të keq nga pikëpamja e përdorimit të ujit<sup>23</sup>. Të dy shembujt tregojnë dy ekstremet që përfshijnë llojet e ndryshme të skenarëve (CESR, 2011).

## Disponueshmëria e ujit në sistemet e ujit nëntokësor

Disponueshmëria e ujit në sistemet e ujërave nëntokësore varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve, avullimi përmes shtresave të tokës, ndikimi i temperaturës, aftësia e dherave për të mbajtur lagështinë, mbulesa e bimësisë, si dhe rritja e nivelit të ujit të detit dhe përdorimi i tokës (UNFCCC, 2011). Të gjithë këta faktorë mund të ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve në klimë (Arias, 2014). Ndërkohë që kapaciteti ujëmbajtës është një karakteristikë e dherave bazuar në përmbajtjen e argjilës, strukturën dhe nivelet e përmbajtjes organike, përmbajtja faktike e ujit është shumë e ndryshueshme (DKU, 2012).

Akuiferët rimbushen vetëm pasi të jetë mbledhur sasi e mjaftueshme uji në sipërfaqe në ato zona, ku filtrimi në formacione më të ulëta të pakonsoliduara dhe të konsoliduara është i mundur. Në situatat kur toka është e thatë, filtrimi i ujërave sipërfaqësore ndodh në rastet e reshjeve të dendura; përndryshe uji thithet shpejt dhe përdoret nga bimësia ose avullon përsëri në atmosferë. Si rrjedhojë, ndryshimet në reshjet vjetore (dhe/ose ndryshimet në modelet e ngjarjeve të reshjeve ekstreme), do të ndikojnë disponueshmërinë e ujit për rimbushje (UNFCCC, 2011).

<sup>20</sup> Deri në 2030, një simulim i skenarëve SRES të IPCC's TAR në deltat e Lumenjve Drin-Mat parashikon një rënie të shkarkimeve mesatare me 6 deri 8%.

<sup>21</sup> Q95, rrjedha tejkalon 95% të kohës, konsiderohet si një kufi kritik për ruajtjen e funksioneve të ekosistemeve ujore, ku nuk lejohet tërheqje e ujit nga lumi.

<sup>22</sup> Skenari i Qëndrueshmërisë Përfundimtare skicon tranzicionin nga një Evropë globalizuese e orientuar për nga tregu, drejt qëndrueshmërisë mjedisore, ku nismat vendore drejtojnë dhe ku panorama bëhet njësisë bazë.

<sup>23</sup> Skenari i Ekonomisë në Vendin e Parë, parashikon se një ekonomi e globalizuar dhe e liberalizuar jep shtysë për përdorimin e të gjitha burimeve të disponueshme të energjisë dhe një intensifikim të bujqësisë kur ajo është fitimprurëse.

Përmbajtja e ujit në tokë parashikohet të ulët, veçanërisht në verë dhe kushtet e ngopjes parashikohen të bien (gjithmonë e më shumë) gjatë dimrit dhe pranverës në Mesdhe (DKU, 2012), me humbjet më të mëdha përgjatë bregdetit të Adriatikut. Në këtë kuadër, parashikohet një ndryshim në avullimin mesatar vjetor prej -0.1 deri +0.2 mm/në ditë (EVN/Statkraft, 2009).

Rritja e nivelit të detit do të ndikojë zonat ku akuiferët me ujë të ëmbël po i nënshtrohen tërheqjes së tepërt që rezultojnë në ndërhyrjen e ujit të kripur, çka sjellin kripësimin e ujërave nëntokësore. Duhet theksuar se ndryshimi i klimës mund të ndikojë edhe disponueshmërinë e ujërave nëntokësore për shkak të kërkesës më të lartë për të, në shkëmbim të një disponueshmërie më të kufizuar të ujërave sipërfaqësore, që lidhen në mënyrë më dinamike me ndryshimet klimatike (Portmann dhe të tjerë, 2013).

## Përmbytjet

Përmbytjet janë një problem i shpeshtë (Selenica, 2011) duke qenë se përmbytjet nga reshjet (uji i reshjeve) ndodhin rregullisht; veçanërisht midis Nëntorit dhe Marsit, kur bien rreth 80% e reshjeve vjetore. Ultësirat perëndimore dhe basenet ujore të lumenjve Drin dhe Vjosë janë veçanërisht të prirur ndaj përmbytjeve për shkak të shpyllëzimit dhe mungesës së menaxhimit të shtretërve të lumenjve (Banka Botërore, 2003). Përmbytjet kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e komuniteteve vendore, duke dëmtuar shtëpitë e tyre dhe duke dobësuar situatën e tyre ekonomik. Me shkaktimin e dëmeve të konsiderueshme në tokat bujqësore dhe ndërprerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, përmbytjet rrisin rreziqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mund të dëmtojnë në mënyrë serioze vepra të ndryshme infrastrukturore.

Shumica e përmbytjeve ndodhin përgjatë baseneve ujore të lumenjve Bunë, Drin, Vjosë dhe Seman, duke ndikuar potencialisht 24,000 ndërtesa dhe deri në 840,000 persona. Sipas raporteve të brendshme të MBZHRAU, përmbytja e Lumit Vjosë në Janar të vitit 2016, ishte më e rënda që prej vitit 1954. Përmbytjet në basene të tjera ujore mund të ndikojnë 8,000 ndërtesa dhe deri në 50,000 persona (UNDP-Becchi, 2011).

Puna kërkimore bazuar në skenarët e IPCC-së<sup>24</sup> tregon se afati i kthimit në nivelin e rrjedhjeve me përsëritje 1 herë në 100 vite mund të ulet në 1 herë në 50 vite ose më pak, që do të thotë se një ngjarje e lidhur me nivelin e përsëritjes 1 herë në 100 vite në periudhën 1960-1990 është shumë më i mundshëm të ndodhë në periudhën 2020-2050. Kjo ilustron në Tabelën 9 më poshtë:

**Tabela 9: Shpeshtia mesatare vjetore e rrjedhjes maksimale me probabilitet përsëritjeje 1/100 vjet për Shqipërinë dhe Evropën dhe ndryshimi në përqindje midis situatës normale dhe afateve kohore të parashikuara**

Vendi	Ne	1990	f100		Δf100	
			2020	2050	2020	2050
Shqipëria	299	0.0096	0.0123	0.0405	29%	324%
Evropa	51154	0.0080	0.0159	0.0181	97%	126%

Burimi: Alfieri dhe të tjerë., 2015

Analiza e ndikimit të përmbytjeve të pritshme me një rrjedhje më të madhe do të ndikojë në rreth 340 aglomerate. Do të ndikohet një total prej 85,500 ndërtesash me një sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi prej 7,900 km<sup>2</sup> dhe 565,000 banorë (Poiani dhe Tola, 2010).

Rritja e nivelit të ujit të detit e parashikuar në bregdete, pritet të jetë 1 deri në 2 cm deri në vitin 2025 dhe 3 deri në 15 cm deri në vitin 2050 (Bruci, 2008), duke sjellë një përmbytje të zonave nën nivelin e detit. Komunitetet që jetojnë në këto zona pritet të zhvendosen më në brendësi të vendit. Bruci (2008) parashikon që plazhet në zona specifike (Shëngjin, Kune-Vain, Tale, Patok, Ishëm) do të ndikohen dhe toka bujqësore do të jetë më e përmbytur. Po kështu, përmbytjet mund të ndikojnë pjesërisht plazhet e ndodhura në zonat më në lartësi (Durrës, Golem, Divjakë, Himarë, Borsh).

<sup>24</sup> Bazuar në skenarin e shkarkimeve SRESA2 të IPCC TAR, duke përdorur modelin LISFLOOD.

Modelet e ndryshueshme të parashikuara të reshjeve (reshjet e dendura që mundësisht kombinohen me reshjet e dëborës së mëparshme dhe të dendura të ndikuara nga temperaturat e larta), parashikohet të sjellin përmbytje më të shpeshta (Si përmbytjet e shpejta edhe përmbytjet e thjeshta), me pika të reja ekstreme. Temperaturat më të larta dhe thatësitat mund të ndryshojnë strukturën e dherave në mënyrë të tillë që mund të humbasin në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin për të thithur reshje, çka sjell si pasojë përmbytjet. Zonat më kritike ku toka është tashmë e dëmtuar në mënyrë serioze janë Shkodra, Tropoja, Saranda dhe Gjirokastra. Për më tepër, praktikat e menaxhimit të tokës dhe përdorimit të tokës, si ndërtimi, administrimi i pyjeve, argjinaturat, digat dhe rezervuarët, kanë patur gjithashtu një ndikim të konsiderueshëm mbi faktorët që ndikojnë përmbytjet. Shkalla e përmbytjeve mund të ndikohet gjithashtu nga ngjarje ekstreme të ujërave të larta bregdetare, rritja e nivelit të detit dhe stuhitë me shpeshti të rritur, sidomos në Lezhë. Këto ndikime të parashikuara të ndryshimeve klimatike kërkojnë një kuptim më të mirë dhe njohuri më të thellë, për të qenë të aftë të parashikohen përmbytjet dhe të merren masa efikase ndaj përmbytjeve, në mënyrë që të shmangen ndikime domethënëse mbi shëndetin njerëzor, ekosistemet dhe infrastrukturën.

Mbrojtja nga përmbytja përfshin parandalimin e përmbytjeve, paralajmërimin e hershëm, minimizimin e dëmeve edhe reagim emergjent. Drejtoria e Ujërave pranë MBZHRAU aktualisht ka përgjegjësinë për parandalimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet, paralajmërimin e hershëm dhe minimizimin e dëmeve dhe rrezikut si pasojë e përmbytjeve. Bordet e kullimit janë përgjegjës për zbatimin e punëve mbrojtjeve nga përmbytjet. Drejtoria e Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme është përgjegjëse për reagimin emergjent. Mbrojtja nga përmbytjet është përgjegjësi publike dhe rrjedhimisht financimi i tij vjen nga buxheti i shtetit.

Dy tabelat e mëposhtme përmbledhin historinë e përmbytjeve në Shqipëri dhe përfshijnë vetëm vite kur ka ndodhur dëmtimi në një nga kolonat e përmendura. Në disa vite kishte lloje të tjera të dëmtimit. Ajo tregon se përmbytja është një dukuri e zakonshme në Shqipëri dhe se përmbytja shpesh çon në vdekje. Është gjithashtu e qartë se më shumë informacion është në dispozicion për përmbytjet më të fundit. Përmbytja e vitit 1905 shkaktoi numrin më të madh të vdekjeve dhe shtëpive të shkatërruara, por ka pak informacion për llojet e tjera të dëmtimeve, thuhet se përmbytjet ndodhën në rajonin e Liqenit të Shkodrës (Toto, 2014). Në të njëjtin vit kishte një shkallë 6.6 magnitude, një nga më të mëdhatë në Evropën Juglindore në 100 vitet e fundit, gjithashtu në rajonin e Shkodrës, duke rezultuar në 120 vdekje (Ghosh et al., 2014). Nuk është e qartë nëse janë apo jo të lidhura këto dy ngjarje.

**Tabela 10: Efektet e përmbytjes ne nivel kombëtar**

Viti	Vdekjet	Shtëpitë e shkatërruara	Viktimat	Dëmet në të mbjella (ha)	Kafshët e humbura	Rrugët e dëmtuara (m)
1865	14	0	0	0	0	0
1905	200	1500	0	0	0	0
1946	14	124	0	12861	2873	205
1947	0	5	0	0	0	0
1949	0	0	0	2642	0	0
1953	5	3	0	3778	87	0
1955	0	0	0	2994	0	0
1956	0	0	0	0	10	0
1960	4	177	557	569	27	0
1961	0	0	0	5	0	0
1962	7	351	3483	24900	7572	610
1963	0	79	56	1407	34	0
1968	0	0	0	1500	0	0
1970	0	0	0	21914	155	200
1971	0	0	0	26057	0	0
1972	2	0	0	0	0	0
1973	0	2	0	835	7	4800
1975	0	0	0	919	0	0

Viti	Vdekjet	Shtepitë e shkatërruara	Viktimat	Dëmet në të mbjella (ha)	Kafshët e humbura	Rrugët e dëmtuara (m)
1976	3	0	0	13862	0	0
1978	0	0	0	8342	0	0
1979	4	13	0	33206	24	0
1980	0	0	0	2163	0	0
1981	9	709	0	24321	546	0
1985	0	0	900	21434	573	0
1989	0	1	7	0	0	0
1994	0	0	40	800	0	0
1995	1	466	2000	10987	0	2000
1996	2	31	2600	5544	80	0
1997	0	0	68	6000	0	0
1998	0	28	29	7440	0	0
1999	0	6	26	7000	126	15000
2000	0	5	0	3	0	0
2001	1	1	589	3000	0	0
2002	0	4	16	0	0	0
2003	0	2	4	1063	26	40
2004	0	2	155	3050	0	0
2005	0	6	368	7620.2	25	800
2006	0	0	0	450	0	0
2008	0	0	17	410	0	0
2009	0	1	5	0	0	0
2010	0	3	68649	19049	31622	410
2011	0	3	6793	1092	75	0
2012	0	0	66	2001	0	0
2013	0	3	1155	9824	11	300
2015	1	0	1	7	0	0

Burimi: <http://www.desinventar.net/DesInventar/profiletab.jsp>

**Tabela 11: Efektet e përmbytjeve sipas qarqeve (quark)**

Qarku	Vdekjet	Shtepitë e shkatërruara	Shtepitë e dëmtuara	Viktimat	Dëmet në të mbjella (ha)	Kafshët e humbura	Rrugët e dëmtuara (m)
Berat	2	306	266	4140	10387	442	800
Dibër	0	9	112	79	980	0	200
Durrës	2	76	610	246	37675	1124	0
Elbasan	3	13	56	96	6040	216	15200
Fier	12	791	3542	140	84235	7841	150
Gjirokastër	17	2	9	0	2564	647	2050
Korçë	4	11	98	0	9925	20	610
Kukës	4	8	6	0	31	0	0
Lezhë	1	50	244	2973	50542	109	0
Shkodër	206	1972	6627	77528	51937	31721	4850
Tiranë	14	88	1331	1528	7309	599	205
Vlorë	2	199	2460	854	27422	1154	300

Burimi: <http://www.desinventar.net/DesInventar/profiletab.jsp>

### Cilësia e ujit

Ndryshimet klimatike ndikojnë cilësinë e ujit përmes një vijimësie të ndërlikuar mekanizmash natyrorë dhe antropogjenikë. Lloji i pellgut ujëmbledhës, gjeologjia vendore dhe përdorimi i tokës, stina, ndotësi i objektit dhe burimet e mundshme të ndotjes në kushtet vendore duhet të merren në konsideratë gjatë çdo

ekzaminimi të ndikimeve nga ndryshimet klimatike mbi cilësinë e ujit. Kjo mund të ndikojë negativisht në ekosisteme, shëndetin njerëzor dhe besueshmëri, si dhe kostot e operimit të shërbimeve ujore (IPCC, 2014).

Ritja e temperaturës së ajrit, do të ndikojnë gjithashtu në temperaturën e ujit, shtrirja do të ndikohet nga faktorë të ndryshëm si shpejtësia e rrjedhës, avullimi dhe thellësia e ujit (Defra, 2012). Uji me temperaturë më të lartë ndikon shkallën e proceseve bakteriologjike dhe reaksionet kimike në ujë. Ajo që është më e rëndësishme, kjo temperaturë favorizon rritjen e algave, që në vetvete ul nivelin e ngopjes me oksigjen, duke ndryshuar kështu shtresëzimin e ujit dhe duke intensifikuar eutrofizimin. Eutrofizimi mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ujit duke ndryshuar transparencën e tij, nivelet e oksigjenit të tretur dhe pH, që së bashku mund të kenë ndikime negative në funksionimin e ekosistemit si dhe në shëndetin njerëzor dhe sigurinë, veprimtaritë argëtuese dhe proceset e trajtimit të ujit. Eutrofizimi ndikohet gjithashtu nga ngjarje më të shpeshta reshjesh ekstreme, që mund të shpëlajnë lëndët ushqyese duke i dërguar në trupat ujorë. (IPCC, 2014).

Jo vetëm ushqyesit, por edhe ndotësit e tjerë si kripërat, koliformat fekale, patogjenët, metalet e rënda dhe kimikatet e ndryshme mund të gjenden dhe të shpëlahen në trupat ujorë, përfshirë rrëketë ujore, liqenet dhe ujërat nëntokësore, në sasi më të mëdha nga rrjedhjet e stuhive dhe përmblytjet, që në vijim mund të dëmtojnë ekosistemet përreth dhe shëndetin njerëzor (GWP-TEC, 2009). Si i tillë, ky është një rrezik i veçantë në Shqipëri, ku uji dhe trajtimi i ujërave të ndotura shpesh mungon. Këta ndotës mund të vijnë nga tokat bujqësore (plehurat kimike, pesticidet) si dhe nga (mbetjet) urbane dhe burimet industriale. Ngarkesat e mëdha të ndotësve në ujërat sipërfaqësore mund të dëmtojnë cilësinë e ujërave nëntokësore në mënyrë të konsiderueshme. Cilësia e ujit mund të jetë e ndjeshme edhe ndaj disa specieve invazive që mund të shfaqen si pasojë e ndryshimeve në ekosistem të shkaktuara nga ndryshimet e temperaturës së ujit dhe disponueshmëria e ujit e ndikuar nga ndryshimet klimatike (UNECE, 2012). Duke marrë në konsideratë efektet jo të drejtpërdrejta, fenomenet e lidhura me ndryshimet klimatike, mund të dëmtojnë infrastrukturën e rëndësishme të ujit dhe ujërave të ndotura dhe kështu të kërcënojnë cilësinë e furnizimit me ujë. Në veçanti, thatësit mund të çojnë në rëshqitje të dheut, që mund të çajë tubat e furnizimit me ujë dhe të lejojë ndotësit të futen në sistemet e ujit të pijshëm, apo në sistemet e largimit të ujërave të ndotura, duke shkakuar derdhjen e ujërave të ndotura në tokë dhe si rrjedhojë të arrijë në ujërat nëntokësore. Për më tepër, *“efektet e kombinuara të temperaturave më të larta, përqendrimit më të mëdha të ndotësve, periudhat më të gjata të ruajtjes dhe sedimentimi i mbetjeve të ngurta mund të sjellë rritje të gërryerjes së tubacioneve të largimit të ujërave të ndotura, jetëgjatësi më të shkurtër të asetëve, më shumë ndotje të ujit të pijshëm dhe kosto më të larta mirëmbajtje”* (IPCC, 2014).

Me rritjen e nivelit të detit, uji i detit depërton në akuiferët bregdetarë, veçanërisht aty ku ujërat nëntokësore pakësohen për shkak të reshjeve më të pakta (IPCC, 2014). Depërtimi i kripësirës në ujërat nëntokësore është një problem aktualisht ekzistues në afërsi të Lezhës, në Laç (UNECE, 2012). Për më tepër, uji i detit ka hyrë edhe në grykaja, ku rrjedhjet e pakësuara të lumenjve nuk mund të parandalojnë rrjedhjen në kahun e kundërt me rrymën drejt burimit (GWP-TEC, 2009). Ky ndryshim i cilësisë së ujit, ndikon gjithashtu në uljen e disponueshmërisë të ujit të ëmbël për përdorim nga njerëzit dhe nga ekosistemet.

Efektet e ndryshimeve klimatike të përshkruara më sipër tregojnë qartë se cilësia e ujit kërkon vëmendje të menjëhershme për të shmangur ndikimet e konsiderueshme në shëndetin e njerëzve, bujqësi, ekosistemet e lidhura me ujin dhe mjedisin në përgjithësi.

### 1.3 Përdorimi aktual i ujit

Qeveria Shqipëtare formalisht ka ngritur një mekanizëm bashkërendimi për menaxhimin e ujit për të gjithë sektorët e lidhur me të. Është hartuar një strategji bashkërendimi në nivelet më të larta politike për të integruar politikat kombëtare të sektorit të ujit, si dhe pikëpamjet dhe interesat sektoriale në hartimin dhe zbatimin e kuadrit MIBU (GWP-Jønch-Clausen, 2004). Për këtë janë përcaktuar katër shtylla:

- **Uji për Njerëzit**, që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve;
- **Uji për Ushqimin**, që përfshin bujqësinë;

- **Uji për Industrinë**, që përfshin hidro-energjetikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe kulturat ujore, peshkimin dhe zbavitjen;
- **Uji për Mjedisin**, që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet.

Do të aplikohen parimet e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, që janë të bazuar në efikasitet ekonomik, qëndrueshmëri mjedisore dhe barazi shoqërore (GWP-Pena, 2011). Barazia shoqërore është përkufizuar si *“sigurimi i aksesit të barabartë në ujë dhe në përfitimet nga përdorimi i ujit, midis grave dhe burrave, të varfërve dhe të pasurve, nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike si brenda vendit ashtu edhe në vende të tjera, dhe që përfshin çështje të së drejtës, aksesit dhe kontrollit”* (Lenton dhe Muller, 2011).

Këto çështje barazie janë të lidhura ngushtë me organizimin e përdorimit të ujit. Përfaqësimi i të gjithë përdoruesve të ujit në Këshillat e Baseneve Ujore të lidhur me menaxhimin e (burimeve) ujore dhe vendim marrjen, janë si rrjedhojë një aspekt thelbësor i Strategjisë MIBU, që ka qëllimin të mundësojë akses dhe shpërndarje të barabartë të ujit<sup>25</sup>.

### 1.3.1 Uji për Njerëzit

Deri në fund të vitit 2016, afërsisht 80% e popullsisë së përgjithshme ishte e lidhur me një sistem të furnizimit me ujë ku 50% ishte e lidhur me sisteme të ujërave të zeza, dhe ku të dyja administrohen nga 60 Ndërmarrje për Shërbimin e Ujit (NSHU)<sup>26</sup>. të cilat zotërohen edhe menaxhohen nga Bashkitë përkatëse.

Shumica e ujit të pijshëm (75%) nxirret nga burimet nëntokësore. 80% e popullsisë së përgjithshme shërbehet nga sistemet me furnizim me ujë, 76% të së cilave janë lidhje të drejtpërdrejta në banesë. Sipas të dhënave zyrtare (MTI, 2015) 91% e popullsisë urbane ishte e lidhur me sisteme bashkiake të furnizimit me ujë, ndërsa vetëm 57% në zonat rurale janë të lidhura me këto sisteme. Qëllimet e mbulimit për vitin 2017 për zonat urbane dhe ato rurale janë përkatësisht 98% dhe 85%, (NWSS, 2011).

Pavarësisht mbulimit relativisht të lartë, niveli i shërbimeve mund të përmirësohet duke qenë se disponueshmëria e ujit të pijshëm ishte vetëm 50% (ERRU, 2016) dhe, megjithëse aktualisht është duke u shtrirë, kjo është shumë më poshtë se vlera bazë e BE-së. Gjendja e puseve të ujërave nëntokësore, stacionet e pompimit, sistemet e shpërndarjes, dhe çisternat nuk monitorohen në mënyrë sistematike. Mirëmbajtja dhe riparimi i pamjaftueshëm, mungesa e matjes dhe kontrollit operacional kanë sjellë si rezultat të përbashkët humbje të tepërta të ujit, që vlerësohen se janë së bashku më shumë se 60% e prodhimit të përgjithshëm të ujit për të gjitha qytetet. Vëllimi i përllogaritur i burimeve ujore (MTI, 2015), është si më poshtë:

- Kapaciteti vjetor mesatar i të gjitha burimeve me ujë të pijshëm është përllogaritur 606 milionë m<sup>3</sup>;
- Vëllimi vjetor mesatar i ujit të pijshëm të prodhuar është 270 milionë m<sup>3</sup>.

**Tabela 12: Përmbledhje e performancës së sektorit të furnizimit me ujë për vitin 2012-2015**

Treguesit e performancës	2012	2013	2014	2015	2016	Prirja e Performancës	Objektivat e strategjisë sektoriale (2016)	Objektivat e strategjisë mirë
Mbulimi me furnizim me ujë (%)	80.51	80.06	80.8	81	79	Në ulje	n/a	96
Mbulimi me kanalizime (%)	49.37	48.29	51	50	49	Në ulje	75	87

<sup>25</sup> Duke marrë parasysh gjendjen aktuale gjinore në Shqipëri, një qasje me ndjeshmëri gjinore në lidhje me menaxhimin e ujit do të japë kontribut për arritjen e qëllimeve të barazisë shoqërore, duke përfunduar shpërndarjen e përfitimeve, duke ulur kostot shoqërore, duke ulur varfërinë, duke përfunduar menaxhimin dhe fuqizimin.

<sup>26</sup> Situata e licencimit në fund të vitit 2015 tregon se nga 57 kompani që vepron në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve sanitare, 43 operatorë kanë licenca të vlefshme, 7 operatorë ishin në procesin e rinovimit të licencës, 3 operatorë kishin licenca të skaduara dhe nuk kishin dorëzuar të gjithë informacionin e kërkuar për licencim, dhe 3 operatorë nuk ishin të licencuar.

Treguesit e performancës	2012	2013	2014	2015	2016	Prirja e Performancës	Performancë e mirë	Objektivat e strategjisë sektoriale (2016)
Furnizimi me ujë (ditë/orë)	11.69	11.99	12.1	12.1	11.7	Në ulje	18	18
Raporti i largimit (%)	90.9	82.23	91	92	93	Në rritje	95	96
Raporti i Matjes (%)	55.05	58.97	61.2	64	64	Nuk ka ndryshim	85	80
Ujë që nuk sjell të ardhura (%)	66.98	67.07	67.3	66.7		Nuk ka ndryshim	45	45

Burimi: ERRU, 2017

Në përgjithësi, sfidat e furnizimit me ujë janë (Banka Botërore, 2013):

- Praktikant joefikase tregtare, që kanë një ndikim të madh në stabilitetin financiar të NUK-ve. Kostot e larta të operimit, stafi i tepërt, mbledhje e ulët e faturave, niveli i lartë i ujit që nuk sjell të ardhura, sjellin si rezultat një deficit financiar që autoritetet qendrore dhe vendore janë duke e mbuluar me anë të subvencioneve, duke mbuluar shpesh 30% të kostove operative;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese është e kufizuar në veprimtarinë e emergjencës, vetëm si rezultat i mungesës së financimeve; duke sjellë si rezultat një degradim të përsheptuar të aseteve;
- Menaxhimi i kërkesës: me më pak se 50% të lidhjeve me matësa nxiten shumë humbja dhe konsumi i tepërt, duke ndikuar negativisht përpjekjet e NUK-ve për faturim dhe mbledhje të tarifave;
- Sfidat institucionale përfshijnë: menaxhimin me përvojë të paktë për zbatimin e kuadrit të ri legjislativ sipas praktikave ndërkombëtare tregtare; procedurave operative standarde që mungojnë dhe dokumentimi gjithëpërfshirës i aseteve të cilat kufizojnë operimin efikas, kapacitetin për investime dhe ndarjen në përparësi.

Aktualisht, rreth 50% popullsisë së Shqipërisë është e lidhur me sisteme të kanalizimeve, veçanërisht në zonat urbane por vetëm 25% shërbehet nga impiante të trajtimit të ujërave të ndotura që janë plotësisht funksionale. Kështu që, shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të ndotura në trupa ujorë ka sjellë një ndotje në masë dhe të rëndë të zonave bregdetare, lumenjve dhe shtretërve të lumenjve (BB, 2003).

Sfidat për një shërbim efikas të ujërave të ndotura përfshijnë (BB, 2013):

- Numrin e kufizuar të impianteve tradicionale për trajtimin e ujërave të ndotura që janë në funksion (Kavajë, Pogradec, Durrës, Sarandë, Korçë dhe Lezhë), të cilat nuk i shërben shumicës së popullsisë dhe efikasiteti i tyre ka një kontribut të kufizuar ndaj mbrojtjes mjedisore;
- Rehabilitimi i pjesshëm i rrjeteve të ujërave të ndotura ka sjellë si rezultat i bllokimeve të shpeshta në stacionet e pompimit, që kanë rezultuar në përmbytje.

Programi i investimeve që është duke u zbatuar aktualisht përmes financimeve ndërkombëtare në sektorin e ujit dhe të ujërave të ndotura mbulon si fushat teknike dhe institucionale, dhe ka si qëllim të rrisë nivelin dhe standardin e shërbimit sipas standardeve ndërkombëtare, duke u bazuar në përparësitë e identifikuara në Strategjinë Kombëtare për Furnizim me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017 (GoA, 2011).

#### Koha e lirë dhe turizmi

Turizmi po bëhet një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm në ekonominë e vendit. Në vitin 2006, kishin 937.038 vizitorë prej të cilëve 697.623 ishin për pushime (INSTAT, 2012). Për vitin 2012, shifrat ishin përkatësisht 3.513.666 dhe 1.582.897. Metoda e paraqitjes së statistikave u ndryshua në vitet e mëvonshme, por numri i përgjithshëm i vizitorëve në vitin 2015 ishte 4,131,242 (INSTAT, 2015c). Gjatë viteve 1990, turizmi përbënte vetëm një përqindje të vogël të PBB-së. Grafiku vijues tregon kontributin e turizmit në GDP-në e Shqipërisë.

Figura 4: Rritja e Turizmit





Burimi: [http://www3.weforum.org/docs/TT15/WEF\\_Albania.pdf](http://www3.weforum.org/docs/TT15/WEF_Albania.pdf)

Brenda kontekstit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, turizmi ka ndikim në dy fusha:

1. Ndryshim sezonal në kërkesën për ujë. Situata në vitin 2003 u përmblohd si më poshtë:

"Zhvillimi i turizmit në zonën e bregdetit kërkon më shumë disponueshmëri të ujit të pijshëm, sidomos në verë kur kërkesa rritet edhe nga konsumatorët tjerë, por infrastruktura nuk mundëson furnizimin e mjaftueshëm me ujë edhe pengon zhvillimin turistik. Një shembull është qyteti bregdetar i Durrësit (qyteti i dytë më i madh në Shqipëri me kapacitetin më të madh të akomodimit për turistët) ku uji është në dispozicion vetëm një herë në dy ditë për jo më shumë se disa orë. Situata është e ngjashme në qytete të tjera që kanë shumë turizëm, p.sh. në Sarandë, Vlorë dhe Pogradec." (INSTAT, 2012)

Një raport i vitit 2017 tregoi se problemet mbeten. Durrësi dhe Saranda ishin qytetet me mesataren më të ulët të furnizimit me ujë (Shoqërite Ujësjetëlës Kanalizime, 2017).

2. Përdorimi i lumenjve si atraksione turistike. Që lumenjtë të jenë një tërheqje turistike, duhet që ato të mbahen sa më shumë të jetë e mundur në gjendjen e tyre natyrore; Një objektiv në harmoni të plotë me Direktivën Kuadër të Ujërave. Shembujt përfshijnë:

- Kajak në lumin e Osumit;
- Lumi Vjosa, përshkruhet si një "thesar evropian", vlera e saj më e madhe qëndron në paprekshmërinë e saj.

#### Efektet e ndryshmeve klimatike lidhur me Ujin për njerëzit

Ngjarje më ekstreme të motit, përfshi këtu edhe përmytjet, mund të dëmtojë infrastrukturën dhe të sjellin ndërprerjen e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të higjienës. Thatësirat dhe temperaturat e larta do të rrisin kërkesën për ujë të pijshëm dhe disponueshmëria burimeve ujore është me shumë gjasa në rënie. Disa puse të ujit të pijshëm do të thahen, ndërsa ato që do të mbeten do të shfrytëzohen akoma më shumë, e cila mund të sjellë pasoja shtesë (OBSH, 2009).

Për më tepër, siç edhe është përmendur, përmytjet dhe shirat e dendur mund të dërgojnë pesticidet, plehrat kimikë dhe ndotësit e tjerë të burimeve ujore. Ndërkohë që elementët ndotës filtojnë nën tokë duke rrezikuar akuiferët e cekët; ato dëmtojnë gjithashtu trupat e ujërave sipërfaqësore që përdoren për ujë dhe

veprimtaritë argëtuese, duke shkaktuar përfundimisht infeksione apo sëmundje. Epidemitë e sëmundjeve<sup>27</sup> të përhapura përmes ujit janë të lidhura me thatësitë e ndjekura nga shirat e dendur dhe rritjet e temperaturave, (DKU, 2012), kështu që një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar veprimtarive për kontrollin e cilësisë së ujit.

Të moshuarit, të vegjlit, dhe personat me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të ekspozuar ndaj përmbajtjeve dhe si rrjedhojë ndaj mungesave të furnizimit me ujë, gjë e cila sjell një rritje të mundësisë për t'u prekur nga sëmundjet që përcillen me anë të ujit. Ndryshimet klimatike ndikojnë gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme si rrjedhojë e nevojave, prioritetëve dhe mundësive të tyre të ndryshme dhe kjo ndodh edhe për menaxhimin e ujit. Gratë me të ardhura të ulëta, pa akses në mjediset me ujë të rrjedhshëm, mund të marrin më shumë njohuri dhe përvojë për kursimin e ujit në kushtet e shtëpisë; kështu që është e rëndësishme që të dëgjohet zëri i tyre në vendimmarrje si një grup i cënueshëm dhe si kontribues në planifikim (Banka Botërore, 2011). Shëndeti dhe siguria njerëzore, veçanërisht ajo e grupeve të cënueshme, do të jetë më shumë në rrezik si rrjedhojë e ndikimeve të ndryshimeve klimatike që kanë lidhje me ujin.

### 1.3.2 Uji për Ushqim

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë kombëtare në të cilën është e punësuar 50% e popullsisë (37.4% Meshkuj dhe 53.5% Femra). Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 695,000 hektarësh, e cila mbulon 24% të sipërfaqes së vendit, 80% është në pronësi private dhe 20% është në pronësi shtetërore (INSTAT 2013). Madhësia mesatare e fermës është 1.26 hektarë por ajo është e ndarë mesatarisht në 4.7 parcela, që do të thotë se madhësia mesatare e fermës për familje është vetëm 0.27 hektarë. Kulturat kryesore janë perimet, frutat dhe vreshtat, drithërat dhe ulliri.

Megjithëse ka dallime të shumta ndërmjet zonave agro-ekologjike (Figura 5), bujqësia kërkon një sasi shtesë të ujit në verë duke qenë se vetëm 20% e reshjeve të përgjithshme vjetore (mesatarisht 1,485 mm/vit) bien midis Majit dhe Tetorit. Deficitet e ujit ndërmjet Qershorit dhe Gushtit variojnë midis 400 dhe 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efikas të kulturave. Kullimi nga ana tjetër është i rëndësishëm në dimër për të zbutur përmbajtjet, erozionin dhe mbingopjen e tokës me ujë.

Për sa i përket organizimit dhe menaxhimit të ujitjes dhe kullimit, tradicionalisht, skemat e vogla për ujitje kanë ekzistuar dhe kanë qenë të mirë-organizuara sipas Rregullave zakonore të Kanunit (QJoiA, 2011). Intensifikimi i zonave të ujitura dhe zhvillimi i programeve të kullimit u krye gjatë regjimit socialist, duke rezultuar në 500 kooperativa bujqësore dhe në 150 ferma shtetërore që mbulonin, me 70% të tokës me akses në ujitje. Rreth mesit të viteve tetëdhjetë, skemat e ujitjes dhe kullimit mbuluan rreth 420,000 ha dhe 280,000 hektarë. Gjatësia totale e kanaleve ujitës ishte 25,000 km me 15,700 km kanale kullimi (Ismaili, 2010). Në total u ndërtuan 626 rezervuarë ujitjeje. Sistemet ishin menaxhuar nga organe qendrore nga Drejtoria e Tokës dhe Ujërave e Ministrisë së Bujqësisë, nëpërmjet Ndërmarrjeve të Ujit (NU) dhe Ndërmarrjeve të Ndërtimit (NN) në nivel rrethi. Ndërtimi i sistemeve të ujitjes në fushat bregdetare dhe të kullimit të ligatinave shkaktoi shkatërrime të mëdha të ligatinave.

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, më shumë se 300,000 ha të sistemeve të ujitjes dhe 153,000 ha të sistemeve të kullimit degraduan për shkak të mungesës së investimeve, buxhetit të pamjaftueshëm për funksionim dhe mirëmbajtje, dhe një kuadri menaxhimi të paqartë. Gjithashtu, performanca ishte e dobët pasi sistemet u projektuan me një efikasitet prej 70%, por efikasiteti aktual u vlerësua të ishte ndërmjet 30% dhe 60%. Për më tepër, privatizimi i tokës rezultoi në më shumë se 400,000 ferma të vogla (midis 0.5 ha dhe 3.0 ha). Këto ferma të vogla private kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bujqësisë dhe rolin e ujitjes. Si reagim, Qeveria Shqiptare miratoi një politikë për transferimin e përgjegjësisë operative të kanaleve dytësore të ujitjes tek përdoruesit e ujit, nëpërmjet krijimit të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (SHPU). Funksionimi dhe mirëmbajtja e kanaleve parësore dhe rezervuarëve të ujitjes mbetën përgjegjësi e Ndërmarrjeve Shtetërore të Ujit.

<sup>27</sup> Të tilla si speciet e Campylobacteriosis, Cryptosporidiosis, Norovirus dhe Vibrio.

Përpjekjet për rehabilitimin dhe rindërtimin e sistemeve të ujitjes kanë qenë të vazhdueshme (Sallaku, 2003) që prej mesit të viteve nëntëdhjetë. Nëpërmjet projekteve të financuara nga donatorët dhe buxheti i shtetit, infrastruktura e ujitjes është përmirësuar dhe është kryer rehabilitimi i sistemeve të kullimit. Digat, rezervuarët dhe argjinaturat mbrojtëse u rehabilituan. Megjithatë, SHPU-të nuk funksionuan siç pritej, pasi kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimit të ujitjes nuk ishin të mjaftueshme dhe SHPU-të nuk ishin të afta të mbulonin kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes. Në vitin 1998, qeveria shqiptare vendosi se përgjegjësia për funksionimin dhe mirëmbajtjen e strukturave parësore të ujitjes duhej t'i transferoheshin përdoruesve të ujit nëpërmjet krijimit të Federatave të Shoqërive të Përdoruesve të Ujit (FSHPU). Në përgjithësi, u krijuan më shumë se 200 SHPU dhe 2 FSHPU. Duke qenë se përgjegjësia për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes u transferua te përdoruesit e ujit, ndërmarrjet shtetërore të Ujit u ristrukturuan në 13 Borde Kullimi. Sistemi funksionoi, derisa në vitin 2008 u bënë disa ndryshime në Ligjin Nr. 8518, "Për ujitjen dhe kullimin", që ndryshuan statusin ligjor të Federatave të Shoqërive të Përdoruesve të Ujit (FSHPU) duke i transformuar ato në Organizata të Përdoruesve të Ujit (OPU), që janë njësi ligjore publike të vetë-financuara, që kryejnë vetëm veprimtari jofitimprurëse lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujitjes dhe ofrimin e ujit të ujitjes për përdoruesit e saj. Tre Organizata të Përdoruesve të Ujit u krijuan për të mbikëqyrur infrastrukturën prej rreth 12,000 ha tokë me akses në ujitje.

**Figura 5: Zonat agro-ekologjike**



Burimi: Ministria e Mjedisit


Duke qenë se shërbimet e ujitjes dhe kullimit kishin ende nevojë për përmirësime, u pa e nevojshme të përfshiheshin bashkitë dhe komunat në rolin thelbësor për vendimmarrjen lidhur me sistemet e ujitjes dhe kullimit, për këtë qëllim u hartua VKM Nr. 1108, nxjerrë më 30.12.2015 "Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelin dhe asetet nga Bordet Rajonale të Kullimit." Si pasojë, infrastruktura sekondare e ujitjes dhe digat e vogla u transferuan nga Bordet e Kullimit në Bashki. Nga 13 të mëparshme u krijuan katër Borde Rajonale të Kullimit të reja dhe të ristrukturuara, të cilat, së bashku me MBZHRAU, administrojnë vetëm infrastrukturën kryesore dhe digat kryesore të ujitjes dhe kullimit.

Uji nga 626 rezervuarët për ujitje (me një kapacitet të parashikuar prej 560 milion m<sup>3</sup>) përdoret për ujitje, ndërsa rreth 450 milion m<sup>3</sup> ujë devijohen drejtpërsëdrejti nga lumenjtë dhe përrenjtë. Përdorimi i ujërave nëntokësore për ujitje është i kufizuar (vetëm 3% e totalit (Ismaili, 2010)). Në përgjithësi uji për ujitje ka një cilësi të kënaqshme.

Megjithëse, kapaciteti i projektuar i rezervuarëve të ujitjes është rreth 560 milionë m<sup>3</sup>, për shkak të erozionit dhe aluvionit, kapaciteti i tyre real është përafërsisht 290 milionë m<sup>3</sup> ujë, ose 51% e kapacitetit të parashikuar. Për më tepër, 410 nga 626 diga kanë dëmtime të konsiderueshme teknike të cilat kanë nevojë


për vëmendje urgjente për të rritur sigurinë e digave dhe disponueshmërinë e ujit për ujitje. Reduktimi mesatar në kapacitetin e parashikuar është 45%, si pasojë e ciklit jetësor funksional të digave dhe rezervuarëve që janë drejt shkatërrimit dhe mbushjes me baltë. Vendndodhjet e digave tregohen në Figurën 6.

Figura 6: Vendndodhja e digave bujqësore



Grafiku i mëposhtëm i zonës së ujitur bazohet në të dhënat e marra nga shërbimi i FAO Aquastat. Deri në vitin 1992, sipërfaqja e pajisur për ujitje dhe zona e ujitur në të vërtetë ishin të njëjta. Që atëherë zona e pajisur për ujitje ka rënë nga me rreth 15%. Nga ana tjetër, aktualisht zonat e pajisur me infrastrukture ujitje ka rënë edhe më shumë. Arsyet për këtë janë komplekse, ku përfshijnë vështirësinë e planifikimit të ujitjes së tokës bujqësore të ndarë në parcela të vogla, gjendjes së dobët të funksionimit të disa prej stacioneve të ujitjes dhe kapacitetit të reduktuar të rrjedhjes së disa kanaleve të ujitjes.

**Figura 7: Zona e Ujitur**



Gjetjet paraprake të detajuara nga MBZHRAU (2015), treguan se afërsisht 200.000 hektarë në një zonë që ujitet ka nevojë për rehabilitim të infrastrukturës ujitëse. Kanalet kanë nevojë për largimin e llumit dhe veshjen e 5,000 km. Për më tepër, afërsisht 3,000 struktura ujitëse kërkojnë rehabilitim ose zëvendësim. Gjithashtu, pothuajse të 640 stacionet e pompimit për ujitje kanë defekte si rrjedhojë e kostove të larta të energjisë elektrike, mirëmbajtjes së dobët, vjedhjeve dhe dëmtimeve.

Për sa i përket kullimit, është bërë një përllogaritje se 9,000 km kanale kanë shumë llumë, dhe kërkojnë heqjen e rreth 20 milion m<sup>3</sup> llumë. Mungesa e mirëmbajtjes së vazhdueshme të kanaleve shkarkuese ka bërë që 100,000 hektarë të kenë nevojë për rehabilitim të infrastrukturës kulluese. Gjithashtu, 138 hidrovorët (stacionet e pompimit të kanaleve shkarkuese) janë në fund të jetës së tyre funksionale (MBZHRAU, 2015).

#### Efektet e ndryshimeve klimatike lidhur me Ujin për Ushqim

Sipas Programit për Vlerësimin e Ujit në Botë, sistemet ujitëse bujqësore në Evropën Jugore janë të prekshme nga ndryshimet klimatike në një nivel “mesatar”, ndërsa kapaciteti i tyre përshtatës u klasifikua si i ‘ulët’. Kontribues të rëndësishëm që shtojnë rrezikun për bujqësinë është reduktimi i reshjeve të kombinuara me temperatura më të larta të cilat sjellin si rezultat rënien e vëllimit si të ujërave sipërfaqësore ashtu dhe të atyre nëntokësore (UNESCO, 2009), ndërsa në të njëjtën kohë temperaturat më të larta rrisin kërkesën për ujë të kulturave bujqësore nëpërmjet nivelit të avullim-transpirimit. Numri i ditëve të thata është në rritje veçanërisht në pranverë dhe verë, gjatë stinës së rritjes së kulturave bujqësore (DKU, 2012).

Prodhimi bujqësor në Shqipëri, veçanërisht i perimeve dhe frutave, është më i ndjeshëm si rrjedhojë e temperaturave më të larta si dhe thatësirave të cilat mund të krijojnë kërkesë shtesë për ujitje. Megjithatë, kultura të tilla si gruri, jonxha dhe kullotat konsiderohen se përfitojnë nga temperaturat më të larta. Shirat ushqejnë vreshtat në të gjitha zonat agro-ekologjike, ndërsa prodhimi i ullinjve veçanërisht në zonat agroekologjike fushore pritet që të ulet, kurse domatet, të cilat ujitin, mund të bien pre e dëmtimit që vjen nga nxehtësia. Nëse nuk merret asnjë masë përshtatëse, kjo mund të çojë në një rënie të prodhimit të kulturave me më shumë se 15% (Ciscar dhe të tjerë, 2010).

Një faktor kritik që nxit cënueshmërinë në sektorin bujqësor është uji i tepërt nga përmbytjet, i cili shkakton dëmtime duke vonuar ose parandaluar mbjelljen ose kultivimin, duke kufizuar rritjen e kulturave ose shkatërruar bimët. Vlerësohet se disponueshmëria e ujit do të jetë më se e mjaftueshme për të përmbushur

kërkesën në rritje që parashikohet të vijë si rrjedhojë e rritjes së kërkesës nga bujqësia në vitet Mott MacDonald | Përgatitja dhe Zbatimi i një Strategjie MIBU 2050 (Sutton dhe të tjerë, 2013). Ky konstatim konfirmohet gjithashtu nga Harta e Agjencisë Evropiane për Mjedisin për parashikimet për disponueshmërinë e ujit për ujitje në Mesdhe (DKU, 2015).

Megjithëse disponueshmëria e ujit për prodhimin ushqimor pritet të jetë e mjaftueshme, duhet të ndërmerren masa për të ulur cënueshmërinë dhe rritur përshtatjen ndaj bujqësisë. Këto masa lidhen kryesisht me modernizimin e bujqësisë, (Miratimi i Praktikave më të Mira), ujitjes dhe infrastrukturës së kullimit dhe organizimin institucional të këtyre sistemeve.

### 1.3.3 Uji për Industrinë dhe Energjinë

Industria është një sektor relativisht i vogël. Kontributi i saj në PBB u rrit pak më shumë se 8% në vitin 2007 deri në 10 % në vitin 2012, kryesisht përmes një performance të përmirësuar në prodhimin industrial dhe minierave (SKZHI, 2013). Kur përfshihet sektori i ndërtimeve, kontributi i përgjithshëm është i qëndrueshëm, me rreth 24%. Industria mundëson vetëm 17.4% të punësimit të përgjithshëm në vitin 2014. Për sa i përket gjinisë, përqindja e femrave që punojnë në industri është 11.6%, ndërsa treguesi përkatës për meshkujt është 21.9% (INSTAT, 2015).

#### Hidro-energjetika

Prodhimi i energjisë hidrike është burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike, duke zënë 97% të prodhimit energjetik aktual të brendshëm. Prodhimi nga hidrocentralet publike është 72.1% e prodhimit të brendshëm të përgjithshëm, ndërsa prodhimi i energjisë nga prodhuesit e pavarur të energjisë përbën 27.9% në vitin 2014. Prodhimi nga hidrocentralet publike kontrollohet nga KESH Sh.a., kompani 100% në kontroll shtetëror. Aktualisht, prodhimi ndryshon afërsisht nga 2900 GWh në vite shumë të thata deri në pothuajse 6,000 GWh në vite me shumë lagështirë (Banka Botërore, 2009).

Si pjesë e një përpjekjeje për të reformuar sektorin energjetik, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë ka privatizuar katër hidrocentrale (me kapacitet prej 76.7 MWh) dhe ka veçuar sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes me Kosovën dhe Malin e Zi; ka paraqitur një model të ri tregu dhe ka dhënë koncesione për ndërtimin e hidrocentraleve të reja (IFC, 2013).

Mbështetja pothuajse ekskluzive në energjinë hidrike për furnizimin me energji elektrike e bën prodhimin vjetor Shqiptar shumë të varur nga ndryshueshmëria e kushteve hidrologjike. Gjatë viteve të thatë, energjia elektrike hidrike mund të bjerë deri në 40% nën mesataren e prodhimit afatgjatë (siç edhe ka ndodhur në vitin 2007) ose të rritet 60% mbi mesataren gjatë një viti veçanërisht të lagësht (2010). Vitet e thatë kërkojnë importe të energjisë me kosto të lartë nga shtetet fqinje për të përballuar kërkesën e vendit. Megjithatë, si rrjedhojë e kapacitetit të kufizuar në shpërndarjen e energjisë, importimi i energjisë elektrike nuk mund të plotësojë prodhimin e brendshëm dhe operatori i sistemit është i detyruar të ndërpresë energjinë në vend gjatë periudhave kur kërkesa është më e lartë. Nga ana tjetër, viti tejet i lagësht 2010 e ktheu Shqipërinë në një eksportues neto të energjisë elektrike për herë të parë që prej vitit 1997. Interkoneksionet me sistemet fqinje të energjisë elektrike kanë një rëndësi kritike për furnizimin me energji elektrike, për balancimin e ngarkesës në çdo ditë dhe në çdo stinë.

Në dekadën e fundit, Qeveria mbështeti ndërtimin e Hidrocentraleve të Vegjël (WWF, 2015). Deri më 2015, 178 kontrata koncesionare ishin firmosur për ndërtimin e 517 hidrocentraleve të vegjël, 104 prej tyre janë në funksion dhe 75 janë duke u ndërtuar. Potenciali i furnizimit me energji i këtyre 517 HEC-eve sipas kontratave koncesionare të nënshkuara është rreth 2,130 MW (shifrat paraqiten nga AKBN).

#### Rezervuaret

Edhe pse hidrocentralet nuk janë të përfshira në bilancin e ujit ato janë sigurisht një përdorim i rëndësishëm i ujit në Shqipëri.

Një përparësi është se uji i përdorur për hidrocentral mund të përdoret më shumë se një herë. Uji që hyn në një digë në rrjedhën e sipërme mund të kalojë në një digë në drejtim të rrymës dhe të përdoret përsëri. Kjo ndodh në lumin Drini. Për periudhën 1998-2013, rrjedha mesatare vjetore në secilën nga tre zonat e digave në Drin ishte  $5.9 \times 10^9 \text{ m}^3$ ,  $9.0 \times 10^9 \text{ m}^3$  dhe  $9.9 \times 10^9 \text{ m}^3$  respektivisht. Nëse të gjitha ujërat kalojnë përmes

turbinave në secilën digë kjo do të nënkuptonte një 'përdorim' të ujit prej  $24.8 \times 10^9 \text{ m}^3$  në vit; Më e madhe se rrjedha totale e lumenjve Drini-Buna.

Situata është e ngjashme për tre digat e ndërtuara ose të planifikuara për lumin Devoll, një degë e lumit Semani. Në këtë rast, vlerat ekuivalente për 3 digat janë  $0.65 \times 10^9 \text{ m}^3$ ,  $0.79 \times 10^9 \text{ m}^3$  dhe  $1.36 \times 10^9 \text{ m}^3$  në vit. Me fjalë të tjera, rrjedha totale që kalon përmes turbinave është më shumë se dyfishi i rrjedhës së lumit në vendin e digës së fundit në seri.

Diga, të tilla si ato në Drin dhe Seman, kanë dy avantazhe. Së pari, kur hidrocentrali funksionon gjatë gjithë vitit, shkarkimi nga digat në verë do të jetë më i madhe se rrjedha natyrore. Kjo do të ndihmojë që ujtja të kryhet në rrjedhën e poshtme të digës. Së dyti, prania e rezervuarëve ka gjithashtu një përfitim tjetër për komunitetet që jetonë në pjesën e poshtme të saj. Për periudhën nga tetori deri në mars, rezervuarët operojnë në mënyrë të tillë që të mos kenë kapacitet të plotë. Kjo do të thotë se uji i përmbytjes mund të ruhet në rezervuarë dhe kështu të minimizohet dëmtimi i mundshëm në pjesën e poshtme të saj.

### Diga në lumin Drin

Në lumin Drin ekzistojnë tri diga të mëdha të ndërtuara kryesisht për hidrocentralin, por që operojnë gjithashtu për të minimizuar efektin në përmbytje. Aktualisht rregullat e veprimit janë ato të vendosura që nga vitin 1988. Tiparet kryesore të digave janë dhënë në tabelën vijuese:

Emri	Kapaciteti total ( $10^9 \text{ m}^3$ )	Kapaciteti dobishëm( $10^9 \text{ m}^3$ )	Niveli max (m)	Niveli në dimër (m)	Rruajtja nga përmbytjes ( $10^9$ $\text{m}^3$ )
Fierza	2.70	2.30	295	289	0.400
Komani	0.50	0.063	170	175	0.150
Vau i Dejes	0.580	0.044	76	74	0.075

Siç mund të shihet, rezervuari i Fierzës ka sigurinë më të madhe nga përmbytjet të tre digave. Niveli i dhënë më lart si "Dimri" është niveli, i cili, për aq sa është e mundur, nuk tejkalohet gjatë periudhës tetor-mars, prilli është një muaj kalimtar dhe gjatë kësaj periudhe niveli lejohet të rritet në nivelin maksimal operativ të tij. Ky rregull është zhvilluar për të siguruar mbrojtjen maksimale nga vërshimet në dimër kur ndodhin shumica e përmbytjeve dhe për të grumbulluar në muajt e fundit kur dëborat shkrihet dhe deri në pranverë, për të maksimizuar ruajtjen e ujit në dispozicion për verën.

Prurjet e vlerësuara të përmbytjeve për rezervuarin e Fierzës janë: 1 në 100 vjet:  $4570 \text{ m}^3/\text{s}$ , 1 në 1000 vjet:  $6100 \text{ m}^3/\text{s}$ , 1 në 10000 vjet:  $9600 \text{ m}^3/\text{s}$ .

Kolona e treguar si ruajtje e përmbytjeve është vëllimi ndërmjet nivelit "dimëror" dhe "maksimal". Kjo ruajtje nga përmbytjet për Fierzën është e barabartë me një rrjedhje prej  $4629 \text{ m}^3/\text{s}$  gjatë një periudhe 24-orëshe. Sidoqoftë, tunelet e shkarkimit në digë mund të shkarkojnë  $2600 \text{ m}^3/\text{s}$  dhe, për përmbytjen më të madhe, nivelet mund të rriten në 306.5 m, duke siguruar një ruajtje totale prej përmbytjeve prej  $1.345 \times 10^9 \text{ m}^3$ .


Për të lejuar akumulimin në rezervuarin e Komani, në lidhje me Fierzën, një sërë skenarësh janë marrë në konsideratë me nivele të ndryshme në rezervuar, në fillim të përmbytjes. Metoda e operimit bazë në rezervuarin e Komani është zvogëlimi i nivelit të tij deri kur Fierza është afër mbingarkesës.

Në rastin e Vau i Dejes, strukturat e shkarkimit në rezervuar janë të afta të shkarkojnë rrjedhën 1-në-10000-vjeçare, pas lejimit të funksionimit të Fierzës.

**Figura 8: Diga e Vaut të Dejës turbina edhe nen-stacioni elektrik**

Përfundimi është se për tre digat në Drin, edhe për një periudhë të kthimit prej 1 deri në 10 000 vjet, ka kapacitet për ta përballuar përmbytjen.

Grafiku i mëposhtëm tregon fluksin dhe rrjedhjen mesatare mujore natyrore për digën e Fierzës në Vaun e Dejës. Siç mund të shihet, shkarkimet janë më të ulëta se hyrjet në dimër, ndërsa digat janë duke u mbushur dhe rrjedhja është më e lartë se hyrja në verë. Funkcioni kryesor i digave është të sigurojë prodhim hidroelektrik gjatë gjithë vitit. Fakti që rrjedha e poshtme të digave në verë janë pothuajse dy herë më të larta se rrjedhat natyrore sigurojnë një përfitim të rastësishëm për përdoruesit e ujit, kryesisht në ujitje.



Gjatë ndërtimit të digës, është marrë në konsideratë edhe mundësia e rrëshkitjes që do të çonte në dëmtimin e saj. Në rastin e Fierzës u shqyrtuan dy plane të mundshme kundër rrëshkitjes; njëri nga të cilët mund të çonte në një volum të madh të rrëshqitjes së tokës, duke mbushur edhe plotësisht rezervuarin dhe krijuar përmbytje . Ekzistonte një mundësi e tretë e rrëshkitjes së tokës në rrjedhën e poshtme të digës së Komanit. Në secilin rast mundësia e rrëshkitjes dhe niveli I tokës monitorohen rregullisht edhe aktualisht nuk ka vend për shqetësim.

### Diga në lumin Seman

Hidrocentralet e mbi lumin Devoll, një degë e lumit Seman. Diga e parë është ndërtuar në Banjë. E dyta ajo e Moglicës është nën ndërtim. Digat janë ndërtuar nga Devoll Sh.A. e cila është një kompani shqipëtare, e zotëruar edhe administruar nga kompania norvegjeze Statkraft AS .



Hidrocentrali i Banjës e ka vendndodhjen në fshatin Banjë. Ndërtimi i një dige në këtë vend ka filluar që në mes të viteve 1980, si pjesë e Hidrocentralit të Banjës. Në fillim të viteve 1990 projekti ndaloi edhe struktura e tij nuk u finalizua kurrë. Përfundimi i hidrocentralit të Banjës ka një kapacitet instalues 70 MW edhe një prodhim esatar vjetor 242 GWh. Diga me bërthamë argjile është 940 m e gjatë, 370 m e gjëra edhe 80 m e lartë. Kapaciteti i rezervuarit është 391 milion m<sup>3</sup> edhe do të ketë një sipërfaqe 14 km<sup>2</sup>. Minimum i lëshimit të ujit është 4 m<sup>3</sup>/s. rezervuari është dizenuar të mbaj 1-në-1000-vit përmytje të 1812 m<sup>3</sup>/sec edhe një Përmytje Maksimale të Mundshme 3007m<sup>3</sup>/sec.

**Figura 9: Diga e Banjës – Tregon shkarkuesin nga përmytjet dhe bankinat mbrojtëse ne bjeftin e poshtëm**



Hidrocentrali i Moglicës është i dyti që do të ndërtohet në lumin e Devollit. Hidrocentrali i Moglicës do të ketë të instaluar një kapacitet 172 MW edhe një mesatare vjetore prodhimi 475 GWh. Digë me bërthamë asfalti do të jetë 320 m e gjatë, 150 m e lartë edhe 460 m e gjërë. Rezervuari i Moglicës do të ketë një sipërfaqe 7.2 km<sup>2</sup> edhe një kapacitet ruajtjeje 360 milion m<sup>3</sup>.

### **Diga të tjera Hidrocentralesh**

Në lumin Mat janë operojnw dy hidrocentrale, ai i "Ulëzës" edhe i "Shkopetit", me kapacitet të instaluar prej 49 MW (AEA, 2007).

Në lumin Vjosa, hidrocentrali i "Kalivaçit" me një kapacitet të instaluar deri në 100 MW.

Në lumin Bistrica operojnë dy hidrocentrale, "Bistrica I" dhe "Bistrica II", me një kapacitet të instaluar prej 27,5 MW.

Në Shqipërisë ka edhe 70 hidrocentrale të vegjël me një kapacitet që varion nga 20 KW në 9200 KW. Aktualisht vetëm 38 nga këto janë funksionale.

Nga totali i hidrocentraleve të vegjël:

- 32 Hidrocentrale operojnë me kontrata koncensionit, me kapacitet të instaluar 24,4 MW;
- 16 Hidrocentrale janë privatizuar edhe operojnë me një kapacitet të instaluar 2,047 MW;
- 22 Hidrocentrale janë në pronësi shtetërore me një kapacitet të instaluar 11,0 MW.


Qëllimi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve të vogla ishte furnizimi me energji i zonave të largëta malore. Ato kryesisht janë hidrocentrale me derivacion dhe përdorin rrjedhat e ujit pranë këtyre zonave.

### **Diga të tjera**

Përveç digave të përmendura më sipër, ka edhe 620 rezervuare më të vogla, me një kapacitet total ruajtjeje prej 5.6 miliardë m<sup>3</sup>, nga të cilat 307 kanë një lartësi prej 15 m ose më shumë. Ato u ndërtuan për mbrojtjen

nga përmbytjet. Shumë prej tyre kanë një kapacitet të reduktuar për shkak të depozitimit të baltës. Disa prej tyre funksionojnë me kapacitet jo të plotë. Kjo zvogëlon efektivitetin e tyre për kontrollin e përmbytjeve dhe ujitjen; Gjendja e disa prej tyre është e tillë që vetë ato përbëjnë rrezik përmbytjeje (UNECE, 2012).

**Figura 10: Vendndodhja e e hidrocentraleve të vegjël**



## Minierat

Minierat kanë qenë një aktivitet ekonomik i rëndësishëm dhe janë të pranishme në shumë rajone Malore të vendit. Para vitit 1990, sektori i minierave zinte një pjesë të madhe të fitimeve nga eksporti dhe Shqipëria ishte prodhuesi i tretë më i madh në botë për mineralin e kromit (UNDP, 2009). Prodhimi në miniera, pasurimi dhe shkrirja duke përdorur Mërkur dhe Arsenik, prodhon skorie dhe mbetje ujërash të ndotura që mbahen në pellgje, duke i lejuar elementët e tretur në ujë të kullojnë poshtë në tokë në ujëra nëntokësore dhesipërfaqësore, pa marrë parasysh ndikimet mjedisore. Gjithashtu këto mbetje shkarkohen në ujërat sipërfaqësore të cilat furnizojnë popullsitë, industrinë dhe tokat bujqësore në rrjedhën e poshtme. Impiante të tjera të prodhimit lëshojnë përbërës të klorinuar PCB dhe hidrokarbure (UNDP, 2009).

Nxjerrja dhe përpunimi i hershëm i naftës në zonën rreth Fierit (Lumi Seman), ka sjellë si rezultat ndotjen e konsiderueshme me hidrokarbure të tokës dhe ujit sipërfaqësor. Që prej vitit 2012, janë bërë përpjekjeve të bashkërenduara për të përmirësuar metodat e përpunimit dhe rehabilituar zonat e ndotura me hidrokarbure (Banka Botërore, 2015). Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre përpjekjeve sistemi ujor është përgjigjur në mënyrë pozitive por ndotja është ende e konsiderueshme. Faktori që kufizon jetësimin e ndryshimeve të konsiderueshme në rrjedhën e lumit janë mbetjet urbane të vazhdueshme dhe shkarkimet industriale në rrjedhën e sipërme dhe ndikimet e bujqësisë në rrjedhën e poshtme (UNECE, 2012).

Mbetjet e ndotura përfshijnë nën-produkte të kromit, bakrit, elementë të tjerë toksikë dhe kimikë. Një dëm i madh mjedisor vijon të ekzistojë nga minierat e braktisura, fonderitë dhe rafineritë që vijnë të punojnë me një kapacitet të kufizuar, ose të cilat janë braktisur dhe janë prishur. Megjithëse që prej vitit 2004 janë dokumentuar 35 zona të ndotura (Peck, 2004), shumë zona të tjera nuk janë analizuar ende për sa i përket llojit të ndotjes dhe vëllimit, ose për ndikimin që ato mund të kenë mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe cilësisë së ujit.

## Përdorime të tjera industriale të ujit

Ka një numër të kufizuar vend grumbullimesh për mbetjet e ngurta që pajtohen me standardet e mjedisit (Landfilli i Sharrës në Tiranë, Bushat në Shkodër, dhe Bajkaj në Sarandë), që sjellin si rezultat volume të mëdha mbetjesh që depozitohen në lumenj ose që mbledhen në zona të tjera të pakontrolluara apo të parregulluara. Dymbëdhjetë nga qytetet më të mëdha shqiptare kanë shërbimet e grumbullimit të mbetjeve në njëmbëdhjetë vend grumbullime të ndryshme me një mbulim që ndryshon. Riciklimi bëhet nga kompani private për produkte të tilla si metal, letër, plastikë, shishe qelqi, kuti alumini dhe goma. Shumica e produkteve eksportohen për përpunim, megjithëse ekziston një impiant i vogël i përpunimit afër Tiranës (UNECE, 2012). Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), në bashkëpunim me KfW dhe ministri të tjera të linjës, është duke hartuar Master Planin për mbetjet e ngurta urbane, të cilat, pas përfundimit, do të drejtojnë investimet e huaja deri në vitin 2030.

Peshkimi dhe akuakultura janë sektorë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Të dhënat e mbledhura së fundmi në nivel kombëtar tregojnë se 47.2% e sasive të kapura të peshkut kanë origjinë detare; ujërat e brendshme llogariten në 35.2%; ujërat bregdetare dhe lagunat përfaqësojnë përkatësisht 12% dhe 4.9%. Aktualisht, ka rreth 100 aktivitete të akuakulturës për kultivimin e troftës në përrrenj dhe lumenj malorë.

Operacionet ekzistuese të hidroenergjisë kanë krijuar liqene artificiale, që po përdoren gjithashtu për rritjen e peshqve. Aktivitetet me barka në lumenj dhe liqene artificiale nuk u është kushtuar shumë rëndësi, edhe pse ka një rritje të akomodimit, kapaciteteve të përpunimit dhe efikasitetit të portit, që ka çuar në shtimin e transportit detar. Master planet ekzistuese parashikojnë rehabilitimin e infrastrukturës dhe superstrukturës në portet detare të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës, si edhe Transportin Ujor të Komanit, me qëllim që portet të kenë natyrë tregtare si promovim i parimeve ekonomike të tregut. (SKZHI, 2013).

## Efektet e ndryshimeve klimatike mbi Ujin për Industrinë dhe Energjinë

Ndryshimet e faktorëve klimatikë dhe ndikimi stinor së bashku ndikojnë kërkesën dhe furnizimin me energji. Stina e dimrit pritet të jetë më e shkurtër dhe më e ngrohtë dhe kjo do të çojë në një rënie të kërkesës për energji për ngrohje. Gjithsesi, temperaturat e larta në stinën e verës do të çojnë në rritje të konsumit të energjisë për ftohje. Për sa i përket pjesës së furnizimit me energji, teknologji të ndryshme të prodhimit të energjisë ndikohen ndryshe nga ndryshimet e motit dhe kushtet ekstreme të motit që mund të shkaktohen nga ndryshimet klimatike (Ciscar dhe Dowling, 2014).

- Zhvillon dhe administron Geoportalin Kombëtar dhe garanton qasje publike sipas dispozitave të Ligjit 72/2012.

[Njësitë e qeverisjes vendore, këshillat e baseneve ujore dhe agjencitë e baseneve ujore](#)

Që prej zgjedhjeve vendore të vitit 2015, organizimi i qeverisjes vendore ka ndryshuar. Përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për ndarjen e re administrative dhe territoriale (Ligji Nr. 115/2014), ishte e ndarë në 308 komuna, 65 bashki dhe 12 rajone qarqe. Reforma administrative dhe territoriale nuk solli ndryshime në nivelin e qarkut duke mos ndryshuar numrin prej 12, por u ndërmorën ndryshime radikale në nivelin e komunave dhe bashkive. Sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale janë krijuar 61 bashki të reja. Bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore, duke përfaqësuar kështu nivelin e parë të qeverisjes. Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) janë të organizuara në njësi administrative përbërëse (ish komunat) dhe si nën ndarje administrative të bashkive. Nga pikëpamja e planifikimit të territorit, bashkitë do të vijojnë të organizohen në qytete dhe fshatra.

Ndikimi i zhvillimit social dhe ekonomik në nivel rajonal dhe roli i institucioneve rajonale ka qenë i dobët në të shkuarën si pasojë e mungesës së një modeli të qartë për veprimtarinë rajonale, mungesës së burimeve financiare, aseteve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme institucionale. Organet e decentralizuara në nivel vendor përfaqësohen nga dy institucione: përkatësisht (i) Prefekti dhe (ii) drejtoritë/zyrat rajonale/vendore të ministrive të linjës. Menaxhimi i Ujërave është i organizuar në nivelin e Baseneve Ujore nëpërmjet gjashtë Këshillave të Baseneve Ujore (KBU), ku secili ka një Agjenci të Basenit Ujor (ABU).

Secili nga Këshillat e Baseneve Ujore (KBU) kryesohet nga një prej Prefektëve përgjegjës dhe është i përbërë nga 9 deri në 23 anëtarë që përfaqësojnë ministrinë, NJQV-të, bizneset dhe konsumatorët e basenit. (VKM No.342, date 4 Maj 2016: "Për miratimin e kufijve teritorial e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre").

Neni 12 i Ligjit Nr. 111/2012 thekson se çdo KBU duhet të sigurojë:

- Mbrojtje, zhvillim dhe veprimtari të arsyeshme me burimet ujore brenda kufijve të basenit të tij;
- Shpërndarje të drejtë brenda kufijve të basenit të tij në përputhje me qëllimin e përdorimit dhe administrimin efikas të tyre;
- Mbrojtje të burimeve ujore nga ndotja, keqpërdorimi dhe mbi-përdorimi.

Këshillat e Baseneve Ujore asistohen nga Agjencitë e Baseneve Ujore (ABU), që funksionojnë si një Sekretariat Teknik për KBU-në. Ato janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Burimet Ujore. Ato ndërmarrin vlerësimin teknik të aplikimeve për përdorimin e ujit (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe japin rekomandime për miratim nga KBU-të, mbështesin bashkitë për zgjidhjen e problematikave të lidhura me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për inspektimin e të gjitha veprimtarive që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, ABU-të kanë autoritet të kufizuar për të zbatuar procedurat ligjore dhe rregullatore.

Pjesëmarrja/përfshirja e përdoruesve përfundimtarë në menaxhimin e burimeve ujore rregullohet nga Vendimi Nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU), datë 21.6.2006, që shprehet se përfaqësuesit e përdoruesve të ujit përbëjnë 30% të anëtarësisë së KKU-së. Për më tepër, takimet e KBU-së mbahen me dyer të hapura. Në praktikë, publiku i gjerë dhe grupet e vegjël të përdoruesve mund të marrin pjesë në mënyrë shumë të kufizuar në proceset formale të menaxhimit të burimeve ujore. Furnizimi me Ujë të Pijshëm është përgjegjësi e 57 ndërmarrjeve të ujësjellësit që veprojnë nën Njësitë e Qeverisjes Vendore. (VKM No.342, date 4 Maj 2016: "Për miratimin e kufijve teritorialë e hidrografike të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre").

Në vitin 2010<sup>33</sup> një Vendim i Këshillit të Ministrave ka transferuar pronësinë e 305 rezervuarëve të vegjël bujqësorë tek NJQV-të duke i bërë kështu përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Dhënia e

<sup>33</sup> Nr. 567, date 14.07.2010, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

lejeve dhe zbatueshmëria e legjislacionit mjedisor është përgjegjësi e dymbëdhjetë Agjencive Rajonale Mjedisore (ARM).

Në vitin 2015, u miratua me VKM Nr. 1108, date 30.12.2015, "Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, personelit dhe asetëve nga Bordet Rajonale të Kullimit", duke qenë se shërbimet e ujitjes dhe kullimit kishin ende nevojë për përmirësim. Duke i transferuar infrastrukturën e vogla të ujitjes te bashkitë dhe komunat, do të përmirësohet vendimmarrja lidhur me sistemet e ujitjes dhe kullimit.

Meqënëse vetëm infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe digat menaxhohen tashmë nga MBZHRAU, bashkitë do të bashkëpunojnë dhe do të bashkërendojnë së bashku me strukturën rajonale të MBZHRAU dhe BRK-të aktivitetet planifikuese për kërkesën vjetore për ujë për ujitje, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit<sup>34</sup>. Organizimi i sotëm institucional për ujitjen dhe menaxhimin e kullimit përfshin komunat/bashkitë si një lidhje e rëndësishme, që sjell si rezultat tre nivele menaxhimi:

- Qeverisjen qendrore, ku MBZHRAU dhe Bordet e Kullimit kanë kompetencat më të larta të nivelit të administrimit mbi asetet parësore dhe digat;
- Bashkitë si një nivel i ndërmjetëm administrimi për asetet dytësore dhe tretësore; dhe
- Organizatat e përdoruesve të ujitjes dhe bashkimet e tyre si niveli më i ulët i administrimit.

Lidhja e ndërmjetme midis qeverisë qendrore dhe strukturave të saj vendore nga njëra anë, dhe SHPU-ve/OPU-ve nga ana tjetër, është bërë kështu më i mirë, e cila mungonte nga reforma e mëparshme bujqësore. Bordet e Kullimit dhe njësitë e reja të qeverisjes vendore dhe bashkitë do të punojnë në partneritet me SHPU-të për të përmirësuar kapacitetet vendore dhe pritet që sistemet e ujitjes do të sjellin si rezultat një prodhim të lartë të kulturave bujqësore dhe do të bëhen të qëndrueshme.

## 1.5 Përfundime

Të gjitha të dhënat tregojnë se ka burime ujore të bollshme. Aktualisht, vendi ka rezerva të mjaftueshme ujore të një cilësie të mirë për të plotësuar me ujë nevojat e popullsisë, industrisë ushqimore, mjedisit dhe industrisë në përgjithësi. Megjithatë, brenda shumë mundësive, kjo situatë mund të ndryshojë në të ardhmen, kryesisht për shkak të ndryshimeve klimatike edhe pse shtimi i numrit të popullsisë dhe zhvillimi i industrisë do të kenë ndikimin e tyre domethënës në burimet ujore, në qoftë se zhvillimi i vendit nuk mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë.

Një raport mbi përmytjet (MPB, 2012) të lumenjve të poshtëm të Drinit dhe Bunës përmbante disa të dhëna për përmytjen e vitit 2010. Për vendet e tjera ose për analiza statistikore për të përcaktuar periudhën e kthimit të përmytjeve të frekuencave të ndryshme të ndodhjes ato kryesisht përdorën të dhëna deri në vitin 1990. Në zhvillimin e bilancit të ujitjes, të përmendur më lart, shumica e të dhënave erdhën nga raporti i cili i referohej të dhënave para kësaj date. Një raport mbi burimet ujore të Shqipërisë nga MedHYSCOS (Selenica, ~ 2001) i referohet të dhënave klimatike për periudhën 1951-1980 dhe për të dhënat për periudhën 1951-1985.

Vërshimet e vëzhguara tregojnë tre karakteristika kryesore. E para është se ka pasur shumë viktima për shkak të përmytjeve, edhe pse më rrallë në vitet e fundit sesa në të kaluarën. Kjo si rezultat i përpjekjeve të autoriteteve vendore. Së dyti, përmytjet shpesh shkaktojnë rrëshqitje të dheut, duke përkeqësuar problemet e rrugëve dhe të transportit. E treta, edhe nga këndvështrimi ekonomik, ndoshta më seriozja, është përmytja e zonave të ulëta të ujitjes pranë bregut. Kjo lloj përmytjeje mund të zgjasë disa javë dhe ujërat e përmytjes mund të evakuohen vetëm duke pompuar.

<sup>34</sup> Strategjia Kombëtare Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020.

Ndër raporte të shumta të konsultuara vetëm një i referohet të dhënave të rrjedhjes gjatë viteve të fundit (Norconsult, 2012). Aty ka të dhëna për tre stacione matëse rrjedhëse: Gjnikas nga 1968 deri në 1995, Kokel nga viti 1952 deri në vitin 2005 dhe Kozare nga viti 1951 deri në vitin 1983. Ata gjithashtu paraqesin të dhëna 6 mujore për Kokel viti 2010.

Burimet kryesore publike (interneti) të përdorura për modelimin ishin ' Qendra Globale e të Dhënave të Rrjedhës' e drejtuar nga Shërbimi Meteorologjik Gjerman; Të dhënat ishin në një hap kohor mujor dhe asnjëri prej tyre nuk kishte të dhëna pas vitit 1984. Njësia e Kërkimit Klimatik të Universitetit të Anglisë Lindore u përdor për të dhënat e temperaturës dhe të tjera të klimës dhe grupi i të dhënave të reshjeve të CHIRPS të zhvilluara nga Universiteti i Kalifornisë Santa Barbara Përdoret për të dhënat e reshjeve. Të dhënat e CHIRPS, të bazuara në imazhet satelitore infra të kuqe, përdorën të dhënat e reshjeve të mbledhura nga USGS (Survejimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara) dhe NOAA (Administrata Kombëtare Oqeanografike dhe Atmosferike) për terheqjen e tokës dhe kalibrimin. Të dhënat e reshjeve të përditshme u shkarkuan edhe nga faqja e internetit TuTiempo. Ky web site ka të dhëna të përditshme të reshjeve dhe klimës për 12 stacionet e klimës në Shqipëri. Të dhënat në dispozicion pasqyrojnë situatën e vështirë në grupe të caktuar të të dhënave; Cilësia e të dhënave ishte përgjithësisht e mirë deri në vitin 1990 dhe nga viti 2013 e tutje. Jashtë këtyre periudhave cilësia e të dhënave ishte e dobët ose jo-ekzistente. Shqipëria ka përfshirë në kuadrin e saj ligjor pjesën më të madhe të legjislacionit të Komunitetit Evropian me rëndësi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Megjithatë, Shqipërisë i duhet ende të zhvillojë plane koherente për zbatimin e këtij legjislacioni në të cilët të jenë shqyrtuar me kujdes të gjitha vështirësitë që mund të ndeshen në një afat kohor të shkurtër e të mesëm.

Urdhri Nr. 129 i datës 21.09.2015 "Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave" krijon një grup të tillë për ujin. Shumica e antarëve të Grupit të Menaxhimit të Politikave të Integruara për Ujin vijnë nga Këshilli Kombëtar i Ujit, duke inkurajuar kështu vetëdijen për çështjet institucionale dhe menaxheriale. Ndërsa pjesa tjetër janë donatorë, institute kërkimore dhe të tjerë. Kjo ofron një mundësi për bashkërendimin (koordinimin) e donatorëve në sektorin e ujit.

Vendimi Nr. 4 i Këshillit të Ujit i datës 2 dhjetor 2015 krijon 4 grupe nën-tematike (Ujë për Popullsinë, Ujë për Ushqimet, Ujë për Mjedisin dhe Ujë për Industrinë). Antarësimi dhe strukturimi i këtyre kroupeve është bërë në mënyrë të tillë që të sigurojë që interesat për ujë janë kuptuar qartë në ministrinë e linjës, portofoli i të cilave prek, në një farë mënyre, strategjinë e ujit. Deri në njëfarë pike, grupet i japin përparësi menaxhimit të ujit në mënyrë efçente. Përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar qartë dhe, për më tepër, kanë atë shkallë fleksibiliteti që nevojitet për t'iu përgjigjur situatave të paparishikuara në kohën e duhur e në mënyrë efçente. Në parim, do të duhet të mblidheshin dy herë në muaj ose, sa herë që të jetë e nevojshme.

Sidoqoftë, kjo nuk mund të mohojë progresin domethënës që këto struktura përbëjnë në vetvete. Një ndër sfidat kryesore me të cilat do të ndeshen në vitet në vijim do të jetë të qenurit realiste rreth asaj çka mund të arrijë brenda mundësive të saj, me institucionet që ka dhe me mundësitë për të gjeneruar të ardhura nga popullsia dhe zhvillimi ekonomik i saj.

Duke patur si qëllim antarësimin në Bashkimin Evropian, Qeveria e Shqipërisë i ka dhënë përparësi harmonizimit të politikave dhe politikës me ato të BE-së. Njohuritë e nevojshme për planifikimin dhe zbatimin e politikave si dhe kufizimet në lidhje me burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme në këtë rast duhen shqyrtuar me kujdes, në mënyrë të tillë që planifikimi i fazës së zbatimit, të kryhet gjatë gjithë kohës në bazë të parashikimeve realiste dhe të zbatueshme. Mënyra e organizimit të institucioneve, ku përfshihet edhe niveli i centralizimit dhe decentralizimit, (p.sh. në nivel baseni) në një afat të shkurtër dhe të mesëm duhet të udhëhiqet më shumë nga kërkesa për një përdorim efektiv të burimeve dhe kapitalizimit të arritjeve dhe zhvillimeve rajonale apo lokale.

Si përfundim, ka shumë përparime të rëndësishëm në lidhje me aspektin konceptual të kuadrin të menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Megjithatë, zbatimi mbetet ende në fazë fillestare dhe vendi ndeshet me sfida të mëdha për të ecur me të njëjtin hap me Bashkimin Evropian.

## 2 Vizionet, Politikat dhe Qëllimet Strategjike


### 2.1 Deklarata e Vizionit

Këshilli Kombëtar i Ujit ka miratuar një vizion afatgjatë të qartë për menaxhimin e ujërave<sup>35</sup>. Me qëllim sigurimin dhe mbështetjen e këtij përkufizimi të përgjithshëm, Vizioni për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore pohon se:

**“Deri në vitin 2027, Shqipëria do të jetë një vend me efikasitet në përdorimin e ujit, me menaxhim të integruar e funksional të burimeve ujore që përfshin edhe një sistem të plotë monitorimi dhe menaxhimi të rreziqeve nga përmbytjet dhe pamjaftueshmëria e burimeve ujore. Përdorimi i burimeve ujore bazohet nëparimin e barazisë dhe qëndrueshmërisë për përfitime të barabarta socio-gjinore-ekonomike, dhe drejtësi mjedisore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.**

Strategjia Kombëtare MIBU mund të shihet si një kuadër i përgjithshëm që përmbledh të dyja politikat e Bashkimit Evropian për ujin dhe mjedisin, ndërsa integron njëkohësisht edhe përqsasjet dhe objektivat e Politikave Kombëtare për menaxhimin e ujit duke u bazuar në katër **“shtyllat” strategjike**, d.m.th. Ujë për Njerëzit, për Ushqim, për Mjedisin, dhe për Industrinë dhe Energjinë, ndërkohë që merren parasysh parashikimet e pritshme dhe rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike (Figura 12).

**Figura 12: Integrimi i katër ‘shtyllave’ strategjike për menaxhimin e ujit**



Në përputhje me Vizionin e Qeverisë Shqiptare për Menaxhimin e Ujit, objektivi kryesor i Strategjisë MIBU është të krijojë të gjitha kuadrot ligjore, ekonomike, institucionale, teknike dhe sociale që nevojiten duke u bazuar në politikat mjedisore Evropiane dhe parimet MIBU (GWP, 2000), për të arritur Vizionin, që në terma afat-gjatë menaxhimi i integruar të jetë transparent dhe i mirëfilltë për të gjitha burimeve ujore të vendit. Për të arritur një gjë të tillë, nevojiten parime të qarta udhëzuese që shërbejnë për të mbështetur praktikën

<sup>35</sup> “Krijimi i një Sistemi të Integruar për Qeverisjen e Sektorit të Ujit për të përmbushur nevojat bazë të jetesës, konkurrenca për përdoruesit dhe prioritetizimi i përfitimeve ekonomike dhe marrjen parasysh të qëndrueshmërisë së ekosistemeve” (Grupi për politikën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, Tiranë, 23-6-2015).

ekzistuese shqiptare për menaxhimin e ujërave. Për këtë qëllim, Strategjia ndërthur parimet e MIBU-s me Politikën Mjedisore të BE-së për Ujin (Direktiva Kuadër e Ujit), përmbytjet (Direktiva për Menaxhimin e Përmbytjeve), dhe Kuadrin e OECD për Menaxhimin e Ujërave (OECD, 2015b).

## 2.2 Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore dhe Direktiva Kuadër e Ujit

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU) bazohet në politikën e hartuar nga Partneriteti Botëror i Ujit (GWP) dhe të mbështetura nga Konferenca Ndërkombëtare për Ujin dhe Mjedisin (ICWE) që u zhvillua në Dublin, Irlandë më 26-31 Janar 1992. Sipas GWP, MIBU është “proçes që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve të tjera që lidhen me to, me qëllim maksimizimin e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore që rrjedh prej saj në mënyrë të drejtë, pa dëmtuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetike”. Parimet udhërrëfyese, të hartuara nga ICWE janë renditur më poshtë:

- **Parimi 1** - Ujërat e ëmbla janë burime të shterrueshme dhe lehtësisht të cënueshme, të domosdoshme për jetën, zhvillimin dhe mjedisin.

**Duke qenë se uji është element kyç për jetën, për një menaxhim efikas të burimeve ujore nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila lidh zhvillimin ekonomik e shoqëror me mbrojtjen e ekosistemeve natyrore. Menaxhimi efikas lidh përdorimin e tokës dhe të ujit përgjatë të gjithë pellgut ujëmbledhës ose akuiferëve nëntokësorë.**

- **Parimi 2** - Zhvillimi dhe menaxhimi i ujit duhet të bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse, ku marrin pjesë përdoruesit, planifikuesit dhe politikëbërësit e të gjitha niveleve

**Qasja gjithëpërfshirëse përfshin ndërjegjësimin e politikëbërësve dhe publikut të gjerë rreth rëndësisë së ujit. Kjo do të thotë se vendimet merren në nivelin më të ulët të përshtatshëm, me konsultiminë publikut dhe përfshirje të përdoruesve të ujit në fazën e planifikimit dhe zbatimit të projekteve të ujit.**

- **Parimi 3** - Gratë luajnë rol kryesor në sigurimin, menaxhimin dhe ruajtjen e ujit

**Roli kryesor i grave si ofruese dhe përdoruese të ujit, si dhe mbrojtëse të mjedisit nuk është reflektuar shpesh në marrëveshjet institucionale për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve ujore. Pranimi dhe zbatimi i këtyre parimeve, kërkon hartimin e politikave pozitive për plotësimin e nevojave specifike të grave, si dhe për t'i dhënë mundësi dhe për t'i fuqizuar ato që të marrin pjesë në të gjitha nivelet në programe rreth burimeve ujore, duke përfshirë këtu edhe vendimmarrjen dhe zbatimin, sipas mënyrave të përcaktuara nga vetë ato.**

- **Parimi 4** - Uji ka vlerë ekonomike në të gjitha përdorimet e tij që konkurrojnë ndërmjet tyre dhe duhet njohur si mall me vlerë ekonomike

**Sipas këtij parimi, është shumë e rëndësishme që të njohim fillimisht të drejtat themelore të njeriut për të pasur akses në ujë të pastër dhe kanalizime me një çmim të arsyeshëm. Mosnjohja e vlerës ekonomike të ujit në të shkuarën ka sjellë shpërdorimin dhe dëmtimin mjedisor të burimeve ujore. Menaxhimi i ujit si një e mirë ekonomike është një mënyrë e rëndësishme për të arritur përdorimin efikas dhe të drejtë të tij, si dhe për të nxitur ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve ujore.**

Direktiva Kuadër e Ujit (DKU) e Bashkimit Evropian (BE) është një instrument politik që rrjedh nga politikën e BE-së. Në fakt, është më tepër një kuadër për zbatimin e menaxhimit të baseneve ujore sesa një pikë referimi për planifikimin dhe programimin e investimeve kapitale në infrastrukturë, të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të MIBU-s. Për këtë arsye, ndërkohë që strategjia mund të kontribuojë në përmbushjen e disa kërkesave të DKU-së, është e rëndësishme të theksohet se DKU-ja e vë theksin në politika të ndryshme nga Strategjia.

## 2.3 Politikat dhe parimet

Republika e Shqipërisë ka bërë kërkesë zyrtare për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në vitin 2009 dhe i është dhënë statusi i vendit kandidat për anëtarësim në BE në Qershor të vitit 2014. Pritet që të arrihet anëtarësimi i plotë në BE para afatit përfundimtar të Vizionit MIBU, që do të thotë para vitit 2027. Si pasojë, kjo Strategji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore synon të përafrojë (harmonizojë) rregullat dhe procedurat e BE-së, të cilat bazohen në një sërë parimesh në politikat lokale.

### 2.3.1 Politikat dhe parimet e BE-së

Një nga parimet më të rëndësishme mjedisore është “parimi i parandalimit”<sup>36</sup>, që nënkupton se autoritetet nxiten të parandalojnë rreziqet e mundshme ndaj mjedisit. Kjo reflektohet në Direktivën e Kuadrit të Ujit (2000/60/EC, DKU), nëpërmjet detyrimit të vendosur për Shtetet (Kandidate) Anëtare për të marrë të gjitha masat për parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të gjendjes së ujërave (Neni 1). Si e tillë DKU-ja përcakton objektiva të qartë se “Gjendja (Cilësia e Ujit) e mirë” duhet të arrihet para një date të caktuar dhe mbulon të gjitha kategoritë ujore (lumenj, liqene, ujëra nëntokësore, si edhe ujëra bregdetare dhe të përkohshme).

Proçeset dhe arsyetimi i DKU-së, me qasjen e integruar ndaj menaxhimit të tokës, ujit dhe ekosistemit, e kombinuar me proçesin e riciklimit, janë në përputhje me idealet e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Hapat për proçesin e PMBU-së, ofrojnë një strukturë të përshtatshme për kryerjen e ndërhyrjeve ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet: vlerësimit të rrezikut, monitorimit dhe vlerësimit, vendosjes së objektivave, analizës ekonomike dhe programit specifik të masave (PM) për të arritur objektivat mjedisore.

Rikuperimi i kostos dhe parimi ndotësi paguan janë pjesë e themelimit të Unionit Evropian, siç thuhet në nenin 191 (2) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian:

**"Politika e BE-së për mjedisin do të synojë një nivel të lartë mbrojtjeje duke marrë parasysh diversitetin e situatave në rajone të ndryshme të Bashkimit. Duhet të bazohet në parimin parandalues dhe në parimet që kërkojnë marrjen e veprime parandaluese, dëmet mjedisore duhet t'u jepet prioritet dhe në çdo rast ndotësi duhet të paguajë. "**

Prandaj, sigurimi i kostos në DKU i referohet fuqishëm parimit 'ndotësit paguan', të nxitur nga sigurimi i stimujve për përdoruesit e ujit për të konsumuar ujin në mënyrë efikase dhe në përputhje me interesin publik. Një tjetër parim i rëndësishëm që ka lidhje me BE-në është “proporcionaliteti”, që nënkupton se Qeveria duhet të trajtojë me kujdes ambiciet e saj për politika, por të kufizohet në masa që i shërbejnë interesit të përbashkët, duke lejuar liri veprimi të mjaftueshme për tregun për të reaguar (Tridimas, 2006). Proporcionaliteti ndërmjet masave të marra dhe nivelit të zgjedhur të mbrojtjes është një nga parimet e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut që aplikohet kur kërkohet parimi i parandalimit.

Direktiva e Përmblyjeve (2007/60/EC, DP) bazohet në dy parime të tjera të politikës mjedisore të BE-së (Bakker, 2009). “Parimi i plotësueshmërisë” nxit (Kandidatin) Shtetet Anëtare për të bërë rregullimet e duhura administrative, përfshirë identifikimin e autoritetit të duhur kompetent. “Parimi i solidaritetit” bën thirrje për bashkëpunim ndërmjet Shtetit Anëtar dhe Shteteve Kandidate për Anëtare, për planifikimin ndërkombëtar të menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet, dhe promovon ndarjen e drejtë të përgjegjësisë përse i përket menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet së bashku me rrjedhat ujore (Parathënia 15 e DP). DP-ja pohon se “Në interes të solidaritetit, planet e hartuara për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet në një

<sup>36</sup> Parimi i parandalimit mëshirohet fuqishëm në politikën e mjedisit të BE-së. Parimi pohohet në Nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian. Kriteret për aplikimin e këtij parimi janë përcaktuar në Protokollin (Nr. 2) për aplikimin e parimeve shtesë dhe të proporcionalitetit, të përfshira në Traktatin për Bashkimin Evropian dhe Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian nga Traktati i Lisbonës i 13 dhjetorit 2007.

*Shtet Anëtar nuk duhet të përfshijnë masa që, në shkallën dhe ndikimin e tyre, rrisin ndjeshëm rreziqet për përmbytje në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të shteteve të tjera në të njëjtin basen ujor ose nën-basen, përveçse kur masat janë koordinuar dhe një zgjidhje për të cilën është rënë dakord, është gjetur ndërmjet shteteve Anëtare të përfshira” (Neni 7.4). Së fundi, kur një Shtet identifikon një çështje për rrezik përmbytjeje që nuk mund ta zgjidhë vetë, ai mund ta raportojë këtë çështje në Komision dhe te çdo Shtet tjetër (Kandidat) Anëtar i përfshirë.*

Që prej vitit 2007, fokusi ka qenë te sinkronizimi i Direktivës së Kuadrit të Ujit dhe Direktivës së Përmbytjeve. Kjo ka çuar në një sërë parimesh drejtuese pragmatike (EU, 2014), që synojnë të marrin vendime të mirë-informuara që janë në raport të drejtë dhe rrepta, bazuar në pasiguri të informuara në ndikimet rajonale të ndryshimeve klimatike. Kur është e mundur, duhen miratuar masa “të forta”, , pasi ato sjellin rezultate përfituese, pavarësisht rezultateve të mundshme të ndryshueshmërisë dhe ndryshimeve klimatike (EU, 2009).

Shtetet (Kandidate) Anëtare të BE-së duhet të tregojnë qartësisht në ciklin e dytë (2021) dhe të tretë (2027) të PMBU-së se si parashikimet e ndryshimeve klimatike do të ndikojnë në vlerësimet mbi presionet dhe ndikimet e DKU-së; se si programet e monitorimit janë konfiguruar për të zbuluar ndryshimet klimatike; dhe se si masat e përzgjedhura të jenë sa më strikte që të jetë e mundur ndaj kushteve të parashikuara klimatike. Përveç rrethanave përjashtuese, nuk pritët që, brenda afatit kohor të zbatimit të DKU-së (deri në vitin 2027) ndikimet e drejtpërdrejta të jenë të konsiderueshme. Ka shumë gjasa që presionet e drejtpërdrejta që lindin nga reagimet njerëzore ndaj ndryshimeve klimatike – si përshtatja dhe zbutja –të kenë një ndikim të madh (siç është rritja e nivelit të sasisë së ujit për ujitjen, infrastruktura e re për mbrojtjen nga përmbytjet ose efektet për cilësinë dhe sasinë e ujit për prodhimin e vazhdueshëm të të mbjellave).

Parimet e mbivendosura të DKU-së dhe DP-së janë aplikuar brenda Strategjisë MIBU për Shqipërinë dhe ato janë reflektuar te Objektivat Strategjikë. Në krahasim me MIBU dhe BE DKU/DP, parimet tregojnë se pika të përbashkëta përfshijnë qasjen ndaj planit të basenit, pjesëmarrjen publike dhe transparencën. DKU-ja dhe DP-ja nuk përmbajnë qëllime për zhvillimin socio-ekonomik, siç nxiten në qasjen MIBU, përse i përket përfitimeve të barabarta social-gjinore dhe drejtësisë mjedisore për brezat e tashëm dhe të ardhshëm. Edhe pse përfshirja publike është një gur themeli për zhvillimin e Planeve DKU për Menaxhimin e Integruar të Basenit Ujor, MIBU përqendrohet më shumë në nevojën për lehtësimin e aksesit real. MIBU merr parasysh pjesëmarrjen publike të grupeve vulnerabël dhe grave në veçanti, që është thelbësore në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për menaxhimin e burimeve ujore. Në DKU, ndërgjegjësimi për gjininë është hequr dhe nuk përqendrohet te reduktimi i varfërisë (Rahaman dhe të tjerë, 2004).

Megjithëse Nenet 13 dhe 14 të BE DKU-së përcaktojnë udhëzime të qarta për pjesëmarrjen e palëve të interesit në zhvillimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të basenit ujor, të dyja Nenet kanë mungesa për udhëzime të qarta për përdoruesit e ujit dhe palët e tjera të interesit në menaxhimin e burimeve ujore. Duke qenë se uji mund të fuqizojë njerëzit, veçanërisht në procesin e menaxhimit të ujërave, pjesëmarrja e palëve të interesit është një nga çështjet më të rëndësishme në MIBU, dhe si e tillë, ajo kërkon që vendimet në nivelin më të ulët të arrijnë menaxhimin efikas, të barabartë, dhe të qëndrueshëm të ujërave brenda qasjes MIBU. Kjo është gjithashtu në përputhje me parimin shtesë të BE-së<sup>37</sup>.

### 2.3.2 Politikat dhe strategjitë ekzistuese për menaxhimin e ujit

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI), (QSH 2013), së bashku me strategjitë e sektorit, strategjitë ndërsektoriale, master planet dhe planet e veprimit, të gjitha së bashku formojnë kuadrin

<sup>37</sup> Parimi shtesë i nxit Shtetet (e ardhshme) Anëtare për të bërë rregullime të duhura administrative, përfshirë identifikimin e autoritetit të duhur kompetent për aplikimin e rregullave të DKU-së dhe DP-së. Për më tepër, parimi shtesë, që kërkon që çështja duhet të paraqitet nga autoriteti më pak i centralizuar i aftë për trajtimin e suksesshëm të çështjes në fjalë, pohohet në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (2012/C 326/01)



e zhvillimit gjithëpërfshirës strategjik. Ato përcaktojnë prioritetet, vizionin dhe në të njëjtën kohë objektivat e përgjithshëm dhe specifikë afatmesëm dhe afatgjatë.

Analizat e politikave ekzistuese për ujin, tregojnë se niveli i shërbimeve të ujit, pavarësisht investimeve të qenësishme në të gjithë sektorët gjatë 25 viteve të fundit, janë shumë më të ulëta se pritshmëritë, si rrjedhojë pjesërisht e mangësisë së politikave të qarta (EC-IPA 2, 2014). Për më tepër, nevojat për investime janë ende të qenësishme dhe kufizimet në kapacitetin menaxhues janë ende ekzistuese.

Qeveria e Shqipërisë është aktualisht duke marrë në konsideratë reforma të mëtejshme për të ofruar ujë të pijshëm në sasi dhe në cilësi të përshtatshme, 24 orë në ditë, si dhe të gjithë gamën e shërbimeve të higjienës, në të gjitha fushat. Riorganizimi i të gjithë sektorit të furnizimit me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotur do të bëhet duke rikrijuar marrëdhënie të reja ndërmjet institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (SKUK) për vitet 2011-2017 (QSH 2013) parashtrohet si objektivin e saj kryesor krijimin e një përfaqëse të tillë *“për krijimin e menaxhimit, monitorimit dhe sigurimit e funksionimit efikas të një sistemi të integruar furnizimi me ujë i cili mundëson fleksibilitet në situata të ndryshme”*.

SKUK përcakton objektivat e mëposhtme: (i) zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë dhe të shërbimeve për ujërat e ndotura, (ii) orientimin e shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të kostos; (iii) përmirësimin e administrimit dhe rregullave në sektor; (iv) investime për të rritur kapacitetin e sektorit, dhe (v) shkuarjes drejt pajtueshmërisë së plotë të ligjeve dhe rregullave kombëtare me Direktivat e BE-së për Ujin. Deklaratat e politikës së qeverisë (MT, 2014) për furnizimin me ujë dhe kanalizimet përfshijnë:

- Rehabilitimin dhe modernizimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Juridiksionin e politikave të tarifave;
- Diferencimin e tarifave dhe strukturat;
- Subvencione ndërsektoriale ndërmjet kategorive të konsumatorëve;
- Rikuperimin e kostove për ofruesit e shërbimeve;
- Prezantimin e subvencioneve të synuara;
- Inventarin dhe vlerësimin e aseteve të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Marrjen parasysh dhe hartimin e një Ligji Specifik për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet;
- Liçencimin e ofruesve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
- Autorizimin për të zëvendësuar një operator që ka dështuar në ofrimin e shërbimit.

Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane janë dy faktorët më të dukshëm me ndikim në cilësinë e burimeve ujore sipërfaqësore. Parimi kyç që nevojitet të ndiqet gjatë planifikimit dhe programimit të investimeve të tilla është: investimi kapital në infrastrukturën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, duhet të planifikohet vetëm pasi të jetë përcaktuar se kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes, do të mbulohen plotësisht dhe vetëm nga të ardhurat e nxjerra nga taksat/tarifat e zonës që përfitojnë nga shërbimi.

Investimi kapital në infrastrukturën që nevojitet fillimisht mund të bashkëfinancohet nga burime të jashtme. Megjithatë, kostot e vazhdueshme të funksionimit, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të aseteve duhet të mbulohen nga të ardhurat e brendshme, të cilat përfitohen nga tarifat. Prandaj, programimi i investimeve duhet të bazohet kryesisht në atë çka mund të përballojë ekonomia vendore sesa në bashkëfinancimet e ofruara nga organizatorët e jashtëm.

Ky fakt njihet nga Direktiva e Bashkimit Evropian për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane. Direktiva i përcakton kërkesat në lidhje me aglomeratet. Sipas saj, një aglomerat është “një zonë ku popullsia dhe/ose

veprimtaritë ekonomike janë përqendruar në nivelin e duhur për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane në një impiant ose në vendin përfundimtar të shkarkimit”. Elementët që përcaktojnë “nivelin e duhur të përqendrimit” janë realizueshmëria financiare dhe teknike. Zona së cilës do t’i shërbehet, duhet të nxjerrë të ardhura të mjaftueshme nga tarifat (bazuar në tarifat e arsyeshme) për të mbuluar kostot e vazhdueshme të funksionimit, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të aseteve. E thënë më thjeshtë, nuk ka kuptim të ndërtohet një impiant në qoftë se komuniteti të cilit ai i shërben nuk është në gjendje të përballojë funksionimin dhe mirëmbajtjen e tij pa subvencione të jashtme.

Një pasojë konkrete për planifikimin strategjik është mosprojektimi real i programit të investimeve për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, derisa të jetë zbatuar realizueshmëria financiare e rritjes së të ardhurave, që burojnë nga tarifat në aglomeratet potenciale. Në thelb, ekzistenca e një fshati apo qyteze nuk do të thotë se duhet të shihet si aglomerat, përveç rasteve kur ka dendësi të mjaftueshme banesash për të nxjerrë të ardhura nga tarifat, që njerëzit janë në gjendje dhe të gatshëm të paguajnë. Sa më e ulët të jetë dendësia e banesave, aq më i vështirë do të jetë përfundimi (gjenerimi) i të ardhurave të nevojshme.

Nëse ky parim zbatohet siç duhet, Shqipëria nuk duhet ta gjejë kurrë veten në një situatë ku nxit projekte me përballueshmëri të diskutueshme. Kjo mbështet parimin se legjislacioni i BE-së nuk mund t’i kërkojë një vendi të bëjë investime që nuk janë të qëndrueshme.

Ky parim ka ndikime domethënëse në planifikimin dhe programimin e investimeve për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Shqipëri. Periudhat tranzitore të zbatimit të Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane në Shqipëri duhet ende të negociohen me Bashkimin Evropian. Këto negociata duhet të bazohen në atë çka është në gjendje të përballojë Shqipëria për mbajtjen në funksion dhe shërbim, pavarësisht nga çfarë Bashkimi Evropian ka vullnet të bashkë-financojë. Kjo do të thotë se Shqipërisë do t’i duhet të ketë bërë vlerësimet e të ardhurave nga tarifat lokale, përpara se të hyjë në negociata me BE-në në lidhje me zbatimin e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane.

Objektivat afatgjata të përcaktuara në dokumentet e sipërpermendur në lidhje me sektorin e ujit përfshijnë por nuk kufizohen;<sup>38</sup>:

- Arritjen e mbrojtjes dhe cilësinë e përmirësuar të ujit nëpërmjet zbatimit të Planeve për Menaxhimin e Burimeve Ujore deri në vitin 2020;
- Arritjen e monitorimit cilësor të vazhdueshëm të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me ME;
- Rehabilitimin dhe modernizimin e sistemeve të ujit;
- Zgjerimin e zonave më të ujitura për prodhimin e të mbjellave tregtare me cilësi të lartë për fermerët e vegjël;
- Një objektiv deri në 90% i rikuperimit të kostove për veprimtaritë rutinë, mirëmbajtjen dhe menaxhimin;
- Një rritje e kapacitetit të rezervuarëve nga mesatarja e tyre aktuale prej 45% e kapacitetit fillestar të projektimit deri në 90% të kapacitetit të tyre të projektimit nëpërmjet një fushate të largimit të baltës;
- Një rritje të kapacitetit total të grumbullimit të ujit;
- Përmirësimin e standardeve të sigurisë së digave, sipas standardeve të BE-së për sigurinë për digat ekzistuese dhe lloje të tjera që mund të ndërtohen;
- Reduktimin e ndikimit mesatar të dëmtimeve nga përmblytjet në vend në më pak se 50% se çfarë ka qenë në dekadën e mëparshme;
- Zhvillimin e infrastrukturës shtesë për mbrojtjen nga përmblytjet kur është e nevojshme.

Sektori i ujit dhe kullimit iu nënshtrua një reforme institucionale, Bordet e Kullimit (BK) janë transferuar te Autoritetet vendore dhe vetëm 4 (Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë) janë ende nën administrimin e MBZHRAU.

<sup>38</sup> Strategjia Mjedisore 2015-2020.

BK-të do të jenë përgjegjëse për administrimin e kanalit kryesor dhe dytësor (ujitje dhe kullim), përfshirë e digat. Një strategji e përgjithshme për ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet në Shqipëri u përgatit nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si pjesë e Projektit të Burimeve të Ujit dhe Ujitjes, duke përdorur fondet e Bankës Botërore, që paraqet një përshkrim të situatës aktuale dhe Sfidat kryesore për ujitje (përfshirë digat dhe rezervuarët), kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Ajo identifikoi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet të cilat vijnë si pasojë e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.

Qeveria Shqiptare ka si synim të zhvillojë një sistem energjie që bazohet mbi parimet e tregut i cili të jetë i aftë të mbulojë kërkesën për energji për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar siguri, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e mirëqenies me kosto minimale sociale. Prioritetet Strategjike përfshijnë:

- Përmirësim të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe institucional dhe pajtueshmëri maksimale me Direktivat e Bashkimit Evropian;
- Përkushtim për zbatimin e projekteve për shtrirjen e tubacioneve të gazit dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit;
- Përmirësimin e burimeve për furnizim me energji dhe planifikimin me kosto më të ulët dhe ndikim minimal mjedisor;
- Përmirësimin e tregut kombëtar të energjisë dhe integrimin e tij në tregun rajonal.

Hydroenergjinë konsiderohet si energji e rinovueshme, e qëndrueshme, fleksibël dhe e sigurt. Megjithatë, ajo mund të shikohet gjithashtu në një shkallë të madhe, si një investim i shtrenjtë me ndikim negativ mbi mjedisin. Duke iu referuar kushteve vendore ndoshta energji të tjera të rinovueshme janë më efikase dhe të qëndrueshme në parametrat e tyre ekologjike dhe ekonomike, dhe si rrjedhojë, duhet të merren parasysh në politikat e ardhshme të energjisë. Kjo do të thotë se ndërtimi i hidrocentraleve të planifikuara duhet të rishikohet veçanërisht për ato që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (ZM-ve), gjë që kërkon zbatimin të kritereve përkatës mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm të biodiversitetit dhe habitateve (WWF, 2015).

Si përdoruesi më i madh i ujit, hidrocentrali ndikon ndjeshëm në praktikën e duhura të MIBU-së. Menaxhimi i ujit të digave duhet të bazohet në mundësimin e ujit të mjaftueshëm për qëllime të tjera dhe ruajtjen e prurjeve mjedisore, duke marrë parasysh mundësinë për përdorim kompleks të ujit për më shumë sesa një qëllim. Përdorimi i rezervuarëve të ujit për qëllime të ndryshme mund të merret parasysh për diga të mëdha, p.sh. përdorimi për turizëm, peshkim dhe ujitje, janë disa nga mundësitë që do të veprojnë për të diversifikuar përdorimin e ujit për projekte të reja dhe madje edhe ato ekzistuese.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve (QSH 2011), nxit mbylljen e vend grumbullimit të mbetjeve, së bashku me emetimet e ujërave të ndotur të pakontrolluar dhe të patrajtuar, dhe zëvendësimin e tyre me 12 landfille rajonale të kontrolluar deri në vitin 2025. Autoritetet sugjerojnë se do të ketë nevojë për më pak landfille si rrjedhojë e prezantimit të aktiviteteve të riciklimit dhe ripërtëritjes, të cilat janë parimet bazë (ekonomia e qarkullimit) të menaxhimit të mbetjeve në BE, ku landfilli është opsioni më pak i dëshiruar. Duke mundësuar zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, rreziqet për ndotjen e ujërave nëntokësore ulen në mënyrë të konsiderueshme dhe si rrjedhojë këto politika janë të rëndësishme për të aplikuar parimet MIBU.

Objektivat strategjike afatgjatë (QSH, 2015) për menaxhimin e mbetjeve përfshijnë:

- Zhvillimin e landfilleve rajonale;
- Monitorimin dhe mbylljen e atyre ekzistues, landfillët bashkiakë që nuk përputhen;
- Zhvendosjen e të gjitha Direktivave përkatëse të BE-së;
- Rritjen e mbledhjes së mbetjeve për landfill nga 45% në 50% deri në vitin 2025;

- Rritjen e riciklimit të mbetjeve urbane nga 30% në 55% deri në vitin 2025.

Dokumenti i Politikave Strategjike per Mbrojtjen e Biodiversitetit (QSH, 2015) është brenda kuadrit të objektivave globale të Konventës për Biodiversitetin për kuadrin kohor deri në vitin 2020, e cila siguron harmonizimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit të BE-së në lidhje me mbrojtjen e natyrës. 17 % e territorit dhe ujërave të brendshme, si dhe 5-6 % e zonës bregdetare janë rekomanduar si zona të veçanta dhe janë deklaruar më vonë si zona të mbrojtura. Në fushën e mbrojtjes së natyrës, politikat janë përgatitur për të garantuar: (i) sigurimin e zonave të mbrojtura; (ii) zbatimin e rregullave të miratuara në vitin 2011 për krijimin e zonave të mbrojtura të veçanta sipas Kornizës Natyra 2000; (iii) masat për të ndaluar aktivitetet e paligjshme si gjuetia, prerja në mënyrë të paligjshme e drurëve dhe ndërtimi në zonat e mbrojtura pa pasur një leje; (iv) fuqizimin e kapacitetit administrativ të inspektoriateve për të ndaluar këto fenomene. Të paktën 15 % e zonave të degraduara do të rehabilitohen përmes masave konservuese dhe rehabilituese.

Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015-2020) (QSH, 2015) përfshin politikat e mëposhtme:

- Në fushën e pylltarisë, prioritetet e Ministrisë së Mjedisit janë: (i) harmonizimi i plotë i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, (ii) krijimin e një strategjie të re 10 vjeçare për pyjet dhe kullotat, (iii) krijimin e një Inventari Kombëtar të Pyjeve;
- Në fushën e lëndëve kimike, dy nga prioritetet e Ministrisë së Mjedisit janë (i) zbatimi i këtij legjislacioni, dhe(ii) krijimi i një sistemi kombëtar për menaxhimin e integruar të lëndëve kimike;
- Në lidhje me ndryshmet klimatike, prioritetet përfshijnë krijimin e një strategjie kombëtare dhe një plani kombëtar të veprimit mbi ndryshimet klimatike, krijimin e një sistemi kombëtar të inventarëve mbi emetimet e gazeve serrë dhe fuqizimin e bashkëpunimit me institucionet e linjës për zbatimin e politikave të ndryshme mbi ndryshimet klimatike në strategjinë e tyre sektoriale.

Si Dokumenti i Politikave Strategjike per Mbrojtjen e Biodiversitetit, ashtu edhe Strategjia Kombëtare për Mjedisin janë shumë të lidhura me Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore. Tre Strategjitë ofrojnë një kuadër për mbrojtjen e burimeve të çmuara natyrore të Shqipërisë. Kjo është e rëndësishme për përdorimin e qëndrueshëm të ujit nga të gjithë sektorët e tjerë.

Një sektor i rëndësishëm në të ardhmen në këtë aspekt është Turizmi. Strategjia e Turizmit tregon kështu vëmendjen e saj për të pasur një efekt pozitiv, me efekt asnjës në buxhet, mbi cilësinë e burimeve ujore të vendit përderisa parimi udhëheqës i turizmit është zhvillimi i qëndrueshëm.

Masat e përfshira në strategji janë projektuar të kontribuojnë në qëllimet dhe synimet e mësipërme. Megjithatë niveli i arritjes së tyre është vështirë të deklarohet në mungesë të të dhënave koherente që kanë qenë të siguruara në kohën e përgatitjes së strategjisë. Kjo ka nevojë të trajtohet në rishikimin e strategjisë në të ardhmen.

Të gjitha strategjitë e mësipërme të menaxhimit të ujit nga sektorë të ndryshëm (p.sh. planifikimi, buxheti, ujitja, energjia, burimet) janë Strategji sektoriale, ndrsa Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore vepron si një ombrellë për sigurimin e burimeve të përshtatshme ujore në aspektin e cilësisë dhe sasisë për përdorime të ndryshme të ujit . Shumica, nëse jo të gjitha strategjitë e zhvilluara aktualisht, konstatojnë çështjet dhe problematika të përbashkëta që lidhen me ujin, siç janë identifikuar edhe gjatë punës koordinuse të Strategjisë të datës 17 shkurt 2015:

- potencial i madh për zhvillimin e një platforme të palëve të interesuara në çështjen e ndërthurur të ujit;
- të dhëna të besueshme dhe të sakta janë çelësi për efikasitetin e investimeve dhe vendimmarrjes në të ardhmen;
- koordinimi i afateve është i rëndësishëm, madje edhe me strategjitë që janë aktualisht në zhvillim;
- nevojiten instrumente praktike për të menaxhuar përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore;

- bashkërendimi efikas ndërinstitucional, shkëmbimi i informacionit dhe komunikimijane jetike dhe Grupi Ndërinstitucional i krijuar aktualisht përshtatet me këtë qëllim.

Në përgjithësi, Shqipëria është në një fazë shumë të hershme të anëtarësimit në BE (EC-IPA 2, 2014). Për t'i kthyer pikat e dobëta në mundësi, nevojat përcaktim prioritesh, siç edhe përshkruhen në kapitujt më poshtë, zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të qeverisë në nivel qendror dhe vendor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Kërkohej përputhje e mëtejshme me politikën dhe legjislacionin e BE-së për mjedisin dhe klimën, për sigurimin e zbatimit efektiv.

## 2.4 Analiza e mangësive

Objektivat për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore janë identifikuar nëpërmjet analizës së mangësive<sup>39</sup> ndërmjet kushteve aktuale të menaxhimit të burimeve ujore dhe parashikimeve të ardhshme për burimet e disponueshme dhe përdorimin e tyre në përputhje me BE DKU (EU, 2009) dhe DP (EU, 2014). Kjo analizë fillon me vlerësimin e kushteve aktuale, të politikave ekzistuese dhe rezultateve të konsultimeve me palët e interesit<sup>40</sup>. Gjithashtu, mangësitë janë identifikuar duke krahasuar Kuadrin e OECD-së për Menaxhimin e Ujërave (OECD, 2015) me praktikën ekzistuese për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në vend. Duke kombinuar të dyja analizat, përfshirë rezultatet e konsultimeve me palët e interesit dhe fokus grupet, është arritur në hartimin e Objektivave Strategjike.

### 2.4.1 Problematikat kryesore të burimeve ujore

Vlerësimet tregojnë se burimet ujore janë shpërndarë në mënyrë jo të barabartë në territorin e vendit. Nga ana tjetër, vëzhgimet tregojnë se sasia e ujërave sipërfaqësore nuk dihet me saktësi dhe se shifrat për ujërat nëntokësore duken si jo reale. Si rezultat, fizibiliteti dhe qëndrueshmëria e investimeve të ardhshme në infrastrukturën është vështirë të përcaktohet Për më tepër, 1/3 e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore burojnë nga shtete fqinje, që e bën disponueshmërinë e ujit në të ardhmen edhe më të pasigurt.

Efektet e parashikuara të ndryshimit të klimës tregojnë se deri në vitin 2027, prurjet do të bien nga 4.5% në 20% në basenet e Lumit të Drinit, Matit dhe Vjosës (UNFCCC, 2011). Ujërat nëntokësore parashikohet që të pakësohen. Pritet që një ngritje e vogël e nivelit të detit të ndikojë në akuiferët e ujërave të ëmbla nëpërmjet depërtimit të ujit të kripur dhe përmytjeve të deltave lumore dhe lagunave bregdetare, e do të ndikojë tek ekosistemet ekzistuese. (Banka Botërore, 2009).

Segmente të Basenit të Semanit dhe Ishmit janë më të ndotura se të tjerat (Lushaj dhe të tjerë, 2016). Burimet e ujërave nëntokësore po pakësohen vazhdimisht për shkak të përdorimit të tyre për qëllime shtëpiake dhe industriale, dhe për shkak se këto akuifere ndodhen pranë zonave urbane. Si rrjedhojë, ato janë më shumë të prekshëm nga ndotja njerëzore. Për shkak se ndotësit ushqimorë dhe organikë nga toka përfundojnë në të gjitha Basenet Ujore, liqenet dhe ligatinat do të vazhdojnë të degradojnë dhe do të rrisin brishtësinë e ekosistemeve ujore.

Edhe pse çka u tha më sipër është e pa konfirmuar, ato, bazohen në informacionet ekzistuese, prandaj për këtë nevojitet një kuptueshmëri më e mirë dhe njohuri më të thella, për të qenë në gjendje që të bëhen parashikime rreth sasive të disponueshme të ujit në terma afat-gjatë, dhe për të kryer monitorime të cilësisë së ujit që shërben për përcaktimin e masave të duhura dhe efikase që synojnë shpërndarjen e ujit me sasi të mjaftueshme dhe cilësi të duhur të burimeve të ndryshme ujore ndërmjet përdoruesve të tij.

<sup>39</sup> Analiza për Mangësitë është një metodologji promovuar nga, ndërmjet të tjerash, Direktivat e BE DKU/DP (EU, 2003), Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Direktivat për Liqenet Ndërkombëtare (UNECE, 2013) dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD, 2016).

<sup>40</sup> MBZHRAU ka publikuar një dokument për procesin e konsultimit dhe rishikimit para miratimit të Strategjisë.

## 2.4.2 Problematikat kryesore lidhur me përdorimin e ujit

Pavarësisht mbulimit me shërbime relativisht të kënaqshme, ndërprerjet e ujit të pijshëm gjatë ditës tregojnë për probleme që kanë të bëjnë me sasinë e ujit. Duke qenë se shfrytëzimi prek më shumë akuiferët aluvialë që ndodhen pranë zonave urbane, këta akuiferë janë të ndjeshëm ndaj ndotjes nga njeriu.

Funksionimi i strukturave për trajtimin e ujërave të ndotura është rritur gjatë dekadës së fundit, por performanca e tyre ende nuk është e mjaftueshme, sasi të mëdha të ujërave të zeza shkarkohen direkt në lumenj. Më shumë investime dhe mirëmbajtje më e mirë nevojitet për të arritur përmirësime në cilësinë e ujit, siç kërkohet edhe nga standardet evropiane. Mungesa e trajtimit parësor të ujërave të ndotura në burim, do të thotë gjithashtu se industritë joqëllimisht, mund të shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në rrjedhën e sipërme të burimeve ujore që përdoren për furnizim me ujë të popullsisë që banon në rrjedhën e poshtme. Edhe pse janë mbyllur shumë industri dhe miniera, zonat historikisht të ndotura përbëjnë rrezik të konsiderueshëm mjedisor dhe ndotës për shkak të mungesës së vëmendjes dhe rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit.

Përdorimi i plehrave kimike në bujqësi ka çuar në rritjen e niveleve të amoniakut, nitrogjenit dhe fosforit në burimet ujore përreth gjë që ka rritur brishtësinë (vulnerabilitetin) e ekosistemeve ujore. Përsa u përket këtyre ekosistemeve, është e rëndësishme që të theksohet se konsiderimi i ligatinave dhe pyjeve si përdorues të ujit është më shumë një koncept i ri, që nuk është marrë në konsideratë kur është planifikuar edhe pse vendi ka shumë zona ujore të mbrojtura të pavarura dhe prurjet e mjedisit në lumenj janë jetike për ekzistencën e ekosistemeve ujore të pavarura.

Plane të hollësishme sektoriale janë hartuar me qëllim përmirësimin e performancës së sektorit të ujit ose të energjisë. Megjithatë, nevoja për një strategji të integruar është e dukshme, p.sh. për përcaktimin e masave zbutëse, efikase dhe efektive, që synojnë ruajtjen e prodhimit të energjisë, dhe në të njëjtën kohë, përmbushjen e nevojave për ujitje dhe ruajtjen e nivelit ekologjik të lumenjve me qëllim që të shmangen ndikimet e mundshme në jetën e njeriut, prodhimin bujqësor dhe ekosistemet

## 2.4.3 Problematikat kryesore lidhur me menaxhimin e ujit

Kuadri institucional është konsideruar nga të gjitha palët e interesit si çështja kryesore që pengon menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Për këtë qëllim është kryer një analizë për nxjerrjen në pah të mangësive specifike bazuar në Kuadrin e OECD për Menaxhimin Ujërave (OECD, 2015)<sup>41</sup>.

<sup>41</sup> Parimet e Kuadrit të OECD për Menaxhimin e Ujërave përfshijnë:

**Parimi 1:** Cakton dhe dallon qartësisht rolet dhe përgjegjësitë për politikëbërjen për ujin, zbatimin e politikës, menaxhimin dhe rregullimin operacional, dhe nxitjen e koordinimit me këto autoritete përgjegjëse;

**Parimi 2:** Menaxhon ujin në shkallën(t) e duhur brenda sistemeve të menaxhimit të integruar të basenit për të reflektuar kushtet vendore dhe për të nxitur koordinimin ndërmjet shkallëve të ndryshme;

**Parimi 3:** Nxit koherencën për politika nëpërmjet koordinimit ndërsektorial efektiv, veçanërisht ndërmjet politikave për ujin dhe mjedisin, shëndetin, energjinë, bujqësinë, industrinë, planifikimin e hapësirës dhe përdorimin e tokës;

**Parimi 4:** Përshtat nivelin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për ndërlikueshmërinë e sfidave të ujit që duhen përmbushur, dhe setin e kompetencave që kërkohen për kryerjen e detyrave të tyre;

**Parimi 5:** Prodhon, përditëson dhe ndan në kohë të dhëna dhe informacione të vazhdueshme, të krahasueshme dhe që lidhen me politikën dhe me ujin, dhe e përdor atë për të orientuar, vlerësuar dhe përmirësuar politikën e ujit;

**Parimi 6:** Siguron se rregullimet e qeverisjes ndihmojnë për mobilizimin e financave ujore dhe akordimin e burimeve financiare në mënyrë efikase, transparente dhe në kohë;

**Parimi 7:** Siguron se kornizat e shëndosha për menaxhimin e ujërave zbatohen në mënyrë efektive dhe përforcohen në ndjekje të interesit publik;

**Parimi 8:** Promovon miratimin dhe zbatimin e praktikave novatore për menaxhimin e ujërave me autoritetet përgjegjëse, nivelet e qeverisë dhe aktorët përkatës;

**Parimi 9:** Ruan integritetin dhe praktikën e transparencës për politikat e ujit, institucionet e ujit dhe kornizat për menaxhimin e ujërave për llogaridhënie më të madhe dhe besim në vendimmarrje;

**Parimi 10:** Promovon angazhimin e palëve të interesit për kontribute të informuara dhe të orientuara nga rezultatet për projektimin dhe zbatimin e politikës së ujit;

## Mangësitë institucionale

Parimet e MIBU-s kërkojnë krijimin e një kuadri të qartë institucional (MIBU), i cili përcakton mirë dhe ndan përgjegjësitë dhe rolet për hartimin e zbatimit e politikave për ujin, veprimtaritë operacionale dhe rregullatore, ndërkohë që nxit bashkërendimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

Nga pikëpamja institucionale, menaxhimi i burimeve ujore pothuajse i centralizuar, pëson ndryshime të vazhdueshme, të cilat kanë çuar në mbivendosjen e përgjegjësive ndërmjet instituteve të nivelit qendror dhe atij vendor, gjë që ka rezultuar në një sektor ujqor të fragmentuar, me veprimtari joefikase dhe mungesë transparence. Ligji nr. 111/2012 gjithashtu përcakton që Ministria, e cila përkufizohet si 'Ministria përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore' (Neni 4) pa specifikuar nëse ky rol i është dhënë Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZRAU) ose një Ministrie tjetër, zhvillon dhe zbaton politikën e MIBU, strategjitë, programet dhe projektet, në bashkëpunim me ministritë e linjës, dhe është autoriteti kontraktues për konçesione. Ministria gjithashtu përcaktohet nga Ligji si "trupi që krijon, mundëson dhe përditëson Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore. Dallimi midis kadastrës kombëtare dhe inventarit të burimeve ujore kombëtare që do të zhvillohet nga Sekretariati nuk është i qartë.

Mangësia kryesore në vënien në jetë të parimeve të MIBU-së, është fragmentimi i madh i institucioneve të përfshira në menaxhimin e integruar të burimeve ujore (Magnus Opus Group, 2014). Mund të numërohen rreth 50 autoritete të ndryshme, organizata dhe grupe të angazhuara në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve ujore, shumica prej të cilave veprojnë pa ndarë informacionin me agjenci të tjera. Vetëm për monitorimin e burimeve ujore marrin pjesë 20 institucione të ndryshme qeveritare.

Një kuadër institucional ndërsektorial me përfshirjen e palëve të interesit të informuara në MIBU mungon, përgjegjësitë nuk janë përcaktuar qartë, por shpesh janë dyfishim edhe, ndonjëherë, kontradiktore. Vendimet për investimet që lidhen me ujin shpesh merren duke u patur parasysh vetëm nevojat e një sektori të vetëm gjë që ka çuar në investime jo-optimale, mundësi të humbura dhe shpenzimet të tepërta të financave publike të kufizuara. Ky keqmenaxhim i burimeve financiare përbën një pengesë kryesore për rritjen ekonomike, rritjen sektoriale, zbutjen e varfërisë dhe sigurinë e ushqimit në vend (Banka Botëore, 2012).

Rolet në sektorin e burimeve ujore janë shpërndarë në institucione të shumta: Këshilli Kombëtar i Ujit i mbështetur nga STKKU, Drejtoria për Politikën e Burimeve Ujore të MBZHRAU në Nivel Kombëtar dhe Këshillat e Basenit Ujqor dhe Agjencitë në Nivel Baseni. Megjithëse struktura organizative është relativisht e qartë, aktualisht ka një sërë përgjegjësish që mbivendosen ose që nuk lidhen qartësisht me një organ të dhënë si:

- Vendimmarrja në shkallën e duhur;
- Monitorimi dhe raportimi i integruar i ujit;
- Menaxhimi operacional, veçanërisht ofrimi i shërbimeve, operimi i infrastrukturës dhe investimet;
- Rregulloret dhe zbatimi, veçanërisht vendosja e tarifave, standardet, liçencimi, monitorimi dhe mbikëqyrja, kontrolli dhe audit, menaxhimi i konflikteve;
- Nxitja e mekanizmave të bashkërendimit që synojnë hartimin e politikave koherente ndërmjet ministrive, agjencive publike dhe niveleve të qeverisjes, përfshirë planet ndërsektoriale;

---

**Parimi 11:** Nxit kornizat për menaxhimin e ujërave që ndihmojnë në menaxhimin e balancimit ndërmjet përdoruesve të ujit, zonave rurale dhe urbane, dhe brezave;

**Parimi 12:** Promovon monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të politikës dhe menaxhimit të ujit kur është e mundur, ndan rezultatet me publikun dhe bërjen e rregullimeve të nevojshme.

Duke qenë se çështjet për menaxhimin e burimeve ujore janë vendosur aktualisht si fillim në nivel qendror, kjo ka çuar në një mungesë kapaciteti në nivel baseni edhe pse kjo është shkalla e duhur për menaxhimin e ujit<sup>42</sup>, p.sh. *‘Menaxhimi i burimeve ujore në shkallë të përshtatshme brenda sistemeve të menaxhimit të integruar të basenit me qëllim reflektimin e kushteve lokale dhe bashkërendimin ndërmjet niveleve të ndryshme duke u bazuar në një menaxhim të mirëtë ciklit hidrologjik’.*

Një nga çështjet kryesore që rrezikon në të ardhmen për zbatimin e Strategjisë MIBU (dhe DKU) është krijimi i Këshillave të Basenit Ujor (gjashtë), me autonomi të qartë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me çështjet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

### Mangësitë e të dhënave dhe informacionit

Shumë prej institucioneve kryejnë aktivitete të monitorimit të burimeve ujore, përveç Ministrisë së Mjedisit (kryesisht lidhur me zonat e mbrojtura), duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë nëpërmjet Inspektoriatit Shtetëror të Shëndetësisë (për ujin e pijshëm dhe sanitar), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar brenda Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (për ujërat nëntokësorë) dhe Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, nën Ministrinë e Arsimit, e cila gjithashtu mbulon monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujit.

Si rezultat, funksionet instrumentale për zhvillimet e ardhshme të Planeve të Menaxhimit të Basenit Lumor që duhet të jenë të ndërlidhura i janë transferuar entiteve të ndara, si më poshtë:

- inventari i burimeve ujore në nivel pellgu është përgjegjësi e Agjencive të Basenit Ujor, pjesë e strukturës së MBZHRAU, ndërkohë që Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, i cili është nën Zyrën e Kryeministrit, është përgjegjës për inventarin kombëtar; marrëdhënia midis kadastrës së ujit dhe inventarit të ujit është e paqartë;
- MBZHRAU është përgjegjëse për klasifikimin e trupave ujorë, me kërkesë të Këshillave të Baseneve Ujorë. Klasifikimi do të miratohet nga Këshilli i Ministrave (Ligji MBIU, Neni 26);
- objektivat mjedisore, përcaktohen nga MBZHRAU dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave (Ligji MIBU, Neni 25);
- lejet e përdorimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza lëshohen dhe administrohen nga Këshillat e Baseneve Ujore ose, kur aktivitetet në fjalë shtrihen përtej kufijve të një pellgu ujor, nga KKKU. Prandaj, lejet dhe konçesionet janë në parim të regjistruara në Këshillin e Basenit Ujor dhe në nivel KKKU. Shkarkimi i ujërave të zeza janë, sidoqoftë, gjithashtu subjekt i lejeve mjedisore të lëshuara nga Ministria e Mjedisit nën Ligjin No. 10 448, datë 14 Korrik 2011, mbi lejet mjedisore. Ndaj, informacioni mbi shkarkimet e ujërave të zeza rregjistrohet në nivelin e Ministrisë së Mjedisit, përsëri shkëmbimi i informacionit dhe verifikimi i saktësisë së tij është i paqartë;
- autoriteti kontraktues për konçesionet e ujit është MBZHRAU, sipas Ligjit MIBU, prandaj regjistri i konçesioneve mirëmbahet nga MBZHRAU. Në realitet, konçesionet për furnizimin me ujë dhe hidrocentralet janë përgjegjësi e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Prandaj, informacioni mbi konçesionet të lidhur me këta sektorë posedohet prej këtyre ministrive dhe nuk është detyruesisht i regjistruar në regjistrin e MBZHRAU;
- përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Basenit Ujor është përgjegjësi e Agjencisë së Basenit Ujor. Projektplanet miratohen nga Këshillat e Baseneve Ujore dhe më pas nga KKKU. Së fundi, ato miratohen nga Këshilli i Ministrave;
- planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet janë një pjesë integrale e Planeve të Menaxhimit të Basenit Ujor. MBZHRAU është përgjegjëse për përgatitjen e tyre, të cilat më pas aprovohen nga Drejtoria e Emergjencave Civile;
- monitorimi i burimeve ujore është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit, por gjithashtu e Ministrisë së Shëndetësisë, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, MBZHRAU dhe Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit

<sup>42</sup> Koncepti kryesor i baseneve ujore si shkalla e duhur për menaxhimin e ujërave i referohet Deklaratës së Dublinit për Ujin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (1992), e njohur gjithashtu si Parimet e Dublinit.



dhe Mjedisit, përsëri anjë prej këtyre institucioneve nuk duket të jetë nën detyrimin të furnizojë të dhënat e grumbulluara tek STKKU, as tek MBZHRAU. Sipas Nenit. 86, të Ligjit MBIU, Këshilli i Ministrave, mbështetur në propozimin e Ministrit (të Mjedisit), përshtat rregullat për monitorimin sistematik të ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë dhe zonave të mbrojtura. Koordinimi i rolit monitorues i është dhënë Ministrisë së Mjedisit, nëpërmjet AKM, por vëtëm për sa i përket cilësisë së ujit, kështu që është e vështirë, pothuajse e pamundur për të pasur akses në regjistrat e parametrave sasiorë.

- Sipas VKM No. 386, datë 06 Maj 2015, Inspektoriat i Ujit i është bashkëlidhur përgjegjësi të ministrisë për menaxhimin e ujit, aktualisht MBZHRAU.

Një nga mangësitë më serioze të vërejtura gjatë zhvillimit të Strategjisë ishte vështirësia e përgjithshme për të marrë të dhëna të besueshme për hidrologjinë dhe klimën e vendit. Vizita dhe takime të shumta u mbajtën me Projektin e Kadastrës, me përfaqësues të Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM). Nga Projekti i Kadastrës nuk u morën të dhëna për hidrologjinë apo klimën pasi ky projekt nuk ishte në gjendje të merrte ose të gjeneronte të dhëna të tilla në kohë reale. Në lidhje me IGJEUM, kishte disa të dhëna për klimën në dispozicion në formate të shkruara nga vëzhguesit, megjithatë institucioni nuk kishte fonde në dispozicion për t'i përpunuar ato dhe projekti nuk ishte në gjendje të paguante për përpunimin të të dhënave.

### Mangësitë financiare

Mobilizimi dhe akordimi i financimeve për sektorin ujqor në mënyrë efikase, transparente dhe në kohë është një mangësi e dukshme. Parimet e BE-së për politikën e mjedisit, siç janë parimet “ndotësi paguan” dhe “përdoruesi paguan”, si dhe pagesa për shërbimet mjedisore janë përfshirë në rregullore.

Parimi 'ndotësi paguan' dhe 'rekuperimi i kostos' paraqesin një sfidë në këtë kohë. I pari mund të zbatohet vetëm kur barra financiare që a'i vendos mbi ndotësit është në përputhje me potencialin e gjenerimit të të ardhurave në kontekstin ekonomik . Plani i Veprimit i paraqitur në kapitujt vijues kontribon për këtë qëllim. Rekuperimi i kostove duket mjaft i drejtpërdrejtë në vlerë nominale, por në fakt paraqet një sfidë të rëndësishme politike: shpenzimet mund të mbulojnë indirekt dhe drejtpërdrejtë dhe qasja që vendi do të marrë, varet nga ekuilibri midis politikave socialiste dhe atyre të orientuara drejt tregut. Vlerësimi i kostove për zbatimin në të ardhmen të “investimeve të mëdha” të Direktivave të BE-së, që përfshijnë investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata është ende nën rishikim për të arritur përputhshmërinë me Direktivat që merren me trajtimin e ujërave të ndotura urbane, ofrimin e ujit të pijshëm dhe menaxhimin e rrezeve të përmblyetjeve. Kostot për përdorimin dhe mbrojtjen e ujit do të ndihmojnë në vlerësimin e kërkesave për financimin e ujit lidhur me zbatimin e masave në PMBU në të ardhmen. Në përputhje me këtë, zhvillimi i një sistemi tarifash administrative efektive dhe të barabarta do të sigurojë se mangësia e financimit ulet efektivisht në nivel të Basenit Ujqor. Për aq kohë sa nuk ka rikuperim të kostove në këtë nivel ka ende një mangësi financiare për t'u mbuluar nga subvencionet shtetërore dhe financimet e mundshme ndërkombëtare.

### Mangësitë ligjore

Parimi i shtatë i OECD mbi qeverisjen e ujit, *“për të siguruar se kuadrot e shëndosha rregullatore për menaxhimin e burimeve ujore janë zbatuar dhe përforcuar në mënyrë efektive në ndjekje të interesit publik”*.

Ligji Nr. 111/2012 është një akt kuadër tipik me dispozita për çështje të ndryshme që duhet të bëhen nëpërmjet akteve nënligjore (Vendimet e Këshillit të Ministrave), gjithsesi sistemit Shqiptar i mungon legjislacioni përkatës dytësor, për sa i përket menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe mekanizmat e zbatimit që duhet të përcaktohen, me qëllim ofrimin e një sektori efektiv dhe të integruar të ujit. Kjo kërkon gjithashtu nxitjen e krijimit të kornizave të menaxhimit të ujit që ndihmojnë në menaxhimin e balancimit ndërmjet përdoruesve të ujit, zonave rurale dhe urbane dhe brezave të ardhshëm.

Shumica e këtij legjislacioni dytësor nevojitet të hartohen nga ministritë e linjës, që mund të kenë detyra të tjera shtesë. Me qëllim përmbushjen e kërkesave të Direktivave Evropiane dhe trajtimin e disa aspekteve të rëndësishme, ligji do të kishte nevojë ndërmjet të tjerash për disa akte ligjore dytësore,

- Monitorimi i gjendjes së ujërave detare dhe të përkohshëm, ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe zonave të mbrojtura;
- Menaxhimi i ujërave natyrore (ujërave kurative, minerale, gjeotermale);
- Sanksione dhe penalitete për moszbatimin e ligjit, kryesisht për ndotjen e burimeve natyrore, ujërave kurative, minerale dhe gjeotermale.

Për të shmangur mbivendosjet, dhe mosmarrëveshjet, është jetike që të përshtaten përjasje të arsyeshme për zhvillimin e këtyre akteve nënligjore, duke minimizuar sa më shumë është e mundur numrin e VKM-ve.

Objektivi për arritjen e detyrimeve që vijnë nga Bashkimi Evropian në sektorin e ujit, fillimisht nëpërmjet hartimit të një legjislacioni dhe sistemesh planifikimi të përshtatshëm dhe më pas nëpërmjet zbatimit të masave praktike duket e realizueshme në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme.

Mangësi të tjera të nxjerra në pah, lidhen me legjislacionin që duhet të sigurojë se; (i) funksionet kyçe rregullatore janë shpërndarë ndërmjet agjencive publike, instituteve të posaçme dhe niveleve qeverisëse të specializuara dhe (ii) autoriteteve rregullatore u vihen në dispozicion burimet e nevojshme.

### Mangësitë ndërmjet gjinive

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave janë disa nga përparësitë kombëtare. Ratifikimi i Konventës për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), si dhe miratimi i ligjeve për barazinë gjinore, kundër diskriminimit dhe kundër dhunës në familje janë provë e këtij angazhimi dhe, së bashku me miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, ofrojnë kornizën për arritjen e qëllimeve kombëtare.

Një numër ligjesh të rëndësishme të miratuara gjatë dy dekadave të fundit kanë luajtur një rol të rëndësishëm për ndryshimin gradual të ekuilibrit gjinor. Në vitin 2014, Treguesi Global i Mangësisë Gjinore e Renditi Shqipërinë në vendin e 83-të (duke e spostuar nga vendii 108-të në vitin 2013) nga 142 vende gjithsej.

Sipas studimit të INSTAT-it mbi perspektivat gjinore në Shqipëri, gratë përbëjnë pothuajse gjysmën e popullsisë së vendit (INSTAT, 2014). Megjithëse ka patur një rritje ekonomike gjatë viteve të fundit, pozicioni i gruas në tregun e punës vazhdon të mbetet i vogël krahasuar me atë në shtetet të tjera të BE-së. Në përgjithësi, gratë janë të përqendruara në sektorë dhe profesione që ofrojnë rroga më të ulëta në krahasim me sektorët ku zotërojnë meshkujt. Sipas Studimit të Fuqisë Punëtore në vitin 2011, 60.8% e grave dhe 76.4% e burrave janë pjesë e fuqinë punëtore. Burrat, ka më shumë gjasa të jenë punëdhënës ose të vetëpunësuar, ndërsa gratë, ka më shumë gjasa të jenë të punësuar në një biznes familjar. Gratë e punësuar janë kryesisht të përqendruara në sektorin e shërbimeve. Ndryshimi më i madh ndërmjet dy gjinive vihet re në sektorin e industrisë, ku gratë zënë vetëm një të tretën e vendeve të punës. Një numër i madh grash punojnë në bujqësi, në tokën e tyre, pa të ardhura të mjaftueshme për t'i bërë ballë vështirësive ekonomike.

Sipas raporteve të OJF-vë<sup>43</sup> që operojnë në Basenet e Vjosës dhe Drinit, për promovimin e turizmit, prodhimit të ushqimit, trajnimit profesional dhe artizanatit, gratë në zonat malore në Jug dhe në Veri janë aktoret kryesore përgjegjëse për krijimin e bizneseve të vogla ekonomike duke transformuar shtëpitë dhe

<sup>43</sup> CESVI dhe IFAW.

tokat e tyre në një turizëm vendor të qëndrueshëm. Këto zhvillime ofrojnë një situatë pozitive për krijimin e tregjeve për produktet e tyre bujqësore dhe zhvillimin e turizmit.

Duke patur parasysh situatën aktuale gjinore, zbatimi i përfaqes MIBU për çështjet gjinore ka si qëllim të arrijë qëllimet e barazisë sociale për menaxhimin e ujërave, me qëllim që të arrihet shpërndarja e përfitimeve, ulja e kostos sociale, zbutja e varfërisë, dhe rritja e fuqizimit të grave. Një strategji që i kushton vëmendje e duhur barazisë gjinore krijon një balancë pozitive gjinore në procesin e marrjes së vendimeve rreth furnizimit me ujë në nivelet vendore dhe rajonale.

### Mangësitë në kapacitete

Këto mangësi kanë të bëjnë me kapacitetet dhe aftësitë e autoriteteve përkatëse për të përballuar ndërlikimet që sjell zbatimi i MIBU-së, i cili në fund të fundit ka të bëjë me ndërthurjen e një sërë detyrave të ndërlikuara, që mund të përfshijnë shumë aktivitete të ndryshme. Detyrat e ABU lidhen me zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, kur kërkohen kapacitete administrative për çështjet e mëposhtme:

- Përdorimi i ujit: Përdorimi i ujit për qëllime të ndryshme e nga përdoruesit më të mëdhenj, duke ruajtur nivele minimale për përdorim social dhe mjedisor, ndërkohë që plotëson nevojat për barazi dhe zhvillim të shoqërisë;
- Kontrolli i ndotjes: Menaxhimi i ndotjes duke zbatuar parimet “ndotësi paguan” dhe duke dhënë incentivat e duhura për uljen e problemeve më të rëndësishme të ndotjes, si dhe duke pakësuar ndikimet mjedisore dhe sociale;
- Monitorimi: Krijimi i një rrjeti efektiv për monitorim, që ofron informacion thelbësor për menaxhimin, duke identifikuar dhe marrë masa ndaj shkeljeve të ligjit, rregulloreve dhe kërkesave për leje;
- Planifikimi i basenit ujqor: Përgatitja dhe përditësimi i rregullt i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujqor duke përfshirë këndvështrime të palëve të interesit për zhvillimin dhe menaxhimin e prioriteteve për basenin;
- Pjesëmarrja e palëve të interesit: Nxitja e pjesëmarrjes së palëve të interesit si bazë për marrjen e vendimeve që kanë parasysh interesat më të larta të shoqërisë dhe mjedisit gjatë zhvillimit dhe përdorimit të burimeve ujore në basen;
- Menaxhimi ekonomik dhe financiar: Përdorimi i mjeteve ekonomike dhe financiare për investim, rikuperim të kostove dhe ndryshim të sjelljes për arritjen e objektivave lidhur me aksesin e barabartë dhe përfitimet e qëndrueshme për shoqërinë nga përdorimi i ujit;
- Menaxhimi i informacionit: Ofrimi i të dhënave thelbësore që janë të nevojshme për marrjen e vendimeve të informuara dhe transparente për zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në basen.
- Kapacitetet aktuale në Nivel Baseni (me 5-7 anëtarë të stafit për Autoritetin e Basenit Ujqor) nuk i përmbushin nevojat për kapacitete teknike, financiare dhe institucionale që të përmbushin nevojat për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore dhe zbatimin e DKU-së së BE-së.

### Mangësitë në angazhimin e grupeve të interesit

Angazhimi aktual i aktorëve vendorë, nuk është i qenësishëm përse i përket kontributeve të mëdha në lidhje me hartimin dhe zbatimin e praktikave të zakonshme. Strategjia MIBU përfshin një raund konsultimesh me grupet e interesit për të hyrë në diskutim me aktorët privatë dhe ata jo përfitues, të cilët kanë një rol në arritjen e rezultatit, apo kanë më tepër mundësi të ndikohen nga vendimet që lidhen me ujin.

Nxitja e ndërgjegjësimit publik (dhe debatit) për rreziqet dhe kostot që lidhen me disponueshmërinë e ujit (shumë ose shumë pak) ose me trupat e ndotur ujqorë, do të ndihmojë për të ndërtuar konsensus mbi atë se “kush paguan” dhe “për çfarë paguan”, dhe do të kontribuojë për një qëndrueshmëri më të mirë të burimeve dhe përballim më të mirë, tani dhe në të ardhmen.

Megjithatë është e nevojshme t'i kushtohet një vëmendje e veçantë kategorive më pak të përfaqësuara (gratë, të rinjtë, të varfrit, përdoruesit shtëpiakë). Lind nevoja për udhëzime të qarta për pjesëmarrjen aktive të banorëve vendorë dhe përdoruesve të ujit, në menaxhimin e tij, me një fokus specifik mbi rolin e grave në furnizimin, përdorimin dhe ruajtjen e ujit.

Është e qartë që mangësia e përfshirjes së aktorëve vendorë do të zbutet dukshëm duke ndërmarrë iniciativat e mëposhtme:

- Hartëzim të faktorëve vendorë;
- Planifikim dhe udhëzim për përfshirjen e aktorëve;
- Program informimi dhe komunikimi publik, përfshirë zhvillimin e mjeteve për aktorët vendorë.

Projektet për zhvillimin e infrastrukturës duhet të përfshijnë më shumë palë interesi në diskutime dhe në zbatimin e përpjekjeve, pasi disa projekte mund të përkeqësojnë problemet ekzistuese me ujin në zonë. Ndërgjegjësimi publik, përfshirja e shkollës si dhe edukimi dhe aktivitetet e vazhdueshme dhe praktike janë jetike për të qenë të aftë të krijojmë një debat të sinqertë dhe informues.

### Mangësitë në Infrastrukturë

Aktualisht ekziston një kapaciteti i kufizuar në nivel kombëtar për analizë të plotë të mostrave të ujit. Laboratorët ekzistues në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin e Tiranës janë në gjendje të analizojnë vetëm disa parametra fizikë, kimikë dhe lëndë ushqyese, Laboratori REDISH në Tiranë mund të bëjë vetëm disa analiza bakteriologjike dhe asnjë prej tyre nuk ka akreditim ndërkombëtar.

Për sa i përket digave dhe rezervarëve nga 626 digat në vend 410 kanë dëme të konsiderueshme teknike kanë nevojë për vëmendje urgjente si për të siguruar sigurinë e digave dhe disponueshmërinë e ujit për ujitje. Ka gjithashtu probleme në lidhje me pajisjet e nevojshme për funksionimin e digave dhe lëshimin e ujit. Është vlerësuar se reduktimi mesatar dhe ndërtimi i kapacitetit të projektimit është 45%. Rivendosja e kapacitetit origjinal të projektimit dhe nevoja për kapacitete shtesë për të përballuar sfidat e ndryshimeve klimatike konsiderohet si një nga sfidat kryesore.

Situata në lidhje me kanalet e kullimit gjithashtu jep shkak për shqetësim. Në Shqipëri, 280,000 ha janë pajisur me kanale dhe struktura të tjera dhe kullimi. Nga kjo, 205,000 ha janë drenazhuar përmes kanaleve të hapura dhe rrjedhës së gravitetit dhe pjesa tjetër është drenazhuar nga 29 stacione pompimi.. Shumica e stacioneve të pompimit janë afër përfundimit të jetës së tyre teknike dhe kanë nevojë serioze jo vetëm për rehabilitimin, por edhe për modernizimin, për të përmirësuar kapacitetin e pompimit dhe efikasitetin. Kostoja e rikthimit të sistemit të kullimit funksional vlerësohet 72 milionë USD.

## 2.5 Objektivat Strategjike

Për identifikimin e të gjitha problematikave (Çështjeve) dhe Mangësive janë formuluar pesë objektiva strategjike me aktorët e përfshirë gjatë konsultimeve, me qëllim zbatimin dhe përmirësimin e kuadrit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore.

Objektivat Strategjike janë përcaktuar në vijim:

1. **Sasia e ujit:** sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat traspozojnë Direktivat e BE-së.;
2. **Cilësia e ujit:** sigurimi i statusit "cilësi e mirë" për ujin e të gjitha burimeve ujore deri në vitin 2027 duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat traspozojnë Direktivat e BE-së
3. **Rreziqet nga uji:** Përballja me rreziqet që vijnë nga uji/mungesa e ujit (përmbytjet dhe thatësitrat) nëpërmjet menaxhimit dhe investimeve, që i shërbejnë të gjitha interesave, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat traspozojnë Direktivat e BE-së;

4. **Informacioni për ujin:** sigurimi i modeleve dhe të dhënave për ujin dhe klimën të pranuar gjerësisht si të besueshme, e për të gjitha palët e interesit, dhe ofrimi për qeverinë i këshillave mbi hartimin e politikave të përshtatshme për ujin, bazuar në këto të dhëna dhe modele, nga institucione relevante që zotërojnë të dhëna;

**Menaxhimi i ujit:** menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, që i shërben të gjitha interesave, ofron përfitime socio-ekonomike të barabarta që vijnë nga uji dhe përfshin në vendimmarrje gjeneratat e ardhshme, sipas parimeve të politikave mjedisore të ujit të MIBU edhe BE-së.

Është shumë e rëndësishme që vizioni i strategjisë i sjellë në fillim të këtij kapitulli të përkthehet në objektiva të qartë strategjike siç është raportuar më sipër. Kapitulli 3 përshkruan me hollësi këto objektiva dhe aty ku është e mundur, përcakton edhe një afat kohor.

## 3 Objektivat e politikës dhe rezultatet kryesore

### 3.1 Objektivat e politikave që lidhen me sasinë e ujit

**Sasia e ujit: sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore që i shërben të gjitha interesave, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore kombëtare të cilat transpozojnë me Direktivat e BE-së.**

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me sasinë e ujit dhe, si rrjedhojë, edhe me shpërndarjen e ujit ndërmjet përdoruesve. Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni kërkon aftësi profesionale për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Basenit Ujor, që synojnë përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit, marrjen e masave për mbrojtjen e tij si dhe marrjen parasysh të ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Aftësia për t'i bërë ballë ndryshimeve klimatike mund të shihet edhe si aftësi e sistemit për të përballuar pasojat që vijnë nga ndryshimet klimatike dhe për të ruajtur funksionet e tij, ndërkohë që përshtatet, riorganizohet dhe zhvillohet.

Përveç masave teknike, shpërndarja e ujit ndërmjet përdoruesve lidhet me ndikimet socio-ekonomike. Kush kontrollon, ka akses dhe përfiton nga burimet ujore, ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga menaxhimi i ujërave. Për këtë arsye në rastin e këtij objektivi nevojitet një analizë e perspektivës socio-ekonomike dhe gjinore me qëllim marrjen e masave të duhura për arritjen e barazisë gjinore. Arritja e barazisë për përfitimet që vijnë nga përdorimi i ujit kërkon marrjen parasysh të grupeve vulnerabël të shoqërisë, të cilët zakonisht kanë më pak mundësi ose aftësi për të shprehur shqetësimet e tyre. Me zhvillimin e PMBU-ve dhe PM-ve përkatëse, institucionet drejtuese dhe palët e interesit duhet të kenë parasysh aksesin në ujë kur përcaktojnë se cilat investime do të kenë përparësi (sigurimi i shërbimeve bazë sipas rëndësisë në lidhje me përmirësimin e shërbimeve ekzistuese.). Kjo do të ishte një çështje diskutimi për grupin nën-tematik "ujin për njerëzit".

#### 3.1.1 Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni ujor

Një ndër parimet kryesore të MIBU-s është menaxhimi i burimeve ujore në nivelin e duhur brenda sistemeve të integruara të menaxhimit të baseneve me qëllim që të reflektohen kushtet vendore. Ekzistenca e gjashtë këshillave dhe agjencive të baseneve ujore përbën një bazë të shëndoshë që respekton këtë parim. Megjithatë, aktualisht autoritetet nuk kanë kapacitetet që u nevojiten për menaxhimin e burimeve ujore në mënyrë të integruar dhe që i bën ballë ndryshimeve klimatike.

Përmirësimi i parashikuar i infrastrukturës (së ujitjes) kontribuon në një shpërndarje më të mirë të burimeve ujore dhe për këtë arsye kërkon përfshirjen e grupeve të interesit. Për më tepër, zhvillimi i PMBU-ve për secilin basen ujor do të përcaktojë kriteret e qarta dhe përparësitë për sasinë e përdorur të ujit të huazuar në kushtet specifike të secilit basen.

#### 3.1.2 Masat për përballjen me ndryshimet klimatike

Në sektorin e ujit, masat që duhen marrë për periudhën 2017-2019 për përballjen me ndryshimet klimatike në të cilat përfshihen edhe masat për arritjen e barazisë gjinore, në bazë të kriterëve kosto-efikase, duhet të lidhen si me cilësinë ashtu dhe me sasinë e ujit. Kjo do të arrihet nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës zbatimi i të cilit nevojitet që të përfundojë në fund të vitit 2027 dhe të përfshijë të gjitha institucionet që kanë lidhje me ujin në nivelin qendror, rajonal dhe vendor.

Duke pasur parasysh sasinë e ujit, përfshirë problemet gjinore, masat ndaj ndryshimeve klimatike në të cilat do të konsiderohen edhe masat për arritjen e barazisë gjinore, do të përfshijnë edhe masa shtesë për

mbrojtjen nga përmbytjet dhe konservimin e ujit duke u bazuar në kushte specifike në secilin basen, veçanërisht duke marrë në konsideratë zhvillimet e hidroenergjisë.

### 3.1.3 Përmirësimi i rrjetit tëshpërndarjes së ujit (infrastruktura) dhe masat për ruajtjen e tij

Masat për ruajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës duhet të analizohen dhe përcaktohen nga grupet e interesit gjatë periudhës 2017-2021, në bazë të kriterëve para-përcaktuesë që mundësojnë paanshmëri, efektivitet në kosto dhe ndikim sa më të madh pozitiv. Përgjegjësia e përgatitjes së projektit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës duhet të shpërndahet vazhdimisht ndërmjet sektorëve të lidhur me ujin (bujqësisë, furnizimit me ujë, energjisë dhe mjedisit) në periudhën 2017-2027, si pjesë e procesit të bashkërendimit ndërsektorial.

Infrastruktura e Ujit përfshin projekte të cilat janë të nevojshme për të siguruar që uji është në dispozicion për periudhën e kërkuar, në sasinë e duhur, me cilësinë e duhur, i shpërndarë në vendin e duhur, tek përdoruesit e regjistruar dhe që paguajnë. Elementët e infrastrukturës përfshijnë rezervuarë, stacione pompimi, kanale dhe tubacione shpërndarëse, punime për ujitje, impiante trajtimi dhe punime për ruajtjen nga përmbytjet. Kostot dhe përfitimet që vijnë nga infrastruktura e ujit kanë ndikime sociale dhe mjedisore të cilat nuk kufizohen në një sektor të veçantë. Gjatë periudhave të ndryshimeve klimatike, rehabilitimi/rindërtimi i sistemeve të mbrojtjes nga përmbytjet, si argjinaturat lumore ose detare dhe rritja e sigurisë së tyre është e domosdoshme (Mukaj, 2014). Masat për ruajtjen (konservimin) janë të ndryshme nga matsat e ujit, incentivat ekonomike, pajisjet për kursimin e ujit, siç janë matësat për kursimin e ujit, deri tek rrjeti për ujitje (GWP-TEC, 2009).

Me qëllim rritjen e efikasitetit në përdorim, konservim, riciklim dhe ripërdorim të ujit, Menaxhimi i Kërkesës për Ujë do të shtjellohet më në thellësi. Kjo kërkon një ndryshim të madh të mënyrës së menaxhimit të ujërave, larg zhvillimit tradicional të përqëndruar në furnizimin me ujë (ndërtimin e infrastrukturës fizike për grumbullimin e një sasive sa më të madhe uji për përdorim të drejtpërdrejtë) dhe ecjen drejt rritjes së efikasitetit në përdorimin, ruajtjen, riciklimin dhe ripërdorimin e ujit.

Për të garantuar menaxhimin e drejtë të kërkesës për ujë, kërkohet marrja e veprimeve të mëposhtme:

- Kërkimi i opsioneve me perfshirrjen e masave komplekse funksionale, siç është: ulja e niveleve të ujit në diga përpara sezonit të përmbytjeve, në mënyrë që ujërat e grumbulluara nga përmbytja të mund largohen, me koston e zvogëlimit të potencialit për prodhimin e hidroenergjisë;
- Zhvillimi i skemave që detyrojnë kufizimin e përdorimit të ujit gjatë periudhës së verës me prurje të pakta;
- Vendosja e matsave në të gjithë vendin për matjen e sasisë së ujit nëpër tubacione (në shfrytëzim);
- Futja e skemave “përdoruesi paguan” që përfshin incentiva për mbylljen e puseve dhe lidhjeve të paligjshme;
- Kërkimi i mundësive për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes/kullimit bazuar në racionalizim dhe modernizim;
- Stimulimi e metodave të ujitjes me efikase nëpërmjet incentivave që synojnë uljen e sasisë së ujit të përdorur.

### 3.1.4 Shpërndarja e barabartë e përfitimeve

Për të shmangur pabarazitë në varfëri, mirëqenie dhe ndërmjet gjinive në zonat e baseneve, nevojitet një analizë e dallimeve sociale dhe gjinore lidhur me aksesin, kontrollin dhe përdorimin e burimeve ujore, ndërsa përcaktohen skenarët e zhvillimit të basenit. Si të tillë, nevojitet studimi i gjendjes sociale për periudhën 2017-2019. Në vijim të planeve të veprimit për integrimin e çështjeve gjinore dhe të preksshmërisë sociale në menaxhimin e burimeve ujore, të prezantuara në strategji dhe raporte të ndryshme që kanë lidhje me ujin,

nevojitet zhvillimi i një liste prioritesh nga Grupi Tematik në lidhje me “Ujin për Njerëzit” deri në Korrik të vitit 2018, përfshi projekte pilote për zonat e pazhvilluara në 18 muajt në vijim (deri në fund të vitit 2019).

Miratimi i akteve nënligjore duhet të pasohet nga një numër i madh përpjekjesh të instituteve qendrore, gjatë periudhës 2017-2018, për të zhvilluar udhëzime specifike dhe procedura dhe për të ndihmuar këshillat e baseneve ujore që gjatë zbatimit të tyre të bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, të grupeve të interesit e veçanërisht të grave gjatë menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

### 3.1.5 Përfshirja e publikut dhe debati i hapur

Ndërgjegjësimi i përdoruesve të ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e ujit dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të tij. Interesat konkurruese (nga sektorë dhe nga grupe sociale) kërkojnë që publiku të jetë i informuar dhe i përditësuar sistematikisht nga trajnues femra dhe meshkuj. Për këtë qëllim, vlerësimi i kurrikulës ekzistuese dhe zhvillimi i temave shtesë që synojnë futjen e kulturës për mbrojtjen e ujit duhet të përfundojë nga fundi i vitit 2017. Është e rëndësishme që mësuesit dhe instruktorët duhet të trajnohen në fundin e muajit Korrik 2018 rreth temës “uji për jetën”.

## 3.2 Objektivat e politikave për cilësinë e ujit

**Cilësia e ujit: Sigurimi i cilësisë së ujërave të të gjitha burimeve ujore duke arritur statusin “cilësi e mirë” deri në vitin 2027, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore kombëtare të cilat traspozojnë me direktivar e BE-së.**

Ky objektivi strategjik merret me cilësinë e ujit, që ndikon përdorimin e ujit dhe si pasojë ka ndikime socio-ekonomike. Cilësia e ujit në shtetet (kandidate) anëtare përcaktohet në Nenin 1 të Direktivës Kuadër të Ujit, që pohon se “Qëllimi i kësaj Direktive është krijimi i një kuadri për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të brendshme, ujërave të përkohshme, ujërave bregdetare dhe atyre nëntokësore që:

- Parandalon përkeqësimin e mëtejshëm dhe mbron dhe përmirëson gjendjen e ekosistemeve ujore dhe që lidhet me nevojat e tyre ujore, ekosistemet tokësore dhe ligatinat që varen direkt nga ekosistemet ujore;
- Nxiti përdorimin e qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore;
- Synon përfundimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ndër të tjera, nëpërmjet masave specifike për uljen shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave prioritare dhe ndërprerjen ose ndarjen në faza të shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave prioritare të rrezikshme;
- Siguron uljen e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe parandalon ndotjen e mëtejshme të tyre, dhe
- Ndihmon në zbutjen e pasojave që kanë përmbytjet dhe thatësitat.”

DKU-ja përqendrohet së pari tek mbrojtja e ekosistemeve ujore dhe së dyti tek përdorimi i qëndrueshëm i ujit ku përfshihet edhe uji i pijshëm. Si pasojë, përcaktimi i masave jostrukturale (institucionale dhe për parandalimin e ndotjes) duhet të jetë prioritet në periudhën e parë. Edhe pse njësoj të rëndësishme, masat lidhur me strukturat (sistemet inxhinierike dhe ndërtimore) duhen përcaktuar mbas një analize e planifikimi që duhet të zhvillohet gjatë periudhës 2018-2021.

### 3.2.1 Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni ujor

Një nga parimet kryesore të MIBU-së është menaxhimi i burimeve ujore në nivelin e duhur brenda sistemeve të integruara të menaxhimit të baseneve me qëllim që të mbahen parasysh kushtet vendore. Ekzistenca e gjashtë këshillave dhe autoriteteve të baseneve ujore është një bazë e shëndoshë. Megjithatë, autoritetet nuk kanë kapacitetet e nevojshme për menaxhimin e burimeve ujore në mënyrë të integruar dhe që të marrë në konsideratë efektet e ndryshimeve klimatike.



Duke patur parasysh cilësinë e ujit, në vitin 2017 duhet të zhvillohen dy PMBU bazë, që përcaktojnë përparësi dhe kriteret të qarta për përdorimin e ujit duke u bazuar në kushte specifike të secilit basen, që bëjnë të mundur monitorimin sipas parimeve të DKU-së dhe i hapin rrugën zhvillimit të PMBU-ve të mbetura.

### 3.2.2 Përcaktimi i masave për përballjen me ndryshimet klimatike

Qëndresa ndaj ndryshimeve klimatike mund të merret edhe si aftësi e sistemit për t'i bërë ballë pasojave të ndryshimeve klimatike dhe për të ruajtur funksionet e tij, ndërkohë që përshtatet, riorganizohet dhe zhvillohet. Për sektorin e ujit, masat e qëndresës ndaj ndryshimeve klimatike që do të përzgjidhen për periudhën 2017-2019, duke përdorur kriteret e përzgjedhjes me kosto-efektive, duhet të lidhen si me cilësinë ashtu edhe me sasinë e ujit.

Duke pasur parasysh cilësinë e ujit, në Programet e Masave për secilin PMBU është parashikuar "kontrolli i klimës". Qëllimi i përgjithshëm i kontrollit klimatik është të garantojë se PM-të janë përshtatur mjaftueshëm për ndryshimet e ardhshme klimatike (shih 3.2.4).

### 3.2.3 Përcaktimi i statusit "cilësi e mirë e ujit"

Statusi "cilësi e mirë e ujit" përcaktohet në DKU (Aneksi V) dhe bazohet në karakteristikat kimike të ujit të gërshetuara me florën dhe faunën ujore. Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim në BE, i kërkohet të klasifikojë ujërat sipas rastit. Për përcaktimin e statusit ekologjik të ujërave, DKU-ja thekson nevojën e përcaktimit të cilësisë së ujërave. Kjo nënkupton se vendi do të ketë nevojë që gjatë periudhës 2017-2018 të përcaktojë metodat/mjetet e saj për monitorimin e gjendjes ekologjike si për elementët cilësorë biologjikë ashtu edhe për ata fiziko-kimikë.

Tabela e mëposhtme përmbledh treguesit biologjikë, kimikë dhe hidro-morfologjikë siç përcaktohet në DKU të cilët duhen përdorur gjatë vlerësimit të cilësisë së ujërave (EC, 2005).

Niveli që mund të arrijë ndonjë prej tyre dhe afatet kohore për të bërë të mundur këtë është në varësi të negociatave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së si pjesë e procesit të anëtarësimit, qëllimet duhet të jenë të arsyeshme edhe të suksesshme.

**Tabela 16: Përmbledhje e treguesve siç përcaktohet në Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin**

Aneksi V 1.1.1. Lumenjtë	Aneksi V 1.1.2. Liqenet	Aneksi V 1.1.3. Ujërat Tranzitore	Aneksi V 1.1.4. Ujërat Bregdetare
<b>Elementët Biologjikë<sup>44</sup></b>			
Përbëja dhe sasia e florës ujore; Përbërja dhe sasia e faunës intervetebrore bentike; Përbërja, sasia dhe struktura e moshës së faunës së peshqve.	Përbërja dhe sasia e florës ujore; Përbërja dhe sasia e florës tjetër ujore; Përbërja dhe sasia e faunës intervetebrore bentike; Përbërja, sasia dhe struktura e moshës së faunës së peshqve.	Përbërja, sasia dhe biomasa e fitoplanktonit; Përbërja dhe sasia e florës tjetër ujore; Përbërja dhe sasia e faunës intervetebrore bentike; Përbërja dhe sasia e faunës së peshqve.	Përbërja, sasia dhe biomasa e fitoplanktonit; Përbërja dhe sasia e florës tjetër ujore; Përbërja dhe sasia e faunës intervetebrore bentike.
<b>Elementë hidromorfologjikë që mbështesin elementët biologjikë</b>			
Regjimi Hidrologjik: ● Sasia dhe dinamika e rrjedhës	Regjimi Hidrologjik: ● Sasia dhe dinamika e	Regjimi i rrjedhës: ● Rrjedha e ujit të ëmbël;	Regjimi i rrjedhës ● Drejtimi dhe rrjedhat

<sup>44</sup> Diatoma -(alga) gjenden në shkëmbinjtë dhe bimë, Makrofite – Bimë ujore të dukshme për syrin e lirë, që rriten në lumenjtë Makroinvertebrorë – Insekte, krimba, molusqe, krustacë etj. Që jetojnë në shtyrat e lumit, Fitoplankton – bimë mikroskopike që lundron e lirë, Algat Makro – leshterikë deti të dukshëm për syrin e lirë, Angiosperms – barëra deti dhe bimë të njemëlta.

Aneksi V 1.1.1. Lumenjtë	Aneksi V 1.1.2. Liqenet	Aneksi V 1.1.3. Ujërat Tranzitore	Aneksi V 1.1.4. Ujërat Bregdetare
<p>së ujit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Lidhja me trupa ujqre nëntokësorë;</li> <li>Vazhdimësia e lumit.</li> </ul> <p>Kushtet morfologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshueshmëria në thellësinë dhe gjerësinë e lumit;</li> <li>Struktura dhe nënshtresa e shtratit të lumit;</li> <li>Struktura e zonës në breg.</li> </ul>	<p>rrjedhës së ujit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Koha e largimit;</li> <li>Lidhja me trupa ujqre nëntokësorë.</li> </ul> <p>Kushtet morfologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshueshmëria e thellësisë së liqenit;</li> <li>Sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit të liqenit;</li> <li>Struktura e bregut të liqenit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekspozimi ndaj valëve.</li> </ul> <p>Kushtet morfologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshueshmëria në thellësi;</li> <li>Sasia, struktura dhe nënshtresa e shtratit;</li> <li>Struktura e zonës përpara bregut.</li> </ul>	<p>kryesore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>ekspozimi ndaj valëve.</li> </ul> <p>Kushtet morfologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshueshmëria në thellësi;</li> <li>Struktura dhe nënshtresa e shtratit bregdetar;</li> <li>Struktura e zonës përpara bregut.</li> </ul>
<b>Elementë kimikë dhe fiziko-kimikë që mbështesin elementët kimikë</b>			
<p>E përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kushtet termale;</li> <li>Kushtet e oksigjenimit;</li> <li>Kripësia;</li> <li>Gjendja e acidifikimit;</li> <li>Kushtet e ushqimit.</li> </ul> <p>Ndotësit specifikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotja me substanca prioritare të identifikuar si substanca që shkarkohen në një trup ujqre;</li> <li>Ndotja me substanca të tjera të identifikuar si substanca që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në një trup ujqre.</li> </ul>	<p>E përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Transparenca;</li> <li>Kushtet termale;</li> <li>Kushtet e oksigjenimit;</li> <li>Kripësia;</li> <li>Gjendja e acidifikimit;</li> <li>Kushtet e ushqimit.</li> </ul> <p>Ndotësit specifikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotja me substanca prioritare të identifikuar si substanca që shkarkohen në një trup ujqre;</li> <li>Ndotja me substanca të tjera të identifikuar si substanca që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në një trup ujqre;</li> </ul>	<p>Epërgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Transparenca</li> <li>Kushtet termale</li> <li>Kushtet e oksigjenimit</li> <li>Kripësia</li> <li>Kushtet e ushqimit</li> </ul> <p>Ndotësit specifikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotja sipas substancave prioritare të identifikuar si substanca që shkarkohen në trupin ujqre;</li> <li>Ndotja nga substanca të tjera të identifikuar si substanca që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në trupin ujqre.</li> </ul>	<p>Epërgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Transparenca;</li> <li>Kushtet termale;</li> <li>Kushtet e oksigjenimit;</li> <li>Kripësia;</li> <li>Kushtet e ushqimit.</li> </ul> <p>Ndotësit specifikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotja me substanca prioritare të identifikuar si substanca që shkarkohen në një trup ujqre;</li> <li>Ndotja me substanca të tjera të identifikuar si substanca që shkarkohen në sasi të konsiderueshme në një trup ujqre.</li> </ul>

Pas vitit 2017, Inspektoriatet Mjedisore do të jenë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e standardeve të reja të cilësisë së ujit në të gjithë vendin, me mbështetjen e autoriteteve të baseneve ujqre.

### 3.2.4 Zhvillimi i programeve lidhur me masat për zbatimin e DKU-së

Gjatë hartimit të udhëzuesve për zbatimin e DKU-së në vitin 2017, që synojnë zbatimin efektiv, të qëndrueshëm, për secilin Basen Ujqre, duhet të vihen në jetë parimet e mëposhtme udhëzuese të BE-së (BE DKU Dokument Udhëzues Nr. 24, 2009):

- Marrja parasysh e ndryshimeve klimatike të mundshme gjatë planifikimit të masave veçanërisht kur këto masa janë afatgjate dhe kanë kosto të lartë. Është e rëndësishme që sa herë planifikohet marrja e masave të analizohet fakti nëse këto masa janë efektive për t'i bërë ballë ndryshimeve klimatike;
- Përzgjedhje të masave të qëndrueshme dhe fleksibël ndaj pasigurive që marrin parasysh larminë e pasojave që lidhen me kushtet e ardhshme klimatike. Hartim të masave duke u bazuar në vlerësime dhe analiza paraprake rreth parashikimeve lidhur me ndryshimet e klimës;
- Zgjedhja e masave të qëndrueshme e të përshtatshme, veçanërisht për ato masa që sjelin përfitime ndërsektoriale, dhe që kanë ndikimin më të pakët mjedisor, përfshirë shkarkimet e gazrave serë.

Për shkak se brenda cikleve të planifikimit të menaxhimit të njëbaseni ujqre do të bëhen investime financiare të shumta, dhe se shumë masa dhe investime do të kenë një kohë të gjatë veprimi dhe, me shumë mundësi, nuk do t'u jepet mundësia që të ndryshojnë ose të përshtaten, autoritetet qendrore/BRK-të, me mbështetjen e këshilltarëve, sipas rastit, duke filluar që nga viti 2018, mund të ketë nevojë për ekzaminim të efekteve të mundshme të ndryshimeve klimatike dhe ndërmarrjen e një "kontrolli klimatik" për Programet e propozuara të Masave për secilin PMBU.

Qëllimi i përgjithshëm i mbajtjes në vëzhgim të ndryshimeve të klimës është sigurimi se PM-të i janë përshtatur mjaftueshëm kushteve klimatike të ardhshme. Vëzhgimi i ndryshimeve klimatike duhet të ofrojë një lloj analize të ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, që shërben si bazë për përzgjedhjen e masave efektive, të qëndrueshme dhe me kosto efektive për kushtet gjithnjë e më ndryshim. Gjithashtu, duhet të sigurojë se masat sjellin përfitime për objektivat e planeve të menaxhimit të basenit ujor, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen.

Në ciklet pasuese të MBU-së, Programi i Masave duhet të marrë parasysh ndryshimet klimatike të përcaktuara në bazë të kërkimeve shkencore, duke patur parasysh se njohuritë dhe të dhënat rreth ndryshimeve klimatike ndryshojnë vazhdimisht. Në përgjithësi, vetëm masat që janë të qëndrueshme ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe që nuk i shtojnë ndryshimet klimatike duhet të merren parasysh në PMBU-të e ardhshme.

Çdo vëzhgim i ndryshimeve klimatike për PM-të duhet të përfshijë edhe një vlerësim të çdo mase më vete ose të masave të një kategorie, në mënyrë që të përcaktohet nëse masat e përcaktuara janë të qëndrueshme në kohë ndaj ndryshimeve të ardhshme.

Për trajtimin e ujërave të ndotura nevojiten investime të mëdha. Dispozitat e Direktivës së Trajtitimit të Ujërave të Ndotura Urbane për trajtimin e ujërave të ndotura në vendndodhjet me popullsi më të madhe se 2,000 banorë janë të vlefshme deri në fundin e vitit 2031 dhe për trajtimin e përparuar për një popullsi më të madhe se 10,000 banorë, në zonat e ndjeshme të vlefshme deri në fundin e vitit 2027.

### 3.2.5 Pjesëmarrja e publikut dhe një debat i bazuar në ndarje informacioni

Përfshirja publike për përmirësimin e cilësisë së ujit është përshkruar në Nenin 14 të Direktivës së DKU-së. Ky nen përshkruan përfshirjen e publikut në të gjitha aspektet e zbatimit të Direktivës, veçanërisht në procesin e planifikimit. Shtetet (Kandidate) Anëtare duhet të nxisin përfshirjen aktive të konsultohen dhe të kenë akses në informacionet bazë. Pjesëmarrja e publikut është aktive atëherë kur i jepet mundësia që të ketë ndikim në proces. Kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se publiku duhet të mbajë përgjegjësi për menaxhimin e burimeve ujore. Pjesëmarrja aktive kërkon më shumë sesa zbatimin e Ligjit aktual Nr. 146/2014, "Për Njoftime dhe Konsultime Publike". Është gjithashtu e rëndësishme që të hapet një debat informues me palët e interesit dhe publikun e gjerë. Dokumenti Nr. 8 i Udhëzimit për Direktivën Kuadër të Ujit për Pjesëmarrjen Publike ofron udhëzime të qarta për mënyrën se si të përfshihen palët e interesit dhe publiku i gjerë në procesin e vendimmarrjes. Shqipëria do të ketë nevojë të zhvillojë një plan të plotë zbatimi për Direktivën Kuadër të Ujit.

Deri në Dhjetor të vitit 2017, duhet zhvilluar një program afatshkurtër për fushata ndërgjegjësuere me fokus problemet specifike të baseneve ujore për shkollat në të gjithë vendin, i cili të mund të përfshijë vizita në në sistemet e ujitjes ose në rrjetet e furnizimit me ujë, në digat e rinovuara, në festën e Ditës Botërore të Ujit, në konkurse esesh, etj. Zbatimi i fushatave të tilla ndërgjegjësuere nga institucionet qendrore në shkolla gjatë vitit 2018 dhe vitit në vazhdim do të ketë synime të dyfishta, përfshirja e publikut dhe ndryshimi social do të rritet nga poshtë-lartë (nga fëmijët tek prindërit, tek komunitetet) dhe autoritetet vendore dhe shoqëria civile do të kenë mësuar të mobilizohen dhe të jenë ndërgjegjësuar për problemet e menaxhimit të (integruar) të burimeve ujore.

### 3.3 Objektivat e politikave lidhur me rreziqet që vijnë nga uji

Rreziqet që vijnë nga uji (përmblytjet dhe thatësitrat) përballohen me një menaxhim efikas të burimeve ujore dhe me investime që i shërbejnë të gjitha interesave, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore kombëtare

të cilat traspozjnë me direktivat e BE-së Ky objektivi strategjik ka të bëjë me rreziqet që lidhen drejtpërsëdrejti me ujin, siç janë thatësitrat dhe përmytjet, dhe rreziqet jo të drejtpërdrejta<sup>45</sup>. Ndryshimet klimatike janë shumë të rëndësishme pasi ato janë shtyssa kryesore e rreziqeve që vijnë nga uji në Shqipëri. Prurjet parashikohet që të pakësohen dhe nivelet e ujërave nëntokësore të ulen duke zvogëluar kështu rezervat e ujit në vend. Rritja e nivelit të detit ndikon në prishjen e cilësisë së ujërave nëntokësore në zonat ku akuiferët janë duke shteruar nëpërmjet depërimit të ujit të kripur të detit.

Nga ana tjetër, rreziqet nga përmytjet do të rriten për shkak të reshjeve të mëdha që, me shumë mundësi, do të gërshetohen me shkrirjen e borës të shkaktuar nga temperaturat e larta. Praktikata e përdorimit të tokës duhet të rishikohen pasi ato ndikojnë ndjeshëm në përmytjet, erozionin, zjarret në pyje dhe sigurinë e digave. Prandaj, përgatitja për katastrofa të mëdha është e pashmangshme, dhe duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë krijimit të sistemeve paralajmëruese që kanë fokusohen veçanërisht tek gratë dhe grupet e rrezikuara sociale. Grupet nën-tematike duhet të konsiderojnë çfarë mund të ishte një strategji menaxhimi e përshtatshme në kushtet e thatësitrave.

### 3.3.1 Menaxhim efektiv i katastrofave natyrore në vend

Sipas të dhënave<sup>46</sup> të EM-DAT, për periudhën 1980-2016, janë regjistruar 29 katastrofa natyrore nga të cilat, 17<sup>47</sup> kishin të bënin me ujin. Për zhvillimin e një Plani Kombëtar për Menaxhimin e Fatkeqësive në vend duhet të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Analizimi i situatës lidhur me përmytjen dhe ndotjen në çdo basen ujor për periudhën 2017-2018;
- Analizimi i situatës lidhur me thatësitren, pamjaftueshmërinë e ujit dhe zjarrin në pyje në çdo basen ujor për periudhën 2018-2019;
- Analizimi, përditësimi dhe forcimi i sistemeve paralajmëruese nga pikëpamja organizative dhe teknike deri në fund të vitit 2019;
- Forcimin e strukturave që merren me uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe menaxhimin e tyre në periudhën 2018-2019;
- Analizimi dhe përmirësimi i kapacitetit të qeverisë për ndërhyrjet në rastet e katastrofave natyrore deri në fund të vitit 2020;
- Hartimi dhe zbatimi i fushatave për ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet që vijnë nga përmytjet në vitin 2018.

### 3.3.2 Sigurimi i mbrojtjes nga përmytjet

Mbrojtja ndaj përmytjet në Shtetet Anëtare (Kandidate) përcaktohet nga Direktiva e Përmytjeve (DP) e cila u miratua në vitin 2007. Kjo direktivë ka si qëllim të ulë pasojat e dëmshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe të aktiviteteve ekonomike që vijnë si pasojë e përmytjeve. Kjo përfshin përmytjet si nga lumenjtë ashtu edhe nga deti, por jo përmytje nga rrjeti i kanalizimeve. Hapat kryesorë që duhen ndjekur për periudhën 2017-2020 janë:

- **Vlerësim paraprak i rrezikut nga përmytjet:** (Harta) të vendndodhjes dhe përshkrimi i zonave që ndikohen nga përmytjet duke u bazuar mbi përmytjet në të kaluarën dhe mbi studime zhvillimore afatgjata (veçanërisht ndryshimet klimatike);

<sup>45</sup> Përfshin ndër të tjera sasi të pakta ujore, epidemi, temperatura ekstreme, uti, përmytje, aksidente industriale, rrëshqitje tokash, aksidente rrugore, dallgë/valë, zjarre në lëndët e djegshme dhe stuhi.

<sup>46</sup> EM-DAT është një bazë e të dhënave globale mbi katastrofat natyrore dhe teknologjike e cila përmban të dhëna kyç mbi ndodhitë dhe pasojat të më shumë se 21,000 katastrofave në botë prej 1900 deri më sot. EM-DAT mirëmbahet nga Qendra për Kërkime mbi Epidemiologjinë e Katastrofave (CRED).

<sup>47</sup> Për të ilustruar rëndësinë në lidhje me to në Shqipëri; nga 29 gjithësej, 13 ishin përmytje, 2 valë të nxehti, një zharr në pyll, dhe një që pati ndikim mbi shumë njerëz, u shkaktua nga thatësira e 1989.

- **Hartat e zonave qërrezikojnë nga përmbytjet:** zonat që me probabilitet të ulët, mesatar dhe të lartë përmbytjeje, dhe që tregojnë: shtrirjen e përmbytjes, thellësinë e ujit ose nivelin e ujit dhe shpejtësinë e rrjedhës (aty ku është e mundur);
- **Harta e rreziqeve nga përmbytjet:** pasojat që vijnë nga përmbytjet lidhur me: numrin e banorëve që mund të ndikohen, llojin e aktiviteteve ekonomike, impiantet/aktivitetet që kanë leje mjedisore të tipit A dhe B dhe tregues të tjerë të dobishëm;
- **Planet e Menaxhimit të Rreziqeve nga Përmbytjet,** që përmbajnë:
  - Përfundimet e vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet;
  - Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat me rreziqet nga përmbytjet;
  - Objektivat që kanë si qëllim zbutjen e pasojave potenciale të dëmshme;
  - Masat për arritjen e objektivave (parandalim, mbrojtje, përgatitje);
  - Një analizë kosto-fitim që përdoret për të vlerësuar masat me efekte ndërkufitare.

Përgatitja e masave jo-strukturore (institucionale) duhet të ketë përparësi për periudhën 2021-2022. Edhe pse të të njëjtës rëndësi, masat strukturore (sistemet e projektuara dhe tëndërtuara) kanë nevojë për përpjekje të konsiderueshme për sa i përket analizimit, planifikimit, financimit të tyre dhe duhen përcaktuar në periudhën kohore 2022-2026.

### 3.3.3 Përgatitja për përballje me thatësitrat dhe kufizimet e ujit

Ndërkohë që përgatitimi për thatësitrat dhe sasirat e pakta të ujit është e rëndësishme që të kuptojmë se ato janë dy fenomene të ndryshme. Thatësitrat janë me origjinë natyrore ndërsa pamjaftueshmëria e ujit (ose shterrimi i ujit) përkufizohet si një situatë ku burimet ujore janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat afatgjata për përdorim të ujit. Planifikimi për t'i bërë ballë thatësirave dhe menaxhimi i sasirave të pakta të ujit është një ndërthurje e ndërlikuar e monitorimit të tendencave hidro-meteorologjike me menaxhimin teknik të burimeve ujore dhe lehtësimin e ndikimeve socio-ekonomike.

Sipas Komisionit Evropian, thatësitrat duhet të trajtohen në një mënyrë të ngjashme me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet. Megjithatë nuk ka Direktiva të BE-së, ka Direktiva të qarta të bazuara te DKU-ja për përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të Thatësirave (GWPCCE, 2015). Informacioni efektiv, sistemet paralajmëruese dhe harta e rreziqeve që vijnë nga thatësira shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe planeve efektive për përballjen me thatësitrat, si edhe rrjetëzimin dhe koordinimin efektiv ndërmjet autoriteteve kompetente për menaxhimin e ujërave në nivele të ndryshme. Këto hapa duhen ndërmarrë gjatë periudhës 2017-2020.

Zhvillimi i Planeve për Menaxhimin e Baseneve Ujore ofron një mundësi të mirë për të trajtuar problematikat lidhur me thatësitren dhe pamjaftueshmërinë e ujit. Në mënyrë specifike, kërkesa e DKU-së për arritjen e statusit sasior të ujërave nëntokësore përfshin balancimin ndërmjet shterrimit të ujërave nëntokësore dhe rimbushjes së tyre. Përsa i përket kërkesës për arritjen e statusit të mirë ekologjik për ujërat sipërfaqësore, është e nevojshme që të përcaktohet rrjedha minimale ujore (ekologjike) për çdo lumë, gjë që mbështet arritjen e objektivave specifike për një zone lidhur me biodiversitetin ujor. Masat për arritjen e këtyre objektivave duhet të përfshihen në Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Zhvillimi i një plani për menaxhimin e thatësirave duhet të jetë pjesë e planeve të Menaxhimit të Katastrofave në vend për parandalimin dhe lehtësimin e ndikimeve të thatësirës. Objektivi kryesor i planifikimit për menaxhimin e thatësirave është pakësimi i ndikimeve socio-ekonomike dhe bujqësore. Përcaktimi i masave jostrukturore duhet të jetë prioritet për periudhën 2021-2022. Përcaktimi i masave që kanë të bëjnë me strukturat (sistemet inxhinierike dhe ndërtimore) kërkon përpjekje për analizimin e situatës, planifikimin dhe financimin e tyre që duhet të zhvillohet gjatë periudhës 2022-2026.

### 3.3.4 Plane kontrolli dhe masa për përballjen me ndryshimet klimatike

Përsa i përket rrezikut nga uji, kryerja e një “kontrolli klimatik” për Programet e propozuara të Masave është shumë e rëndësishme. Qëllimi i përgjithshëm i kontrollit klimatik është të sigurojë se PM-të janë përshtatur mjaftueshëm ndaj kushteve klimatike të ardhshme (shih 3.2.4).

## 3.4 Objektivat e politikave lidhur me informacionin për ujin

**Informacioni për ujin: përgjithësisht të dhëna dhe modele të pranuar të vlefshme për ujin dhe klimën janë siguruar për të gjitha palët e interesit, dhe qeverisë i ofrohet politikë e duhur e bazuar në këto të dhëna dhe modele të siguruar nga institucionet që i disponojnë ato.**

Ashtu si MIBU dhe parimet e politikës Mjedisore të BE-së kërkojnë prodhimin e të dhënave dhe informacioneve të vazhdueshme, të krahasueshme, të përditësuara dhe të shkëmbyera mes palëve në lidhje me politikën mbi ujin dhe me të dhënat/ informacionin mbi të, ato duhet që të drejtojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë politikën dhe menaxhimin e ujërave. Kjo kërkon mbledhjen e të dhënave efektive ndërmjet prodhuesve të të dhënave dhe koordinimin e shkëmbimit të të dhënave ndërmjet agjencive që mbledhin dhe përdorin të dhënat.

### 3.4.1 Përcaktimi i rrjetit të monitorimit të ujit

Një nga strategjitë e zakonshme për zbatimin e Direktivën Kuadër të Ujërave është zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi të përshtatshëm monitorimi i cili mbledh dhe analizon të dhënat në mënyrë të tillë që të sigurojë kryerjen e planifikimit dhe menaxhimit të sistemeve ujore në mënyrë efikase dhe duke kërkuar kështu një inventar gjithëpërfshirës të burimeve ujore.

Për periudhën 2018-2019, duhet të zhvillohet një sistem monitorimi kombëtar për ujërat nëntokësore, që është në përputhje me DKU-në, për të:

- Dhënë një vlerësim të besueshëm të gjendjes sasiorë të trupave të ujërave nëntokësore ose grupeve të trupave;
- Vlerësuar drejtimin dhe shkallën e rrjedhës në trupat e ujërave nëntokësore që kapërcejnë kufijtë e shtetit;
- Plotësuar dhe bërjen e vlefshme të procedurës për vlerësimin e rrezikut;
- Për t'u përdorur në vlerësimin e tendencave afatgjata si rezultat i ndryshimeve natyrore dhe aktiviteteve ndotëse që e kanë origjinën nga njeriu;
- Vlerësuar gjendjen kimike të trupave të ujërave nëntokësore ose grupeve të trupave të përcaktuar si në rrezik;
- Monitoruar gjendjen kimike të trupave të ujërave nëntokësore ose grupeve të trupave;
- Regjistruar tendencat në rritje të konsiderueshme në përqendrimin e ndotësve; dhe,
- Vlerësuar efektet që nevojiten për riparimin e këtyre tendencave në përqendrimin e ndotësve në ujërat nëntokësore.

Për periudhën 2018-2020, duhet të zhvillohet një sistem monitorimi kombëtar për ujërat sipërfaqësore, që është në përputhje me DKU-në, për të:

- Klasifikuar gjendjen trupave të ujërave;
- Plotësuar dhe bërjen e vlefshme të Aneksit II të DKU-së, mbi procedurën e vlerësimit të rrezikut;
- Hartuar me efektshmëri dhe efikasitet programet e ardhshme monitoruese;
- Vlerësuar ndryshimet afatgjata në kushtet natyrore;
- Vlerësuar ndryshimet afatgjata që vijnë nga aktivitetet ndotëse të shumë përhapura nga njeriu;

- Vlerësuar ngarkesën ndotëse që transferohet përmes kufijve ndërkombëtarë ose shkarkohet në det;
- Vlerësuar ndryshimet në gjendjen e atyre trupave ujorë që janë identifikuar si trupa ujorë në rrezik në përgjigje të aplikimit të masave për përmirësimin ose parandalimin e prishjes;
- Konstatuar shkaqet e trupave ujorë që nuk mund të arrijnë objektivat mjedisore, aty ku arsyeja për dështim nuk është identifikuar;
- Konstatuar madhësinë dhe ndikimin e ndotjes aksidentale;
- Përdorur përpjekjet e përbashkëta me shtetet e tjera;
- Vlerësuar rrjetin kombëtar hidrologjik sipas kërkesave DP;
- Vlerësuar pajtueshmërinë me standardet dhe objektivat e zonave të Mbrojtura; dhe,
- Vendosur në sasi kushtet referencë (aty ku ato ekzistojnë) për trupat e ujërave sipërfaqësore. (kërkesë e Aneksit II).

Në lidhje me ndryshimet klimatike nevojitet informacion shtesë. Sistemi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore do të bëjë:

- Identifikimin e pikave të nxehta të biodiversitetit në ujërat e ëmbla dhe rezervat; përmirësimin e kapacitetit për të modeluar marrëdhëniet hidro-ekologjike dhe agroekologjike; dhe zhvillimin e një mirëkuptimi të plotë të ndërveprimeve ndërmjet ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore, sjelljen afatgjatë të ekosistemit dhe lidhjet ujë-tokë (Davis dhe të tjerë, 2015);
- Sjellë informacion për modelet stinore të reshjeve për të garantuar hapësirë, për të manovruar me rregullat operative të sistemeve të furnizimit me ujë, për të gjetur një vlerë optimale globale midis përdorimit të ujit.

Para bërjes së investimeve të mëdha në sistemet e mbledhjes së informacionit, sistemet e monitorimit, strukturat analitike laboratorike e kështu me radhë, do të ishte më e logjikshme që stafi të prezantohej me disa nga metodat e përdorura për të hartuar programet e kampionimit dhe monitorimit për menaxhimin e baseneve ujore në Bashkimin Evropian. Kjo duhet të ketë si qëllim rritjen e vetëbesimit në vendimmarrje, përmbajtjes së të dhënave, niveleve të informacionit të nevojshëm për të bazuar vendimmarrjen, si edhe shpërndarjen në mënyrën më të mirë të mundshme të burimeve për të trajtuar sa më shumë që të jetë e mundur të gjitha nevojat e mbështetura në vendime. Nga ana tjetër, kjo do të mundësojë një vlerësim më të madh për të menduarit përtej kuadrove ligjorë, siç është Direktiva Kuadër e Ujit dhe Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane;

### 3.4.2 Nxitja e kërkimeve shkencore

Lehtësimi i një sistemi kërkimor (monitorimi dhe vlerësimi i burimit, procedurat e formulimit dhe zbatimit) dhe ndërtimi i kapaciteteve që kërkohen për të zhvilluar bazën e dijeve. Aktivitetet kryesore që priten të ndërmerren janë:

- Kryerja e vlerësimeve për zhvillimin e kapaciteteve në lidhje me MIBU-në (duke përfshirë përfaqësimin gjinor), në të gjithë sektorët përkatës, deri në fund të vitit 2017;
- Sigurimi i shërbimeve me Asistencë Teknike për institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, për periudhën 2017-2019;
- Sigurimi i shërbimeve për rritjen e kapaciteteve për studiuesit, ekspertët teknikë dhe teknicienët që kanë përgjegjësi që lidhen me MIBU-në, për periudhën 2018-2021;
- Sigurimi i shërbimeve me asistencë teknike për Universitetet e përzgjedhura për rishikimin e kurrikulës dhe krijimin e programeve zhvillimore për studiuesit, ekspertët teknikë dhe teknicienët që kanë përgjegjësi që lidhen me MIBU-n, për periudhën 2018-2021;
- Krijimi i partneriteteve ndërmjet universiteteve dhe instituteve për trajnimin MIBU, analizat e politikave, për periudhën 2018-2021.

### 3.4.3 Përmirësimi i aksesit në informacion dhe i prodhimit të të dhënave

Kërkesat për prodhueshmëri të qëndrueshme dhe me kosto-efektive, si dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve që lidhen me ujin me cilësi të lartë, siç janë gjendja e burimeve ujore, financimi i ujit, nevojat mjedisore, të dhënat social-ekonomike dhe zonimi institucional, do të mbulohen nga aplikimi i Kadastrës së Ujit, e cila duhet të përfundojë në vitin 2017. Ky program mundëson zhvillimin e ndërfaqeve të përdoruesve që mund të shkëmbejnë nivele të ndryshme informacioni, në varësi të nevojave të grupeve të interesit.

Laboratorët e akredituar për testimin e cilësisë së ujit janë një komponent i rëndësishëm i prodhimit të të dhënave të cilat do të duhet të shtohen dhe konsolidohen. Shkalla sipas së cilës kjo mund decentralizohet kërkon gjykim të kujdesshëm të logjistikës dhe kostove në lidhje me nevojat; por në çdo rast një laborator kombëtar reference është një kërkesë e pashmangshme. Hapi i parë do të ishte vlerësimi i laboratorëve ekzistues deri në fund të vitit 2018 sipas ISO/IEC 17025:2005 “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e testimit dhe kalibrimin e laboratorëve”, i pasuar nga një plan furnizimi dhe akreditimi për periudhën 2018-2020.

### 3.4.4 Krijimi i një kuadri institucional të përshtatshëm për ujin dhe klimën

Të dhënat edhe analiza e mangësive të informacionit na çojnë në përfundimin se funksionet e menaxhimit të burimeve ujore që aktualisht janë të shpërndara ndërmjet institucioneve të ndryshme duhet të centralizohen dhe të vendosen nën ombrellën e një institucioni të vetëm kombëtar - një autoritet kombëtar ose agjenci e burimeve ujore - me degë në pellgun e lumenjve perkatës (që korrespondon me agjencitë aktuale të pellgjeve të lumenjve) dhe vepron në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të pasurise ujore KJU duhet të mbetet Institucioni përgjegjës për miratimin e Planeve për MIBU. miratimin e projekteve të politikave, strategjive dhe legjislacionit të burimeve ujore, miratimin e planeve, projekteve dhe programeve me rëndësi kombëtare dhe miratimin e koncesioneve. Në thelb KJU duhet të veprojë si Këshilli i Ministrave për problematikat e pasurive ujore.

Institucionet e ndryshme që veprojnë tani në vartësi të Ministrave të ndryshme dhe që kanë të bëjnë me përdorimin dhe menaxhimin e burimeve ujore duhet të jenë pjesë e AKPU sipas shtyllave kryesore të përdorimit të ujit (furnizim me ujë të pijshëm, bujqësi dhe industria), duke bashkuar në një institucion të vetëm institucionet si për shembull IGJEUM, departamenti i ujërave nëntokësore të AGS, departamenti i SHPP në NANR, Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë Sanitar dhe Departamentin e Ujitjes, pjesë e Institutit për Rinovimin e Teknologjisë dhe Administrimit të Tokës. Në veçanti, AKPU duhet të jetë përgjegjëse për:

- formulimin e politikave, strategjive, programeve dhe projekteve të burimeve ujore që kanë të bëjnë me sektorin e ujit në tërësi (që do të miratohet nga KJU) dhe koordinimin e zbatimit të tyre;
- formulimi i legjislacionit të ujit (aktet nënligjore), sipas nevojës, gjithashtu duhet të miratohet nga KJU;
- ngritjen dhe përditësimin periodik të një inventari të burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit, duke përfshirë aspektet sasore dhe cilësore. Ky inventar duhet të mbahet në lidhje me pellgjet e lumenjve;
- klasifikimi i trupave ujorë brenda pellgjeve të lumenjve, sipas përdorimit dhe cilësisë së ujit;
- zhvillimi i planeve të menaxhimit të burimeve ujore (pellgut lumor) që synojnë objektiva specifike (mjedisore dhe të tjera), të miratuara nga KJU;
- përcaktimi i kërkesave minimale të rrjedhjes për trupat ujorë;
- dhënien e lejeve dhe autorizimeve të shkarkimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura;
- shqyrtimi i koncesioneve të ujit, për miratim nga Këshilli i Ministrave pas miratimit nga KJU;
- mirëmbajtjen e një regjistri të lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve, nga pellgu i lumit;
- koordinimi i zbatimit të programeve të monitorimit të resurseve ujore, me institucionet monitoruese që i dorëzojnë ose i bëjnë të arritshme - të dhënat dhe informatat e mbledhura në formatin e dakorduar;



- miratimi i planeve / studimeve / projekteve të ndryshme, etj., lidhur me menaxhimin e burimeve ujore në nivelin kombëtar ose në pellgun e lumit.
- koordinimi i projekteve, studimeve dhe kërkimeve në lidhje me burimet ujore;
- promovimi i pjesëmarrjes së përdoruesve të ujit në planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore;
- zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për burimet ndërkufitare të ujit në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
- zbatimi i legjislacionit të ujit;
- duke vepruar si sekretariat në KKU.

Disa nga këto funksione duhet të kryhen në konsultim me institucionet e tjera. Për shembull, lejet e shkarkimit të ujërave të ndotura duhet të lëshohen në konsultim me Ministria e Mjedisit, e cila është përgjegjëse për përcaktimin e vlerave kufi të shkarkimeve. Në të njëjtën mënyrë, një leje për përdorimin e ujit për qëllime të ujitjes duhet të lëshohet në konsultim me MBZRAU; Një leje që përfshin përdorimin e ujërave nëntokësore duhet gjithashtu të shqyrtohet nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe kur përdorimi i ujit mund të sjellë rrezik për shëndetin, Ministria e Shëndetësisë duhet të përfshihet në shqyrtimin e aplikacionit përkatës. Përsëri, Ministria e Mjedisit duhet të ketë një mendim për projektet e ujit që kërkojnë VNM paraprake në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.

Autoriteti ose Agjencia kombëtare e burimeve ujore duhet të krijohet nga një kombinim i Sekretariatit Teknik të KKU dhe Departamentit të Politikave të Ujit të MBZRAU. Ai duhet të përbëhet nga departamente të specializuara, sipas funksioneve, duke përfshirë:

- një departament që merret me politikën, strategjitë dhe programet e burimeve ujore, koordinon studimet dhe kërkimet, koordinon projektet e burimeve ujore dhe bashkëpunon me institucionet financiare;
- një departament që merret me sistemet e monitorimit dhe sistemet e informacionit të burimeve ujore (lidhur me ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, cilësinë e ujit, efektet e ndryshimeve klimatike);
- një departament që merret me lejet, autorizimet dhe koncesionet dhe mbajtjen e regjistrave (ose regjistrave) të lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve;
- një departament planifikimi të resurseve ujore, i cili do të punonte me zyrat e degës (baseni) dhe do të sigurojë mbështetje;
- një departament ligjor, që merret me të gjitha çështjet ligjore, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me lejet, autorizimet dhe koncesionet;
- një departament i financave dhe administratës.

Këto departamente duhet të kompletuara me personel të marrë nga institucionet ekzistuese, duke përfshirë, por pa u kufizuar si: MBZRAU, Shërbimet Gjeologjike Shqiptare dhe Instituti i Gjeologjisë, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit. Inspektorati i Ujërave, i cili është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të ujit, duhet t'i bashkëngjitet autoritetit ose agjencisë kombëtare të pasurive ujore.

Departamenti i baseneve ujore në autoritetin kombëtar të burimeve ujore ose agjencinë, do të kryej funksionet e agjencive aktuale të pellgjeve ujore, duke qenë përgjegjës për problematikat ujore në nivelin e pellgut. Meqenëse kapaciteti aktual institucional dhe profesional në këtë nivel është i kufizuar, dhe duke pasur parasysh madhësinë e vogël të territorit të Shqipërisë, përbërja e grupit në nivel baseni mund të kufizohet duke u përqëndruar në anën administrative dhe komunikimin në nivel lokal. Këto funksione duhet të kufizohen, të paktën fillimisht, si më poshtë:

- marrjen e aplikimeve për përdorim të ujit dhe lejeve dhe autorizimeve për shkarkimin e ujërave të ndotura, vendimin për lëshimin ose jo të lejeve dhe autorizimeve që bëhen në nivel kombëtar (nga autoriteti ose agjencia);
- identifikimin, pas konsultimit me këshillat e baseneve të lumenjve, çështjet që duhet adresuar përmes planeve të menaxhimit të basenit lumor dhe propozimin e objektivave të planit;


- identifikimin, pas konsultimit me këshillat e baseneve të lumenjve, masat që duhet të ndërmerren për zbatimin e planeve dhe arritjen e objektivave të planit;
- organizimi i mbledhjeve të këshillave të baseneve lumore dhe konsultimi i palëve të interesuara në nivelin e pellgut për çështjet që kanë të bëjnë me projekt-planet, duke përfshirë identifikimin e çështjeve, vetë projekt planet dhe çështjet që lidhen me zbatimin e planit;
- propozimin e studimeve dhe kërkimeve që synojnë përmirësimin e gjendjes së trupave ujorë brenda pellgjeve;
- identifikimin e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve.

Në thelb, duke pasur parasysh afërsinë e tyre me palët e interesuara brenda pellgjeve, zyrat e pellgjeve do të ishin përgjegjëse për mbledhjen e informacionit mbi atë që ndodh në basenet, që nevojitet për të zhvilluar planet e menaxhimit të pellgjeve lumore dhe për të lëshuar leje dhe autorizime. Zhvillimi i planit dhe administrimi i lejeve dhe autorizimeve, do të trajtohen nga autoriteti ose agjencia kombëtare, e cila ka kapacitetin e kërkuar. Paralelisht me këtë,, zyrat e baseneve do të shërbenin si sekretariat për Këshillat e baseneve ujore. Fuqia duhet t'i jepet autoritetit ose agjencisë kombëtare të burimeve ujore, përmes legjislacionit të ujit.

Duke pasur parasysh madhësinë e vogël të territorit të Shqipërisë, mund të jepet një mendim për të marrë përgjegjësitë që lidhen me dy ose më shumë basene lumore në një zyrë baseni, që do të thotë bashkimin e dy ose më shumë agjencive ekzistuese të pellgjeve lumore në një, nëse kjo do të ishte e mundur duke reduktuar për shëmbull, në tre ose katër zyra basenesh në vend të gjashtë. Zyrat e baseneve mund të kenë selinë e tyre në varësi të kushteve dhe rrethanave, por ato mund të organizohen si pjesë e zyrave pranë Prefekturës përkatëse. Zgjidhja e fundit gjithashtu do të siguronte pavarësinë në lidhje me institucionet e ndryshme që përdorin ujin dhe nuk do të shkaktonte kosto të larta.

Këshillat e baseneve të lumenjve nuk duhet të konceptohen si organe vendimmarrëse, por si një forum për konsultime, në nivelin e basenit, për çështjet e trajtuara nga zyrat e baseneve dhe për miratimin e propozimeve përkatëse, veçanërisht në lidhje me Zhvillimin e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore dhe me masat e nevojshme për zbatimin e planit. Prandaj, Këshillat nuk duhet të raportojnë në KKU.

Kuadri i sugjeruar institucional është paraqitur në Figurën më poshtë.

**Figura 13: Kuadri i propozuar institucional për menaxhimin e burimeve ujore**

Sa i përket pozicionimit të autoritetit ose agjencisë kombëtare të burimeve ujore, janë të mundshme tre opsione:

- një autoritet ose agjenci kombëtare e bashkangjitur në MBZRAU. Megjithatë, pasi MBZRAU është kryesisht përgjegjës për ujitje dhe kullim dhe për këtë arsye është një zhvillues dhe përdorues i burimeve ujore, ai mund të neglizhojë sektorë të tjerë të përdorimit të ujit dhe prandaj nuk mund të jetë i paanshëm kur përdoret uji për qëllime të tjera. Përveç kësaj, mbrojtja e cilësisë së ujit nuk është përgjegjësia e saj.
- një autoritet ose agjenci kombëtare e lidhur me Ministrinë e Mjedisit, si në të kaluarën e afërt. Kjo Ministri nuk është një 'përdorues' i burimeve ujore, prandaj mund të veprojë në mënyrë të paanshme. Megjithatë, fokusi i tij është i kufizuar në cilësinë e ujit dhe çështjet mjedisore që lidhen me burimet ujore.
- një autoritet ose agjenci kombëtare prane zyrës së Kryeministrit. Në këtë rast, autoriteti ose agjencia nuk do të ndikoheshin nga institucionet përgjegjëse për sektorët e ndryshëm të përdorimit të ujit dhe do të ishin plotësisht të pavarur. Prandaj kjo është ndoshta alternativa më e mirë.

Pyetja për pozicionimin ideale të autoritetit / agjencisë nuk mund të ketë përgjigje këtu, pasi kjo është një çështje për vendimarrjen politike. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e ndërthurur të pasurive ujore, menaxhimi i tyre duhet ti jepet një institucion që është sa më i pavarur që të jet e mundur.

Ngritja e një autoriteti apo agjencie kombëtare të burimeve ujore siç përshkruhet më sipër do të kërkonte ndryshimin e Ligjit të MBIU.

### 3.5 Objektivat e politikës lidhur me menaxhimin e ujit

**Menaxhimi i ujit: uji menaxhohet në një mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse, që i shërben të gjitha interesave, ofron përfitime socio-ekonomike të barabarta që lidhen me ujin dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të MIBU-së dhe BE-së për politikën e ujërave.**

#### 3.5.1 Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësisë në MIBU

Duke e ditur se vendi ka nevojë për një organizim institucional që mund të funksionojë në mënyrë efektive me burimet që vendi realisht mund të sigurojë, ka gjasa që të nevojitet një reformë institucionale në një

shkallë të caktuar. Do të ishte e parakohshme të hamendësojmë se cilat do të jenë rezultatet e kësaj reforme. Megjithatë, ka një sërë parimesh të qarta të cilat ajo mund të bazohet.

Pa paragjykuar asnjë prej reformave institucionale që mund të konsiderohen si të përshtatshme për të ardhmen e burimeve ujore të integruara, zbatimi i një ose më shumë planeve të zhvillimit institucional për institucionin ose institucionet që janë përfshirë në të do të ishte thelbësor. Institucionet financiare ndërkombëtare mund ta lehtësojnë këtë proces duke pasur parasysh elementet e mëposhtme:

- Në parim do të ishte e mundur marrja parasysh e forcimit të kapaciteteve në terren [*in situ*] (p.sh. pa ndonjë ristrukturim të konsiderueshëm institucional). Për këtë është e nevojshme për t'u përqendruar te kualifikimi i stafit për proceset e përmendura më sipër, zhvillimin e planifikimit strategjik dhe kapacitetet për menaxhimin operacional, në vend të investimit në sisteme (Investimi në sisteme do të ishte me kosto më efikase nëse bëhet gjatë ose pas riorganizimit/trajnitimit, dhe jo para tij);
- Çdo zhvillim i konsiderueshëm institucional në lidhje me MIBU, që përfshin ose jo riorganizimin institucional, duhet të përfshijë hapat e mëposhtëm, për të cilat Qeveria mund të marrë parasysh që të diskutojë me donatorët mundësinë e ofrimit të asistencës teknike:
  - Vlerësimi i sfondit të përgjithshëm të roleve dhe funksioneve institucionale që kërkohen për planifikimin efikas, menaxhimin, rregullimin dhe administrimin e baseneve ujore dhe burimeve ujore;
  - Qartësimi i qëllimit për përmbushjen e sa më shumë nevojave që të jetë e mundur duke zhvilluar ose riorganizuar institucionet ekzistuese;
  - Paraqitja e këtij informacioni për Qeverinë e cila do të vendosë më pas se cilën rrugë zhvillimi do të jetë më e preferueshme për tu ndjekur;
  - Bazuar në opsionin që Qeveria preferon, hartohet një plan zhvillimi institucional i detajuar për institucionin ose institucionet e përfshira, duke përdorur kërkesat e ngarkesës së punës dhe parametrat e tjerë operacionale, që lidhen me mandatet institucionale, si bazë për të punuar drejt funksionimit të plotë dhe kuadrit institucional me burime të përshtatshme, i cili mundëson menaxhimin e burimeve ujore në përputhje me praktikën e mirë të Bashkimit Evropian. Kjo synon, mbi të gjitha, të jetë realiste: në mënyrë që të mos ndodhë që të planifikohet diçka dhe në fund realizimi i saj të dështojë.

Për sa i përket mundësisë së riorganizimit të përmendur më sipër, është e rëndësishme që çdo zhvillim ligjor të lejojë në të njëjtën kohë fleksibilitetin e nevojshëm në mandatet dhe strukturat institucionale. Kjo aplikohet veçanërisht në të gjitha ligjet që hartohen në lidhje me transpozimin e Direktivës 2000/60/EC. Përcaktimi i Kuadrit Komunitar për Veprim në Fushën e Politikës së Ujërave, i ndryshuar me Direktivën 2008/105/EC. Nevoja për studime në lidhje me zhvillimin institucional e përshkruar më sipër duhet t'i japë përparësi hartimit të ligjeve, në veçanti atyre që lidhen me diçka kaq komplekse siç është Direktiva Kuadër e Ujit.

### 3.5.2 Zbatim i plotë i parimeve të BE-së për ujin dhe mjedisin

Afatet kohore për zbatimin e pjesëve të ndryshme të Akisë mjedisore të Bashkimit Evropian do të jetë një çështje për diskutim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Për pasojë, do të ishte e parakohshme që në këtë pikë të gjykojmë se cilat do të jenë ato, veçanërisht në pikëpamjen e ndërlikimeve buxhetore të konsiderueshme të sektorit publik. Negociatat duhet të përqendrohen në njohjen e kufizimeve që dalin nga studimet e reformës institucionale të përshkruar më sipër, dhe jo të angazhojnë Shqipërinë në afate kohore kalimtare që nuk do të respektohen nga kjo e fundit. Kjo nënkupton që Shqipëria nuk duhet të mbyllë negociatat për kapitullin e mjedisit në marrëveshjen e saj të pranimit në BE, deri sa të përfundohen këto studime dhe përfundimet e tyre të përvetësohen si duhet në negociata.

Si pjesë e rëndësishme e këtyre gjykimeve, parimet e politikave mjedisore, të cilat përfshijnë parimet e parandalimit, plotësueshmërisë, proporcionalitetit dhe solidaritetit duhet të miratohen në legjisllacionin Kombëtar. Kjo do të fillojë në periudhën 2017-2021 me një asistencë financiare nga IPA 2: Mjedi dhe Veprimi për Klimën, e cila merret me harmonizimin e legjisllacionit kombëtar me ligjet dhe standardet e BE-së, ndjekur nga hartimi i vlerësimeve specifike mjedisore për sektorin e ujit dhe raporte për zgjerimin. Duhet

theksuar se harmonizimi ligjor është i arsyeshëm vetëm nëse vendi ka burime për të zbatuar me efikasitet legjislacionin përkatës. Duke pasur parasysh diçka të tillë, fazat e mëposhtme të harmonizimit të legjislacionit duhet të jenë të përshtatshme, pa vendosur në këtë fazë afate që mund të ndikojnë rezultatin e negociatave me BE-në:

- Krijimi i një Dispozite e cila integron Aneksin X të Direktivës 2000/60/EC Përcaktimi i Kuadrit të Komunitetit për Veprim në Fushën Politikave të Ujit, amenduar nga Direktiva 2008/105 / EC. Një projekt vendim i ngjashëm është përgatitur paraprakisht nga qeveria, por hyrja në fuqi e Ligjit 111/2012, datë 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” e bëjnë të pavlefshëm kështu që brenda një kohe të përshtatshme duhet të përgatitet një tjetër VKM e përditësuar;
- Direktiva 91/271 / EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane amenduar nga Direktiva 98/15/C, Rregulli EC / 1882/2003 dhe Rregulli EC / 1137/2008 kërkon integrimin e saj në legjislacionin kombëtar sepse Ligji Nr. 111 / 2012, datë 15.11.2012 mbi “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” nuk ofron një rregullim në lidhje me standardet e cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore. Ky boshllëk duhet të mbushet me akte nënligjore që integrojnë Direktivën 91/271 EEC. Përkthimit në shqip të përkufizimit të një aglomerati i duhet kushtuar vëmendje e veçantë për të siguruar se vendi ka fleksibilitetin për quajtur si aglomerate vetëm zonat që mund të prodhojnë të ardhura të mjaftueshme nga tarifat për të mbajtur funksionale infrastrukturën e kërkuar;
- Direktiva 2000/60/EC mbi krijimin e Kuadrit për Aktivitetet e Komunitetit në Fushën e Politikave Ujore, amenduar nga Direktiva 2008/32 / EC dhe Direktiva 2009/31 / EC; Direktiva 2009/90 / EC mbi specifikimet teknike për analizat teknike dhe monitorimin e gjendjes së ujit, nuk është integruar deri më sot në ligjin kombëtar. Këto kërkesa kanë kosto të konsiderueshme, si edhe ndërlikime për burime njerëzore, që do të kufizojnë shkallën e transpozimit në ligjin kombëtar. Megjithatë, në një kohë të caktuar vendi do të ketë nevojë për akte nënligjore që përcaktojnë përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive që lidhen me ujin;
- Direktiva 2006/118 / EC “Mbi Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore kundër Ndotjes dhe Prishjes” dhe Direktiva 2007/60 / EC “Mbi Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmbajtjet” kërkon hartimin e akteve ligjore të nevojshme në lidhje me Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Plane të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbajtjet. Në këtë rast, edhe puna mund të duhet të ndahet në faza me qëllim respektimin e kufizimeve në burime;
- Një nga tiparet kryesore të Direktivës Kuadër për Ujërat është përcaktimi i kufijve territorialë dhe hidrogeografikë. Aktualisht ndarja bazohet mbi kufijtë administrativë në vend që të bazohet mbi kufijtë hidrogeografikë. Ky kriter përcaktohet nga neni 8, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”. Ky kriter i veçantë me shumë gjasa mund të shndërrohet në një hap, sepse ndërlikimet për burimet janë pak a shumë njësoj, pavarësisht se si dikush i përcakton kufijtë;
- Neni 8, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 shpjegon se është e rëndësishme që të krijohet një Komision i Veçantë për menaxhimin e ujërave ndërkufitare të ëmbla dhe detare. Deri më sot, administrimi dhe menaxhimi i ujërave detare ndër-kufitare nuk është përmbushur. Ky komitet do të ketë detyrën e trajtimit të çështjeve vetëm në kontekstin e menaxhimit të burimeve ujore.

Përveç nevojës për akte normative për pajtueshmërinë e Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 me Direktivat Evropiane duhet të hartohen akte ligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 111/2012. Më poshtë janë kapitujt e Ligjit 111/2012 datë 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” për të cilat kërkohen akte ligjore:

- Neni 25, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012, kërkon rregullim me anë të një akti normativ për krijimin e kriterëve për objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe zonat e mbrojtura janë krijuar për të parandaluar dëmtimin dhe mbrojtur trupat ujorë dhe për të ndihmuar në rehabilitimin e tyre;
- Neni 26, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012 kërkon hartimin e një akti nënligjor me qëllim për të klasifikuar ujërat sipas gjendjes së tyre ekologjike dhe kimike, sasiore dhe kimike;
- Neni 34, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012 i referohet zonave për mbrojtjen e ujit por ka nevojë për më shumë trajtim duke reflektuar dispozitat e tij në një akt nënligjor;

- Neni 36, paragrafi 2 i ligjit Nr. 111/2012, kërkon krijimin e një akti normativ duke dhënë specifikime teknike për çdo basen për të vlerësuar ndikimit e aktivitetit njerëzor, gjendjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe zonave të mbrojtura;
- Krijimi i një udhëzimi ose një VKM-je që lidhet me dispozitat e Nenit 41, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012 në mënyrë që aktivitetet e përcaktuara në Nenin 41 të ushtrohen mbi bazën e lejes administrative të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- Në vijim të Nenit 50, paragrafi 6, dhe neni 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 111/2012, duhet të përgatitet një akt normativ, që parashtron kushtet për licencimin e përgjithshëm dhe specifik, autorizimet, liçencat dhe konçesionet për përdorimin e burimeve ujore;
- Neni 60 i Ligjit Nr. 111/2012, i referohet miratimit të zonave të veçanta nga ana konservuese. Prandaj për këtë qëllim rekomandohet që të përgatitet një akt nënligjor;
- Rekomandohet krijimi i një akti nënligjor për të miratuar kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve (Neni 76 i Ligjit Nr. 111/2012);
- Rregullat për projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura sipas dispozitave të Nenit 82 të Ligjit Nr. 111/2012;
- Neni 86, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 111/2012, parashikon kushtet për zbatimin e saktë të ligjit. Në terma konkretë, është shumë e nevojshme që të zhvillohet një akt normativ i cili të ketë si synim programin e monitorimit sistematik të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe zonat e mbrojtura;
- Në përputhje me Nenin 88 pika 3 duhet të zhvillohet kuadri i përshtatshëm ligjor për zhvillimin dhe menaxhimin e kadastrës së ujit.

Mendohet se disa rregulla/VKM duhet të hartohen (disa prej tyre janë krijuar, por nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave) dhe miratohen brenda një periudhe maksimale dy vjeçare. Është e rëndësishme për institucionet e ndikuara nga këto akte të ardhshme, që të hartojnë një plan drejtimi brenda kësaj periudhe, për të marrë miratimin për gjithë paketën me akte ligjore në vijim të Ligjit Nr. 111/2012. Ky plan veprimi duhet të përfshijë ekspertizën e ekspertëve vendorë/ndërkombëtarë, si dhe një analizë financiare të ndikimit që këto akte do të kenë në buxhetin e shtetit. Rekomandimet janë si më poshtë:

#### Faza 1

- Kornizë ligjore për zhvillimin dhe menaxhimin e kadastrës ligjore;
- VKM “Mbi përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore, dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet”;
- Akte nënligjore “për të miratuar kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve”;
- Kuadër ligjor për hartimin, ndërtimin dhe funksionimin e impianteve të sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Një akt nënligjor që ka si qëllim miratimin e rregullores mbi programin e monitorimit sistematik të kushteve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe zonat e mbrojtura.

#### Faza 2

- Miratimi i një akti nënligjor për klasifikimin e ujërave sipas gjendjes së tyre ekologjike, kimike, si dhe asaj sasore;
- Miratimi i aktit ligjor për zonat e mbrojtura ujore.

#### Faza 3

- Miratimi i një akti normativ mbi specifikimet teknike për të vlerësuar ndikimin e aktivitetit njerëzor, gjendjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe zonave të mbrojtura;
- Miratimi i kuadrit ligjor në mënyrë që aktivitetet e përcaktuara në Neni 41 të kryhen mbi bazën e lejes administrative të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Gjatë miratimit të rregullave të mësipërme do të organizohen seminare për harmonizimin e politikave dhe legjislacionit për politikë-bërësit dhe shërbyesit publikë duke rritur kështu bashkëpunimin ndërministror.

### 3.5.3 Arritja e zhvillimit të kapaciteteve

Autoritetet përgjegjëse duhet të përballen me kompleksitetin e sfidave të ujit që duhet të përmbushen dhe me kompetencat që kërkohen për të kryer këto detyra. Këto përfshijnë: planifikimin, krijimin e rregullave, menaxhimin e projektit, financimin, buxhetimin, mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin, menaxhimin e rrezikut dhe vlerësimin. Për më tepër autoritetet duhet të përputhin nivelin e kapaciteteve teknike, financiare dhe institucionale në sistemet e administrimit të ujit me natyrën e problemeve dhe nevojave të identifikuara. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve do të kërkohet gjithashtu për të përballuar sfidat për të qenë në pajtim me legjislacionin mjedisor të BE-së. Për të arritur këtë, pritet që një gamë e madhe programesh dhe materialesh trajnimi do të zhvillohen nga MBZHRAU, me mbështetjen e konsulentëve, nëse është e nevojshme, duke u bazuar mbi Propozimin për Zhvillimin e Kapaciteteve të krijuar në Projektin Burimet Ujore dhe Ujitja. Ofrimi i kurseve të trajnimit mund të shihet si një proces shumë vjeçar, i paraprirë nga një vlerësim vjetor i nevojave për trajnim.

### 3.5.4 Nxitja e bashkërendimit dhe planifikimit ndërsektorial

Duhet të përmirësohet koherenca e politikave përmes një koordinimi efikas të gjithë aktorëve, atyre të brendshëm dhe të jashtëm, veçanërisht ndërmjet politikave për ujin dhe mjedisin, shëndetësinë, energjinë, bujqësinë, industrinë, planifikimin hapësinor dhe përdorimin e tokës. Nevojitet koordinimi ndërsektorial për mekanizmat e koordinimit të menaxhimit të burimeve ujore për të lehtësuar politika koherente ndërmjet ministrive, agjencive publike dhe niveleve të qeverisjes. Kjo do të përfshinte gjithashtu zhvillimin e planeve ndërsektoriale duke krijuar Grupin për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 129 (datë 21.09.2015) dhe krijimin e Grupeve Tematike në lidhje me “Ujin për Njerëzit”, “Ujë për Ushqimin”, “Ujë për Industrinë dhe Energjinë” dhe “Ujë për Mjedisin” që tashmë janë efektive.

Vetë procesi i përgatitjes së Planit Kombëtar të Menaxhimit të Ujit duhet të marrë parasysh opsionet dhe skenarët e zhvillimit brenda vetë sektorit të ujit, si dhe marrëdhëniet midis sektorëve që mund të kenë një ndikim mbi burimet ujore, si Industria për shembull. Në mënyrë të ngjashme, pasojat e vendimeve të menaxhimit të ujit në sektorë të tjerë duhet të jenë një pjesë integrale e analizave të bëra gjatë procesit të planifikimit. Për pajtueshmërinë me BE-në është thelbësore që procesi i planifikimit, siç edhe parashtrohet te PMBL-të, të përfshijë analiza të rrezikut, si për shembull ndryshimet klimatike, ndotjen e ujërave nëntokësore, përmbytjet dhe thatësitat, si dhe rreziqet ekonomike, politike dhe të tjera si dhe trajtimin e masave të nevojshme dhe të përshtatshme për të reduktuar ose menaxhuar rreziqet, duke u bazuar mbi një mirëkuptim të përbashkët për parimet e pranuar MIBU, dhe duke ndjekur takimet në tavolina të rrumbullakëta në nivelin e basenit ujor dhe atë qendror, që pritet të kryhen rregullisht.

Me qëllim krijimin e një sistemi MIBU efikas, përtëritës për klimën, studimet do të duhet të kryhen gjatë periudhës 2018-2019 për aftësinë përtëritëse të ndryshimeve klimatike, vulnerabilitetin dhe tendencat lidhur me menaxhimin operacional, veçanërisht ofrimin e shërbimit, funksionimin e infrastrukturës dhe monitorimin në nivel baseni ujor. Në të njëjtën linjë, për të mbështetur kuptueshmërinë e përbashkët të parimeve MIBU dhe disponueshmërinë e ujit për sektor, Ministritë, Institutet dhe Agjencitë e Baseneve Ujore do të duhet të konsiderojnë përfshirjen e informacionin për ndryshimet klimatike në proceset e planifikimit të sektorit deri në fund të vitit 2019. Si pasojë, mund të arrihet një nivel i lartë njohurish për planifikimin, hartimin e rregullave, menaxhimin e projektit, financimin, buxhetimin, mbledhjen e të dhënave, menaxhimin e rrezikut dhe vlerësimin në të gjashta Basenet Ujore që do të lejonte një qasje të integruar dhe ndërsektoriale për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

### 3.5.5 Zhvillimi i instrumenteve ekonomike dhe financiare për rikuperimin e kostove

Instrumentet ekonomike përdorin çmimet e mallrave dhe masa të tjera që bazohen në treg për të përmirësuar mënyrën se si uji menaxhohet dhe përdoret. Dispozita e rikuperimit të kostos në DKU i referohet fuqishëm parimit “ndotësi paguan”. Ajo nxitet nga dhënia e stimuljeve për përdoruesit e ujit për ta konsumuar ujin me efikasitet dhe në një mënyrë që është në përputhje me interesin publik. Parimi “ndotësi paguan” kërkon që kostot e ndotjes të paguhen nga ata që i shkaktojnë. Ky parim synon përcaktimin e mënyrës se si duhet të përcaktohen kostot e parandalimit dhe kontrollit të ndotjes. Përshtatja e kuadrit ligjor që vendos gjopa për ndotjen, pritet që do të ndiqet nga një periudhë e përputhshmërisë për ndotësit e mundshëm, dhe për pasojë duhet krijuar edhe një buxhet ekologjik nga Janari i vitit 2018 dhe në vazhdim.

Si pasojë, deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018, duhet të zhvillohen standardet dhe udhëzuesit për krijimin e vlerave bazë për përdorimin e ujit në sektorë të ndryshëm, të ndjekur nga përcaktimi i shpejtë i këtyre vlerave.

Instrumentet ekonomike për t'u zhvilluar midis Janar - Dhjetor 2018 përfshijnë:

- **Tarifat dhe çmimet** e paguara nga përdoruesit e ujit (familjet, industrinë, fermerët) për ofruesit e tyre të shërbimeve. Për të qenë efektive, tarifat duhet të jenë volumetrike – d.m.th. bazuar mbi sasinë e ujit të konsumuar. Tarifat aplikohen si për pagesat për trajtimin e ujit të ëmbël ashtu dhe për trajtimin e ujërave të ndotura;
- **Pagesat për nxjerrjen e ujit** të vendosura për nxjerrjen e ujit bruto nga lumenjtë, liqenet dhe akuiferët nga ofruesit e shërbimeve bashkiake, fermerët, kompanitë industriale dhe ato minerare;
- **Pagesat për ndotje** të cilat penalizojnë shkarkimin e ujit të ndotur në trupa ujorë publikë ose akuiferë;
- **Subvencione** për të ofruar nxitje pozitive për sjellje që konsiderohen se janë në interes të publikut, p.sh. për lidhje në sistemin e ujit publik, promovimin e higjienës së sigurt familjare, për kompanitë që instalojnë pajisje me përdorim eficient të ujit.

Integrimi i këtyre instrumenteve në kuadrin ligjor kombëtar deri në Dhjetor 2018, do të ketë efekte pozitive dhe negative për përdoruesit e ujit, duke shpërblyer përdoruesit që njohin vlerën e vërtetë të ujit, dhe duke penalizuar përdorimin e pakujdesshëm dhe jo social. Një seri gjithëpërfshirëse seminaresh për zhvillimin e kapaciteteve do të zhvillohet në kuadrin e Projektit IPA në vitet 2018-2019 për departamentet teknike, administrative, dhe financiare me përgjegjësi që lidhen me përdorimin e ujit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kontributi i kërkuar i përdorueseve të ndryshme të ujit u zbërthye në industri, mirëmbajtje dhe agrikulturë, sepse rikuperimi i kostos (AEM, 2013) se shërbimeve të ujit do të kërkojë që analizat ekonomike të bëhen sipas DKU-së Aneksi III. Kostot që do të rikuperohen nuk përbëhen vetëm nga kostot financiare të shërbimeve të ujit, por do të përfshijnë gjithashtu kostot e mjedisit dhe të atë të burimeve.

### 3.5.6 Rritja e integritetit dhe transparencës

Integriteti nuk mund të detyrohet: ai duhet të nxitet dhe të ndihmohet për t'u rritur. Transparenca është rezultat i kombinimit të integritetit me procedurat që e demonstrojnë atë përmes veprimeve. Integrimi i këtyre praktikave në aktivitetet dhe institucionet që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore promovon llogaridhënie dhe besim më të madh. Si pasojë, kjo çon në vendimmarrje më efikase në zbatimin e programeve të masave për të cilat është rënë dakord.

Menaxhimi i integruar efikas i burimeve ujore në nivel baseni ujor varet nga përmirësimi i performancës dhe llogaridhënies nëpërmjet vlerësimeve të rregullta duke përdorur tregues performace, si edhe rrjete raportimi



dhe njohurish. Çdo sistem i krijuar për këtë qëllim duhet të jetë realist për sa i përket nivelit të gjetjes së burimeve që mund të jenë të disponueshme për zbatimin e tyre. Standardet për performancën dhe procedurat shoqërore për rishikim nga kolegët kanë nevojë që së pari të promovojnë besimin ndërmjet grupeve të ndryshme të përdoruesve të ujit, duke çuar në një bashkëpunim më proaktiv nga poshtë-lartë. (Mekanizmat nga poshtë-lartë janë gjithmonë të dobishëm në situata ku burimet rregullatore janë të kufizuara). Standarde dhe procedura të tilla duhet të synojnë të jenë sa më realiste që të jetë e mundur: jo të jenë shumë teknike ose të mbingarkuara me të dhëna; të bazohen sa më shumë që të jetë e mundur në vëzhgime të thjeshta, por gjithsesi objektivisht të verifikueshme, që kanë njëfarë rëndësie për individët e përfshirë; dhe të shprehen në terma që mund të komunikohen te publiku i gjerë. Kjo e bën më të thjeshtë aplikimin e këtyre masave në një mjedis me palë të shumta interesi. Skemat PPP mund të luajnë një rol të rëndësishëm për këtë. Së fundi, qëllimi duhet të jetë, zhvillimi i një kompleti mjetesh përkatëse dhe plane veprimi që identifikojnë dhe trajtojnë çështjet e integritetit dhe transparencës në lidhje me menaxhimin e integruar të burimeve ujore, siç janë paktet e integritetit, analiza e rreziqeve dhe dëshmitarët socialë. Në të njëjtën kohë, ka nevojë për një sërë trajnimesh gjithëpërfshirëse për zhvillim kapacitetesh dhe këshillimi (aktualisht të parashikuara si pjesë e Projektit IPA për periudhën 2017-2018) për MTI (AKUK), OJQ dhe përfaqësues të sektorit privat në pozicione të përgjegjësive sociale dhe mjedisore të korporatave që lidhen me MIBU. Kjo do të promovojë vetëbesimin e të gjitha palëve të interesit në nivel qendror, rajonal dhe vendor, duke u mundësuar atyre që të përfshihen në mënyrë më produktive në zhvillimin e PMBU-ve të para, që prej fillimit dhe deri në fund të vitit 2021.

### 3.5.7 Pjesëmarrja e grupeve të interesit në MIBU

Duke zhvilluar procedura për të garantuar pjesëmarrjen aktive të grupeve të interesit për zhvillimin e politikave të ujit, institucionet e ujit dhe kornizat e administrimit të ujit do të rrisin llogaridhënien, transparencën dhe besimin në vendimmarrje. Neni 14 i Direktivës Kuadër për Ujin ka të bëjë me pjesëmarrjen e publikut dhe udhëzimet përkatëse që janë në përfitim të grupeve të interesit dhe publikut të gjerë. Plani i angazhimit të grupeve të interesit për kontribute të informuara dhe të orientuara nga produkti në lidhje me hartimin dhe implementimin e politikave të ujit duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë kategorive jo të përfaqësuar mjaftueshëm (të rinjve, të varfërve, grave dhe përdoruesve shtëpiakë) si dhe grupeve të interesit dhe institucioneve të tjera që lidhen me ujin. Për të ekuilibruar pritshmëritë është e nevojshme që të përcaktohen proceset e vendimmarrjes, përdorimi i pritshëm i të dhënave dhe kontributi i grupeve të interesit, zbutja e çekuilibrave në kompetenca dhe fuqi, nga grupe interesi që janë të përfaqësuar në masë më të madhe si dhe ndërmjet atyre që janë ekspertë dhe që nuk janë ekspertë.

Kuadrot ligjore dhe institucionale, strukturat organizative dhe autoritetet përgjegjëse duhet të përshtaten për angazhimin e grupeve të interesit, duke marrë parasysh rrethanat vendore, nevojat dhe kapacitetet ekzistuese. Aktualisht në Republikën e Shqipërisë nevojitet fuqizimi i autoriteteve dhe përdoruesve vendorë për të identifikuar dhe trajtuar përmirësimet në menaxhimin e burimeve dhe shërbimeve ujore<sup>48</sup>. Kjo mund të përmirësohet duke promovuar bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe planifikuesve të ujit, duke integruar të tre nivelet e angazhimit të grupeve të interesit (informimi, konsultimi, vendimi).

Për të zbutur prekshmërinë sociale dhe mungesën e balancës gjinore që lidhet me MIBU-në, kërkohen gjithashtu aktivitete të tjera si për shembull kurrikulat e edukimit publik, hartimi i kornizës për programet e nxitjes dhe zbatimi i saj për të rritur deri në vitin 2020 aksesin në ujë dhe shërbimet e higjienës për grupet e prekshme sociale. Në këtë mënyrë, Ministria e Çështjeve Sociale dhe Rinisë duhet të jetë një anëtare aktive e Grupit Tematik që lidhet me 'Ujin për Njerëzit'.

<sup>48</sup> Korrik, 31 2014, Parlamenti miratoi ligjin 115/2014 "Mbi ndarjen territoriale dhe administrative të njësive që qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

### 3.5.8 Hartimi i marrëveshjeve ndërkufitare

Menaxhimi ndërkufitar i integruar i burimeve ujore kërkon përgjegjësi dhe bashkëpunim midis shteteve. Për të rritur bashkëpunimin me vendet kufitare ujore, deri në fund të vitit 2018 duhet të zhvillohet një Kornizë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Fushën e Ujërave, e cila do të mundësojë negociimin e objektivave të përbashkëta për cilësinë e ujit, përdorimin e ujit dhe kontrollin e përmbytjeve, që duhet të ndërmerren duke filluar në vitin 2019.

Kuadri duhet të përfshijë gjithashtu dispozita për ratifikimin e "Konventës mbi Ligjin e Përdorimit Jo-Lundrimit të Rrjedhave Ndërkombëtare të Ujit" dhe "Protokollit të Konventës për Parandalimin e Ndotjes Detare nga Hedhja e Mbeturave dhe Çështjeve të tjera" dhe të krijojë një plan veprimi për rindërtimin e bashkëpunimit bilateral me Greqinë pas Marrëveshjes së vitit 2003

Duke pasur parasysh ekspertizën teknike që kërkohet, punonjësit publikë në MPJ do të kenë nevojë për trajnim për (i) zhvillimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për përmbytjet ndërkufitare dhe rastet e ndotjeve, (ii) zhvillimin e planeve të përbashkëta për zonën bregdetare, dhe (iii) mirëmbajtjen cilësore të liqeneve ndërkufitare brenda Basenit të Drinit.

Hapi tjetër për bashkëpunimin në nivel ndërkufitar është transferimi i bashkëpunimit te komisionet ndërkufitare, vijimin e inspektimeve të vazhdueshme dhe të përbashkëta jo më vonë se viti 2017 dhe fillimin e zhvillimit të PMBL-ve të përbashkëta deri në vitin 2020.

### 3.5.9 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për menaxhimin e ujit

Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i politikave të ujit dhe ndarja e rezultateve me publikun do t'i bëjnë vendimet MIBU më shumë transparente, do të rrisë integritetin dhe do të mbështesë një vendimmarrje efikase. Sapo të jenë vendosur sistemet rajonale dhe vendore të monitorimit, Çdo dy vjet do të përgatiten, publikohen dhe shpërndahen Raporte Kombëtare për Gjendjen e Burimeve Ujore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore ofron një mundësi të shkëlqyer për të testuar dhe arriturë këtë transparencë, përderisa të gjitha grupet e interesit do të përfshihen në procesin e zhvillimit të planeve, në një mënyrë ose një tjetër, që nga fillimi. Për më tepër, informacioni për kadastrën e ujit duhet të bëhet pjesërisht i aksesueshëm për grupet e interesit dhe publikun e përgjithshëm gjatë vitit 2017 dhe më tej, me anë të kontaktit të përshtatshme për përdoruesit.

Institucionet e caktuara për monitorimin dhe vlerësimin duhet të pajisen me një kapacitet të mjaftueshëm, një shkallë të përshtatshme pavarësie dhe burimet e nevojshme për të vlerësuar administrimin e ujit dhe zbatimin e Strategjisë MIBU dhe çdo rregullim që kërkohet në periudhën 2017-2027.

## 3.6 Rezultatet kryesore

Objektivat e politikave krijojnë një Listë Produktesh Kryesore që duhet të zbatohen. Aneksi A jep detajet e plota të produkteve, ndërsa Kapitulli 5 ofron aktivitetet që janë në përputhje me parimet SMART në lidhje me planifikimin dhe zbatimin.

Rezultatet madhore të mëposhtme janë marrë nga MIBU. Kjo nuk është një listë përfundimtare, por një listë e detyrave që kërkojnë përpjekje për të siguruar që menaxhimi i mëtejshëm i burimeve mund të zhvillohet, zbatohet dhe sigurohet. Prioritarizimi në këtë listë mund të ndryshojë ndërmjet agjencive qeveritare, baseneve të lumenjve dhe palëve të interesuara, por për të siguruar efektivitetin e MIBU-t, këto detyra duhet të adresohen dhe të dokumentohen në mënyrë që agjencia përgjegjëse të mbajë përgjegjësinë.

### Rezultatet e qeverisë

- Përgjegjësit Institucionalë të jenë përcaktuar (p.sh. planifikimi, monitorimi, zbatimi, konsolidim, etj);
- Standardet Shqiptare të Cilësisë së Ujit janë përforcuar edhe monitorohen vazhdimisht;
- Plan Kombëtar manaxhimi efektiv për katastrofat i cili reflekton me prioritet katastrofat të lidhura me ujin dhe rreziqet shëndetësore të lidhura me të;
- Jane hartuar dhe zbatuar Planet e Menaxhimit të Permytjeve dhe Thatësirës sipas kërkesës së DP, me përfshirjen dhe angazhimin, komunikimin, mekanizmin e ndarjes në burra, gra, djem dhe vajza;
- Planet e Menaxhimit krahasuar me dokumentat për Ndryshimet Klimatike për ujin të BE-së;
- Vendosjen e Planeve të Harmonizuara Monitorimi në përputhje me ligjet dhe që përcaktojnë ku, sa shpesh dhe ç'farë duhet monitoruar;
- Testet e cilësisë së ujit dhe laboratorëve analitik (ekologjike dhe kimike) të jenë akredituar;
- Kadastra e Ujit është funksionale;
- Bashkëpunimi midis Institucioneve shkencore të jetë efiçente;
- Guidat dhe raportet në lidhje me parimet mjedisore të parandalimit, subvencionimit, proporcionalitetit dhe solidaritetit janë përcaktuar;
- Janë realizuar vlerësimet në zbatimin e parimeve;
- Planet sektoriale janë bazuar në mirëkuptimin e përbashkët të parimeve të MIPU dhe ujin e nevojshëm për çdo sektor;
- Kuadri ligjor lejon instrumentat ekonomik siç janë tarifatat, pagesa për marrjen e ujit, pagesa për ndotjen dhe subvencionet;
- Politikat për MIPU dhe PMBU janë zbatuar me një përfshirje të qartë të grupeve të interesit dhe autoritetet qendrore bëjnë marrëveshje dhe premtime transparente;
- Marrëveshjet Ndërkufitare janë funksionale, janë zhvilluar plane MBU disa palëshe;
- Raporte monitorimi vjetore dhe 6-vjeçare vlerësimi, konkluzionesh janë zhvilluar/ zbatuar.

#### Rezultatet në nivel baseni ujin

- Zhvillon Plane Menaxhimi të Baseneve Ujorë dhe PM, të cilat vendosin kritere prioritare të qarta në përdorimin e ujit, bazuar në kushtet e pasurive ujore për çdo basen;
- Program i Masave në përputhje me Ndryshimet Klimatike të BE-së në lidhje me ujin;
- Zbaton masat;
- Përmirëson Infrastrukturën;
- Përdorimin në mënyrë më efektive të Uji .;
- Realizon menaxhimin e kërkesës për ujë;
- Përdorimi i ujit (me prioritet të lartë për ujin për pirje) si prioritet;
- Janë realizuar sistemi i monitorimit për ujërat nëntokësorë, lumenjtë, liqenet/rezervuaret, zonat e ndërmjetme dhe ato bregdetare;
- Janë planifikuar dhe buxhetuar kapacitetet institucionale për MIPU përfshirë logjistikën, duke marrë në konsideratë mundësinë e barabartë për rritjen e kapaciteteve për meshkujt dhe femrat e stafeve dhe të grupeve shkencore;
- Materialet e trajnimit dhe kurset janë të përshtatshme për nivelet e larta, mesatare dhe të ulëta të stafeve me mundësi të njëjtë për meshkujt dhe femrat;
- Strategjia për MIPU dhe PMBU janë zhvilluar dhe pranuar nga grupet e interesit.

#### Rezultatet e grupeve të interesit dhe rezultatet e pjesëmarrjes së publikut

- Investimet janë prioritetizuar bazuar në nevojat sociale dhe vlerësimin ekonomik dhe vullnetit për të paguar për F&M (të ndara sipas gjinisë, moshës, vendndodhjes);

- Projektet janë zbatuar në zonat me problematikë të ndjeshme ndaj mungesës së ujit;
- Mekanizmat përfshijnë procedurat për pjesëmarrje të barabartë gjinore në konsultimet me grupet e interesuara dhe janë përcaktuar proceset e marrjes së vendimit;
- Janë realizuar fushatat e ndërgjegjësimit sistematik mbi interesat konkurruese, kurrikulat e arsimit drejt një kulture të menaxhimit të integruar të ujit.

### 3.7 Supozime dhe rreziqe

Supozimet dhe rreziqet duhet të identifikohen në mënyrë që të ndërmerren politika për të minimizuar këto rreziqe dhe për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm të synuar. Në vijim janë identifikuar supozimet, por duhet theksuar se supozimet dhe rreziqet shtesë mund të shtohen në varësi të institucionit që është duke zbatuar planin.

#### 3.7.1 Supozime kyçe

Gjatë hartimit të strategjisë MIBU: Janë identifikuar supozimet kryesore të mëposhtme

- Vullneti politik mbizotërues për zbatimin e Strategjisë do të jetë i qëndrueshëm për një periudhë deri në 2027 dhe do të jenë subjekt i rishqyrtimit çdo 6 vjet. Kjo strategji duhet të pranohet dhe të zbatohet për të siguruar se në qoftë se është prezantuar një mandat i ri politik, stabiliteti i këtyre programeve dhe financimi është i siguruar;
- Palët e interesuara (qeveritare, rajonale dhe vendore dhe OJF-të/OSHQ-të) vazhdojnë interesimin në çështjet MIBU, dhe vazhdojnë të jenë të gatshme të punojnë së bashku në një kuadër qeverisës ndërsektorial;
- Korniza e administrimit MIBU do të zhvillojë kapacitetet për të përmbushur aktivitetet e planifikuara që kërkon sistemi i njohurive dhe do të sigurojë që përfitimet ekonomike nga MIBU të jenë ndarë midis palëve;
- Palët e interesuara janë të gatshme dhe në gjendje për të përqafuar ndryshimin në drejtim të praktikave të mira dhe janë të prirura për të bashkëpunuar edhe në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave;
- Do të rritet akordimi buxhetor ndërsektorial për MIBU-në dhe do të identifikohen burimet shtesë buxhetore gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë MIBU;
- Nuk do të ketë ristrukturim radikal institucional që në mënyrë të konsiderueshme gërryen potencialin për aktivitetet e Strategjisë, të cilat do të financohen dhe / ose zbatohen.

#### 3.7.2 Rreziqet që i kanosen objektivave të synuar

Rreziqet kryesore për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë MIBU janë:

- Koha për të krijuar kornizën e nevojshme të qeverisjes së ujit dhe për të zhvilluar sistemin e nevojshëm dhe kapacitetet e nevojshme MIBU vlerësohet se është shumë e gjatë;
- Pamundësia për të siguruar financim të përshtatshëm;
- Partnerët zhvëllimorë mund të vonojnë apo nuk mbajnë angazhimet e tyre financiare;
- Çështjet e integritetit dhe transparencës ndikojnë vendimmarrjen;
- Mund të jetë e vështirë për t'u siguruar angazhimi nga sektorët përkatës;
- Reformat apo zgjedhjet institucionale mund të prishin ndërtimin e partneritetit dhe kufizojnë procesin e zbatimit.

### 3.7.3 Menaxhimi i riskut

Për të adresuar rreziqet e identifikuara në Seksionin 3.7.2, janë propozuar masat e mëposhtme të menaxhimit të rrezikut:

- **Sigurimi i financimit të përshtatshëm.** Financimi që kërkohet do të sigurohet nga të gjithë sektorët që lidhen me ujin dhe përmes angazhimit politik të miratimit përfundimtar në KKU dhe nga VKM-ja. QSH-ja do të sigurojë që financimi për MIBU-n do të vijë në rritje dhe do të mbrohet nga goditjet financiare. QSH-ja do të ndjekë angazhimet e saj financiare, dhe do të sigurojë një shpërndarje në kohë të buxheteve dhe llogarive. Fonde shtesë do të mundësohen përmes dialogut me Partnerët për Zhvillim si dhe mekanizmave të tjera të reja;
- **Zhvillimi i kapaciteteve për të rritur thithjen e buxheteve:** aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve do të vijojnë me shpejtësi për të krijuar kapacitete operacionale për ta bërë strategjinë funksionale;
- **Prioritet për parimet e integritetit dhe transparencës;**
- **Asistenca teknike** do të ndihmojë për të plotësuar mangësitë dhe të vijohet me shpejtësi për ndërtimin e kapaciteteve. QSH-ja do të sigurojë që të krijohet një strukturë e re MBU me stafin e duhur dhe kompetent deri në mes të 2018.

## 4 Burimet Financiare

### 4.1 Hyrje

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore është një strategji shumë dimensionale me horizont afatgjatë planifikimi (deri në vitin 2027) që përqipet të marrë në konsideratë paqartësitë në një sërë sektorësh, nën-sektorësh, politikash dhe përfundimesh. Në këtë kontekst, ky kapitull synon të hartëzojë dhe shpërndajë burimet sipas lidhjes së tyre me politikat, qëllimet dhe rezultatet që janë trajtuar më parë, për të arritur tek ndikimi që këto vendime do të kenë mbi planifikimin financiar në të ardhmen. Nevojat për financim mund të përmbushen drejtpërsëdrejti nga Buxheti i Shtetit, mbështetja nga donatorët në formën e granteve apo kredive, si dhe të gjitha financimeve të tjera të parashikuara kapitale, operacionale dhe të asistencës teknike. Nga pikëpamja e llogaritjes, në metodologjinë dhe supozimin e ndjekur, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) (Buxheti i Shtetit) është gjithëpërfshirës i burimeve që përmbushin nevojat për financim, qofshin me financim të huaj apo të brendshëm.

Është e qartë që Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore ndikon në shpërndarjen e shpenzimeve publike, siç mund të jenë buxheti afatmesëm dhe ai vjetor. Strategjia paraqet një panoramë të përgjithshme të shpërndarjes së nevojave për burime gjatë një kuadri kohor specifik. Për shkak të faktit se kjo strategji shtrihet gjatë një periudhe relativisht të gjatë (2016-2027), ka gjasa që gjatë viteve në vijim të ketë ndryshime, jo vetëm për sa i përket qëllimeve të identifikuar, që mund të arrihen më shpejt se sa janë planifikuar, por në lidhje me sfidat e reja që mund të lindin në të ardhmen. Për këtë arsye, burimet ekzistuese të planifikuar mund të transferohen nga një program buxhetor në tjetrin, ose mund të nevojitet dedikim i burimeve të reja sipas nevojave të reja.

Roli i Strategjisë, në lidhje me përcaktimin sasior të një niveli të parashikuar investimesh/shpenzimesh kapitale, është të shërbejë si një dokument reference që drejton planet e shpenzimeve qeveritare në të ardhmen.

Ndërkohë, stafi ekzistues i institucioneve të përfshira, në shumicën e rasteve do të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e masave operacionale të nevojshme. Në mbështetje të këtij fakti, Qeveria, në kuadër të Strategjive për Bashkëpunim me vendet partnere, do të kërkojë financime të vazhdueshme me qëllim të posaçëm për ngritjen e kapaciteteve.

Në këtë fazë, Strategjia shërben për të shprehur përparësitë në një mënyrë të qartë. Në këtë mënyrë, ndikimet e mundshme fiskale të politikave dhe të përfundimeve kryesore të shprehura janë krahasuar me spektrin e gjerë të mundshëm të burimeve të financimit.

### 4.2 Metodologjia e përdorur

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur referencat e lidhura me nevojat për burime financiare, që janë të nevojshme për arritjen e qëllimeve strategjike përcaktuar në Kapitullin 2 dhe Objektivat Politikë siç përshkruhen në Kapitullin 3. Në këtë kuadër, siç edhe sugjerohet nga metodologjia për hartimin e strategjive sektoriale apo ndërsektoriale (Urdhër i Kryeministrit Nr. 93, datë 07.08.2012), i referohet planeve buxhetore të dhëna në Programin e Buxhetit Afatmesëm (PBA), që kërkon përgatitjen nga çdo ministri të një plani tre vjeçar brenda kufijve të përcaktuar të shpenzimeve dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 (Miratuar në Maj, 2016). Proçesi i PBA-së drejtohet nga Ministria e Financave me synimin për të siguruar një lidhje të qartë midis shpërndarjeve të buxhetit dhe qëllimeve të politikave, duke arritur kështu një parashikueshmëri dhe efikasitet më të lartë të shpërndarjes së burimeve.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, së bashku me strategjitë e sektorit, strategjitë ndërsektoriale, master planet dhe planet e punës, që të gjitha formojnë kuadrin e zhvillimit strategjik gjithëpërfshirës për vendin. Ato përcaktojnë prioritetet, vizionin dhe në të njëjtën kohë objektivat e përgjithshëm dhe specifike afatmesëm dhe afatgjatë. Këto dokumente do të shërbejnë si drejtim për monitorimin dhe zbatimin e reformave të Qeverisë, duke përcaktuar etapat për përmbushjen e synimeve.

PBA-ja është elementi thelbësor i Sistemit të Integruar të Planifikimit (SIP). Si e tillë, ajo shërben si një instrument për bashkërendimin e buxhetit me politikat e përgjithshme dhe ato sektoriale të SKSHI-së. Proçesi i PBA-së ndihmon me sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike duke paraqitur një platformë afatmesme në planifikimin e shpenzimeve publike.

Tavanet buxhetore për vitin e parë të PBA-së janë të përcaktuar me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor që ndërmerret çdo vit në periudhën Korrik-Tetor. Buxheti për çdo ministri linje i nënshtrohet një proçesi të vazhdueshëm shqyrtimi, përmes hartimit vjetor të PBA-së në një cikël tre vjeçar. Kalendarit i PBA-së është një pjesë përbërëse e kalendarit të përgjithshëm të SIP-it. Vendosja e kalendarit të PBA-së nën tavanin e SIP-it ka transformuar të gjithë filozofinë duke kaluar nga një buxhet i bazuar në inputet, në një buxhet të bazuar në përfundime dhe performancë. Tabela e mëposhtme tregon kalendarin e PBA-së në detaje:

Strategjia MIBU dhe plani i saj i veprimit duhet të jenë në shqyrtim të vazhdueshëm nga aktorët, duke siguruar kështu një bazë informacioni për përcaktimin e taveve të buxhetit dhe për të shërbyer si një bazë e mirë monitorimi dhe informacioni për nevojat e financimit nga buxheti i shtetit apo investimet e huaja. Tabela në vijim ka referenca mbi institucionet dhe programet buxhetore të cilat janë marrë në konsideratë gjatë llogaritjes së Kostos të Startegjisë. Këto janë përcaktuar nga Ministria e Financave, si pjesë e fazës së dytë përgatitore të kuadrit të PBA-së 2016-2018, dhe identifikohen si specifike të lidhura drejtpërsëdrejti me politikat e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (Tabela 17):

**Tabela 17: Programet buxhetore sipas institucionit**

Institucioni	Programet e Buxhetit
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Administrimi i ujërave</li> <li>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit</li> </ul>
Sekretariati Teknik I Këeëshillit Kombëtar të Ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Planifikim, administrim, menaxhim (pagat e stafit; koordinim me sektorin MIBU)</li> </ul>
Ministria e Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtje mjedisore (buxheti lidhet me cilësinë e ujit)</li> </ul>
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Furnizimi me ujë dhe kanalizime (Fondi Rajonal për Zhvillim, ujëra të ndotura, furnizim me ujë, impiante trajtimi)</li> </ul>
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Planifikim, administrim, menaxhim (buxheti që lidhet me furnizimin me ujë dhe ujërat e ndotura)</li> </ul>
Ministria e Punëve të Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Emergjencja Civile (buxheti që lidhet me mbrojtjen nga përmytjet)</li> </ul>
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për Energjinë (buxheti që lidhet me monitorimin e kontratave konçesionare për stacionet e energjisë)</li> </ul>

PBA-ja 2017-2019 e institucioneve të lartpërmendura përmban informacion mbi masat dhe veprimtaritë e nevojshme që duhet të ndërmerren për përmbushjen e qëllimeve madhore të përcaktuara nga çdo institucion për programet përkatëse të lidhura me MIBU-n. Parashikohet që këto dokumente tashmë të dorëzuara në Ministrinë e Financave do t'i nënshtrohen shqyrtimit buxhetor. Vlen të përmendet se, megjithëse qëllimet madhore të politikave janë paraqitur në Kapitullin 3, shkalla e përmbushjes së tyre varet gjithashtu nga volumi i mbështetjes financiare shtetërore, si dhe nga mbështetja nga financimet e huaja.

### 4.3 Kostoja

Kostoja e përllogaritur e kësaj Strategjie është e bazuar në Programet e Buxhetit Afatmesëm për periudhën 2017-2019. Më konkretisht, referuar edhe Planit të Veprimit, është llogaritur që çdo produkt është i lidhur me Politikën e kësaj strategjie sipas kostove në vitet 2017-2019.

Në këtë seksion jepet edhe një vlerësim i burimeve të brendshme për periudhën 2019-2027, bazuar në supozimin për një rritje vjetore 2-3% të shpenzimeve/tavaneve duke marrë në konsideratë kuadrin makroekonomik të përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.

Rreziqet kryesore për një zbatim me sukses të strategjisë MIBU lidhen me kohëzgjatjen që kërkohet për të krijuar kuadrin e kërkuar institucional të administrimit të ujit dhe aftësinë për të siguruar financimin e duhur për periudhën 2017-2019:

Duke patur parasysh parashikimin e burimeve, presupozohet se kostot shtesë do të financohen në një nga tre mënyrat e mëposhtme:

- Burime të reja (të brendshme ose të huaja);
- Rishpërndarje të burimeve ekzistuese nga fusha me vlerë të ulët strategjike në fusha me vlerë të lartë strategjike; dhe
- Menaxhimi i përmirësuar.

Në këtë kontekst, rritja e investimeve duhet të materializohet kryesisht përmes identifikimit të projekteve të reja, fondeve nga donatorët dhe pjesërisht në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes rritjeve të buxhetit të shtetit.

Në këtë seksion kemi paraqitur gjithashtu edhe hendekun e financimit të kësaj strategjie, i cili është rezultat i diferencës midis Kostos së Strategjisë (bazuar në rezultate të nxjerra e të paraqitura në PBA 2016-2018) dhe Tavaneve të planifikuara në të njëjtën periudhë. Kërkesat shtesë që Ministrinë e Linjës kanë shprehur gjatë fazës së II të PBA 2016-2018.

**Tabela 18: Përmbledhja e kostos totale dhe financimi në mbështetje të objektivave të politikës së Strategjisë MIBU (Siç janë detajuar në shtojcën A)**

Objektivat strategjike dhe nënobjektivat të mbuluara nga dokumenti strategjik	Kosto Totale (në /000,000 Lekë)	Kosto Totale (në /000,000 Eur)	Financimi (në /000,000 Lekë)	Mangësitë (në /000,000 Lekë)	Komente mbi mangësitë financiare të objektivave
<b>TOTALI</b>	<b>239,865.71</b>	<b>1,713.32</b>	<b>216,118.49</b>	<b>21,560.35</b>	
Sasia e Ujit	218,826.86	1,563.05	204,000.00	19,000.00	Afërsisht produkte me vlerë 10 Miliardë Lekë janë parashikuar në programin buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime" janë jashtë Tavanit të të njëjtit Program Buxhetor. Ndërkohë 9 Miliardë Lekë janë Kërkesat Shtesë jashtë Tavaneve për Menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
Administrimi i ujit	8,565.20	59.10	7,813.40	461.00	
Cilësia e Ujit	3,237.05	23.12	2,537.00	700.05	
Informacion për ujin	1,420.39	10.15	1,420.39	-	
Rreziqet ngauji	1,747.00	55.83	347.70	1,399.30	Hartimi i Planit Kombëtar menaxhimit të katastrofave dhe zbatimi i tij nuk është parashikuar në PBA 2016-2018



### 4.3.1 Buxheti i shtetit

Tabela 19 paraqet burimet nga buxheti i shtetit, përfshirë financimin e jashtëm, (në milionë Lekë) të shpërndarë për secilin nga programet buxhetore të lidhura drejtpërsëdrejti me MIBU-n, sipas PBA-së 2016-2018.

Kolona e parë paraqet objektivat Strategjike të dokumentit ndaj programeve të buxhetit të katër Ministrive të Linjës. Disa programe buxhetore, si buxheti i planifikimit, menaxhimit dhe administrimit nuk janë përfshirë në këtë tabelë, sepse ato nuk janë të lidhura në mënyrë ekskluzive me një qëllim të veçantë (me përjashtim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit).

Në dy kolonat e mëposhtme paraqiten objektivat politik dhe ato të identifikuar në Deklaratën e Politikës së Programit të Buxhetimit, kështu që tregohet edhe një lidhje e qartë ndërmjet financimit dhe politikave përkatëse.

Tabela përfshin periudhën 2016 (vitin bazë) deri në vitin 2018, për të cilën është miratuar Programi i Buxhetit Afatmesëm.

**Tabela 19: Programet e buxhetit në mbështetje të objektivave të politikës MIBU (në /000,000 Lekë)**

Programi i Buxhetit	Objektivat Strategjik	Objektivat Politik	Objektivi i buxhetit	2016 Buxheti	2017 Buxheti	2018 Buxheti i planifikuar
STKKU	Sasia e ujit	Sigurimi i përfshirjes publike dhe debatit të informuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transpozimi i Direktivave të BE me ato kombëtare.</li> <li>• Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve të dëmtuar nga gërmimet.</li> </ul>	443	45	45
	Menaxhimi i ujit	Vendosja e koordinimit ndërsektorial dhe planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e të ardhurave nga përdorimi i ujit.</li> <li>• Marrëveshje për përdorimin e ujërave ndërkombëtare në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.</li> </ul>			
		Praktika e integritetit dhe transparencës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi i procedurës së lëshimit të lejeve për përdorimin e ujit.</li> </ul>			
		Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Menaxhimit të Ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i Regjistrit Kombëtar të burimeve ujore.</li> </ul>			
Administrimi i ujit	Sasia e ujit	Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i dëmtimeve të shkaktuara nga hedhja e paligjshme e mbetjeve në zonat bregdetare dhe turistike zhvillon veprime rikuperuese.</li> </ul>	432	432	432
	Informacion për ujin	Përcaktimi i Sistemeve të Monitorimit të Ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i bashkëpunimit efikas dhe procedurat e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për monitorimin dhe përdorimin e ujit.</li> </ul>			
		Krijimi i një organizate për ujin dhe klimën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i Programit Kombëtar të Monitorimit Mjedisor, përfshirë kushtet bazë, efektet dhe ndikimet mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore.</li> </ul>			
	Menaxhimi i ujit	Arritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Censusi kombëtar për të gjitha pikat e nxjerrjes (përfshirë puset).</li> <li>• Masat për mbrojtjen nga erozioni në zonat bregdetare.</li> </ul>			
Programet për mbrojtjen mjedisore	Cilësia e ujit	Përcaktimi i Statusit të Cilësisë së mirë të Ujit		2,377	2,556	2,556
	Informacion për ujin	Kontrolli i planeve dhe masave për rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike				
		Përcaktimi i Sistemeve të Monitorimit të Ujit				
Emergjencat civile	Rreziqet e ujit	Sigurimi i Mbrojtjes ndaj përmblytjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i masave ndaj katastrofave natyrore në 11% të njërive të qeverisë vendore, ku këto rreziqe janë identifikuar.</li> </ul>	145	145	145
		Menaxhimi efektiv Kombëtar i Katastrofave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rehabilitimi i shpejtë i dëmtimeve të shkaktuara nga katastrofat natyrore, mobilizimi i shpejtë i ekipeve të emergjencave civile, reduktimi i dëmtimeve të mundshme në NJQV në 5% të vlerave të mëparshme.</li> <li>• Rritje me 2% e buxhetit vjetor për popullsinë e prekur nga katastrofat natyrore.</li> <li>• Rritja e bashkëpunimit dhe përfshirja e shërbimeve të emergjencave civile në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> <li>• Zbatimi i masave për parandalimin dhe zbutjen, për reduktimin me 10% të katastrofave të shkaktuara nga zjarri.</li> </ul>			

Programi i Buxhetit	Objektivat Strategjik	Objektivat Politik	Objektivi i buxhetit	2016 Buxheti	2017 Buxheti	2018 Buxheti i planifikuar
Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	Cilësia e ujit	Përmirësimi i shpërndarjes së ujërave (infrastruktura) dhe masat për konservim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja deri në 98%e mbulimit të furnizimit me ujë të popullsisë deri në vitin 2020.</li> <li>Rritja deri në 77%e mbulimit me kanalizime të popullsisë dhe trajtimi avancuar të shkarkimeve të ujërave të ndotura deri në 50%.</li> </ul>	7,837	7,837	7,837
	Menaxhimi i ujit	Arritja e shpërndarjes së barabartë të përfitimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përforcimi afatshkurtër i parimeve të rikuperimit të kostove direkte dhe afatgjatë për parimet e rikuperimit të plotë të kostove.</li> <li>Rritja e kapaciteteve të stafit për menaxhimin dhe funksionimin, dhe mirëmbajten nëpërmjet një programi kombëtar trajnimesh dhe kualifikimesh.</li> <li>Përputhje e plotë e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.</li> </ul>			
		Zhvillimi i instrumenteve ekonomike dhe financiare për rikuperimin e kostove				
Menaxhimi infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Sasia e ujit	Përmirësimi i shpërndarjes së ujërave (infrastruktura) dhe masat për konservim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përbushja e kërkesave për ujitjen në të gjitha fushat (për rreth 360,000 ha) deri në vitin 2020.</li> <li>Përmirësimi i masave për mbrojtjen nga përmbytjet dhe kullimin (për rreth 280,000 ha) dhe masave për zbutjen e përmbytjeve në zonat vulnerabël të lumenjve dhe ato bregdetare (rreth 130,000 ha) deri në vitin 2020.</li> <li>Rehabilitimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet dhe kullimin, përforcimi i standardeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen (për rreth 280,000 ha) deri në vitin 2020.</li> </ul>	3,865	2,438	2,438
Planifikimi, Administrimi & Menaxhimi (FSHZH)	Sasia e ujit	Përmirësimi i shpërndarjes së ujërave (infrastruktura) dhe masat për konservim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe njohurive në nivel qendror, rajonal dhe vendor.</li> <li>Zhvillimi, përforcimi dhe monitorimi i zbatimit të masave infrastrukturore dhe joinfrastrukturore.</li> </ul>	1,780	1,500	1,969
		Arritja e shpërndarjes së barabartë të përfitimeve				
<b>Totali (në /000,000 Lekë)</b>				<b>16,879</b>	<b>14,953</b>	<b>15,422</b>
<b>Totali (në /000,000 Euro)</b>				<b>121</b>	<b>108</b>	<b>111</b>

Duke përdorur tabelat ekzistuese të buxhetit të ministrive të linjës, analizën e kryer nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, tavanet e përcaktuara nga MF gjatë fazës së dytë të PBA-së 2016-2018 dhe gjykimit të specializuar të Konsulentëve, vlerësimet për vitet e mëtejshme (2019-2027) bazohen në supozimin se raporti i burimeve për këto programe me buxhetin e përgjithshëm do të mbetet i pandryshuar, dhe se rritja ekonomike për këto vite do të jetë 2-3% për vit. Supozimi është i diskutueshëm sepse jetëgjatësia e Strategjisë është shumë më e madhe, kështu që politikat kanë gjasa të ndryshojnë me kalimin e kohës, duke sjellë kështu edhe ndryshime në financim.

Megjithatë, siç është përmendur edhe më sipër, parashikimi i rritjes së buxhetit lidhet me PBB-në sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim 2015-2020. Tabela 206 tregon buxhetin për çdo program të shtrirë deri në vitin 2027.

**Tabela 20: Buxheti i parashikuar për periudhën 2019-2027 (në /000,000 ALL)**

Nën-sektori	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit	182.29	187.03	191.89	196.88	202.00	207.25	212.64	218.16	223.84
Administrimi i ujit	443.23	454.76	466.58	478.71	491.16	503.93	517.03	530.47	544.26
Programet për mbrojtjen e mjedisit	2,561.24	2,627.83	2,696.15	2,766.25	2,838.18	2,911.97	2,987.68	3,065.36	3,145.06
Emergjencat civile	148.77	152.64	156.61	160.68	164.86	169.14	173.54	178.05	182.68
Furnizimi me ujë dhe kanalizime	8,040.76	8,249.82	8,464.32	8,684.39	8,910.18	9,141.85	9,379.54	9,623.40	9,873.61
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	2,989.42	3,067.15	3,146.89	3,228.71	3,312.66	3,398.79	3,487.16	3,577.82	3,670.85
Planifikimi, Administrimi & Menaxhimi (FSHZH)	2,199.06	2,256.24	2,314.90	2,375.09	2,436.84	2,500.20	2,565.20	2,631.90	2,700.32
<b>Totali (në /000,000 Lekë)</b>	<b>16,564.77</b>	<b>16,995.45</b>	<b>17,437.34</b>	<b>17,890.71</b>	<b>18,355.86</b>	<b>18,833.12</b>	<b>19,322.78</b>	<b>19,825.17</b>	<b>20,340.63</b>
<b>Totali (në /000,000 Euro)</b>	<b>118.32</b>	<b>121.40</b>	<b>124.55</b>	<b>127.79</b>	<b>131.11</b>	<b>134.52</b>	<b>138.02</b>	<b>141.61</b>	<b>145.29</b>

#### 4.3.2 Burime të jashtefinancimi

Ky seksion përfshin projektet dhe programet madhore në vijim dhe të planifikuara, të financuara nga donatorë të ndryshëm që janë përfshirë në parashikimin e buxhetit të përmendur më sipër në Tabelat 195 dhe 206.

Sektori i ujit, kryesisht ujësjellësit, sistemet e ujërave të ndotura, ujitja dhe kullimi, ka qenë ndër sektorët kryesorë që kanë përfituar shumicën e asistencës së huaj në vitet e shkuara dhe do të vijojë të jetë një ndër sektorët më të financuar nga jashtë në vitet në vazhdim (2018-2020).

Në sektorin MIBU ka aktualisht 39 projekte të nisura me një vlerë të përgjithshme prej 534 milionë Euro, nga të cilat 149 milionë Euro janë grante dhe rreth 385 milionë Euro janë kredi.

Tabela e mëposhtme rendit këto projekte kryesore në vijim e sipër të financuara përmes asistencës së huaj për secilin nga nën-sektorët e sektorit MIBU<sup>49</sup>, të kategorizuar sipas institucionit dhe burimit të financimit (partneri specifik). Bazuar në disbursimet e planifikuara për vit, ofruar nga partneri përkatës për zhvillim për secilin projekt, shifrat janë pasqyruar në PBA-në 2017-2019 nën tavanet e përcaktuara nga MF.

<sup>49</sup> Lista e projekteve është përmblodhur në bazën e të dhënave të projekteve të donatorëve përgatitur nga Departamenti i Zhvillimit të Programeve, Financimeve dhe Ndihmës së Jashtme. Tabela nuk merr parasysh projekte më të vogla asistence teknike në nën sektorë të ndryshëm, sepse informacioni rreth tyre nuk është i mundësuar.

Për më tepër, aktualisht ka edhe 14 projekte që presin fillimin e zbatimit, me një vlerë të përgjithshme prej 146 milionë Euro, nga të cilat 13 milionë Euro janë grante dhe 13 milionë Euro janë kredi. Parashikimet janë bazuar kryesisht në Dokumentet Strategjike të Vendit të hartuar nga donatorët kryesorë që veprojnë në Shqipëri, veçanërisht në sektorin e ujit, si Bashkimi Evropian, Banka Botërore, dhe GIZ.

**Tabela 21: Projektet në vazhdim të financuara nga fondet e huaja (në /000,000 Euro)**

Institucioni përfitues	Nën-sektori	Partneri i zhvillimit	Titulli i projektit	Fondet e caktuara
MBZHRAU	Ujitja dhe kullimi	Banka Botërore	Projekti për Burimet Ujore dhe Ujitjen (PBUU)	36.22
		Suedi		3.65
	Mbrojtja nga përmbytjet	IPA 2012	Përmbytjet / Emergjencat civile	12.4
		IPA 2012	Programi i Rikuperimit i BE për Përmbytjet	6
		IPA 2013	Programi i Rikuperimit i BE për Përmbytjet	6.4
MM	Burimet Natyrore	Suedi	Projekti për Shërbimet Mjedisore	6.88
		Austri	Rrjeti Themis – Faza 2: Promovimi i bashkëpunimit rajonal në SEE nëpërmjet rrjetëzimit brenda autoriteteve përgjegjëse për sektorët e mjedisit dhe drejtësisë	0.175
	Ndryshimet klimatike	Austri	ENVSEC: Transformimi i Rreziqeve për Mjedisin dhe Sigurinë në Koperacionin në Rajonin e Evropës Juglindore (Faza II); dhe Ndryshimet Klimatike dhe Siguria në Basenin Ujor Dniester	0.162
		Gjermani /GIZ	Përshtatja e ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor (Projekti Rajonal)	3.5
MPB	Emergjencat civile / Mbrojtja nga përmbytjet / Gatishmëria	IPA 2012	Elementi i dytë: Parandalimi / Gatishmëria ndaj Menaxhimit të Përmbytjeve dhe Katastrofave (2.5 milionë euro) Programi i Bashkimit Evropian për Rikuperimin e Përmbytjeve	2.5
		IPA 2013	Elementi i dytë: Parandalimi / Gatishmëria ndaj Menaxhimit të Përmbytjeve dhe Katastrofave	2.5
AFD	Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet	Gjermani / KfW	Furnizimi rural me ujë III	24
		Gjermani / KfW	Programi rural i furnizimit me ujë – Masat shoqëruese (MS)	1
		Gjermani / KfW	Programi rural i furnizimit me ujë (Faza I - II)	9
		Gjermani / KfW	Furnizimi me ujë i zonave rurale III (M)	1.5
		Austri	Sistemi i Kanalizimeve në Bilisht	3
		Austri	Furnizimi me ujë në Peshkopi	4
MEI	Hydroenergija	Banka Botërore	Komuniteti Energjetik i Evropës Juglindore Programi APL - APL për Sigurinë e Digave në Shqipëri	51.5
		BERZH	Përmirësimi i Sigurisë së Digave në Hydrocentralin e Komanit	12.7
MTI	Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet	Banka Botërore	Projekti për Investime në Sektorin e Ujit	77.24
		Zvicër	Projekti i furnizimit me ujë për Shkodrën	7.5
		Zvicër	Projekti i furnizimit me ujë dhe kanalizimet në qytetin e Lezhës. Programi i Bashkisë për Infrastrukturën 1	10.5
		IDB	Projekti rural i furnizimit me ujë/Orikum	5.88
		Zvicër	Infrastruktura bashkiake III & IV	11.75
		Itali	Sistemi i ujit dhe kanalizimeve në Tiranë – Rehabilitimi i Infrastrukturës dhe Asistenca Teknike për Ndërmarrjen e Ujit Tiranë	27.48
		Japoni	Projekti për Përmirësimin e Sistemit të madh të Kanalizimeve Tiranë	73.84
		IPA 2009	Mbështetje për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	23.1
		IPA 2010	Përmirësimi i sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve	26
		IPA 2011	Faza e dytë e ndërtimit të Sistemeve të Kanalizimeve Velipojë	10.5
Austri	Asistenca teknike për Sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	2.87		
Austri	Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në	0.07		

Institucioni përfitues	Nën-sektori	Partneri i zhvillimit	Titulli i projektit	Fondet e caktuara
			politikat e vendit për problemet me ujë	
		Gjermani / KfW	Shtesë për 'Mbrojtjen e Liqenit të Shkodrës'	3
		Gjermani / KfW	Kanalizime Pogradec III	10
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake I	16
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake II	14
		Gjermani / KfW	Kanalizime Korçë IV	15
	Reforma e ujit	Gjermani / GIZ	Reforma e sektorit të ujit (II)	2.4
	Kanalizime	Gjermani / KfW	Kanalizime Korçë III	5
	Furnizimi me ujë	Gjermani / KfW	Furnizimi me ujë Pogradec	4.88
<b>Totali (në /000,000 Euro)</b>				<b>534.097</b>
<b>Totali (në /000,000 Lekë)</b>				<b>74,239.483</b>

Burimi: Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndhmës së Huaj, Kryeministri

**Tabela 22: Projektet e planifikuara të financuara përmes fondeve të huaja (në/000,000 Euro)**

Institucioni Përfitues	Nën-sektori	Partneri për Zhvillim	Titulli i projektit	Fondet e caktuara
MM	Ndryshimet Klimatike	IPA 2013 Dosja e sektorit të mjedisit – ndërhyrje fusha 1 – ndryshimet klimatike		2
		OKB	Ndryshimet klimatike	1.81
FSHZH	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	Gjermani / KfW	Furnizimi Rural me Ujë IV	15
		Gjermani / KfW	Furnizimi Rural me Ujë IV (AM)	2
		IDB	Programi i Menaxhimit të Mbetjeve (AM)	20
MTI	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	Itali	Ujë dhe kanalizime	11.28
		IPA 2012	Sistemi i kanalizimeve Vlorë	18.5
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake III	15
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake IV	20
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake V	40
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake V (AM)	3
		Gjermani / KfW	Infrastruktura bashkiake IV (AM)	2
	Kanalizime	Gjermani / KfW	Programi i Menaxhimit të Mbetjeve	12
		Gjermani / KfW	Programi i Menaxhimit të Mbetjeve (AM)	2.5
<b>Totali (në /000,000 Euro)</b>				<b>165.09</b>
<b>Totali (në /000,000 Lekë)</b>				<b>22,947.51</b>

Burimi: Departamenti i Programim Zhvillimit, Financimit dhe Ndhmës së Huaj, Kryeministri

Një përbërës kyç që parashikohet të kërkojë mbështetje përmes asistencës së Bankës Botërore është ofrimi i mbulimit të përmirësuar me shërbime uji dhe sanitare, përfshirë veprimtaritë analitike dhe këshilluese për sektorin ose Asistencën Teknike (Mbështetja për Politikën e Sektorit të Ujësjellësit dhe Shërbimeve Sanitare). Në këtë përbërës, do të vijojnë të nxiten përpjekjet për qeverisje më të mirë dhe menaxhim transparent të investimeve në ofrimin e shërbimeve publike përmes projekteve ekzistuese në sektorin e ujit dhe në punën analitike përkatëse. Projekti i Investimit në Sektorin e Ujit (PISU) është gjithashtu i përfshirë në përbërësin e Asistencës Teknike, duke qenë se synon të përmirësojë nivelin e shërbimit të ndërmarrjeve komunale dhe të zgjerojë aksesin e qytetarëve në shërbime. Programet e asistencës së Grupit të Bankës Botërore në këtë fushë janë të bashkërenduara me partnerët e tjerë madhorë për zhvillim aktiv në sektorin e ujit, përfshirë Sida, KfW, GIZ, ADA, USAID dhe BE.

Është parashikuar që asistencë e BE-së në sektorin e integruar të ujit mund të menaxhohet nga institucionet kombëtare në vitin 2017 dhe 2018 (nëse plotësohen disa kriteret specifikë), në vend që të përdoret një sistem qendror zbatimi ku fondet e BE-së administrohen nga agjencitë e BE-së. Angazhimi i BE-së për këtë sektor do të jetë në vlerën e 25 milionë Eurove për mbështetjen financiare të projekteve dhe 5 milionë Eurove në

formën e Asistencës Teknike për forcimin e kapaciteteve të menaxhimit të sektorit në linjë me politikat e BE-së dhe konsolidimin e përpjekjeve të mëparshme. Mbështetja financiare për investimet do të përqendrohet në uljen e ndotjes së ujërave bregdetare të Adriatikut duke modernizuar dhe rehabilituar infrastrukturën e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura përgjatë vijës bregdetare, veçanërisht në Velipojë, Lezhë/Shëngjin, Durrës, Kavajë, Vlorë, Ksamil, Sarandë, Orikum, Divjakë, Spille dhe Dhërmi.

Sektori i ujit do të mbështetet gjithashtu edhe në kontekstin e një Protokollit të ri Bashkëpunimi midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për periudhën 2016-2017, ku një nga fushat me përparësi të propozuara është ajo e ujit dhe shërbimeve sanitare.

#### 4.3.3 Nevoja shtesë për periudhën buxhetore 2016-2018

Ky seksion paraqet një përmbledhje të përgjithshme të mangësive financiare në lidhje me kohën. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e kësaj përmbledhjeje lidhet me nevojat që ministritë e linjës nuk mund të mbulojnë me qëllim realizimin e objektivave të tyre në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore sipas programeve përkatëse të buxhetimit.

**Tabela 23: Nevoja për financime shtesë për periudhën buxhetore 2016-2018 (në /000,000 Lekë)**

Nën-Sektori	2016 Mangësia financiare	2017 Mangësia financiare	2018 Mangësia financiare	2016-2018 Mangësia financiare
Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	5,549	2,445	2,150	10,144
Ujitja dhe kullimi	4,200	3,338	1,546	9,084
Administrimi i ujit	208.3	-	-	208.3
Emergjencat civile	454	-	-	1,400
STKKU	139.4	117.5	203.2	460.1
<b>Totali në (në /000,000 Lekë)</b>				<b>21,296.40</b>
<b>Totali në (në /000,000 Euro)</b>				<b>152.12</b>

Kërkesat shtesë të paraqitura nga institucionet zbatuese lidhen me akordimin e buxhetit të pamjaftueshëm me tavanet përkatëse për të mbështetur rezultatet vjetore dhe politikat afatmesme.

Ndërkohë që objektivat dhe rezultatet përkatëse do të vazhdojnë të mos mbulojnë nga tavanet përkatëse (për shkak se numri i rezultateve të pritshme do të vazhdojë vetëm të rritet çdo vit, ndërsa tavanet buxhetore do të jenë konstante dhe do të rriten shumë pak), ne mund të parashikojmë se nevojat aktuale shtesë do të vazhdojnë të jenë në të njëjtat nivele monetare.

## 5 Raportimi, Monitorimi, dhe Vlerësimi

### 5.1 Hyrje

Raportimi, monitorimi dhe analiza e vlerësimit janë thelbësore për një zbatim efikas dhe në kohë të Strategjisë MIBU. Monitorimi i pesë Objektivave Strategjike kundrejt treguesve të përcaktuar qartësisht ofron një bazë të qartë për progresin e monitorimit (UNDP, 2009) lidhur me zbatimin e Strategjisë MIBU (GWP, 2003) duke verifikuar progresin e objektivit dhe rezultateve.

Mjeti kryesor monitorues do të jetë krijimi i një Matrice për Vlerësimin e Performancës, që informon për progresin e arritur në qëllime të ndryshme strategjike, të matur përmes indikatorëve të përcaktuar. Treguesit e Strategjisë MIBU janë përzgjedhur në kuadrin e treguesve përkatës të përdorur për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm 3, 4, 5, 6, 13, 14, 15, 16 (ECOSOC, 2016), zgjerimin e BE-së (KE 2015) dhe Treguesit e Zbatimit të Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së, si dhe treguesit e performancës së OECD-së (OECD 2015). Matrica përfshin një vlerë bazë, etapa afatmesme (2022), etapa të synuara (2027), dhe mënyrat e verifikimit. Matrica e Vlerësimit të Performancës ilustron në Seksionit 5.2.

Identifikimi i treguesve dhe përcaktimi i përgjegjësive është bazuar në përshkrimet e:

- Seksionit 5.2: që përfshin qëllimet strategjike, treguesit e përgjithshëm, mënyrat e verifikimit dhe supozimet, edhe matrica baze e vlerësimit të performancës;
- Seksioneve 5.3 - 5.7: që përcaktojnë qëllimet e politikave, rezultatet kryesore, verifikimin, aktorët, rreziqet dhe supozimet;
- Aneksi A: Rezultatet dhe Veprimtaritë/Masat.

Sekretariati Teknik<sup>50</sup> i K KU-së është përgjegjës për krijimin e një sistemi të integruar të perfshirjes gjinore për monitorimin e menaxhimit të burimeve ujore dhe për zbatimin e sistemit në mënyrë efikase. Si rrjedhojë, duke qenë se MBZHRAU është përgjegjëse për zbatimin e (Strategjisë) MIBU, sinergjia midis MBZHRAU dhe Sekretariatit Teknik të K KU-së është thelbësore gjatë çdo periudhe raportimi dhe përpara dorëzimit të raporteve vjetore të monitorimit pranë K KU-së. Raporti vjetor i monitorimit duhet të fokusohet ndër të tjera në rezultate, tregues, tendencat aktuale dhe të perspektivës, pengesave të shfaqura gjatë kohës së raportimit, mësimet të nxjerra dhe arritjeve, rezultateve të arritura gjatë periudhës së raportimit.

Koordinimi i përgjithshëm i procesit të monitorimit, si dhe vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për amendamente potenciale do të sigurohet nga Sekretariati Teknik i K KU-së së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Kjo e fundit do të kryejë gjithashtu rolin e koordinatorit për procesin e zbatimit të Strategjisë. Ministrinë përkatëse të linjës do të vlerësojnë treguesit specifikë në të gjithë sektorin nëpërmjet rezultateve të mbledhura nga MBZHRAU. Raportet e monitorimit vjetor për zbatimin e strategjisë MIBU do t'i paraqiten për rishikim STKKU-së dhe përfundimisht K KU-së për miratim. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të zbatohet në përputhje me procesin e raportimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe kalendarin e Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Zbatimi i Strategjisë MIBU deri në vitin 2027, do të jetë një proces dinamik pasi ai kërkon përditësime të rregullta për ta mbajtur Strategjinë në përputhje me ndryshimet në politikat, iniciativat dhe prioritetet e

<sup>50</sup> Sipas Ligjit Nr. 111/2012, për "Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 230, datë 23.04.2014, për "Përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit".




Qeverisë, si edhe për të përfshirë ndryshimet në politikat dhe rregulloret e BE-së. Rritja e efektivitetit të Strategjisë MIBU përfshin monitorimin e zbatimit, vlerësimin e kombinuar me aktivitete trajnimi, dhe vlerësimin e zhvillimeve reale në botë për të përcaktuar nëse objektivat strategjike dhe të politikës, si dhe rezultatet janë arritur apo kanë nevojë për përshtatje. Nëse ky proces aplikohet siç duhet, Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore bëhet një pjesë integrale e procesit të planifikimit.

Në nivel institucional, strategjia do të monitorohet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Ndërkohë që përgjegjësia për mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit mbetet tek MBZHRAU, strategjia MIBU përfshin ministri të ndryshme, institucione të qeverisjes qendrore dhe qeverisjen lokale.

I gjithë procesi do të menaxhohet dhe monitorohet në nivel politik nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), i kryesuar nga Kryeministri, në të cilin Sekretariati Teknik i KKU shërben si koordinator qendror i të gjitha politikave dhe masave ndërsektorial që janë zbatuar nëpërmjet një metode të integruar në sektorët.

Në bazë të ligjit Nr. 111/2012 mbi "Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 23/04/2014, mbi "Përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit", Sekretariati Teknik i KKU është përgjegjës për krijimin e një sistemi të integruar për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe monitorimin, që sistemi të zbatohet në një mënyrë efikase. Prandaj, sinergjia midis MBZHRAU dhe Sekretariatit Teknik të KKU është vendimtar gjatë çdo periudhe të raportimit dhe para dorëzimit të Raporteve Monitoruese Vjetore të KKU.

**Figura 14: Rrjeti Institucional dhe përgjegjësitë për Monitorimin dhe Vlersimin e Strategjisë MIBU**



Koordinimi i përgjithshëm i procesit të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe dhënia e rekomandimeve për ndryshime të mundshme, do të sigurohet nga Sekretariati Teknik i KKU së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), e cila më vonë do të kryejë rolin e koordinatorit ndërsektorial për procesin e zbatimit të strategjisë.

Treguesit e shumtë të sektorëve specifik do të vlerësohen në mënyrë periodike nga ministritë përgjegjëse dhe rezultatet do të mblidhen nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Më pas, raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e strategjisë MIBU do të paraqitet për shqyrtim në Sekretariatit Teknik të KKKU dhe së fundi, për miratim, në Këshillin Kombëtar të Ujit.

Treguesit e referencës ofrojnë informacione për temat kryesore për situatën në kohën e përgatitjes së strategjisë. Treguesit e output-it matin rezultatet e prekshme të aktiviteteve të zbatuara. Për monitorim dhe raportim do të mblidhen informacione për treguesit përkatës në varësi të llojit të ndërhyrjes. Treguesit e rezultateve matin efektet e drejtpërdrejta dhe të menjëhershme të ndërhyrjeve të përfutuesit, për shembull; në aksesin në ujë dhe kullim, pajtueshmërinë me standardet e Komunitetit dhe përmirësimin e performancës së fermave dhe sipërmarrjeve bujqësore që janë mbështetur. Treguesit e impaktit fokusohen në efektet e strategjive ndërsektoriale tek Menaxhimi në mënyrë të Integruar të Burimeve Ujore.

Të dhënat që i shërbejnë monitorimit (3 mujore; 6 Mujore dhe Vjeçare) do të futen në një bazë të dhënash që do të përditësohet nga Drejtoria e Politikave për Administrimin e Ujit (MBZHRAU). Kjo drejtori do të ketë detyrë funksionale të kryejë kërkesat për të dhëna që do të gjenerohen nga Drejtoritë e tjera në Ministri (Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës; Bordet Rajonale të Kullimit; Agjencitë Rajonale të Baseneve Ujore; etj) apo Institucionet e tjera si MTI, MEI, MM, etj.

Të dhënat e mbledhura do të konfirmohen dhe transferohen në një format të pajtueshëm e të rënë dakord nga Drejtoria e Politikave për Administrimin e Ujit (MBZHRAU), ku të dhënat do të përpunohen dhe sistemohen në tabela me tregues monitorimi. Gjithashtu do të përgatitet “Pashaporta” për cdo Indikatorë, e cila do të ofrojë informacion më të detajuar mbi Indikatorin, dhe do të shoqërojë raportin e monitorimit.

Më pas këto do të paraqiten për vendimmarrje pranë Grupit për Menaxhim Strategjik të MBZHRAU, i drejtuar nga Ministri, për të mundësuar kështu përcjelljen zyrtare pranë STKKU që do ta shqyrtojë dhe paraqesë me frekuence vjetore pranë Këshillit Kombëtar të Ujit.

Zbatimi i strategjisë do t'i nënshtrohet një vlerësimi të vazhdueshëm nëpërmjet veprimtarive të vazhdueshme për vlerësimin në nivelin e ndërhyrjeve me raportime vjetore për këto veprimtari. Vlerësimet operative do të fokusohen në aspekte specifike të zbatimit të strategjisë, dhe të lidhura më së shumti me aspekte të planifikimit të programit buxhetor afatmesëm.

Proçesi i monitorimit dhe vlerësimit do të realizohet në përputhje me proçesin e raportimit për realizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, kalendarin e Sistemit të Planifikimit të Integruar.

## 5.2 Objektivat Strategjikë

	Rezultatet Kryesore	Mënyrat e verifikimit	Supozimet	Treguesit SDG	
<b>Vizioni</b>	<b>Deri në vitin 2027 Shqipëria të bëhet një vend me efikasitet ujqor, me një menaxhim të integruar funksional të burimeve ujore, përfshirë edhe një sistem të konsoliduar monitorimi dhe rreziqesh nga përmbytjet dhe mungesa e ujit. Përdorimi i ujit bazohet në parimet e barazisë dhe qëndrueshmërisë për përfitime të barabarta ekonomike, shoqërore dhe gjinore dhe drejtësi mjedisore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.</b>				
<b>Misioni</b>	<b>Krijimi i të gjitha kuadrove të nevojshme ligjore, ekonomike, institucionale, teknike dhe shoqërore, bazuar në legjislacionin mjedisor të BE-së dhe parimet e MIBU për menaxhimin e integruar e të sinqertë, të shëndoshë të përfshirjes gjinore të gjitha burimeve ujore në vend.</b>				
Objektivat strategjike (1-5)	<b>Sasia e Ujit:</b> Sigurohet përdorimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, duke i shërbyer të gjitha interesave	Alokim dhe shpërndarje efikase dhe me barazi e ujit dhe rritje thelbësore e efikasitetit të përdorimit të ujit në të gjithë sektorët dhe sigurimi i thithjes, riciklimit dhe ripërdorimit të qëndrueshëm	Baza e të Dhënave e Kadastrës së Ujit Raporte në lidhje me Sektorin e Ujit Regjistra zyrtarë qeveritarë	Zbatimi i Direktivave të BE-së Funksionimi i Kadastrës së Ujit	6.1, 15.6,
	<b>Cilësia e Ujit:</b> Cilësia e të gjitha burimeve të ujit, duke arritur një gjendje të mirë deri në vitin 2027	Ulja e ndotjes, eliminimi i derdhjeve dhe zvogëlimi i hedhjes së materialeve dhe kimikateve të rrezikshme	Raportim AKM Kadastri e Ujit Raportet e Institutit të Shëndetit Publik Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore (DKU)	Zbatimi i Direktivave të BE-së Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ujit sipas standardit	6.3, 6.6, 14.1, 14.2, 14.5, 15.1
	<b>Rreziqet e Ujit:</b> Rreziqet që vijnë nga uji (përmbytje dhe thatësira) përballohen përmes menaxhimit dhe investimeve	Përforcohet mbrojtja dhe kapaciteti për përshtatje me zhvillimet klimatike, të rreziqeve dhe katastrofave natyrore	Plane të Menaxhimit të Katastrofave Plane të Menaxhimit të Përmbytjeve Plane të Menaxhimit të Thatësirave Komunikimi shqiptar IPCC	Zbatimi i Direktivave të BE-së Zhvillimi i kapaciteteve dhe sigurimi i financimeve për të pasur aftësinë të hartohen dhe zbatohen planet	3.9, 13.1, 13.2, 15.3
	<b>Informacioni mbi Ujin:</b> Të dhëna dhe modele të besueshme për ujë dhe klimë të siguruar për të gjitha palët e interesuara dhe këshillat adekuate të politikave të bazuara në këto të dhëna dhe modele sigurohen nga qeveria nga institucionet përkatëse të të dhënave institucionale	Një njohuri e qartë i të gjitha burimeve ujore si një bazë njohurish publike për menaxhimin e integruar të ujit për vendime (politikash)	Kadastri e Ujit Raportet e NEA Raportet e BE-së (AEM, DKU)	Zbatimi i Direktivave të BE-së Monitorim dhe vlerësim i cilësisë së ujit sipas standardev	6.a, 12.8
	<b>Menaxhimi i Ujit:</b> Uji menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i shërbyer të gjitha interesave, duke ofruar përfitime të barabarta socio-ekonomike dhe përfshirje në vendimmarrje për gjeneratat e ardhshme	Politika të qarta MIBU dhe zbatim i PMBU-ve që synojnë qëllime të matshme në afatet kohore të para caktuara dhe shkallën e përshtatshme, caktim i qartë i detyrave për autoritetet përgjegjëse, bazuar në monitorim dhe vlerësim të shëndoshë	Legjislacion, Urdhëra Ministrorë, Vendime të KKKU-së dhe akte nënligjore Shkalla e harmonizimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore	Zbatim i parimeve të OECD-së dhe BE-së; parimet mjedisore të kujdesit, plotësueshmërisë, proporcionalitetit dhe solidaritetit dhe legjislacioni i harmonizuar	5.5, 5.a, 5.c, 6.4, 6.5, 16.7

## Matrica e Vlerësimit të Performancës

Objektivat Strategjike	Treguesit e Përgjithshëm (bazuar në treguesit e SDG-së dhe OECD-së)	Viti bazë <sup>51</sup> 2017	Viti i ndërmjetëm 2019	Etapë afat mesme 2022		Viti i ndërmjetëm 2024	Etapa e Synuar 2027	Mënyrat e Verifikimit / Burimet	Treguesit SDG
<b>Sasia e Ujit:</b> Sigurohet përdorimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave, aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat transspozojnë	Rritet në mënyrë thelbësore efikasiteti i përdorimit të ujit në të gjithë sektorët dhe sigurohet thithje , riciklim dhe ri-përdorim i qëndrueshëm i tij <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshimi i përqindjes së efikasitetit të përdorimit të ujit me kohë;</li> <li>Përqindja e pasurisë ujore totale te disponueshme qe perdoret;</li> <li>Realizimi i barazisë gjinore ne lidhje me aksesin, kontrollin e pasurisë ujore</li> <li>Përqindjen e financimit të projekteve të MIPU që kanë tregues ndarë sipas gjinisë, moshës dhe vendndodhjes</li> <li>Përqindja dhe sasia për përdorues (persona, ushqim, energji, mjedis)</li> </ul>	40%	45%	50%	55%	60%		Raportet në kuadrin e sektorit të ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>6.1.1</li> <li>6.1.1</li> <li>15.6.1</li> <li>6.1.1</li> <li>6.1.1</li> </ul>
<b>Cilësia e Ujit:</b> Sigurohet cilësia e të gjitha burimeve ujore, duke arritur një gjendje të mirë deri në vitin 2027, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat transspozojnë;	Përmirësohet cilësia e ujit duke ulur ndotjen, duke eliminuar derdhjet, dhe duke zvogëluar hedhjen e materialeve dhe kimikateve të rrezikshme: <ul style="list-style-type: none"> <li>Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara plotësisht</li> <li>Përqindja e trupave ujorë me statusin e ujit me cilësi të mirë</li> </ul>	30%	35%	45%	60%	75%		Raportet e MTI Raportet e NEA	<ul style="list-style-type: none"> <li>6.3.1,</li> <li>6.3.2, 6.6.1, 14.1.1,</li> <li>14.2.1, 14.5.1, 15.1.2,</li> </ul>
<b>Rreziqet e Ujit:</b> Rreziqet nga uji (përmbytjet dhe thatësitrat) përmbahen përmes menaxhimit dhe investimeve, duke i shërbyer të gjitha interesave, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore të cilat transspozojnë.	Përforcohet rezistenca dhe kapaciteti për t'u përshtatur me rreziqet klimatike dhe katastrofat natyrore: <ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i jetëve të humbura (sipas grupit)</li> <li>Numri i planeve të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat dhe mbrojtja e integruar ndaj klimës së burimeve ujore të (monitorim i zbatimit sipas qëllimeve të politikave)</li> <li>Numri i qytetarëve me sëmundje me shkaktar ujin<sup>53</sup></li> </ul>	0	1 Kombëtar	1 për Basen (6 gjithsej)	Plan Kombëtar i Përditësuar	6 Plane të Përditësuara Baseni		Strategji/Plane Menaxhimi Katastrofash	<ul style="list-style-type: none"> <li>13.1.2</li> <li>13.2.1, 15.3.1</li> <li>3.9.2</li> </ul>
<b>Informacioni i Ujit:</b> Sigurohen të dhëna dhe	Zgjerohet njohuria e nevojshme shkencore, zhvillohet kapaciteti kërkues, hartohet dhe organizohet këshillimi							Programet buxhetore	

<sup>51</sup> Shifrat bazë të cilat janë direkt të lidhura me objektivat e Politikës, rezultatet që do të arrihen kanë nevojë të verifikohen gjatë studimeve të bazës fillestare.

<sup>52</sup> Gjëja e parë që përcaktohet: numri i përgjithshëm i Trupave Ujorë dhe statusit të tyre.

<sup>53</sup> Ne se është e mundur (ne rast se numri/përqindja e qytetarëve) treguesit mund të ndahen sipas gjinis, moshës dhe vendndodhjes.

Objektivat Strategjike	Treguesit e Përgjithshëm (bazuar në treguesit e SDG-së dhe OECD-së)	Viti bazë <sup>51</sup> 2017	Viti i ndërmjetëm 2019	Etapë afat mesme 2022	Viti i ndërmjetëm 2024	Etapa e Synuar 2027	Mënyrat e Verifikimit / Burimet	Treguesit SDG
modele të besueshme për ujin për politikat dhe klimën për të gjitha palët e interesit, dhe këshillimi i përshtatshëm për politikat bazuar në këto të dhëna dhe modele i ofrohet qeverisë;	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpërndahet buxhet për kërkime në menaxhimin e integruar (të burimeve) ujore</li> <li>Plotësohen të dhënat në Kadastrën e Ujit (dhe bëhen të disponueshme)</li> </ul>	Për t'u vendosur 10%		50%	80%	90%	përkatëse sipas institucionit Kadastra	<ul style="list-style-type: none"> <li>6.a.1, 12.8.1</li> <li>6.a.1</li> </ul>
<b>Menaxhimi i Ujit:</b> Uji menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i shërbyer të gjitha interesave. Sigurohen përfitime të barabarta ujore sociale dhe ekonomike dhe përfshirje në vendim marrje për burrat dhe gratë, sipas parimeve të politikave mjedisore ujore të MIBU dhe BE-së	Treguesit e sugjeruar <sup>54</sup> : <ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse</li> <li>Funksionimi i strukturave të financimit dhe rikuperimit të kostos</li> <li>Funksionimi i mekanizmave të bashkërendimit ndërinstitucional</li> <li>Funksionimi i mekanizmave për përfshirje e grupeve të interesit me orjentim për përfshirjen gjinore në konsultim gjatë procesit të vendim marrjes.(debat informues)</li> <li>Konsolidimi i përgjegjësive institucionale (p.sh. planifikimi, vlerësimet, shpërndarja, monitorimi, zbatimi)</li> <li>Përfaqësimi proporcional i grave dhe burave në organet vendim marrëse të ujit (KKU, këshillat e baseneve ujore dhe vendore) dhe në konsultimet me publikun për menaxhimin e ujit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal</li> </ul>	Tbd					Legjislacioni, Urdhra Ministrash, Vendime të KKU-së dhe akte nënligjore Vlerësimi i PMBU nga DKU Statistikat e INSTAT Anketime	<ul style="list-style-type: none"> <li>5.c.1</li> <li>6.4.1</li> <li>6.4.2</li> <li>16.7.2</li> <li>6.5.1, 6.5.2</li> <li>5.a.1, 5.5.2</li> </ul>

<sup>54</sup> Një kuadër praktik për treguesit e Qeverisjes së Ujit është i ndërlikuar, sepse OECD po punon ende për grupet e treguesve për Qeverisjen e Ujit; sugjerohet përcaktimi i vlerës së treguesve në anketime me intervista, siç është bërë për Raportin e Statusit për Aplikimin e Qasjeve të Integruara në Menaxhimin e Burimeve Ujore të OKB-së 2012, që përfshin gjithashtu anketimet e përdorura.

## 5.3 Objektivat e Politikave

### 5.3.1 Sasia e Ujit

#### Objektivi Strategjik: Sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, duke i shërbyer të gjitha interesave

Objektivat e Politikave	Rezultatet Kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rreziku	Supozimi
Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni (gjithashtu lidhur me cilësinë)	Vendimet përfundimtare për vendosjen e kufijve të Baseneve Ujore	KKU, Vendim Ministrie	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU	Vendimi ndalon punën në vijim e sipër	Kapaciteti i mjaftueshëm në Nivelin e Basenit Ujor
	Hartohen Planet për Menaxhimin e Integruar të Basenit Ujor dhe PM-të të cilat nënkuptojnë kritere të qarta dhe me përparësi për përdorimin e ujit bazuar në kushtet e burimit ujor në secilin basen	PMBU dhe PM	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU, ABU-të dhe KBU-të monitorimit.	Shumë herët për PMBU të plota të BE-ve të mungesës së njohurive ekologjike dhe të dhënave të monitorimit. Të vendoset shfuqizimi dhe të kërkohet pëlqimi i BE-së	Kapaciteti në nivel baseni mbështet hartimin e PMBU-ve dhe hartimin e udhëzimeve të zbatimit
Përcaktimi i masave të rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike (gjithashtu lidhur me cilësinë)	PM-të përpunohen me legjislacionin e BE-së për Ndryshimet Klimatike	Raporte të hartuara të brendshme ose të jashtme <sup>55</sup>	STKKU	Nuk ka akoma të dhëna specifike të disponueshme	Të dhëna specifike të mjaftueshme për ndryshimet klimatike në nivelin e basenit ujor
Përmirësimi i shpërndarjes së ujit (infrastruktura) dhe marrja e masave konservative për alokimin efikas dhe me barazi të ujit	Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujit Përdorimi i ujit në mënyrë më efektive Nis menaxhimi bazuar në kërkesën për ujë; Përdorimi i ujit (i jepet përparësi e lartë ujit të pijshëm) si prioritet	PMBU, Dokumentacioni, Raporte vjetore të brendshme të MBU	ABU-ja në bashkëpunim me STKKU-në, Prefekurat, autoritetet vendore	Kapacitete teknike, financiare apo njerëzore të pamjaftueshme në nivelin e basenit	Njihet mirë ekuilibri i ujit Vullneti për të bashkëpunuar në nivelin e basenit
Arritja e shpërndarjes së barabartë të përfitimeve	Investimeve u jepet përparësi bazuar në nevojat sociale dhe vlerësimet ekonomike Zbatimi i Projekteve në zonat e pa privileguara Prioritarizimi i Investimeve bazuar në vlerësimin e vullnetit për të paguar për F&M (ndare sipas gjinisë, moshës dhe vendodhjes)	Treguesit social – ekonomik të INSTAT PMBU Raportet e Planeve Sektoriale Studime Sociale Bazike (përfshirë gjininë)	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU, Ministritë e Linjës, OJQ-të, Prefekurat, autoritetet vendore	Përqendrim në infrastrukturë në vend të përdorimit të ujit Projektet e ujit nuk shihen me përparësi	Zhvillimi ekonomik është i lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore Bashkërendim dhe bashkëpunim i shëndoshë sektorial
Sigurimi i përfshirjes publike informimit dhe debatit (në kuadrin e Qeverisjes së Ujit)	Mekanizma duke përfshirë pjesëmarrje të barabartë gjinore në konsultimet me publikun dhe në proceset vendim-marrëse	Legjislacioni Këshillime Raportim	ABU-të, Prefekurat, bashkëpunim me	Këshillimi me palët e interesit si një kriter për t'u përmbushur; jo si përgatitje debatin për debat të informuar	Këshillimi me palët e interesit bazuar në informuar do të përmirësojë cilësinë dhe pranimin e masave në periudhën

<sup>55</sup> "E Brendshme" i referohet degëve të brendshme, shërbimeve, zyrave, etj. të institucioneve shtetërore përkatëse, mbi të cilat ka kontroll të drejtpërdrejtë. "E Jashtme" i referohet organizatave si OJQ, Institucione Financiare, Shoqatave të Profesionistëve, etj., mbi të cilat institucioni shtetëror nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë.

**Objektivi Strategjik: Sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, duke i shërbyer të gjitha interesave**

autoritetet vendore

afatgjatë.

**5.3.2 Cilësia e ujit****Objektiv strategjik: Sigurimi i cilësisë së mirë të ujrave të të gjitha burimeve ujore, duke arritur një status të mirë brenda vitit 2027**

Objektivat e politikave	Rezultatet kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rreziku	Supozimi
Përcaktimi i masave parandaluese ndaj ndryshimeve klimatike (gjithashtu lidhur me sasinë e ujit)	PM-të në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike	Raporte të brendshme ose të jashtme	STKKU	Nuk ka akoma të dhëna specifike të mjaftueshme	Të dhëna specifike për ndryshimet klimatike të mjaftueshme në nivelin e basenit ujqor
Përcaktimi i "gjendjes të ujit me cilësi të mirë" dhe caktimi i objektivave të përputhshmërisë për të gjithë trupat ujorë	Një dokument praktik (akt nënligjor) që përcakton Standardet Shqiptare të Cilësisë së Ujit	Aktet nënligjore përkatëse		Vendim i paqartë ose i vonuar	Metodologji dhe procese të qarta
Hartimi dhe zbatimi i PMBU-ve të DKU-së dhe Programeve të Masave (PM)	6 PMBU dhe 6 PM Zbatimi i masave	Zbatimi i Masave të PM-ve dhe PMBU-ve (në %)	MBZHRAU në bashkëpunim me STKKU-në, Prefekturat, ABU-të dhe KBU-të	Shumë herët për PMBU të plota sipas BE-së për shkak të mungesës së njohurisë ekologjike dhe të dhënave të monitorimit. Duhet të merret një vendim për shfuqizim. Duhet të kërkohet pëlqimi i BE-së	Kapacitete në nivelin e basenit për të mbështetur hartimin e PMBU-ve dhe udhëzimeve të zbatimit
Sigurimi i përfshirjes publike, informimit dhe debatit (në kuadër të Menaxhimit të Ujit)	Mekanizma duke përfshirë pjesëmarrje të barabartë gjinore në konsultimet me publikun dhe në proceset vendim-marrëse	Legjislacioni Këshillime	ABU-të, Prefekturat, në bashkëpunim me autoritetet vendore	Këshillimi me palët e interesit si një kriter për t'u përmbushur; jo thjesht si përgatitje për debat të informuar	Këshillimi me palët e interesit bazuar në debatin dhe informimin do të përmirësojë cilësinë dhe pranimin e masave për njëperiudhë afatgjatë

### 5.3.3 Rreziqet që vijnë nga uji

#### Objekti Strategjik: Ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësira) nëpërmjet menaxhimit dhe investimeve

Ojektivat e politikave	Rezultatet kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rreziqet	Supozimi
Menaxhim efikas kombëtar të katastrofave	Zbatimi i një plani efikas kombëtar për menaxhimin e katastrofave që pasqyron dhe i jep përparësi katastrofave dhe sëmundjeve të lidhura me ujin.	Hyrja në fuqi e planit kombëtar të menaxhimit të katastrofave	MPB në bashkëpunim me MBZHRAU, Prefekturat Institutet, autoritetet vendore	Përqëndrimi do të jetë në mbrojtjen civile dhe jo në qëllimet e BE-së për mbrojtje mjedisore	Menaxhimi i katastrofave duhet të integrohet në MIBU
Sigurimi i Mbrojtjes nga përmbytjet	Hartimi dhe zbatimi i planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet në përputhje me kërkesat e DP-së, duke përfshirë mekanizmin e angazhimit nëpërmjet komunikimit dhe me përfshirjen e burrave, grave, djemve dhe vajzave.	Raporte të brendshme ose të jashtme	MPB në bashkëpunim me MBZHRAU, Prefektura ABU-të dhe KBU-të	Përqëndrimi është vetëm tek përmbytjet. Investimet nuk janë të siguruara	Të dhëna të mjaftueshme specifike për përmbytjet në nivelin e basenit ujor
Përgatitja për thatësitat dhe mungesën e ujit	Hartimi dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Thatësirave në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë mekanizmin e angazhimit nëpërmjet komunikimit dhe me përfshirjen e burrave, grave, djemve dhe vajzave.	Raporte të brendshme ose të jashtme	MPB në bashkëpunim me MBZHRAU, Prefektura, ABU-të dhe KBU-të	Përqëndrimi është tek thatësitat; procesi i ngadaltë; nuk ka financime të siguruara	Të dhëna të mjaftueshme specifike në nivelin e basenit ujor
Siguri efektive dhe rezistente. Program masash efektive edhe rezistente në përputhje me ndryshimet klimatike (lidhur me sasinë dhe cilësinë)	Përputhja e Planeve të Menaxhimit në përputhje me legjislacionin e BE-së për Ndryshimet Klimatike	Raporte të brendshme ose të jashtme	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU	Nuk ka akoma të dhëna specifike të mjaftueshme specifike	Të dhëna të mjaftueshme specifike për ndryshimet klimatike në nivelin e basenit ujor



### 5.3.4 Informacioni për ujin

**Objektivi Strategjik: Sigurimi i modeleve dhe të dhënave të besueshme e të pranuarra gjerësisht për të gjitha grupet e interesit, si dhe sigurimi i këshillimit të qeverisë mbi politikatat e përshtatshme të bazuara në këto modele dhe institucioneve që i disponojnë këto të dhëna**

Objektivat e politikave	Rezultatet kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rreziku	Supozimi
Sigurimi i sistemeve të monitorimit të ujit	Harmonizimi i Planeve funksionale të monitorimit në përputhje me legjislacionin dhe përcaktimi ku, sa shpesh dhe çfarë do të monitorohet	Strategjia e Monitorimit/Planet e Monitorimit, Identifikimi i pikave të monitorimit, shpeshësia dhe treguesit	MBZHRAU në bashkëpunim me Institucionet e Ujit	Nuk ka të dhëna dhe njohuri bazë të mjaftueshme për hartimin e Planeve të Monitorimit	Vullneti për të shkëmbyer informacion
	Ngritja e rrjeteve të monitorimit të ujërave nëntokësore	Raporte standarde monitorimi	Bashkëpunim midis Institucioneve të Ujit	Bashkëpunim me kosto shumë të lartë, i ngadaltë ose inekzistent	Njohuri e mjaftueshme vendore për monitorimin e ujërave nëntokësore
	Rrjete monitorimi funksionale për cilesinë e ujrave të lumenjve	Raporte standarde monitorimi	Bashkëpunim midis Institucioneve të Ujit	Bashkëpunim me kosto shumë të lartë, i ngadaltë ose inekzistent	Stacione hidrologjike funksionale Njohuri e mjaftueshme vendore për monitorimin kimik dhe ekologjik
	Krijimi i rrjeteve të monitorimit të liqeneve/rezervuarëve	Raporte standarde monitorimi	Bashkëpunim midis Institucioneve të Ujit	Bashkëpunim me kosto shumë të lartë, i ngadaltë ose inekzistent	Njohuri e mjaftueshme vendore për monitorimin kimik dhe ekologjik
	Krijimi i rrjeteve të monitorimit në zonën kalimtare dhe bregdetare	Raporte standarde monitorimi	Bashkëpunim midis Institucioneve të Ujit	Bashkëpunim me kosto shumë të lartë, i ngadaltë ose inekzistent	Njohuri e mjaftueshme vendore për monitorimin kimik dhe ekologjik
Lehtësimi i sistemeve të kërkimit dhe krijimin e kapaciteteve për të zhvilluar njohurinë e nevojshme bazë për monitorimin, vlerësimin e burimeve ujore dhe formulimin dhe zbatimin e masave	Planifikimi dhe buxheti për përmirësimin e aftësive MIBU dhe duke përfshirë logjistikën ,dhe marrë në konsideratë mundësitë e barabarta për ngritjen e kapaciteteve për meshkuj dhe femra	Përmirësim i ndjeshëm i cilësisë së raportimit	Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Institucionet e Ujit, partnerët për zhvillim	Nevojiten disa vite	Kapacitete të mjaftueshme njerëzore në Universitete dhe Institucionet e Trajnimit; kanë kapacitete të përshtatshme për MIBU.
Përmirësimi i aksesit në informacion dhe mbledhjes së të dhënave	Ngritja e Laboratorëve të akredituar të analizave (ekologjike dhe kimike) për testime të cilësisë së ujit	Raporte Akreditimi	MM në bashkëpunim me MSH, MBZHRAU, MTI, MPB	Kosto shumë e lartë	Vullneti për përputhshmëri
	Bërja funksionale e Kadastrës së Ujit	Raportimi mbi Kadastrën	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU	Kosto shumë e lartë, nuk ka bashkëpunim	Vullneti për të shkëmbyer informacion
Ngritja e një Strukture Organizative (koordinuese) të Ujit dhe Klimës në kuadrin institucional ekzistues..	Bërja efikase e bashkëpunimit midis institucioneve kërkimore	MM për Krijimin e nje Institutit (Koordinues) të Ujit dhe Klimës	STKKU në bashkëpunim me Institutet e Ujit	Nuk ka vullnet për kombinim kapacitetesh dhe financash	Vullneti për të bashkëpunuar

### 5.3.5 Menaxhimi i ujit

#### Objektivi Strategjik: Menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i shërbyer të gjitha interesave

Objektivat e politikave	Rezultatet kryesore	Verifikimi	Aktorët	Rreziku	Supozimi
Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të qarta për MIBU	Konsolidimi i përgjegjësi institucionale <sup>56</sup> (p.sh. planifikimi, shpërndarja, monitorimi, zbatimi dhe aplikimi).	Legjislacioni, Urdhrat e Ministrorë, vendimet e KKU-së dhe aktet nënligjore	Qeveria e Shqipërisë	Përqendrim në Reformën Institucionale në vend të zbatimit të MIBU	Vullneti për të rënë dakord për ndarjen e qartë të roleve dhe zbatimi
Arritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE-së për ujin dhe mjedisin në lidhje me parandalimin, subvencionimin, proporcionalitetin dhe solidaritetin që duhet të njihen mirë dhe të zbatohen	Përpunimi i Udhëzimeve të trajnimit dhe raporteve Kryerja e vlerësimeve mbi zbatimin e parimeve	PMBU-të, auditime, raporte të jashtme	STKKU në bashkëpunim me MBZHRAU, MM, Prefekurat, ABU-të dhe KBU-të	Shumë herët, dhe shumë përpjekje për këtë sfidë	Vullneti për të arritur përputhshmëri afat-gjatë me parimet mjedisore të BE-së
